

**Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të
Etikes për Profesionistët Kontabël®**

**Manuali i
Kodit Ndërkombëtar të Etikës për
Profesionistët Kontabël**

**përfshirë
Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë**

Botimi 2023

Fondacioni Ndërkombëtar për Etikën dhe Auditimin (IFEA), Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Profesionistët Kontabël® (IESBA®) dhe Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve ® (IFAC®) nuk mbajnë përgjegjësi për humbjen që mund t'i shkaktohet ndonjë personi, i cili vepron ose nuk vepron në pajtim me materialin që përmban ky publikim, pavarësisht nëse kjo humbje shkaktohet nga neglizhenca apo arsye të tjera.

Kodi Ndërkombëtar i Etikës për Profesionistët Kontabël™ (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë™) Projekt Paraqitjet, Dokumentet për Konsultim dhe publikime të tjera të IESBA® (BSNEK) janë publikuar nga dhe janë pronë e IFAC.

“Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël”, “Kodi Ndërkombëtar i Etikës për Profesionistët Kontabël” (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë™), “, “IESBA”, dhe logo e IESBA, janë marka tregtare të IFAC ose marka tregtare të regjistruara dhe marka shërbimi të IFAC në SHBA dhe vende të tjera. Fondacioni Ndërkombëtar për Etikën dhe Auditimin dhe IFEA janë marka tregtare të IFEA-s , ose marka tregtare të regjistruara dhe marka të shërbimit të IFEA-s në SHBA dhe vende të tjera.

Të drejtat e autorit © Shtator 2023 i përkasin Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të shkarkohet për përdorim personal ose të blihet nga faqja e internetit e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël® (IESBA®): www.ethicsboard.org. Miratimi me shkrim nga IFAC kërkohet për të riprodhuar, ruajtur, shpërndarë, apo për përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti, dokumenti i ruajtur të duhet përdoret vetëm për përdorim individual dhe jo tregtar.

Proceset që mbështesin operacionet e IESBA lehtësohen nga IFAC.

Për të drejtat e autorit, markat tregtare dhe informacionet e lejeve, ju lutemi të shkoni tek lejet ose të kontaktoni permissions@ifac.org.

IESBA

**Bordi i Standardeve
Ndërkombëtare për Etikën për
Profesionistët Kontabël**

529 Fifth Avenue
New York, New York 10017 USA

www.ethicsboard.org
ISBN: 978-1-60815-547-7

**MANUALI I KODIT NDËRKOMBËTAR TË ETIKËS
PËR PROFESIONISTËT KONTABËL (PËRFSHIRË
STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË
PAVARËSISË)**

BOTIMI 2023

Si është organizuar ky manual

Përmbajtjet e këtij Manuali janë organizuar sipas seksioneve të mëposhtme:

Prezantim i Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët kontabël	5
Rreth Fondacionit Ndërkombëtar për Etikën dhe Auditimin	6
Roli i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve.	7
Objekti i këtij Manuali	8
Ndryshimet në Përmbajtje nga Botimi 2022	9
Udhëzuesi për Kodin	12
Tabela e Përmbajtjeve	17
Parathënie	21
Pjesa 1 – Pajtueshmëria me Kodin, Parimet Themelore dhe Kuadri Konceptual	23
Pjesa 2 – Profesionistët Kontabël të Punësuar (në Biznes)	45
Pjesa 3 – Profesionistët Kontabël në Praktikën Publike	88
Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë (Pjesa 4A dhe 4B)	143
Pjesa 4A – Pavarësia për Angazhimet e Auditimit dhe Rishikimit	145
Pjesa 4B – Pavarësia për Angazhimet e Sigurisë që ndryshojnë nga Angazhimet e Auditimit dhe Rishikimit	277
Fjalori i Termave, Përfshirë Listën e Shkurtimeve	323
Hyrja në Fuqi	341
Ndryshimet në Kod	

E drejta e Autorit dhe Përkthimi

IFAC boton manualët, standardet dhe dokumentet e tjera të IESBA-s dhe zotëron të drejtat e autorit.

IFAC pranon se është e rëndësishme që përgatitësit dhe përdoruesit e pasqyrave financiare, audituesit dhe profesionistët e tjerë kontabilistë, rregullatorët, hartuesit e standardeve kombëtare, organizmat anëtare të IFAC, avokatët, akademikët, studentët dhe grupe të tjera të interesuara në vendet jo anglisht-folëse të kenë akses në standardet në gjuhën e tyre amtare. Prandaj, IFAC inkurajon dhe lehtëson riprodhimin, ose përkthimin dhe riprodhimin, të botimeve të tij.

Politika e IFAC-it në lidhje me përkthimin dhe riprodhimin e dokumenteve për të cilat ka të drejtat e autorit është përshkruar në Politikën për Përkthimin dhe Riprodhimin e Standardeve të publikuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve dhe Politikën për Riprodhimin, ose përkthimin dhe riprodhimin e Publikimeve të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve. Të interesuarit që dëshirojnë të riprodhojnë, ose përkthejnë dhe riprodhojnë, këtë manual duhet të kontaktojnë permissions@ifac.org për kushtet dhe termat përkatëse.

PREZANTIMI I BORDIT TË STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË ETIKËS PËR PROFESIONISTËT KONTABËL®

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Profesionistët Kontabël® (IESBA®) është një Bord global i pavarur i hartimit të standardeve. IESBA i shërben interesit publik duke hartuar standarde ndërkombëtare të cilësisë së lartë të etikës (duke përfshirë pavarësinë) si një gur themeli për sjelljen etike në biznes dhe organizata, dhe për besimin e publikut në informacionin financiar dhe jo financiar, i cili është themelor për funksionimin dhe qëndrueshmërinë e duhur të organizatave, tregjeve financiare dhe ekonomive në mbarë botën. Standardet e IESBA-s janë përfshirë në Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi).

IESBA zhvillon dhe publikon standardet e saj në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me një proces të rregullt të miratuar dhe Kuadrin për Interesin Publik, të mbikëqyrur nga Bordi i Mbikëqyrjes me Interes Publik. Mbledhjet e bordit janë të hapura për publikun dhe materialet e rendit të ditës janë në dispozicion në faqen e internetit të IESBA.

Për më shumë informacion mund të vizitoni www.ethicsboard.org.

RRETH FONDACIONIT NDËRKOMBËTAR PËR ETIKËN DHE AUDITIMIN

Fondacioni Ndërkombëtar për Etikën dhe Auditim (IFEA ose Fondacioni) është një organizatë jofitimprurëse që mbështet hartimin e standardeve ndërkombëtare të cilësisë së lartë për etikën, auditimin dhe sigurinë në interes të publikut. Fondacioni e përmbush misionin e tij nëpërmjet dy bordeve të hartimit të standardeve, Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë dhe Bordit të Standardeve Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistet Kontabël.

Fondacioni përfaqëson zbatimin e një rekomandimi kyç të parashikuar në Rekomandimet e Grupit të Monitorimit të muajit Korrik 2020, Forcimi i Sistemit të hartimit të Standardeve Ndërkombëtar të Auditimit dhe Etikës.

Misioni i Fondacionit është të mbështesë zhvillimin e standardeve ndërkombëtare të cilësisë së lartë në etikë, auditim dhe siguri, nëpërmjet:

- Garantimit të një procesi të pavarur, me ekspertizë teknike, dhe rigoroz të hartimit të standardeve për etikën, auditimin dhe sigurinë;
- Mbështetjes së interesit publik gjatë gjithë procesit të hartimit të standardeve për etikën, auditimin dhe sigurinë
- Përdorimit të IAASB dhe IESBA, për të kryer kërkime për të mbështetur zhvillimin, adoptimin dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe për të ndihmuar në edukimin dhe informimin e palëve të interesuara.

Standardet ndërkombëtare transparente dhe me cilësi të lartë janë shtyllat thelbësore të arkitekturës globale të raportimit të jashtëm. Miratimi dhe zbatimi i tyre përmirësojnë disponimin e informacionit financiar dhe jo financiar të një cilësie të lartë për palët e interesuara, investitorët dhe publikun që mbështet besimin dhe konfidencën në raportimin e jashtëm dhe sigurinë dhe, një rritje më të madhe ekonomike.

Për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit të Fondacionit në www.ethicsandaudit.org

ROLI I FEDERATËS NDËRKOMBËTARE TË KONTABILISTËVE

Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve® (IFAC®) është organizata globale profesionit kontabël. Ajo i shërben interesit publik duke punuar me organizmat e saj anëtare për të përgatitur profesionistë kontabël të aftë, të ditur dhe etikë në mbarë botën; duke kontribuar në zhvillimin e organizatave të qëndrueshme të sektorit privat dhe publik; dhe duke mbështetur tregjet financiare ndërkombëtare dhe ekonomitë e forta.

Anëtarësia e IFAC përfshin më shumë se 180 organizata profesionale të kontabilistëve në mbi 135 juridiksione, të cilët përfaqësojnë më shumë se 3 milionë profesionistë kontabël në praktikën publike, industri, sektorin qeveritar dhe edukim.

Si pjesë e mandatit të tij me interes publik, IFAC kontribuon në zhvillimin, miratimin, dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare të cilësisë së lartë dhe lehtëson proceset që mbështesin operacionet e IESBA.

Për informacione të mëtejshme vizitoni faqen e internetit të IFAC në www.ifac.org.

OBJEKTI I KËTIJ MANUALI

BOTIMI 2023

Ky manual sjell së bashku për referencë në vazhdimësi, informacionet rreth Fondacionit, rolit të IFAC-ut dhe tekstin zyrtar të Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi) të publikuar nga IESBA

Manuali i Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (Përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) i publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në gjuhën angleze në vitin 2023 është përkthyer në gjuhën shqipe nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA) në bashkëpunim me Shoqatën e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) në vitin 2024 dhe është riprodhuar me lejen e IFAC. (IFAC) ka ribotuar tekstin në vitin 2023 duke sjellë ndryshime në Kod. Këto ndryshime janë përkthyer në gjuhën shqipe nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA)) në bashkëpunim me Shoqatën e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) në vitin 2022. Procesi i përkthimit të Manuali i Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (Përfshirë Standardet Ndërkombëtare) është marrë në konsideratë nga IFAC dhe përkthimi është bërë në përputhje me “Deklaratën e Politikave – Politikat për Përkthimin e Publikimeve të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC).” Teksti i aprovuar i Manuali i Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (Përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) është teksti që IFAC ka publikuar në gjuhën angleze. IFAC nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e përkthimit ose për veprimet që mund të rrjedhin prej tyre.

Teksti në gjuhën angleze i Manuali i Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (Përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) © 2023 nga IFAC. Të gjithatë drejtat janë të rezervuara.

Teksti në gjuhën shqipe i Manuali i Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (Përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) © 2023 nga IFAC. Të gjithatë drejtat janë të rezervuara.

Titulli original: Handbook of the International Code of Ethics for Professional Accountants (including International Independence Standards), numri ISBN: 978-1-60815-464-7

Kontaktoni adresën Permissions@ifac.org për marrjen e lejes për të riprodhuar, ruajtur, shpërndarë, apo për përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti

NDRYSHIMET NË PËRMBAJTJE NGA BOTIMI 2022

(KODI)

Ky manual zëvendëson botimin e vitit 2022 të *Manualit të Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë)* dhe përfshin rishikimet që jepen në vijim, të cilat hyjnë në fuqi në Dhjetor 2023:

- Rishikimet që kanë të bëjnë me përkufizimin e grupit (ekipit) të angazhimit dhe auditimet e grupit. Rishikimet kanë të bëjnë me pavarësinë dhe ndikime të tjera të ndryshimeve të bëra në Kod për përkufizimin e “grupit të angazhimit”, për t’u përputhur me ndryshimet që i janë bërë të njëjtit term në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të (SNA-të) dhe Standardet Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë (SNMC-të) të BSNAS-së. Rishikimet trajtojnë gjithashtu në mënyrë të plotë konsideratat e ndryshme të pavarësisë në një auditim të pasqyrave financiare të grupit.

Dispozitat e rishikuara që kanë të bëjnë me përkufizimin e grupit të angazhimit dhe auditimeve të grupit do të hyjnë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare dhe auditimet e pasqyrave financiare të grupeve si më poshtë:

- Ndryshimet në seksionin 400 lidhur me rishikimin e përkufizimit të termit grup i angazhimit dhe dispozitat e reja në seksionin 405 lidhur me auditimet e grupit do të hyjnë në fuqi për auditimet dhe rishikimet e pasqyrave financiare dhe auditimeve të pasqyrave financiare të grupit për periudhat që fillojnë me datën 15 dhjetor 2023 ose pas kësaj date.
- Ndryshimet e mëposhtme konformuese dhe pasuese do të hyjnë në fuqi që nga data 15 dhjetor 2023:
 - Ndryshimet konformuese në Seksionin 360 për t’u përputhur me terminologjinë në SNA 600 (i Rishikuar).
 - Ndryshimet konformuese në dispozitat e rishikuara të shërbimeve të jo -sigurisë në Seksionin 400.
 - Ndryshimet konformuese në Seksionet 300, 310, 320, 400, 510, 605 dhe 900 që rezultojnë nga rishikimet në përkufizimin e termit Grupi i angazhimit.
 - Ndryshimet që pasojnë standardet për menaxhimin e cilësisë në Seksionet 540, 800, 940 dhe 990.
- Ndryshimet në Fjalorin e termave hyjnë në fuqi:
 - Për auditimet dhe rishikimet e pasqyrave financiare dhe auditimet e

pasqyrave financiare të grupit për pasqyrat financiare të periudhave që kanë filluar me ose pas datës 15 dhjetor 2023.

- Për angazhimet e sigurisë, që janë të ndryshme nga angazhimet e auditimit dhe rishikimit, në lidhje me çështjet në shqyrtim që mbulojnë periudhat kanë filluar me ose pas datën 15 dhjetor 2023, ose përndryshe të datës 15 Dhjetor 2023

Miratimi më i hershëm është i lejuar.

Ndryshimet u publikuan në faqen e internetit të IESBA në shkurt 2023.

Skadimi i ardhshëm i “Dispozitës juridiksionale” që trajton lidhjen e gjatë të personelit me një klient auditimi

- Paragrafi R540.20 që trajton lidhjen e gjatë të personelit me një klient të auditimit ("dispozita e juridiksionit") nuk do të jetë më në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë me datën 15 dhjetor 2023 ose pas kësaj date. Sipas dispozitës juridiksionale, kur një organ legjislativ ose rregullator (ose një organizatë e autorizuar ose e njohur nga një organ i tillë legjislativ ose rregullator) ka përcaktuar një periudhë qetësie (ndërprerje) për një partner angazhimi prej më pak se pesë vitesh pasuese, atëherë mund të zbatohet periudha më e shkurtër e ndërprerjes, subjekt i një kufiri prej tre vite, me kusht që periudha kohore e zbatueshme të mos kalojë shtatë vjet.

Ndryshimet e miratuara që nuk kanë hyrë në fuqi

Botimi i vitit 2023 i manualit përmban:

- Përkufizimin e rishikuar të termit entitet me interes publik (EIP) i cili, ndër të tjera, specifikon një listë më të gjerë të kategorive EIP, duke përfshirë një kategori të re “entitet i tregtuar publikisht” për të zëvendësuar kategorinë e “entitetit të listuar”.

Përkufizimi i rishikuar i EIP-ve dhe dispozitat e lidhura me to do të hyjnë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë nga data 15 dhjetor 2024 ose pas kësaj date. Lejohet adoptimi me herët.

Ndryshimet u publikuan në faqen e internetit të IESBA në Prill 2022.

- Ndryshimet në përkufizimin e termit “klient i auditimit” dhe “klient i auditimit – grup” në Fjalorin e termave, të cilat rrjedhin nga rishikimet e miratuara të përkufizimeve të entitetit të listuar dhe entitetit me interes publik do të hyjnë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare dhe të pasqyrave financiare të grupit për periudhat që fillojnë me ose pas datës 15 dhjetor 2024.

- Rishikimet në Kod të lidhura me teknologjinë

Rishikimet që lidhen me teknologjinë në pjesët 1 deri në 3 do të hyjnë në fuqi nga data 15 dhjetor 2024.

Rishikimet lidhur me teknologjinë në pjesën 4A do të hyjnë në fuqi për auditimet dhe rishikimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë me ose pas datës 15 dhjetor 2024.

Ndryshimet konformuese dhe pasuese që lidhen me teknologjinë në pjesën 4B në lidhje me angazhimet e sigurisë për çështje në shqyrtim që mbulojnë periudha kohore, do të jenë efektive për periudhat që fillojnë me ose pas datës 15 dhjetor 2024, përndryshe, këto ndryshime do të jenë efektive që nga 15 dhjetori 2024

Miratimi më i hershëm është i lejuar.

Ndryshimet u publikuan në faqen e internetit të IESBA në Prill 2023.

Ndryshimet që do të hyjnë në fuqi në vitin 2024 do të pasqyrohen në EIS në vitin 2024.

Ndryshimet në Kod të publikuara pas prillit 2023 dhe projekt paraqitjet

Për informacione mbi zhvillimet e fundit dhe për të marrë prononcimet përfundimtare të publikuara pas prillit 2023 ose projekt paraqitjet në proces, vizitoni faqen e internetit të IESBA-s në www.ethicsboard.org.

UDHËZUES PËR KODIN

(Ky Udhëzues është një ndihmë jodetyruese për përdorimin e Kodit.)

Qëllimi i Kodit

1. *Kodi Ndërkombëtar i Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë)* (“Kodi”) përcakton parimet themelore të etikës për profesionistët kontabël, duke reflektuar pranimin që profesioni i bën përgjegjësisë së tij me interes publik. Këto parime përcaktojnë standardet e sjelljes që pritet të zbatohen nga një profesionist kontabël. Parimet themelore janë: integriteti, objektiviteti, kompetenca profesionale dhe kujdesi, konfidencialiteti dhe sjellja profesionale.
2. Kodi siguron një kuadër konceptual që duhet të zbatojnë profesionistët kontabël për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore. Kodi përcakton kërkesat dhe materialin për zbatim për çështje të ndryshme që ndihmojnë profesionistët kontabël të zbatojnë kuadrin konceptual për këto çështje.
3. Në rastin e angazhimeve të auditimeve, rishikimeve dhe angazhimeve të tjera të sigurisë, Kodi përcakton Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë, që vendosen nga zbatimi i kuadrit konceptual për kërcënimet ndaj pavarësisë në lidhje me këto angazhimeve.

Si është strukturuar Kodi

4. Kodi përmban materialet si më poshtë:
 - Pjesa 1 - *Pajtueshmëria me Kodin, Parimet Themelore dhe Kuadri Konceptual*, e cila përfshin parimet themelore dhe kuadrin konceptual dhe është i zbatueshëm për të gjithë profesionistët kontabël.
 - Pjesa 2 – *Profesionist Kontabël në Biznes*, e cila përfshin material shtesë që zbatohet nga profesionistët kontabël në biznes, kur ata kryejnë aktivitete profesionale. Profesionistët kontabël në biznes përfshijnë profesionistët kontabël të punësuar, të angazhuar ose të kontraktuar në një kapacitet ekzekutiv ose jo ekzekutiv, për shembull në:
 - Tregti, industri ose shërbim.
 - Sektorin publik.
 - Edukim.
 - Sektorin jofitimprurës.
 - Organizmat rregullatore ose profesionale.
 - Pjesa 2 është gjithashtu, e zbatueshme për individët të cilët janë profesionistë kontabël në praktikën publike, kur kryejnë

	veprimtari profesionale që lidhen me marrëdhëniet e tyre me firmën, qoftë kjo si njëi kontraktuar, i punësuar ose pronar. • Pjesa 3 – <i>Profesionistët Kontabël në Praktikën Publike</i>, e cila përmban material shtesë që zbatohet për profesionistët kontabël në praktikën publike kur ata japin shërbime profesionale. • <i>Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë</i>, e cila përmban materiale shtesë që zbatohen nga profesionistët kontabël në praktikën publike kur japin shërbime të sigurisë, si më poshtë: ○ Pjesa 4A - <i>Pavarësia për Angazhimet e Auditimit dhe të Rishikimit</i>, e cila zbatohet kur kryhen angazhime të auditimit ose të rishikimit. ○ Pjesa 4B - <i>Pavarësia për Angazhimet e Sigurisë të Ndryshme nga Angazhimet e Auditimit dhe të Rishikimit</i>, e cila zbatohet kur kryhen angazhime të sigurisë që ndryshojnë nga angazhime të auditimit ose të rishikimit. • <i>Fjalori i termave</i>, i cili përmban përkufizimet e termave (së bashku me shpjegimet shtesë kur kjo është e nevojshme) dhe përshkrimin e termave të cilat kanë kuptime specifike në disa pjesë të Kodit. Për shembull, siç theksohet në Fjalorin e Termave, në Pjesën 4A, termi ‘angazhim auditimi’ zbatohet në mënyrë të njëjtë për angazhimet e auditimit dhe të rishikimit. Fjalori i termave përfshin gjithashtu lista të shkurtimeve që janë përdorur në Kod dhe në standardet e tjera të cilave ju referohet Kodi.
5.	Kodi përmban seksione, të cilat adresojnë çështje specifike. Disa seksione përmbajnë nën seksione që kanë të bëjnë me aspekte të veçanta të këtyre çështjeve. Çdo seksion i Kodit është strukturuar, aty ku është e përshtatshme, si më poshtë: • Hyrja – përcakton çështjet në shqyrtim që adresohen brenda seksionit dhe paraqet kërkesat dhe materialin për zbatim në kontekstin e kuadrit konceptual. Materiali hyrës përmban informacione, përfshirë një shpjegim të termave të përdorur, i cili është i rëndësishëm për të kuptuar dhe zbatuar çdo Pjesë dhe seksion të tij. • Kërkesat – përcaktojnë detyrimet e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me çështjen në shqyrtim të adresuar. • Materiali për zbatim – jep kontekstin, shpjegimet, sugjerimet për veprime ose çështje për t’u konsideruar, ilustrime dhe udhëzime të tjera që ndihmojnë për të qenë në pajtueshmëri me kërkesat.
Si të përdorim Kodin	
<i>Parimet Themelore, Pavarësia dhe Kuadri Konceptual</i>	
6.	Kodi kërkon që profesionistët kontabël të jenë në pajtim me parimet themelore të etikës. Kodi kërkon gjithashtu, që ata të zbatojnë kuadrin konceptual për të

	identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj parimeve themelore. Zbatimi i kuadrit konceptual kërkon ushtrimin e gjykimit profesional, të qenurit vigjilent për informacione të reja dhe për ndryshime të fakteve e rrethanave, dhe përdorimin e testit të palëve të treta të arsyeshme dhe të besueshme.
7.	Kuadri Konceptual pranon se ekzistenca e kushteve, politikave dhe procedurave të vendosura nga profesioni, ligjet, rregullat, firma, ose organizata punëdhënëse mund të kenë ndikim në identifikimin e kërcënimeve. Këto kushte, politikadhe procedura mund të jenë gjithashtu një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e profesionistit kontabël nëse një kërcënim është në një nivel të pranueshëm. Kur kërcënimet nuk janë në një nivel të pranueshëm, kuadri konceptual kërkon që profesionisti kontabël t'i adresojë këto kërcënime. Zbatimi i masave mbrojtëse është një mënyrë për të adresuar kërcënimet. Masat mbrojtëse janë veprime individuale ose të kombinuara që profesionisti kontabël ndërmerr, të cilat në mënyrë efektive zvogëlojnë kërcënimet deri në një nivel të pranueshëm.
8.	Përveç kësaj, Kodi kërkon që profesionistët kontabël të jenë të pavarur kur ata kryejnë angazhime të auditimit, rishikimit dhe angazhime të tjera të sigurisë. Kuadri konceptual zbatohet në të njëjtën mënyrë për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë sikurse veprohet edhe për kërcënimet ndaj parimeve themelore.
9.	Pajtueshmëria me Kodin kërkon njohjen, kuptimin dhe zbatimin e: • Të gjitha dispozitave përkatëse të një seksioni të veçantë në kontekstin e Pjesës 1, së bashku me materialin shtesë që jepet në Seksionet 200, 300, 400 dhe 900, që janë të zbatueshme. • Të gjitha dispozitave përkatëse të një seksioni të veçantë, për shembull, zbatimi i dispozitave që jepen në nën zërin e titulluar “Të përgjithshme” dhe “Të Gjithë Klientët e Auditimit” së bashku me dispozitat shtesë, përfshirë ato që jepen në nën zërin “Klientët e Auditimit që nuk janë Entitete me Interes Publik” ose “Klientët e Auditimit që janë Entitete me Interes Publik.” • Të gjitha dispozitat përkatëse të dhëna në një seksion të veçantë së bashku me dispozitat shtesë të dhëna në ndonjë nën seksion përkatës.
<i>Kërkesat dhe materiali për zbatim</i>	
10.	Kërkesat dhe materiali për zbatim duhet të lexohen dhe zbatohen me objektiv pajtueshmërinë me parimet themelore, zbatimin e kuadrit konceptual, dhe të qenurit i pavarur, kur kryhet një angazhim auditimi, rishikimi dhe një angazhimtjetër i sigurisë

Kërkesat	
11.	Kërkesat janë shprehur me shkronjën “K” dhe, në shumicën e rasteve, përfshijnë fjalën “do të”. Fjala “do të” në Kod imponon një detyrim që një profesionist kontabël ose një firmë duhet të përmbushë (respektojë) dispozitat specifike në të cilat fjala “do të” është përdorur.
12.	Në disa situata, Kodi bën një përjashtim specifik ndaj një kërkesë. Në një situatë të tillë, dispozita është paraqitur me shkronjën “K”, por përdor fjalën “mund” ose një formulim të kushtëzuar.
13.	Kur në Kod është përdorur fjala “mund”, kjo nënkupton lejen për të kryer një veprim të veçantë në disa rrethana, përfshirë si përjashtim ndaj një kërkesë. Ajo nuk përdoret për të treguar mundësi.
14.	Kur në Kod është përdorur fjala “mundet”, kjo nënkupton mundësinë e lindjes së një çështjeje, të ndodhjes së një ngjarjeje ose një kurs veprimi që po ndërmerret. Termi nuk përcakton ndonjë nivel të posaçëm të mundësisë apo gjasë kur përdoret së bashku me një kërcënim, pasi vlerësimi i nivelit të një kërcënimi varet nga faktet dhe rrethanat e secilës çështjeje, ngjarje apo kursi veprimi të veçantë.
Materiali për zbatim	
15.	Përveç kërkesave, Kodi përmban materialin për zbatim, i cili jep kontekstin përkatës për një kuptim të duhur të Kodit. Në veçanti, materiali për zbatim synon të ndihmojë një profesionist kontabël për të kuptuar mënyrën si të zbatojë kuadrin konceptual në një grup të caktuar rrethanash dhe për të kuptuar e për të përmbushur një kërkesë specifike. Megjithatë një material i tillë për zbatim nuk përbën në vetvete një kërkesë, shqyrtimi i materialit është i nevojshëm për zbatimin e duhur të kërkesave të Kodit, duke përfshirë zbatimin e kuadrit konceptual. Materiali për zbatim është shprehur me shkronjën “A”.
16.	Kur materiali për zbatim përfshin listë me shembuj, këto lista nuk parashikohet të jenë gjithëpërfshirëse.
Shtojcë me udhëzime për Kodin	
17.	Shtojca e këtij Udhëzuesi bën një paraqitje të përgjithshme të Kodit.

PJESA 1 PAJTUESHMËRIA ME KODIN, PARIMET THEMELORE DHE KUADRI KONCEPTUAL (TË GJITHË PROFESIONISTËT KONTABËL - SEKSIONET 100 DERI NË 199)	
PJESA 2 PROFESIONISTËT KONTABËL NË PRAKTIKËN PUBLIKE (SEKSIONET 200 DERI NË 299) (PJESA 2 ËSHTË GJITHASHTU E ZBATUESHME PËR PROFESIONISTËT KONTABËL NË PRAKTIKËN PUBLIKE KUR KRYEJNË VEPRIMTARI PROFESIONALE QË LIDHEN ME MARRËDHENIET E TYRE ME FIRMËN)	PJESA 3 PROFESIONISTËT KONTABËL NË PRAKTIKËN PUBLIKE (SEKSIONET 300 DERI NË 399)
	STANDARDET NËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË (PJESA 4A DHE 4B) PJESA 4A – PAVARËSIA PËR ANGAZHIMET E AUDITIMIT DHE TË RISHIKIMIT (SEKSIONET 400 DERI NË 899) PJESA 4B – PAVARËSIA PËR ANGAZHIMET E SIGURISË TË NDRYSHME NGA ANGAZHIMET E AUDITIMIT DHE TË RISHIKIMIT (SEKSIONET 900 DERI NË 999)
FJALORI I TERMAVE (TË GJITHË PROFESIONISTËT KONTABËL)	

**MANUALI I KODIT NDËRKOMBËTAR TË ETIKËSPËR
PROFESIONISTËT KONTABËL
(përfshirë STANDARDET NDËKOMBËTARE TË PAVARËSISË)**

TABELA E PËRMBAJTJES	Faqe
PARATHËNIE	21
PJESA 1 - PAJTUESHMËRIA ME KODIN, PARIMET THEMELORE DHE KUADRI KONCEPTUAL	22
100 Pajtueshmëria me Kodin	23
110 Parimet themelore	26
111 - Integriteti	27
112 - Objektiviteti	28
113 - Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur	28
114 - Konfidencialiteti	29
115 - Sjellja profesionale	31
120 Kuadri Konceptual	33
PJESA 2 – PROFESIONISTËT KONTABËL TË PUNËSUAR	44
200 Zbatimi i kuadrit konceptual - profesionistët kontabël të punësuar	45
210 Konfliktet e interesit	50
220 Përgatitja dhe paraqitja e informacionit	53
230 Kryerja e detyrës me ekspertizën e nevojshme	58
240 Interesat financiare, kompensimi dhe nxitjet që lidhen me raportimin financiar dhe vendimmarrjen	60
250 Nxitjet, përfshirë dhuratat dhe mikpritjen	62
260 Reagimi ndaj papajtueshmërisë me ligjet dhe rregullat	69
270 Presioni për shkeljen e parimeve themelore	81
PJESA 3 – PROFESIONISTËT KONTABËL NË PRAKTIKËN PUBLIKE	85
300 Zbatimi i kuadrit konceptual - profesionistët kontabël në praktikën publike	86

310	Konfliktet e interesit	93
320	Emërimet Profesionale	100
321	Opinionet dytësore	105
325	Objektiviteti i një rishikuesi të cilësisë së angazhimit dhe i rishikuesve të tjerë të përshtatshëm	107
330	Honoraret dhe format e tjera të pagesave	110
340	Nxitjet, përfshirë dhuratat dhe mikpritjen	113
350	Marrja në ruajtje (në kujdestari) e aktiveve të klientit	120
360	Reagimi ndaj papajtueshmërisë me ligjet dhe rregullat	122

STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË (PJESA 4A DHE 4B) 139

PJESA 4A – PAVARËSIA – ANGAZHIMET E AUDITIMIT DHE TË RISHIKIMIT 141

400	Zbatimi i kuadrit konceptual për pavarësinë për angazhime të auditimit dhe të rishikimit	141
405	Auditimet e grupit	160
410	Honoraret	171
411	Politika e vlerësimit dhe kompensimi	187
420	Dhuratat dhe mikpritja	189
430	Paditë gjyqësore aktuale ose të kërcënuara	190
510	Interesat financiare	192
511	Huatë dhe garancitë	198
520	Marrëdhëniet e biznesit	200
521	Marrëdhëniet familjare dhe personale	202
522	Shërbimet e kohëve të fundit me një klient të auditimit	206
523	Shërbimi si drejtorit ose zyrtar i një klienti të auditimit	208
524	Punësimi tek një klient i auditimit	210
525	Caktimet e përkohshme të personelit	214
540	Lidhja e gjatë e personelit (përfshirë rotacionin e ortakut) me një klient të auditimit	216

600	Dhënia e shërbimeve të jo sigurisë për një klient të auditimit	223
601	Shërbimet kontabël dhe të mbajtjes së kontabilitetit	234
602	Shërbimet administrative	237
603	Shërbimet e vlerësimit	238
604	Shërbimet tatimore	240
605	Shërbimet e auditimit të brendshëm	250
606	Shërbimet e sistemeve të teknologjisë së informacionit	254
607	Shërbimet e ndihmëse për proceset gjyqësore	256
608	Shërbimet ligjore	260
609	Shërbimet e rekrutimit	263
610	Shërbimet e financave të korporatës	265
800	Raportet mbi pasqyrat financiare për qëllime të veçanta që përfshijnë një kufizim në përdorim dhe në shpërndarje (angazhimet e auditimit dhe rishikimit)	268

PJESA 4B - PAVARËSIA PËR ANGAZHIMET E SIGURISË TË NDRYSHME NGA ANGAZHIMET E AUDITIMIT DHERISHIKIMIT	272
--	------------

900	Zbatimi i kuadrit konceptual të pavarësisë për angazhimet e sigurisë të ndryshme nga angazhimet e auditimit dhe rishikimit	273
905	Honoraret	283
906	Dhuratat dhe mikpritja	288
907	Paditë gjyqësore aktuale ose të paralajmëruara	289
910	Interesat financiare	290
911	Huatë dhe garancitë	293
920	Marrëdhëniet e biznesit	296
921	Marrëdhëniet familjare dhe personale	298
922	Shërbimet e kohëve të fundit me një klient të sigurisë	302
923	Shërbimi si drejtor ose zyrtar tek një klient i sigurisë	304
924	Punësimi tek një klient i sigurisë	306
940	Lidhja e gjatë e personelit me një klient të sigurisë	309
950	Kryerja e shërbimeve të jo sigurisë për klientët e sigurisë të ndryshëm	312

nga klientët e angazhimeve të auditimit dhe rishikimit

990	Raportet që përfshijnë një kufizim në përdorim dhe shpërndarje (angazhimet e sigurisë të ndryshme nga angazhimet e auditimit dhe rishikimit)	316
-----	--	-----

FJALORI I TERMAVE, PËRFSHIRË LISTËN E SHKURTIMEVE	319
--	------------

DATA E HYRJES NË FUQI	337
------------------------------	------------

NDRYSHIMET NE KOD	390
--------------------------	------------

PARATHËNIE

IESBA zhvillon dhe publikon nën autoritetin e tij Kodin *Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë)* (“Kodin”). Kodi është për përdorim nga profesionistët kontabël në mbarë botën. IESBA e publikon Kodin për zbatim ndërkombëtar duke ndjekur një proces të duhur.

Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) përcakton *kërkesa* të veçanta për organizmat e saj anëtare në lidhje me Kodin.

PJESA 1 - PAJTUESHMËRIA ME KODIN, PARIMET THEMELORE DHE KUADRI KONCEPTUAL

Seksioni 100 Pajtueshmëria me Kodin	24
Seksioni 110 Parimet Themelore	27
Nën seksioni 111– Integriteti	28
Nën seksioni 112– Objektiviteti	29
Nën seksioni 113 Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur	29
Nën seksioni 114– Konfidencialiteti	30
Nën seksioni 115– Sjellja profesionale	32
Seksioni 120 Kuadri Konceptual	34

PJESA 1 -PAJTUESHMËRIA ME KODIN, PARIMET THEMELORE DHE KUADRI KONCEPTUAL

SEKSIONI 100

PAJTUESHMERIA ME KODIN

Hyrje

100.1 Një shenjë që e dallon profesionin kontabël është pranimi prej tij i përgjegjësisë për të vepruar në interes të publikut.

100.2 Besimi në profesionin kontabël është arsyeja pse bizneset, qeveritë dhe organizatat e tjera përfshijnë profesionistët kontabël në një numër të gjerë fushash, përfshirë raportimin financiar dhe të korporatës, sigurinë dhe aktivitete të tjera profesionale. Profesionistët kontabël e kuptojnë dhe pranojnë se ky besim bazohet në zotësitë dhe vlerat që profesionistët kontabël sjellin për të kryer aktivitetet profesionale që ata ndërmarrin, duke përfshirë:

- (a) Respektimin e parimeve etike dhe të standardeve profesionale;
- (b) Përdorimin e aftësive të orientuara nga biznesi;
- (c) Aplikimin e ekspertizës për çështje teknike dhe të tjera;
- (d) Ushtrimin e gjykimit profesional.

Zbatimi i këtyre aftësive dhe vlerave ju mundëson kontabilistëve të japin këshilla ose zgjidhje të tjera që përmbushin qëllimin për të cilin jepen dhe mbi të cilat mund të mbështeten përdoruesit e synuar të këtyre këshillave apo zgjidhjeve.

100.3 Kodi përcakton standarde të cilësisë së lartë të sjelljes etike që pritet të zbatohen nga profesionistët kontabël, të cilat duhet të adoptohen nga organizatat e profesionit kontabël, të cilat janë anëtare të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC), ose për përdorim nga këta anëtarë si një bazë për kodet e tyre të etikës. Kodi mund të përdoret ose adoptohet gjithashtu nga organizmat që kanë përgjegjësinë për vendosjen e standardeve të etikës për profesionistët kontabël në sektorë apo juridiksione të veçanta dhe nga firmat për zhvillimin e politikave të tyre të etikës dhe pavarësisë.

100.4 Kodi ka përcaktuar pesë parime themelore për t'u respektuar nga të gjithë profesionistët kontabël. Ai përfshin gjithashtu një kuadër konceptual që përcakton mënyrën që duhet të përdoret për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar kërcënimet ndaj respektimit të këtyre parimeve themelore dhe, për auditimet dhe angazhimet e tjera të sigurisë, kërcënimet ndaj pavarësisë. Kodi zbaton edhe parimet themelore dhe kuadrin konceptual për një game të

gjere të fakteve dhe rrethanave që kontabilistët mund të ndeshin, qoftë në biznes ashtu edhe në praktikën publike

Kërkesat dhe materiali për zbatim

- 100.5 A1 Kërkesat në Kod, të shprehura me shkronjën “K” imponojnë detyrime
- 100.5 A2 Materiali për zbatim, i shprehur me shkronjën “A”, jep kontekstin, shpjegimet, sugjerimet për veprimet ose çështjet për t'u konsideruar, ilustrimet dhe udhëzimet e tjera që kanë të bëjnë me kuptimin e duhur të Kodit. Veçanërisht, materiali për zbatim është parashikuar të ndihmojë një profesionist kontabël të kuptojë mënyrën sesi të zbatojë kuadrin konceptual për një sere rrethanash të veçanta, dhe për të kuptuar e për të qenë në pajtueshmëri me një kërkesë specifike. Ndërsa ky material për zbatim, në vetvete nuk imponon një kërkesë, marrja në konsideratë e tij është e nevojshme për zbatimin e duhur të kërkesave të Kodit, përfshirë zbatimin e kuadrit konceptual.
- K100.6** Një profesionist kontabël do të jetë në pajtueshmëri me Kodin.
- 100.6 A1 Respektimi i parimeve themelore dhe respektimi i kërkesave specifike të Kodit ju mundësojnë profesionistëve kontabël të përmbushin përgjegjësinë e tyre për të vepruar në interes të publikut.
- 100.6 A2 Respektimi i Kodit përfshin dhënien e konsideratës së duhur për qëllimin dhe qëllimin e kërkesave specifike
- 100.6 A3 Respektimi i kërkesave të Kodit nuk nënkupton që profesionistët kontabël do të kenë përmbushur gjithmonë përgjegjësinë e tyre për të vepruar në interes të publikut. Mund të ketë rrethana të pazakonta ose të jashtëzakonshme në të cilat një kontabilist beson se respektimi i një kërkesë apo disa kërkesave të Kodit mund të mos jetë në interes të publikut ose do të çonte në një përfundim shpërpjesëtimor. Në këto kushte, profesionisti kontabël inkurajohet të konsultohet me një organ të përshtatshëm, siç mund të ishte një organ profesional apo rregullator.
- 100.6 A4 Duke vepruar në interes të publikut, një profesionist kontabël merr në konsideratë jo vetëm preferencat ose kërkesat e një klienti individual ose të një organizate punëdhënëse, por edhe interesat e palëve të tjera të interesuara gjatë kryerjes së aktiviteteve profesionale.
- K100.7** Nëse ka rrethana, ku ligjet ose rregullat e përjashtojnë një profesionist kontabël nga pajtueshmëria me disa pjesë të Kodit. Në këto rrethana, këto ligje dhe rregulla prevalojnë dhe profesionisti kontabël do të jetë në pajtim me pjesët e tjera të Kodit.

- 100.7 A1 Parimi i sjelljes profesionale kërkon që një profesionist kontabël të jetë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat. Disa juridiksione mund të kenë dispozita që ndryshojnë ose shkojnë përtej atyre të vendosura në Kod. Profesionistët kontabël në këto juridiksione duhet të jenë të ndërgjegjshëm për këto diferenca dhe të jenë në pajtim me dispozitat që janë më detyruese, përveç nëse janë të ndaluar nga ligji ose rregullat.

Shkeljet e Kodit

K100.8 Paragrafët K400.80 deri K400.89 dhe K900.50 deri K900.55 adresojnë një shkelje të *Standardeve Ndërkombëtare të Pavarësisë*. Një profesionist kontabël, i cili identifikon një shkelje të ndonjë dispozite tjetër të Kodit do të vlerësojë rëndësinë e shkeljes dhe ndikimin e saj në aftësinë e profesionistit kontabël për të përmbushur parimet themelore. Profesionisti kontabël gjithashtu do të:

- (a) Ndërmarrë çfarëdo veprimi që mund të jetë në dispozicion, sa më shpejt të jetë e mundur, për të adresuar në mënyrë të kënaqshme, pasojat e shkeljes; dhe
- (b) Vlerësojë nëse do ta raportojë shkeljen tek palët përkatëse.

- 100.8 A1 Palët përkatëse tek të cilat mund të raportohet një shkelje e tillë, përfshijnë ato të cilat mund të jenë prekur nga shkelja, një organ profesional, rregullator ose një autoritet mbikëqyrës.

SEKSIONI 110

PARIMET THEMELORE

Të përgjithshme

110.1 A1 Pesë parimet themelore të etikës për profesionistët kontabël janë:

- (a) Integriteti - të jetë i drejtpërdrejtë dhe i ndershëm në të gjitha marrëdhëniet e tij profesionale dhe të biznesit.
- (b) Objektiviteti – të ushtroje gjykimin profesional ose të biznesit pa u kompromentuar nga:
 - (i) Paragjykimi
 - (ii) Konflikti i interesit, ose
 - (iii) Influenca e tepruar ose mbështetja e tepruar tek individët, organizatat, teknologjia ose faktorë të tjerë.
- (c) Kompetenca Profesionale dhe Kujdesi i Duhur:
 - (i) Të arrijë dhe të mbajë njohuri dhe aftësi profesionale në nivelin e kërkuar, për të garantuar që një klient ose organizata punëdhënëse marrin shërbime profesionale kompetente, të cilat bazohen në standardet aktuale teknike e profesionale dhe legjislacinin përkatës, dhe
 - (ii) Të veprojë me kujdes dhe në pajtim me standardet e zbatueshme profesionale dhe teknike.
- (d) Konfidencialiteti - të respektojë konfidencialitetin për informacionet që ai merr si rrjedhojë e marrëdhënieve profesionale dhe të biznesit.
- (e) Sjellja Profesionale:
 - (i) të respektojë ligjet dhe rregullat përkatëse
 - (ii) të sillet në një mënyrë që është në koherencë me përgjegjësinë e profesionit për të vepruar në interes të publikut në të gjitha aktivitetet e tij profesionale dhe marrëdhëniet e biznesit; dhe
 - (iii) të mënjanojë çdo sjellje që profesionisti kontabël di ose duhet ta dijë se mund të diskreditojë profesionin.

K110.2 Një profesionist kontabël duhet të veprojë në pajtim me secilin nga parimet themelore.

110.2 A1 Parimet themelore të etikës përcaktojnë standardin e sjelljes që pritet të zbatohet nga një profesionist kontabël. Kuadri konceptual përcakton

metodën që kërkohet të zbatohet nga një profesionist kontabël, për ta ndihmuar atë për të qenë në pajtueshmëri me këto parime themelore. Nën seksionet 111 deri 115 përcaktojnë kërkesat dhe materialin për zbatim në lidhje me secilin prej parimeve themelore.

110.2 A2 Një profesionist kontabël mund të përballet me një situatë në të cilën pajtueshmëria me një parim themelor bie në konflikt me pajtueshmërinë me një ose më shumë parime të tjera themelore. Në një situatë të tillë, profesionisti kontabël mund të konsiderojë këshillimin, mbi një bazë anonime, nëse është e nevojshme, me:

- Të tjerë brenda firmës ose organizatës punëdhënëse.
- Personat e ngarkuar me qeverisjen.
- Një organizëm profesional
- Një organizëm rregullator
- Një këshilltar ligjor

Megjithatë, një konsultim i tillë nuk e çliron kontabilistin nga përgjegjësia për të ushtruar gjykim profesional për të zgjidhur konfliktin ose, nëse është e nevojshme dhe nëse nuk ndalohej me ligj apo rregulla, të shkëputet nga çështja që krijon konfliktin.

110.2 A3 Profesionisti kontabël inkurajohet të dokumentojë thelbin e çështjes, detajet e çdo diskutimi, vendimet e marra dhe arsyetimin për këto vendimeve.

N/SEKSIONI 111 - INTEGRITETI

K111.1 Një profesionist kontabël do të veprojë në pajtim me parimin e integritetit, i cili kërkon që profesionisti kontabël në të gjitha marrëdhëniet profesionale dhe të biznesit, të jetë i drejtpërdrejtë dhe i ndershëm.

111.1 A1 Integriteti përfshin trajtimin e drejtë, vërtetësinë dhe forcën e karakterit për të vepruar siç duhet, madje edhe kur përballesh me presion për të bërë ndryshe ose kur të vepruarit ndryshe mund të ketë pasoja të mundshme të dëmshme personale ose organizative.

111.1 A2 Të vepruarit në mënyrë të përshtatshme përfshin:

- (a) Të qëndrosh fort kur përballesh me dilema dhe situata të vështira;
- (b) Të sfidohen të tjerët si dhe kur rrethanat e lejojnë,

në një mënyrë të përshtatshme për rrethanat.

- K111.2** Një profesionist kontabël, në kushtet e dijenisë, nuk duhet të lidhë veten e tij me raporte, deklarata, komunikime apo informacione të tjera, kur ai beson se informacioni:
- (a) Përmban një deklaratë materialisht të rremë ose mashtruese;
 - (b) Përmban deklarata ose informacione të dhëna në mënyrë të nxituar; ose
 - (c) Ka mungesa ose fsheh disa të dhëna që duhet të jepen, kur kjo mungesë ose fshehje do të ishte mashtruese.
- 111.2 A1 Nëse një profesionist kontabël jep një opinion të modifikuar në lidhje me një raport, deklaratë, komunikim apo informacion tjetër, ai nuk është në shkelje të paragrafit K111.2.
- K111.3** Kur një profesionist kontabël vihet në dijeni të faktit që ka qenë i lidhur me informacionin e përshkruar në paragrafin K111.2, ai duhet të marrë masa për t'u shkëputur nga ky informacion.

N/SEKSIONI 112 - OBJEKTIVITETI

- K112.1** Një profesionist kontabël do të veprojë në pajtim me parimin e objektivitetit, i cili kërkon që një profesionist kontabël të mos kompromentojë gjykimin profesional ose të biznesit, për shkak të:
- (a) Paragjykimit,
 - (b) Konfliktit të interesit ose
 - (c) Influencës ose mbështetjes së tepruar tek individët, organizatat, teknologjia ose faktorë të tjerë.
- K112.2** Një profesionist kontabël nuk do të ndërmarrë një aktivitet profesional në qoftë se një rrethanë ose marrëdhënie paragjykon ose influencon tepër gjykimin e tij profesional në lidhje me këtë aktivitet.

N/SEKSIONI 113 - KOMPETENCA PROFESIONALE DHE KUJDESI I DUHUR

- K.113.1** Një profesionist kontabël do të veprojë në pajtueshmëri me parimin e kompetencës profesionale dhe të kujdesit të duhur, i cili kërkon që një profesionist kontabël:
- (a) Të arrijë dhe të mbajë njohuritë dhe aftësitë profesionale në nivelin e kërkuar, për të garantuar që një klient ose një organizatë punëdhënëse merr shërbim profesional e kompetent bazuar në standardet aktuale teknike e profesionale dhe legjislacionin përkatës; dhe

(b) Të veprojë me kujdes dhe në pajtim me standardet teknike e profesionale të zbatueshme.

113.1 A1 Shërbimi ndaj klientëve dhe organizatave punëdhënëse me kompetencë profesionale kërkon që, për zbatimin e njohurive dhe aftësive profesionale, që duhen për kryerjen e aktiviteteve profesionale, të ushtrohet një gjykim i shëndoshë.

113.1 A2 Mbajtja e kompetencës profesionale kërkon një ndërgjegjësim të vazhdueshëm dhe njohjen e standardeve përkatëse teknike e profesionale dhe zhvillimeve të biznesit. Zhvillimi i vijueshëm profesional i jep mundësi profesionistit kontabël të zhvillojë dhe të mbajë aftësitë profesionale për të ofruar shërbime me kompetencë dhe brenda mjedisit profesional.

113.1 A3 Kujdesi përfshin përgjegjësinë për të vepruar në pajtim me kërkesat e një detyre të caktuar, në mënyrë të kujdesshme e të hollësishme dhe në kohën e duhur.

K113.2 Për të qenë në pajtim me parimin e kompetencës profesionale dhe kujdesin e duhur, një profesionist kontabël do të ndërmarrë ato hapa që japin garanci, se personat të cilët punojnë nën autoritetin e tij, në një kapacitet të caktuar profesional, kanë kualifikimin dhe mbikëqyrjen e duhur.

K113.3 Kur është e nevojshme, një profesionist kontabël do të bëjë që klientët, punëdhënësit apo edhe përdorues të tjerë të shërbimeve ose aktiviteteve profesionale, të jenë të vetëdijshëm për kufizimet e vetvetishme të shërbimeve ose aktiviteteve.

N/SEKSIONI 114 - KONFIDENCIALITETI

K114.1 Një profesionist kontabël do të veprojë në pajtim me parimin e konfidencialitetit, i cili kërkon që profesionisti kontabël të respektojë konfidencialitetin e informacionit të marrë si rrjedhojë e një marrëdhënie profesionale dhe të biznesit. Një profesionist kontabël:

- (a) Do të jetë vigjilent ndaj mundësisë së zbulimit të paqëllimshëm të informacionit, përfshirë zbulimin në një mjedis social dhe veçanërisht tek një palë biznesi e lidhur ngushtë, apo një familjar i drejtpërdrejtë ose i ngushtë;
- (b) Do të ruajë konfidencialitetin e informacionit brenda firmës ose organizatës punëdhënëse;
- (c) Do të ruajë konfidencialitetin e informacionit të marrë nga një klient i ardhshëm ose një organizatë punëdhënëse.
- (d) Nuk do të nxjerrë jashtë firmës ose organizatës punëdhënëse,

informacionet konfidenciale të marra si rrjedhojë e një marrëdhënie profesionale ose të biznesit, pa marrë më parë një autorizim të përshtatshëm dhe specifik, përveç rasteve kur ekziston një detyrim apo e drejtë ligjore ose profesionale për dhënien e këtyre informacioneve;

- (e) Nuk do të përdorë informacionet konfidenciale, të marra si rrjedhojë e një marrëdhënie profesionale ose të biznesit, për avantazhin e tij personal apo avantazhin e palëve të treta.
- (f) Nuk do të përdorë ose paraqesë ndonjë informacion konfidencial, qoftë të marrë apo të arritur si rrjedhojë e një marrëdhënie profesionale ose biznesi, pasi marrëdhënia ka përfunduar.
- (g) Do të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshme për t'u siguruar që personeli nën varësinë e tij, dhe personat e tjerë, prej të cilëve janë marrë këshilla e ndihmë, respektojnë detyrimin e profesionistit kontabël për të mbajtur konfidencialitetin.

114.1 A1 Konfidencialiteti i shërben interesit publik, pasi ai lehtëson rrjedhjen e lirë të informacionit nga klienti i profesionistit kontabël ose nga organizata punëdhënëse tek profesionisti kontabël, duke patur parasysh se informacioni nuk do t'i jepet një palë të tretë. Megjithatë më poshtë jepen rrethanat, kur profesionistët kontabël kërkohet apo mund të kërkohet të japin informacione konfidencial, ose kur dhënia e këtyre informacioneve, mund të jetë e përshtatshme:

- (a) Dhënia e informacioneve kërkohet nga ligji, për shembull:
 - (i) Prodhimi i dokumenteve ose dhëniet e tjera të evidencës, gjatë procedurave ligjore, apo
 - (ii) Informimi i autoriteteve përkatëse publike, për informacionet që kanë të bëjnë shkeljet e ligjit; dhe
- (b) Dhënia e informacioneve lejohet me ligj dhe autorizohet nga klienti ose organizata punëdhënëse; dhe
- (c) Ekziston një detyrim ose një e drejtë profesionale për dhënien e informacioneve, kur nuk ndalohet nga ligji:
 - (i) Për të vepruar në pajtim me procedurat e kontrollit të cilësisë të një organizmi profesional;
 - (ii) Për t'u përgjigjur një kërkesë ose një investigimi të bërë nga një organizëm profesional ose rregullator;
 - (iii) Për të mbrojtur interesat profesionale të një profesionisti kontabël gjatë proceseve gjyqësore; ose
 - (iv) Për të respektuar standardet teknike dhe profesionale, përfshirë kërkesat etike.

114.1 A2 Për të përcaktuar nëse do të jepet ose jo informacioni konfidencial, faktorët që do të mbahen parasysh, në varësi të rrethanave, përfshijnë:

- Fakti nëse do të mund të dëmtoheshin interesat e palëve, përfshirë

palët e treta, interesat e të cilave mund të ndikohen, në qoftë se klienti ose punëdhënësi jep pëlqimin që profesionisti kontabël të zbulojë informacionin;

- Fakti, nëse njihen ose janë provuar të gjithë informacionet përkatëse, deri në atë masë që kjo është praktikisht e mundur. Faktorët që ndikojnë në marrjen e vendimit për të paraqitur informacionet përfshijnë:
 - Faktet e paprovuara.
 - Informacion jo i plotë.
 - Konkluzione të paprovuara.
- Tipin e komunikimit të propozuar dhe kujt i adresohet.
- Faktin nëse palët të cilave ju adresohet komunikimi janë marrësit e duhur.

K114.2 Një profesionist kontabël do të vazhdojë të veprojë në pajtim me parimin e konfidencialitetit edhe pas përfundimit të marrëdhënies midis profesionistit kontabël dhe klientit ose organizatës punëdhënëse. Kur ndryshon punësimin apo edhe kur merr një klient të ri, profesionist kontabël ka të drejtë të përdorë eksperiencën e mëparshme, por nuk dotë përdorë ose zbulojë ndonjë informacion konfidencial të mësuar apo edhe të marrë si rrjedhojë e një marrëdhënieje profesionale ose biznesi.

N/SEKSIONI 115 - SJELLJA PROFESIONALE

K115.1 Një profesionist kontabël do të veprojë në pajtueshmëri me parimin e sjelljes profesionale, i cili kërkon që një profesionist kontabël:

- (a) të veprojë në pajtim me ligjet dhe rregullat përkatëse
- (b) të sillet në një mënyrë që është në koherencë me përgjegjësinë e profesionit për të vepruar në interes të publikut në të gjitha aktivitetet e tij profesionale dhe marrëdhëniet e biznesit; dhe
- (c) të shmangë ndonjë sjellje që profesionistët kontabël e dinin ose duhet ta dinin, se mund të diskreditojë profesionin.

Një profesionist kontabël nuk mund të angazhohet në mënyrë të vetëdijshme në ndonjë biznes, profesion apo aktivitet që dëmton apo mund të dëmtojë integritetin, objektivitetin ose reputacionin e mirë të profesionit dhe për rrjedhojë, do të ishte e papajtueshme me parimet themelore.

115.1 A1 Sjellje që mund të diskreditojnë profesionin përfshijnë sjellje, për të cilat një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar, do të kishte të ngjarë të arrinte në përfundimin se, këto sjellje kanë ndikime negative ndaj reputacionit të mirë të profesionit.

K115.2 Kur bën marketing apo promovim aktivitetesh, një profesionist kontabël nuk

duhet të dëmtojë reputacionin e profesionit. Një profesionist kontabël do të jetë i ndershëm dhe i sinqertë dhe nuk do të bëjë:

- (a) Pretendime të ekzagjeruara për shërbimet e ofruara për kualifikimet apo për eksperiencën e profesionistit kontabël; ose
- (b) Referime nënçmuese apo krahasime me punën e të tjerëve, të cilat janë të pavërtetuara.

115.2 A1 Nëse një profesionist kontabël është në dyshim rreth faktit nëse një formë e reklamimit ose marketingut është e përshtatshme, profesionisti kontabël inkurajohet të këshillohet me organizmin profesional përkatës.

SEKSIONI 120

KUADRI KONCEPTUAL

Hyrje

120.1 Rrethanat, në të cilat operojnë profesionistët kontabël, mund të çojnë në kërcënime specifike ndaj respektimit të parimeve themelore. Seksioni 120 përcakton kërkesat dhe materialin për zbatim, duke përfshirë një kuadër konceptual për të ndihmuar profesionistët kontabël në respektimin e parimeve themelore dhe përmbushjen e përgjegjësisë të tyre për të vepruar në interes të publikut. Kërkesa të tilla dhe materiali për zbatim i përshtaten gamës së gjerë të fakteve dhe rrethanave, duke përfshirë aktivitete të ndryshme profesionale, interesa dhe marrëdhënie, të cilat krijojnë kërcënime për respektimin e parimeve themelore. Veç kësaj, ato frenojnë një profesionist kontabël që ai të arrijë konkluzionin se një situatë është e lejuar vetëm sepse ajo nuk është e ndaluar në mënyrë specifike nga Kodi.

120.2 Kuadri konceptual specifikon rrethanat kur një profesionist kontabël:

- (a) Identifikon kërcënimet kundrejt pajtueshmërisë me parimetthemelore;
- (b) Vlerëson kërcënimet e identifikuara; dhe
- (c) Adreson kërcënimet duke i eliminuar ose zvogëluar ato deri në një nivel të pranueshëm.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

K120.3 Profesionisti kontabël do të zbatojë parimet themelore për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar kërcënimet që i bëhen respektimit të parimeve themelore të përcaktuara në Seksionin 110.

120.3 A1 Kërkesat shtesë dhe materiali për zbatim që janë të përshtatshme për zbatimin e kuadrit konceptual janë përcaktuar në:

- (a) Pjesa 2 – *Profesionistët Kontabël të punësuar (në biznes)*;
- (b) Pjesa 3 – *Profesionistët Kontabël në Praktikën Publike*; dhe
- (c) *Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë*, si më poshtë:
 - (i) Pjesa 4A – *Pavarësia për Angazhimet e Auditimit dhe të Rishikimit*; dhe
 - (ii) Pjesa 4B – *Pavarësia për Angazhimet e Tjera të Sigurisë*.

K120.4 Kur merret me një çështje etike, profesionisti kontabël do të marrë në

konsideratë kontekstin në të cilin ka lindur ose mund të lindë çështja. Kur një individ, i cili është një profesionist kontabël në praktikën publike, kryen veprimtari profesionale në përputhje me marrëdhënien e profesionistit me firmën, qoftë si kontraktues, punonjës apo pronar, individit duhet të veprojë në përputhje me dispozitat e Pjesës 2 që zbatohen në këto rrethana.

K120.5 Gjatë zbatimit të kuadrit konceptual, profesionisti kontabël do të:

- (a) Përdorë gjykimin profesional;
- (b) Qëndrojnë vigjilent për informacione të reja dhe ndryshime nëfakte e rrethana; dhe
- (c) Përdorë testin e arsyeshëm dhe të informuar të palës së tretë të përshkruar në paragrafin 120.5 A4.

Të kesh një mendje kërkuese

120.5 A1 Një mendje kërkuese është një parakusht për të kuptuar faktet dhe rrethanat e njohura, të nevojshme për zbatimin e duhur të kuadrit konceptual. Të patrit e një mendje kërkuese përfshin:

- (a) Vlerësimin e burimit, përshtatshmërisë dhe mjaftueshmerisë së informacionit të siguruar, duke mbajtur parasysh natyrën, shtrirjen dhe rezultatet e veprimtarisë profesionale që është ndërmarrë; dhe
- (b) Të qenurit i hapur dhe vigjilent ndaj nevojës për investigime të mëtejshme ose veprime të tjera.

120.5 A2 Gjatë shqyrtimit të burimit, përkatësisë dhe mjaftueshmerisë së informacionit të siguruar, profesionisti kontabël mund të shqyrtojë, ndër të tjera, faktin nëse:

- Kanë dalë në dritë informacione të reja apo ka pasur ndryshime në faktet dhe rrethanat.
- Informacioni ose burimi i tij mund të ndikohen nga paragjykimi ose interesi vetjak.
- Ka arsye për t'u shqetësuar se në faktet dhe rrethanat e njohura për profesionistin kontabël mund të mungojnë informacione potencialisht të rëndësishme ose të përshtatshme
- Ka një mospërputhje midis fakteve dhe rrethanave të njohura dhe pritshmërisë së profesionistit kontabël
- Informacioni siguron një bazë të arsyeshme mbi të cilën të arrihet në një përfundim.
- Mund të ketë përfundime të tjera të arsyeshme që mund të arrihen nga informacioni i siguruar.

120.5 A3 Paragrafi R120.5 kërkon që të gjithë profesionistët kontabël të kenë një

mendje kërkuese kur ata identifikojnë, vlerësojnë dhe trajtojnë kërcënimet ndaj parimeve themelore. Ky parakusht për aplikimin e kuadrit konceptual zbatohet për të gjithë kontabilistët pavarësisht nga veprimtaria profesionale që ata kryejnë. Sipas standardeve të auditimit, rishikimit dhe standardeve të tjera të sigurisë, duke përfshirë ato të publikuara nga IAASB, kontabilistëve ju kërkohet gjithashtu, të ushtrojnë skepticizëm profesional, i cili përfshin një vlerësim kritik të evidencës.

Ushtrimi i gjykimit profesional

120.5 A4 Gjykimi profesional përfshin zbatimin e trajnimit përkatës, njohurive profesionale, aftësive dhe përvojës në përputhje me faktet dhe rrethanat, duke përfshirë natyrën dhe fushën e aktiviteteve të veçanta profesionale, si dhe interesat dhe marrëdhëniet e përfshira. Në lidhje me ndërmarrjen e aktiviteteve profesionale, përdorimi i gjykimit profesional kërkohet kur profesionisti kontabël zbaton kuadrin konceptual me qëllim që të marrë vendime të informuara për veprimet që do të ndërmerren dhe për të përcaktuar nëse këto vendimet janë të përshtatshme për rrethanat.

120.5 A5 Gjykimi profesional kërkohet kur kontabilisti profesional zbaton kuadrin konceptual në mënyrë që të marrë vendime të informuara rreth drejtimeve të veprimeve në dispozicion dhe për të përcaktuar nëse këto vendime janë të përshtatshme për rrethanat. Për të bërë një përcaktim të tillë, kontabilisti mund të mbajë parasysh çështje të tilla si fakti nëse:

- Ekspertiza dhe përvoja e kontabilistit janë të mjaftueshme për të arritur në një përfundim.
- Ka nevojë për t'u konsultuar me të tjerët me ekspertizën ose përvojën përkatëse.
- Paramendimi ose anshmëria e vetë kontabilistit mund të ndikojnë në ushtrimin e gjykimit profesional të kontabilistit

Pala e tretë e arsyeshme dhe e informuar

120.5 A6 Testi i arsyeshëm dhe i informuar i palës së tretë është një vlerësim nga profesionisti kontabël nëse të njëjtat përfundime do të mund të arriheshin nga një palë tjetër. Ky vlerësim bëhet nga këndvështrimi i një pale të tretë të arsyeshme dhe të informuar, e cila peshon të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse që profesionisti kontabël i njeh ose mund të pritej t'i kishte njohur në kohën kur janë bërë përfundimet. Pala e tretë e arsyeshme dhe e informuar nuk ka nevojë të jetë një profesionist kontabël, por duhet të zotërojë njohuritë dhe përvojën për të kuptuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë e përfundimeve të profesionistit kontabël në një mënyrë të paanshme.

Identifikimi i kërcënimeve

K120.6 Profesionisti kontabël do të identifikojë kërcënimet e pajtueshmërisë me parimet themelore.

120.6 A1 Një kuptim i fakteve dhe rrethanave, duke përfshirë çdo aktivitet profesional, interesat dhe marrëdhëniet që mund të pengojnë pajtueshmërinë me parimet themelore, është një parakusht për identifikimin nga profesionisti kontabël të kërcënimeve për një papajtueshmëri të tillë. Ekzistenca e disa kushteve, politikave dhe procedurave të përcaktuara nga profesioni, legjislacioni, rregullorja, firma ose organizata punëdhënëse që mund të nxisin profesionistin kontabël për të vepruar në mënyrë etike, mund të ndihmojnë në identifikimin e kërcënimeve për pajtueshmërinë me parimet themelore. Paragrafi 120.8 A2 përfshin shembuj të përgjithshëm të kushteve, politikave dhe procedurave të tilla, të cilat janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm në vlerësimin e nivelit të kërcënimeve.

120.6 A2 Kërcënimet për pajtueshmërinë me parimet themelore mund të krijohen nga një gamë e gjerë faktesh dhe rrethanash. Nuk është e mundur të përcaktohet çdo situatë që krijon kërcënime. Përveç kësaj, natyra e angazhimeve dhe e detyrave mund të ndryshojnë dhe për pasojë, mund të krijohen lloje të ndryshme të kërcënimeve.

120.6 A3 Kërcënimet për pajtueshmërinë me parimet themelore mund t'i përkasin një ose më shumë kategorie si më poshtë:

- (a) Kërcënimi i egoizmit (interesit vetjak) – kërcënimi që një interes financiar ose një interes tjetër do të influencojë në mënyrë të papërshtatshme gjykimin ose sjelljen profesionale të profesionistit kontabël;
- (b) Kërcënimi i vetë rishikimit – kërcënimi që një profesionist kontabël nuk do të vlerësojë si duhet rezultatet e gjykimeve të mëparshme të bëra prej tij ose të aktiviteteve apo shërbimeve të kryera nga ai vetë, apo nga një individ tjetër brenda firmës ose organizatës punëdhënëse të profesionistit kontabël, mbi të cilin profesionisti kontabël do të mbështetet, kur formon një gjykim që është pjesë e dhënies së shërbimit aktual;
- (c) Kërcënimi i favorizimit (përkrahjes) – kërcënimi që një profesionist kontabël do të stimulojë pozitën e një klienti ose të punëdhënësit deri në atë pikë, sa që të komprometohet objektiviteti i tij;
- (d) Kërcënimi i familjaritetit – kërcënimi, që për shkak të një marrëdhënie të gjatë ose të afër me një klient ose një punëdhënëse, një profesionist kontabël do të bëhet shumë dashamirës (do të tregojë shumë simpati) ndaj interesave të tyre, apo ndaj pranimit të punës së tyre; dhe
- (e) Kërcënimi i frikësimit – kërcënimi që një profesionist kontabël do të

pengohet në kryerjen e veprimtarisë së tij me objektivitet për shkak të presioneve aktuale ose të perceptuara, përfshirë këtu përpjekjet për të ushtruar influencë të panevojshme mbi profesionistin kontabël.

- 120.6 A4 Një rrethanë mund të krijojë më shumë se një kërcënim dhe një kërcënim mund të ndikojë në pajtueshmërinë me më shumë se një parim themelor.

Vlerësimi i kërcënimeve

- 120.7 Kur profesionisti kontabël identifikon një kërcënim për pajtueshmërinë me parimet themelore, ai do të vlerësojë nëse një kërcënim i tillë është në një nivel të pranueshëm.

Nivel i pranueshëm

- K120.7** Niveli i pranueshëm është një nivel në të cilin një profesionist kontabël që përdor testin e arsyeshëm dhe të informuar të palës së tretë ka të ngjarë të arrijë në përfundimin se profesionisti kontabël është në përputhje me parimet themelore.

Faktorët e rëndësishëm në vlerësimin e nivelit të kërcënimeve

- 120.8 A1 Shqyrtimi i faktorëve cilësor dhe sasior është i rëndësishëm në vlerësimin e kërcënimeve të profesionistit kontabël, siç është efekti i kombinuar i kërcënimeve të shumëfishta, nëse është e zbatueshme.

- 120.8 A2 Ekzistenca e kushteve, politikave dhe procedurave të përshkruara në paragrafin 120.6 A1 gjithashtu, mund të jenë faktorë të rëndësishëm gjatë vlerësimit të nivelit të kërcënimeve për pajtueshmërinë me parimet themelore. Shembuj të kushteve, politikave dhe procedurave të tilla përfshijnë:

- Kërkesat e qeverisjes së korporatave.
- Kërkesat për edukimin, trajnimin dhe eksperiencën, që duhet të plotësohen për të hyrë në profesion.
- Sisteme efektive të ankesave që mundësojnë profesionistin kontabël dhe publikun e gjerë të tërheqë vëmendjen ndaj sjelljes jo etike.
- Një detyrim i shprehur qartë për të raportuar shkelje të kërkesave të etikës.
- Monitorimi profesional dhe rregullator dhe procedurat disiplinore.

Vlerësimi i informacioneve të reja ose i ndryshimeve në faktet dhe rrethanat

- K120.9** Nëse profesionisti kontabël merr dijeni për informacione të reja ose ndryshime në faktet dhe rrethanat, të cilat mund të ndikojnë nëse kërcënim

është eliminuar ose reduktuar në një nivel të pranueshëm, profesionisti kontabël duhet ta rivlerësojë dhe ta trajtojë atë kërcënim në përputhje me rrethanat.

120.9 A1 Të qenurit vigjilent gjatë aktivitetit profesional ndihmon profesionistin kontabël në përcaktimin nëse janë shfaqur informacione të reja ose kanë ndodhur ndryshime në rrethana dhe fakte që:

- (a) Ndikojnë në nivelin e një kërcënimi; ose
- (b) Ndikojnë konkluzionet e profesionistit kontabël nëse masat mbrojtëse të zbatuara vazhdojnë të jenë të përshtatshme për të adresuar kërcënimet e identifikuar.

120.9 A2 Nëse informacionet e reja çojnë në identifikimin e një kërcënimi të ri, profesionisti kontabël kërkohet që të vlerësojë dhe sipas rastit, të adresojë këtë kërcënim. (Ref: Parag. K120.7 and K120.10).

Adresimi i kërcënimeve

K120.10 Nëse profesionisti kontabël konstaton se kërcënimet e identifikuar për pajtueshmërinë me parimet themelore nuk janë në një nivel të pranueshëm, ai duhet të trajtojë kërcënimet duke i eliminuar ose reduktuar ato në një nivel të pranueshëm. Profesionisti kontabël do ta bëjë këtë duke:

- (a) Eliminuar rrethanat, përfshirë interesat ose marrëdhëniet, që kanë krijuar kërcënimet;
- (b) Zbatuar masat mbrojtëse, kur janë në dispozicion dhe mund të zbatohen, për të reduktuar kërcënimet në një nivel të pranueshëm; ose
- (c) Refuzuar ose përfunduar veprimtarinë specifike profesionale.

Veprimet për të eliminuar kërcënimet

120.10 A1 Në varësi të fakteve dhe rrethanave, një kërcënim mund të trajtohet duke eliminuar rrethanat që krijojnë kërcënimin. Sidoqoftë, ekzistojnë disa situata në të cilat kërcënimet mund të trajtohen vetëm duke refuzuar ose duke mos vazhduar aktivitetin specifik profesional. Kjo për shkak se rrethanat që krijojnë kërcënimet nuk mund të eliminohen dhe masat mbrojtëse nuk janë në gjendje të zbatohen për të reduktuar kërcënimin në një nivel të pranueshëm.

Masat mbrojtëse

120.10 A2 Masat mbrojtëse janë veprime, individuale ose të kombinuara, që profesionisti kontabël ndërmerr, të cilat në mënyrë efektive reduktojnë kërcënimet për pajtueshmërinë me parimet themelore në një nivel të

pranueshëm.

Shqyrtimi i gjykimeve të rëndësishme të bëra dhe konkluzionet e përgjithshme të arritura

K120.11 Profesionisti kontabël do të formojë një konkluzion të përgjithshëm nëse veprimet që ai ndërmerr ose synon të ndërmarrë, për të adresuar kërcënimet e krijuara, do t'i eliminojnë ato kërcënime ose do t'i reduktojnë ato në një nivel të pranueshëm. Në formimin e konkluzionit të përgjithshëm, profesionisti kontabël:

- (a) Rishikon çdo gjykim të rëndësishëm të bërë ose përfundim të arritur; dhe
- (b) Përdor testin e arsyeshëm dhe të informuar të palës së tretë.

Konsiderata të tjera kur zbatohet kuadri konceptual

Paragjykimi

120.12 A1 Anshmëria e ndërgjegjshme ose e pandërgjegjshme ndikon në ushtrimin e gjykimit profesional kur identifikohen, vlerësohen dhe trajtohen kërcënimet ndaj respektimit të parimeve themelore.

120.12 A2 Disa shembuj të paragjykimit të mundshëm, për t'u mbajtur parasysh kur ushtrohet gjykimi profesional:

- Paragjykimi i ankoruar (parapërcaktuar) - një tendencë për të përdorur një pjesë fillestare të informacioni si një spirancë me anën e së cilës informacioni pasues vlerësohet në mënyrë të papërshtatshme.
- Paragjykimi i automatizuar - tendencë për të favorizuar rezultatin që gjenerohet nga sistemet e automatizuara, madje edhe kur arsyetimi njerëzor ose informacioni që bie në kundërshtim ngre pikëpyetje në lidhje me besueshmërinë e rezultatit ose përshtatshmërinë e tij për këtë qëllim.
- Paragjykimi i disponibilitetit - një tendencë për t'i dhënë peshë më shumë ngjarjeve apo eksperiencave që vijnë menjëherë në mendje ose janë disponibël se sa për ato që nuk janë.
- Paragjykimi i konfirmimit - një tendencë për t'i dhënë peshë më shumë informacionit, i cili provon një besim që ekziston dhe jo informacionit që bie në kundërshtim ose hedh dyshime mbi këtë besim.
- Mendimi i grupit - një tendencë e një grupi individësh për të dekurajuar kreativitetin dhe përgjegjësinë individuale dhe si rrjedhojë arrin një vendim pa bërë ndonjë arsyetim kritik ose pa vlerësuar alternativat.
- Paragjykimi i besimit të tepruar (mbi besimit) - një tendencë për të

mbivlerësuar aftësinë e dikujt për të bërë vlerësime të sakta të rrezikut ose gjykime apo vendime të tjera.

- Paragjykimi i përfaqësimit - një tendencë për t'u bazuar në një model përvojash, ngjarjesh apo bindjesh, të cilat supozohet se janë përfaqësuese.
- Perceptimi selektiv - një tendencë që pritshmëritë e një personi të influencojnë mënyrën se si personi e sheh një çështje ose person të veçantë

120.12 A3 Veprimet që mund të zvogëlojnë ndikimin e paragjykimit përfshijnë:

- Kërkimin e këshillave nga ekspertët për të dhënë informacione shtesë
- Konsultimi me të tjerët për të siguruar sfidën e duhur si pjesë e procesit të vlerësimit'
- Marrjen e trajnimit në lidhje me identifikimin e paragjykimit si pjesë e zhvillimit profesional

Kultura organizative

120.13 A2 Promovimi i një kulture etike brenda një organizate është më efektiv kur:

- (a) Liderat dhe ata që kanë role menaxheriale i kushtojnë rëndësi dhe e mbajnë veten dhe të tjerët përgjegjës për të demonstruar vlerat etike të organizatës;
- (b) Ekzistojnë programe të edukimit dhe trajnimit të përshtatshme, procese të menaxhimit dhe kritere të vlerësimit të performancës dhe të shpërblimit që promovojnë një kulturë etike;
- (c) Janë në fuqi politika dhe procedura efektive për të inkurajuar dhe mbrojtur ata që raportojnë sjelljet faktike ose të dyshuara të paligjshëm ose jo-etike, duke përfshirë fishkëllyesit; dhe
- (d) Organizata u përmbahet vlerave etike në marrëdhëniet e saj me palët e treta.

120.13 A3 Profesionistët kontabël pritet të inkurajojnë dhe promovojnë në organizatën e tyre një kulturë të bazuar në etike, duke mbajtur parasysh pozicionin dhe vjetërsinë e tyre.

Konsiderata për angazhimet e auditimit, rishikimit dhe shërbime të tjera të sigurisë dhe shërbimet e lidhura

Kultura e firmës

120.14 A1 SNMC 1 përcakton kërkesat dhe materialin e aplikimit që kanë të bëjnë me kulturën e firmës në kuadrin e përgjegjësi të një firme për të hartuar, zbatuar dhe vënë në operim të një sistemi të menaxhimit të cilësisë për auditimet apo rishikimet e pasqyrave financiare, ose angazhime të tjera të

sigurisë apo të shërbimeve të lidhura.

Pavarësia

120.15 A1 Profesionistëve kontabël në praktikën publike ju kërkohet nga Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë për të qenë të pavarur gjatë kryerjes së angazhimeve të auditimit, të rishikimit ose angazhimeve të tjera të sigurisë. Pavarësia është e lidhur me parimet themelore të objektivitetit dhe integritetit. Ajo përfshin:

- (a) Pavarësinë e mendjes - gjendja e mendjes që lejon shprehjen e një përfundimi pa u ndikuar nga ndikimet që komprometojnë gjykimin profesional, duke lejuar kështu që një individ të veprojë me integritet dhe të ushtrojë objektivitet dhe skepticizëm profesional.
- (b) Pavarësinë në dukje - shmangia e fakteve dhe rrethanave që janë kaq të rëndësishme sa që një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar do të mund të arrinte në përfundimin se integriteti, objektiviteti ose skepticizmi profesional i një firme ose një pjesëtar i grupit të auditimit ose sigurisë është kompromentuar.

120.15 A2 Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë përcaktojnë kërkesat dhe materialin për zbatim për mënyrën e zbatimit të kuadrit konceptual për të ruajtur pavarësinë gjatë kryerjes së auditimeve, rishikimeve apo angazhimeve të tjera të sigurisë. Profesionistët kontabël dhe firmat profesionale duhet të jenë në pajtueshmëri me këto standarde për të qenë të pavarur gjatë kryerjes së angazhimeve të tilla. Kuadri konceptual për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e kërcënimeve për respektimin e parimeve themelore zbatohet në të njëjtën mënyrë edhe në pajtueshmëri me kërkesat e pavarësisë. Kategoritë e kërcënimeve për respektimin e parimeve themelore të përshkruara në paragrafin 120.6 A3 janë gjithashtu, kategoritë e kërcënimeve për pajtueshmërinë me kërkesat e pavarësisë.

120.15 A3 Kushtet, politikat dhe procedurat e përshkruara në paragrafët 120.6 A1 dhe 120.8 A2, që mund të ndihmojë në identifikimin dhe vlerësimin e kërcënimeve ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore, mund të jenë gjithashtu faktorë të përshtatshëm për identifikimin dhe vlerësimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë. Në kontekstin e auditimeve, rishikimeve dhe angazhimeve të tjera të sigurisë, një shembull i këtyre kushteve, politikave dhe procedurave është një sistem i menaxhimit të cilësisë që një firmë e ka projektuar, zbatuar dhe operuar në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë të publikuara nga IAASB-ja.

Skepticizmi profesional

120.16 A1 Sipas standardeve të auditimit, rishikimit dhe standardeve të tjera të

sigurisë, duke përfshirë edhe ato të lëshuara nga BSNAS, profesionistët kontabël në praktikën publike kërkohet të ushtrojnë skepticizëm profesional gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimeve, rishikimeve dhe angazhimeve të tjera të sigurisë. Skepticizmi profesional dhe parimet themelore që janë përshkruar në Seksionin 110 janë koncepte të ndërlidhura.

120.16 A2 Në një auditim të pasqyrave financiare, pajtueshmëria me parimet themelore, individualisht dhe në grup, mbështet ushtrimin e skepticizmit profesional, siç tregohet në shembujt e mëposhtëm:

- *Integriteti* kërkon që profesionisti kontabël të jetë i drejtpërdrejtë dhe i sinqertë. Për shembull, profesionisti kontabël vepron në pajtueshmëri me parimin e integritetit kur:
 - Është i drejtpërdrejtë dhe i sinqertë kur ka shqetësime lidhur me një pozicion të marrë nga një klient;
 - Ndjek pyetjet në lidhje me informacionet jo koherente dhe kërkon evidence të mëtijshme të auditimit për të adresuar shqetësimet në lidhje me pasqyrat që mund të jenë materialisht false ose keq udhëzuese (çorientuese), në mënyrë që të ndërmarrë vendime të informuara për drejtimin e duhur të veprimit në këto rrethana.
 - Ka forcë karakteri për të vepruar në mënyrë të përshtatshme, madje edhe kur përballlet me presion për të vepruar ndryshe ose kur vepron në këtë mënyrë, mund të ketë pasoja potenciale të pafavorshme personale ose organizative. Të vepruarit në mënyrë të përshtatshme përfshin:
 - (a) Qëndrimin me këmbë në tokë kur përballlet me dilemat dhe situatat e vështira; ose
 - (b) Sfidimin e të tjerëve si dhe kur rrethanat e garantojnë, në një mënyrë të përshtatshme për rrethanat

Duke vepruar në këtë mënyrë, profesionisti kontabël demonstroi për vlerësimin kritik të evidencës të auditimit që kontribuon në ushtrimin e skepticizmit profesional

- *Objektiviteti* kërkon që profesionisti kontabël të ushtrojë gjykimin profesional ose të biznesit pa u kompromentuar nga:
 - (a) paragjykimi,
 - (b) konflikti i interesit ose
 - (c) Influenca e papërshtatshme ose mbështetja e tepruar tek individët, organizatat, teknologjia ose faktorët e tjerë

Për shembull, profesionisti kontabël vepron në pajtueshmëri me parimin e objektivitetit kur:

- (a) Njeh rrethana ose marrëdhënie të tilla si familjariteti me klientin, që mund të cenojnë gjykimin profesional ose të biznesit të profesionistit kontabël; dhe
- (b) Merr parasysh ndikimin e rrethanave dhe marrëdhënieve të tilla në gjykimin e profesionistit kontabël, kur vlerëson mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e evidencës së auditimit në lidhje me një çështje të rëndësishme në pasqyrat financiare të klientit.

Duke vepruar kështu, profesionisti kontabël sillet në atë mënyrë që kontribuon në ushtrimin e skepticizmit profesional.

- *Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur* kërkon që profesionisti kontabël të zotërojë njohuri dhe aftësi profesionale në nivelin e kërkuar për të siguruar shërbime profesionale dhe kompetente, dhe të veprojë me kujdes në pajtim me standardet, ligjet dhe rregulloret në fuqi. Për shembull, profesionisti kontabël vepron në pajtueshmëri me parimin e kompetencës profesionale dhe kujdesin e duhur kur:
 - (a) Zotëron njohuri që janë të përshtatshme sektorin e ekonomisë dhe aktivitetet e biznesit të një klienti të veçantë, për të identifikuar në mënyrën e duhur rreziqet e anomalisë materiale;
 - (b) Harton dhe kryen procedura të përshtatshme të auditimit; dhe
 - (c) Zbaton njohuritë përkatëse gjatë vlerësimit në mënyrë kritike nëse evidenca e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme në këto rrethana.

Duke vepruar kështu, profesionisti kontabël sillet në atë mënyrë që kontribuon në ushtrimin e skepticizmit profesional.

PJESA 2 - PROFESIONISTËT KONTABËL TE PUNESUAR

Seksioni 200	Zbatimi i kuadrit konceptual – profesionistët kontabël të punësuar (në biznes)	45
Seksioni 210	Konfliktet e interesit	50
Seksioni 220	Përgatitja dhe paraqitja e informacionit	53
Seksioni 230	Sjellja bazuar në eksperiencë	58
Seksioni 240	Interesat financiare, kompensimi dhe nxitjet lidhur me raportimin financiar dhe vendimmarrjen	60
Seksioni 250	Nxitjet, përfshirë dhuratat dhe mikpritjen	62
Seksioni 260	Reagimi ndaj papajtueshmërisë me ligjet dhe rregullat	69
Seksioni 270	Presioni për shkeljen e parimeve themelore	81

PJESA 2 - PROFESIONISTËT KONTABËL TË PUNËSUAR

SEKSIONI 200

ZBATIMI I KUADRIT KONCEPTUAL – PROFESIONISTËT KONTABËL TË PUNËSUAR

Hyrje

- 200.1 Kjo Pjesë e Kodit përcakton kërkesat dhe materialin për zbatim për profesionistët kontabël në biznes kur zbatohet kuadri konceptual i dhënë në Seksionin 120. Ajo nuk përshkruan të gjitha faktet dhe rrethanat, përfshirë aktivitetet profesionale, interesat, dhe marrëdhëniet, që mund të hasen nga profesionistët kontabël të punësuar (në biznes), të cilat krijojnë ose mund të krijojnë kërcënime për pajtueshmërinë me parimet themelore. Prandaj, kuadri konceptual kërkon që profesionistët kontabël të punësuar, të jenë vigjilentë ndaj këtyre fakteve dhe rrethanave.
- 200.2 Investitorët, kreditorët, organizatat punëdhënëse dhe sektorët e tjerë të komunitetit të biznesit, si edhe qeveritë dhe publiku në përgjithësi, mund të mbështeten në punën e profesionistëve kontabël të punësuar. Profesionistët kontabël të punësuar mund të jenë vetëm ose bashkërisht përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin e informacioneve financiare dhe informacioneve të tjera, mbi të cilat mund të mbështeten si organizatat e tyre punëdhënëse ashtu edhe palët e treta. Gjithashtu, ata mund të jenë përgjegjës për sigurimin e menaxhimit efektiv financiar dhe dhënien e këshillave kompetente për një shumëllojshmëri çështjesh të lidhura me biznesin.
- 200.3 Një profesionist kontabël i punësuar mund të jetë një punonjës, kontraktor, partner, drejtor (ekzekutiv ose jo ekzekutiv), pronar - menaxher ose vullnetar i një organizate punëdhënëse. Forma juridike e marrëdhënies së profesionistit kontabël me organizatën punëdhënëse nuk ka ndikim në përgjegjësitë etike të profesionistit kontabël.
- 200.4 Në këtë Pjesë, termi “profesionist kontabël” i referohet:
- (a) Një profesionisti kontabël të punësuar; dhe
 - (b) Një individ që është një profesionist kontabël në praktikën publike (që e ushtron profesionin në mënyrë të pavarur) kur ai kryen veprimtari profesionale nëpërmjet një marrëdhënie të profesionistit kontabël me firmën, qoftë si kontraktues, punonjës

apo pronar. Më shumë informacion mbi faktin se kur Pjesa 2 është e zbatueshme për profesionistët kontabël në praktiken publike, jepet në paragrafët K120.4, K300.5 dhe 300.5 A1.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

K200.5 Një profesionist kontabël do të veprojë në përputhje me parimet themelore të dhëna në Seksionin 110 dhe të zbatojë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore.

200.5 A1 Një profesionist kontabël ka përgjegjësinë për të çuar më tej objektivat legjitime të organizatës që e punëson atë. Kodi nuk synon të pengojë profesionistët kontabël të përmbushin këtë përgjegjësi, por ai trajton rrethanat në të cilat mund të kompromentohet pajtueshmëria me parimet.

200.5 A2 Profesionistët kontabël mund të promovojnë pozitën e organizatës së tyre punëdhënëse kur çojnë më tej qëllimet dhe objektivat e saj, po që se deklaratat e bëra prej tyre nuk janë as të rreme e as çorientuese. Veprime të tilla zakonisht nuk do të krijojnë një kërcënim të favorizimit.

200.5 A3 Sa më i lartë të jetë pozicioni i një profesionisti kontabël, aq më e madhe është aftësia dhe mundësia e tij për të patur akses në informacione dhe, për të influencuar politikat, vendimet dhe veprimet e ndërmarra nga personat e tjerë të përfshirë në organizatën punëdhënëse. Deri në masën që është e mundur, duke patur parasysh pozicionin dhe rolin e tyre në organizatë, profesionistët kontabël pritet të inkurajojnë dhe të promovojnë brenda organizatës një kulturë të bazuar në etikë. Shembuj të veprimeve që mund të ndërmerren përfshijnë paraqitjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e:

- Programeve të edukimit dhe trajnimit mbi etikën.
- Proceseve të menaxhimit dhe vlerësimit të performancës dhe kriterëve të vlerësimit që promovojnë një kulturë etike
- Politikave të etikës dhe paralajmërimeve.
- Politikave dhe procedurave që synojnë të pengojnë papajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat.

Identifikimi i kërcënimeve

200.6 A1 Kërcënimet për pajtueshmërinë me parimet themelore mund të

krijohen nga një larmishmëri faktesh dhe rrethanash. Kategoritë e kërcënimeve janë të përshkruara në paragrafin 120.6 A3. Më poshtë jepen shembuj të fakteve apo rrethanave për secilën nga këto kategori, të cilat mund të krijojnë kërcënime për një profesionist kontabël, kur ai ndërmerr një veprimtari profesionale:

- (a) Kërcënimet e Egoizmit (interesit vetjak)
 - Një profesionist kontabël ka një interes financiar në organizatën punëdhënëse apo merr një hua apo garanci nga organizata e tij.
 - Një profesionist kontabël merr pjesë në një marrëveshje nxitëse kompensimi, të propozuar nga organizata punëdhënëse.
 - Një profesionist kontabël ka akses në përdorimin personal të aktiveve të korporatës.
 - Një profesionisti kontabël i ofrohet një dhuratë apo trajtim i veçantë nga një furnitor i organizatës punëdhënëse.
- (b) Kërcënimet e Vetë rishikimit
 - Një profesionist kontabël përcakton trajtimin e duhur kontabël për një kombinim biznesi pas kryerjes së studimit të fizibilitetit mbi të cilin është mbështetur vendimi i blerjes.
- (c) Kërcënimet e Favorizimit
 - Një profesionist kontabël ka mundësinë të manipulojë informacionet në një parashikim financiar (prospekt) në mënyrë që të sigurojë financime favorizuese.
- (d) Kërcënimet e Familjaritetit
 - Një profesionist kontabël është përgjegjës për raportimin financiar të organizatës punëdhënëse, në kohën kur një anëtar i afërt ose i ngushtë i familjes, i punësuar nga organizata, merr vendime që ndikojnë raportimin financiar të organizatës.
 - Një profesionist kontabël ka një lidhje të gjatë me individët, të cilët influencojnë vendimet e biznesit.
- (e) Kërcënimet e Frikësimit
 - Një profesionist kontabël ose një anëtar i drejtpërdrejtë ose i afërt i familjes, përballet me kërcënimin e largimit nga puna apo të zëvendësimit për shkak të një mosmarrëveshje lidhur me:
 - Zbatimin e një parimi kontabël.
 - Mënyrën se si duhet të raportohet informacioni financiar.
 - Një individ përpiket të influencojë procesin e vendimmarrjes të profesionistit kontabël, për shembull, në lidhje me dhënien e kontratave ose zbatimin e një parimi kontabël.

Vlerësimi i kërcënimeve

- 200.7 A1 Kushtet, politikat dhe procedurat e përshkruara në paragrafët 120.6A1 dhe 120.8 A2 mund të ndikojnë në vlerësimin nëse kërcënimi ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore është në një nivel të pranueshëm.
- 200.7 A2 Vlerësimi nga profesionisti kontabël i nivelit të një kërcënimi ndikohet gjithashtu, nga natyra dhe objekti i veprimtarisë profesionale.
- 200.7 A3 Vlerësimi nga profesionisti kontabël i nivelit të një kërcënimi mund të ndikohet nga mjedisi i punës brenda organizatës punëdhënëse dhe mjedisi i saj operativ. Për shembull:
- Lidershipi e vë theksin në rëndësinë e sjelljes etike dhe në pritshmërinë që punonjësit do të veprojnë në mënyrë etike.
 - Politikat dhe procedurat që i japin mundësi dhe inkurajojnë punonjësit të komunikojnë me nivelet e larta të menaxhimit për çështjet etike që i shqetësojnë, pa patur frikë se mund të ndëshkohen.
 - Politikat dhe procedurat për të zbatuar dhe monitoruar cilësinë performancës së punonjësve.
 - Sistemet e mbikëqyrjes së korporatës ose strukturat e tjera të mbikëqyrjes dhe kontrollet e brendshme të forta.
 - Procedurat e rekrutimit që theksojnë rëndësinë e punësimit të personelit kompetent dhe të kalibrit të lartë,
 - Komunikimi në kohë të politikave dhe procedurave, përfshirë ndryshimet e tyre, me të gjithë punonjësit dhe trajnimin dhe edukimin e duhur mbi këto politika dhe procedura.
 - Etika dhe kodi i politikave të sjelljes.
- 200.7 A4 Profesionistët kontabël mund të konsiderojnë marrjen e këshillave juridike kur besojnë se kanë ndodhur sjellje ose veprime jo etike nga të tjerë, ose ato do të vazhdojnë të ndodhin, brenda organizatës punëdhënëse.

Adresimi i kërcënimeve

- 200.8 A1 Seksionet 210 deri 270 përshkruajnë disa kërcënime që mund të shfaqen gjatë kryerjes së veprimtarive profesionale dhe përfshijnë shembuj të veprimeve që mund të adresojnë këto kërcënime.
- 200.8 A2 Në situata ekstreme, nëse rrethanat që krijuan kërcënimet nuk mund të eliminohen dhe nuk ka masa mbrojtëse disponibël, ose ato nuk mund të zbatohen për të zvogëluar kërcënimin në një nivel të

pranueshëm, mund të jetë e përshtatshme që një profesionist kontabël të japë dorëheqjen nga organizata punëdhënëse.

Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen

- K200.9** Kur komunikon me personat e ngarkuar me qeverisjen në përputhje me Kodin, një profesionist kontabël duhet të përcaktojë individin(ët) e duhur, brenda strukturës qeverisëse të organizatës punëdhënëse, me të cilin(ët) duhet të komunikojë. Nëse profesionisti kontabël komunikon me një nëngrup të personave të ngarkuar me qeverisjen, ai do të përcaktojë nëse komunikimi me të gjithë personat e ngarkuar me qeverisjen është gjithashtu, i nevojshëm në mënyrë që ata të jenë të informuar mjaftueshëm.
- 200.9 A1 Për të përcaktuar se me kë të komunikojë, një profesionist kontabël mund të marrë në konsideratë:
- (a) Natyrën dhe rëndësinë e rrethanave; dhe
 - (b) Çështjen që do të komunikohet.
- 200.9 A2 Shembuj të një nëngrupi të personave të ngarkuar me qeverisjen janë një komitet auditimi ose një anëtar i veçantë i personave të ngarkuar me qeverisjen
- K200.10** Nëse një profesionist kontabël komunikon me individët që kanë përgjegjësi drejtuese si edhe përgjegjësi qeverisëse, profesionisti kontabël duhet të jetë i bindur se komunikimi me këta individë informon në mënyrë të përshtatshme të gjithë personat në një rol qeverisës me të cilët profesionisti, përndryshe, do të duhej të komunikonte.
- 200.10 A1 Në disa rrethana, të gjithë personat e ngarkuar me qeverisjen janë të përfshirë në menaxhimin e organizatës punëdhënëse, për shembull, në një biznes të vogël, ku një pronar i vetëm administron organizatën dhe askush tjetër nuk ka rol qeverisës. Në këto raste, nëse çështjet komunikohen me individët, që kanë përgjegjësi drejtuese, dhe këta individë kanë gjithashtu, përgjegjësi qeverisëse, profesionisti kontabël e ka përmbyshur kërkesën për të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen.

SEKSIONI 210

KONFLIKTET E INTERESIT

Hyrje

- 210.1 Profesionistët kontabël kërkohet të respektojnë parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të përshkruar në Seksionin 120, për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 210.2 Një konflikt interesi krijon një kërcënim për objektivitetin dhe mund të krijojë kërcënime për pajtueshmërinë edhe me parimet e tjera themelore. Këto kërcënime mund të krijohen kur:
- (a) Profesioni kontabël ndërmerr një aktivitet profesional që ka të bëjë me një çështje të veçantë për dy ose më shumë palë, interesat e të cilave në lidhje me këtë çështje, janë në konflikt; ose
 - (b) Interesat e profesionistit kontabël në lidhje me një çështje të veçantë dhe interesat e një pale për të cilën profesionisti kontabël ndërmerr një aktivitet profesional të lidhur me atë çështje, janë në konflikt.
- Një palë mund të jetë një organizatë punëdhënëse, një shitës, një klient, një huadhënës, një aksionar ose një palë tjetër.
- 210.3 Ky Seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual për konfliktet e interesit.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- K201.4** Një profesionist kontabël nuk do të lejojë një konflikt interesi që kompromenton gjykimin profesional ose të biznesit.
- 210.4 A1 Shembuj të rrethanave që mund të krijojnë një konflikt interesi janë:
- Rastet kur u shërbehet dy ose më shumë organizatave punëdhënëse në një pozicion menaxherial ose qeverisës dhe, marrja e informacionit konfidencial nga njëra organizatë punëdhënëse, mund të përdoret nga profesionisti kontabël për avantazhin apo dizavantazhin e organizatës tjetër punëdhënëse.
 - Ndërmarrja e një aktiviteti profesional për secilën nga dy palët në një ortakëri, kur të dy palët punësojnë profesionistin kontabël, për t'i ndihmuar ato në procesin e ndarjes së tyre.
 - Përgatitja e informacionit financiar për disa anëtarë të drejtimit të

organizatës punëdhënëse të profesionistit kontabël, të cilët kërkojnë të ndërmarrin një veprimtari menaxheriale të pasqerjes.

- Të qenit përgjegjës për zgjedhjen e një shitësi për organizatën punëdhënëse kur një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së profesionistit kontabël mund të përfitojë financiarisht nga transaksioni.
- Shërbimi në cilësinë e organit qeverisës në një organizatë punëdhënëse që aprovon disa investime për kompaninë kur njëri prej këtyre investimeve do të shtojë vlerën e portofolit të investimit personal të profesionistit kontabël ose të një anëtarit të ngushtë të familjes së tij.

Identifikimi i konflikteve

K210.5 Një profesionist kontabël do të ndërmarrë hapa të arsyeshme për të identifikuar rrethanat që mund të krijojnë një konflikt interesi dhe si pasojë, një kërcënim ndaj pajtueshmërisë me një ose më shumë parime themelore. Këto hapa duhet të përfshijnë identifikimin e:

- (a) Natyrës së interesave përkatëse dhe marrëdhëniet midis palëve të përfshira; dhe
- (b) Natyrës së aktivitetit dhe domethënien e tij për palët përkatëse.

K210.6 Një profesionist kontabël i punësuar do të mbetet vigjilent për ndryshimet që ndodhin me kalimin e kohës, në natyrën e aktiviteteve, interesat dhe marrëdhëniet, të cilat mund të krijojnë një konflikt interesi gjatë kryerjes së një aktiviteti profesional.

Kërcënimet e krijuara nga konflikti i interesit

210.7 A1 Në përgjithësi, sa më e drejtpërdrejtë të jetë lidhja midis aktivitetit profesional dhe çështjes mbi të cilën interesat e palëve janë në konflikt, aq më të mëdha janë gjasat që kërcënimin të mos jetë në një nivel të pranueshëm.

210.7 A2 Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë kërcënimet e krijuara nga konfliktet e interesit, është tërheqja nga procesi i vendimmarrjes në lidhje me çështjen që çon në konflikt interesi.

210.7 A3 Shembuj të veprimeve, të cilat mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për të adresuar kërcënimet e krijuara nga konfliktet e interesit përfshijnë:

- Ristrukturimin ose ndarjen e disa përgjegjësisë dhe detyrave.
- Sigurimin e një mbikëqyrje të përshtatshme, për shembull nën mbikëqyrjen e një drejtori ekzekutiv ose jo ekzekutiv.

Dhënia e informacionit dhe pëlqimit

Të përgjithshme

210.8 A1 Përgjithësisht është e nevojshme:

- (a) Të jepen informacione shpjeguese për natyrën e konfliktit dhe mënyrën si janë adresuar kërcënimet e krijuara për palët përkatëse, përfshirë nivelet e duhura brenda organizatës punëdhënëse të ndikuara nga një konflikt; dhe
- (b) Të sigurohet pëlqimi nga palët përkatëse për ndërmarrjen e aktivitetit profesional nga profesionisti kontabël i punësuar kur zbatohen masat mbrojtëse për të adresuar kërcënimin.

210.8 A2 Pëlqimi mund të ndikohet nga sjellja e një pale, në rrethanat kur profesionisti kontabël ka evidencë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se palët i njohin rrethanat që në fillim dhe se e kanë pranuar konfliktin e interesit, nëse ato nuk kanë ndonjë kundërshtim për ekzistencën e konfliktit.

210.8 A3 Kur dhënia e këtyre informacioneve ose pëlqimi nuk është bërë me shkrim, profesionisti kontabël i punësuar inkurajohet të dokumentojë:

- (a) Natyrën e rrethanave që çojnë në konflikt interesi;
- (b) Masat mbrojtëse të zbatuara për të adresuar kërcënimet, kur kjo është e mundur; dhe
- (c) Marrjen e pëlqimit.

Konsiderata të tjera

210.9 A1 Kur adreson një konflikt interesi, një profesionist kontabël i punësuar inkurajohet të kërkojë udhëzime brenda organizatës punëdhënëse ose nga të tjerët, siç është për shembull, një organizëm profesional, një këshilltar ligjor ose një profesionist tjetër kontabël. Kur jep informacionet shpjeguese ose ndan informacionet brenda organizatës punëdhënëse dhe kërkon udhëzime nga palët e treta, profesionisti kontabël duhet të zbatojë parimin e konfidencialitetit.

SEKSIONI 220

PËRGATITJA DHE PARAQITJA E INFORMACIONIT

Hyrje

- 220.1 Profesionistët kontabël kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual që jepet në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 220.2 Përgatitja ose paraqitja e informacionit mund të krijojë një kërcënim të egoizmit, të frikësimit ose kërcënime të tjera ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore. Ky Seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 220.3 A1 Profesionistët kontabël të punësuar në një organizatë punëdhënëse në të gjitha nivelet, mund të përfshihen në përgatitjen dhe paraqitjen e informacionit, si brenda ashtu edhe jashtë organizatës punëdhënëse.
- 220.3 A2 Palët e interesuara nga të cilat, apo për të cilat është përgatitur ose paraqitur ky informacion, përfshijnë:
- Menaxhimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen.
 - Investitorët dhe huadhënësit ose kreditorët e tjerë.
 - Organet rregullatore.

Ky informacion mund të ndihmojë palët e interesuara në kuptimin dhe vlerësimin e aspekteve të gjendjes së punëve të organizatës punëdhënëse dhe në marrjen e vendimeve në lidhje me organizatën. Informacioni mund të përfshijë informacionet financiare dhe jo financiare, të cilat mund të bëhen publike ose të përdoren për qëllime të brendshme.

Shembujt përfshijnë:

- Raportet e veprimtarisë dhe të performancës.
- Analizat që mbështesin vendimet.
- Buxhetet dhe parashikimet.
- Informacionet që u jepen audituesve të jashtëm dhe të brendshëm.
- Analizën e rreziqeve.
- Pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme ose për qëllime specifike.

- Deklaratat tatimore.
- Raportet e paraqitura pranë organeve rregullatore për qëllime ligjore dhe të pajtueshmërisë.

220.3 A3 Për qëllime të këtij seksioni, përgatitja ose paraqitja e informacionit përfshin dokumentimin, ruajtjen dhe miratimin e informacionit.

K220.4 Kur përgatit dhe paraqet informacione, profesionisti kontabël i punësuar do të:

- Përgatisë ose paraqesë informacionet në pajtueshmëri me kuadrin përkatës të raportimit, kur kjo është e zbatueshme;
- Përgatisë ose paraqesë informacionet në një mënyrë që nuk kërkon as të çorientojë dhe as të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme rezultatet kontraktuale ose rregullatore;
- Ushtrijë gjykimin profesional për të:
 - Ri paraqitur faktet me saktësi dhe në mënyrë të plotë në të gjitha aspektet materiale;
 - Përshkruar qartë natyrën e vërtetë të transaksioneve ose të aktiviteteve të biznesit;
 - Klasifikuar dhe regjistruar informacionet në kohën dhe mënyrën e duhur; dhe
- Nuk do të lerë jashtë në mënyrë të qëllimshme asnjë informacion, për të dhënë informacion që çorienton ose influencon në mënyrë të papërshtatshme rezultatet kontraktuale ose rregullatore;
- Shmangë influencën e tepërt, ose mbështetjen e papërshtatshme tek individët, organizatat ose teknologjia;
- Jetë i ndërgjegjshëm për rrezikun e paragjykitimit;

220.4 A1 Një shembull i influencimit të papërshtatshëm të një rezultati kontraktor ose rregullator është përdorimi i një vlerësimi me çmuarje jorealiste, me qëllimin për të shmangur shkeljen e një kërkesë kontraktuale siç është një kontratë (marrëveshje) borxhi ose një kërkesë rregullatore siç është kërkesa për kapital për një institucion financiar.

Përdorimi i liri veprimit në përgatitjen ose paraqitjen e informacionit

K220.5 Përgatitja ose paraqitja e informacionit mund të kërkojë ushtrimin e liri veprimit në bërjen e gjykimeve profesionale. Profesionisti kontabël nuk do të ushtrojë këtë liriveprimi në funksion të çorientimit të të tjerëve, apo të influencimit në mënyrë të papërshtatshme të rezultateve kontraktuale ose rregullatore.

220.5 A1 Shembuj të mënyrave në të cilat liriveprimi mund të keqpërdoret për të arritur rezultate të papërshtatshme, përfshijnë:

- Përcaktimin e çmuarjeve, për shembull, përcaktimi i çmuarjeve të vlerës së drejtë në mënyrë që të keq paraqitet fitimi ose humbja.
- Përzgjedhjen ose ndryshimin e një politike ose metode kontabël ndërmjet dy ose më shumë alternativave të lejuara sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar, për shembull, zgjedhja e një politike për trajtimin kontabël të kontratave afatgjata me qëllim që të keq paraqitet fitimi ose humbja.
- Përcaktimin e afateve të transaksioneve, për shembull, koha e shitjes së një aktivi afër fundit të vitit fiskal në mënyrë që të çorientojë.
- Përcaktimin e strukturimit të transaksioneve, për shembull, strukturimi i transaksioneve të financimit në mënyrë që të mos paraqiten siç duhet aktivet dhe detyrimet ose klasifikimi i flukseve monetare.
- Përzgjedhjen e informacioneve shpjeguese, për shembull, lënia jashtë apo fshehja e informacionit që lidhet me rrezikun financiar ose operacional, në mënyrë që të çorientojë.

K220.6 Gjatë kryerjes së aktiviteteve profesionale, veçanërisht të atyre që nuk kërkojnë pajtueshmërinë me një kuadër përkatës të raportimit, profesionisti kontabël do të ushtrojë gjykimin profesional për të identifikuar dhe marrë parasysh:

- (a) Qëllimin për të cilin do të përdoret informacioni;
- (b) Kontekstin brenda të cilit është dhënë informacioni; dhe
- (c) Publikun, të cilit ai i drejtohet.

220.6 A1 Për shembull, kur përgatiten ose paraqiten raporte paraprake, buxhete ose parashikime, përfshirja e çmuarjeve, përafrimeve dhe supozimeve përkatëse, kur është e përshtatshme, do t'ju jepte mundësi atyre që të mund të mbështeten në këto informacione, për të formuar gjykimet e tyre.

220.6 A2 Profesionisti kontabël mund të konsiderojë gjithashtu, sqarimin e publikut të synuar, kontekstin dhe qëllimin e informacionit që do të paraqitet.

Mbështetja në punën e të tjerëve

K220.7 Një profesionist kontabël i cili parashikon të mbështetet në punën e të tjerëve, qoftë të brendshëm apo të jashtëm të organizatës punëdhënëse, do të përdorë gjykimin profesional, për të përcaktuar se cilat hapa do të ndërmarrë, në mënyrë që të përmbushë përgjegjësitë e përcaktuara në paragrafin K220.4.

220.7 A1 Faktorët që duhet të merren parasysh në përcaktimin nëse mbështetja tek të tjerët është e arsyeshme, përfshijnë:

- Reputacionin, ekspertizën dhe burimet e mundshme të individit ose organizatës tjetër.
- Nëse individi tjetër i nënshtrohet standardeve të zbatueshme profesionale dhe etike.

Një informacion i tillë mund të merret nga lidhja e mëparshme me ekspertin ose nga konsultimi me të tjerët, në lidhje me individin ose organizatën tjetër.

Adresimi i informacionit që është ose mund të jetë çorientues

K220.8 Kur profesionisti kontabël ka dijeni ose ka arsye të besojë se informacioni me të cilin profesionisti kontabël ka lidhje, është çorientues, ai do të ndërmarrë veprimet e duhura për të zgjidhur çështjen.

220.8 A1 Veprimet që mund të jenë të përshtatshme përfshijnë:

- Diskutimin e shqetësimeve se informacioni është çorientues, me eprorin e profesionistit kontabël dhe/ose me nivelin e duhur të menaxhimit brenda organizatës punëdhënëse të profesionistit kontabël ose të personave të ngarkuar me qeverisjen, si dhe kërkimin nga këta individë që të ndërmarrin veprimet e përshtatshme për të zgjidhur çështjen. Këto veprime mund të përfshijnë:
 - Korrigjimin e informacionit.
 - Kur informacioni ju është dhënë përdoruesve përkatës, informimin e tyre për informacionin e saktë.
- Konsultimin me politikat dhe procedurat e organizatës punëdhënëse (për shembull, një politikë e etikës ose parandaluese) lidhur me mënyrën e adresimit të çështjeve të tilla nga brenda.

220.8 A2 Profesionisti kontabël mund të arrijë në përfundimin që organizata punëdhënëse nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura. Në qoftë se profesionisti kontabël vazhdon të ketë arsye të besojë se informacioni është çorientues, veprimet e mëposhtme, të mëtijshme, mund të jenë të përshtatshme, me kusht që profesionisti të qëndrojë vigjilent ndaj parimit të konfidencialitetit:

- Konsultimi me:
 - Një organizëm të duhur profesional.
 - Audituesin e brendshëm ose të jashtëm të organizatës

- punëdhënëse.
- Një këshilltar ligjor.
- Përcaktimi nëse ekzistojnë kërkesa për të komunikuar me:
 - Palët e treta, përfshirë përdoruesit e informacionit.
 - Autoritetet rregullatore dhe të mbikëqyrjes.

K220.9 Nëse pas ezaurimit të të gjitha opsioneve të mundshme, profesionisti kontabël arrin në përfundimin se nuk janë ndërmarrë veprimet e përshtatshme dhe ekziston arsye për të besuar se informacioni është ende çorientues, profesionisti kontabël do të refuzojë të jetë apo të vazhdojë të jetë i lidhur me informacionin.

220.9 A1 Në këto rrethana, mund të jetë e përshtatshme që profesionisti kontabël të japë dorëheqjen nga organizata punëdhënëse.

Dokumentimi

220.10 A1 Profesionisti kontabël i punësuar inkurajohet të dokumentojë:

- Faktet.
- Parimet kontabël ose standardet e tjera profesionale përkatëse të përfshira.
- Komunikimet dhe palët me të cilat u diskutuan çështjet.
- Drejtimit e veprimit të marra në konsideratë.
- Mënyrën si profesionisti kontabël u përpoq të adresonte çështjen(et).

Konsiderata të tjera

220.11 A1 Kur kërcënimet ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore në lidhje me përgatitjen ose paraqitjen e informacionit lindin nga një interes financiar, përfshirë kompensimin dhe nxitjet e lidhura me raportimin financiar dhe vendimmarrjen, do të zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim i dhënë në Seksionin 240.

220.11 A2 Kur informacioni çorientues mund të përfshijë papajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat, do të zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim i dhënë në Seksionin 260.

220.11 A3 Kur kërcënimet për pajtueshmërinë me parimet themelore lidhur me përgatitjen ose paraqitjen e informacionit lindin nga presioni, do të zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim i dhënë në Seksionin 270.

SEKSIONI 230

KRYERJA E DETYRËS ME EKSPERTIZËN E NEVOJSHME

Hyrje

- 230.1 Profesionistët kontabël kërkohet të respektojnë parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120, për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 230.2 Të vepruarit pa ekspertizën e mjaftueshme krijon një kërcënim të interesit vetjak ndaj pajtueshmërisë me parimin e kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur. Ky Seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- K230.3 Një profesionist kontabël i punësuar nuk duhet të çorientojë në mënyrë të qëllimshme një organizatë punëdhënëse në lidhje me nivelin e ekspertizës ose të eksperiencës që zotëron.
- 230.3 A1 Parimi themelor i kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur kërkon që një profesionist kontabël i punësuar të marrë përsipër të kryejë vetëm ato detyra të rëndësishme për të cilat ai zotëron ose ka mundësi të marrë trajnimin apo eksperiencën specifike të nevojshme.
- 230.3 A2 Një kërcënim i egoizmit ndaj pajtueshmërisë me parimin e kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur mund të krijohet në qoftë se profesionisti kontabël ka:
- Kohë të pamjaftueshme për të kryer ose plotësuar detyrat përkatëse.
 - Informacion jo të plotë, të kufizuar ose të papërshtatshëm për kryerjen e detyrave.
 - Eksperiencë, përvojë, trajnim dhe / ose edukim të pamjaftueshëm.
 - Burime të papërshtatshme për kryerjen e detyrave.
- 230.3 A3 Faktorët e përshtatshëm që lidhen me vlerësimin e nivelit të këtij kërcënimi përfshijnë:

- Shkallën në të cilën profesionisti kontabël i punësuar bashkëpunon me të tjerët.
- Vjetërsinë relative të profesionistit kontabël në punë.
- Nivelin e mbikëqyrjes dhe të rishikimit që zbatohet për punën.

230.3 A4 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për trajtimin e këtyre kërcënimeve të egoizmit, përfshijnë:

- Marrjen e asistencës apo trajnimit nga dikush me ekspertizën e nevojshme.
- Garantimin se ekziston koha e mjaftueshme për të përfunduar detyrat përkatëse.

K230.4 Nëse një kërcënim ndaj parimit të kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur nuk mund të adresohet, profesionisti kontabël i punësuar do të vlerësojë nëse ai duhet të refuzojë ose jo kryerjen e detyrave në fjalë. Nëse profesionisti kontabël i punësuar vlerëson se duhet të bëjë refuzimin, atëherë ai do të komunikojë qartë arsyet pse e ka bërë një gjë të tillë.

Konsiderata të tjera

230.5 A1 Kërkesat dhe materiali për zbatim në Seksionin 270 zbatohen kur një profesionist kontabël gjendet nën presion për të vepruar në një mënyrë që mund të çojë në një shkelje të parimit të kompetencës profesionale dhe të kujdesit të duhur.

SEKSIONI 240

INTERESAT FINANCIARE, KOMPENSIMI DHE NXITJET QË LIDHEN ME RAPORTIMIN FINANCIAR DHE VENDIMMARRJEN

Hyrje

- 240.1 Profesionistët kontabël kërkohet të respektojnë parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120, për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 240.2 Ekzistenca e një interesi financiar ose dijenia për një interes financiar të një anëtari të ngushtë ose të afërt të familjes së profesionistit kontabël, mund të krijojë një kërcënim të egoizmit ndaj parimit të objektivitetit ose të konfidencialitetit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- K240.3** Një profesionist kontabël i punësuar nuk do të manipulojë informacionin ose të përdorë informacionet konfidenciale për përfitime financiare personale apo në favor të të tjerëve.
- 240.3 A1 Profesionistët kontabël të punësuar mund të kenë interesa financiare, ose mund të jenë në dijeni për interesat financiare të anëtarëve të drejtpërdrejtë apo të ngushtë të familjes së tyre, të cilat në disa rrethana, mund të krijojnë kërcënime ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore. Interesat financiare përfshijnë ato interesa që lindin nga marrëveshjet e kompensimit ose të nxitjes, të lidhura me raportimin financiar dhe vendimmarrjen.
- 240.3 A2 Shembuj të rrethanave që mund të krijojnë kërcënime të egoizmit përfshijnë ato situata kur profesionisti kontabël i punësuar ose një anëtar i drejtpërdrejtë apo anëtar i afërt i familjes së tij:
- Ka një motiv dhe mundësi për të manipuluar informacionet sensitive lidhur me çmimin, me qëllim përfitimin financiar;
 - Zotëron një interes financiar të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në organizatën punëdhënëse dhe vlera e këtij interesi financiar mund të ndikohet drejtpërdrejt nga vendimet që

merr profesionisti kontabël i punësuar;

- Ka të drejtën e një bonusi të lidhur me fitimin dhe vlera e këtij bonusi mund të ndikohet direkt nga vendimet e marra prej profesionistit kontabël të punësuar;
- Zotëron direkt ose indirekt opsionin që të shpërblehet nga organizata punëdhënëse me të drejta në aksione të shtyra në kohë ose me aksione, vlera e të cilave mund të ndikohet nga vendimet e marra prej profesionistit kontabël të punësuar;
- Merr pjesë në marrëveshje kompensimi të cilat ofrojnë nxitje për të arritur objektivat e performancës ose për të mbështetur përpjekjet për të maksimizuar vlerën e aksioneve të organizatës punëdhënëse. Një shembull i një marrëveshje të tillë mund të jetë përmes pjesëmarrjes në skemat nxitëse të cilat lidhen me përmbushjen e disa kriterëve të performancës.

240.3 A3 Faktoret e përshtatshëm që lidhen me vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve përfshijnë:

- Rëndësinë e interesit financiar. Se çfarë është një interes financiar i rëndësishëm, kjo do të varet nga rrethanat personale dhe materialiteti i interesave financiare të individit.
- Politikat dhe procedurat e një komiteti të pavarur të menaxhimit për përcaktimin e nivelit ose formës së shpërblimit të nivelit të lartë të menaxhimit.
- Në përputhje me politikat e brendshme, informimi i personave të ngarkuar me qeverisjen për:
 - Të gjitha interesat përkatëse.
 - Çfarëdolloj planesh për të ushtruar të drejtat apo për të tregtuar në aksionet përkatëse.
- Procedurat e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, që shërbejnë specifikisht për të adresuar probleme që çojnë në krijimin e interesit financiar.

240.3 A4 Kërcënimet e krijuara nga marrëveshje kompensimi ose nxitëse mund të komplikohen nga një presion i qartë ose i nënkuptuar nga eprorët ose kolegët. Shiko Seksionin 270, Presioni për të Shkelur Parimet Themelore.

SEKSIONI 250

NXITJET, PËRFSHIRË DHURATAT DHE MIKPRITJEN

Hyrje

- 250.1 Profesionistëve kontabël ju kërkohet të jenë në pajtim me parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 250.2 Ofrimi ose pranimi i nxitjeve mund të krijojë një kërcënim të egoizmit, familjaritetit ose të frikësimit ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore, veçanërisht ndaj parimit të integritetit, objektivitetit dhe sjelljes profesionale
- 250.3 Ky seksion përcakton kërkesat dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në lidhje me ofrimin dhe pranimin e nxitjeve, kur ndërmerren aktivitete profesionale që nuk përbëjnë papajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret. Ky seksion kërkon gjithashtu, që profesionisti kontabël i punësuar të jetë në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse kur jep ose pranon nxitje.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 250.4 A1 Një nxitje është një objekt, situatë ose veprim që përdoret si një mjet për të ndikuar në sjelljen e një individi tjetër, por jo domosdoshmërisht me qëllimin për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në sjelljen e këtij individi. Nxitjet mund të variojnë që nga akte të vogla mikpritje midis kolegëve në biznes, deri tek veprime që rezultojnë në papajtueshmëri me ligjet dhe rregullat. Nxitjet mund të kenë forma të ndryshme, për shembull:
- Dhuratat.
 - Mikpritja.
 - Argëtimi.
 - Donacione politike ose bamirësie.
 - Joshjet për miqësi ose besnikëri.
 - Punësimi ose mundësi të tjera tregtie.
 - Trajtimi preferencial, të drejta dhe privilegje.

Nxitjet që ndalohen nga ligjet dhe rregullat

- R250.5 Në shumë juridiksione, ekzistojnë ligje dhe rregulla, siç janë ato që

lidhen me ryshfetin dhe korrupsionin, të cilat ndalojnë ofrimin ose pranimin e nxitjeve në disa rrethana. Profesionisti kontabël do të duhet të kuptojë ligjet dhe rregullat përkatëse dhe t'i zbatojë ato kur përballat me rrethana të tilla.

Nxitje që nuk ndalohen nga ligjet dhe rregullat

250.6 A1 Dhënia ose pranimi i nxitjeve që nuk është i ndaluar nga ligjet dhe rregullat përsëri mund të krijojë kërcënime ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore.

Nxitjet me qëllim influencimin e papërshtatshëm të sjelljes

K250.7 Një profesionist kontabël i punësuar nuk do të japë ose të inkurajojë të tjerët të japin nxitje që kanë për qëllim, apo që profesionisti kontabël vlerëson se, një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar do të vlerësonte se kanë për qëllim të influencojnë në mënyrë të papërshtatshme sjelljen e marrësit të nxitjes ose të një individi tjetër.

K250.8 Një profesionist kontabël i punësuar nuk do të pranojë, ose të inkurajojë të tjerët të pranojnë nxitje që kanë për qëllim, apo që profesionisti kontabël vlerëson se, një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar do të vlerësonte se kanë për qëllim të influencojnë në mënyrë të papërshtatshme sjelljen e marrësit të nxitjes ose të një individi tjetër.

250.9 A1 Një nxitje konsiderohet se influencon në mënyrë të papërshtatshme sjelljen e një individi, nëse ajo bën që individi të veprojë në një mënyrë jo etike. Një influencim i tillë i papërshtatshëm, mund t'i drejtohet si marrësit të nxitjes, ashtu edhe një individi tjetër që ka një marrëdhënie me marrësin. Parimet themelore janë një kuadër i përshtatshëm reference për profesionistin kontabël, për vlerësimin se çfarë është një sjellje jo etike për profesionistin kontabël, dhe nëse është e nevojshme, për analogji, edhe për individët e tjerë.

250.9 A2 Një shkelje e parimit themelor të integritetit ndodh kur një profesionist kontabël i punësuar jep ose pranon, apo inkurajon të tjerët të ofrojnë ose të pranojnë një nxitje, qëllimi i të cilës është influencimi i papërshtatshëm i sjelljes së marrësit ose të një individi tjetër.

250.9 A3 Përcaktimi nëse ka një qëllim real ose të perceptuar për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme sjelljen, kërkon ushtrimin e gjykimit profesional. Faktorët përkatës që duhen marrë në konsideratë përfshijnë:

- Natyrën, frekuencën, vlerën dhe efektin kumulativ të nxitjes.
- Kohën kur është dhanë nxitja në lidhje me çdo veprim ose vendim që ajo mund të ketë influencuar.
- Faktin nëse nxitja është një zakon ose praktikë kulturore për rrethanat, për shembull, bërja e një dhurate me rastin e një feste fetare ose martesë.
- Faktin nëse nxitja është një pjesë ndihmëse e një aktiviteti profesional, për shembull dhënia ose pranimi i një dreke në lidhje me një takim biznesi.
- Faktin nëse dhënia e nxitjes është e kufizuar tek një individ marrës apo ajo është për një grup më të madh. Grupi më i madh mund të jetë i brendshëm ose i jashtëm për organizatën punëdhënëse, siç janë për shembull, klientët apo shitësit e tjerë.
- Rolet dhe pozicionet e individëve që japin ose ju jepet nxitja.
- Faktin nëse profesionisti kontabël i punësuar ka dijeni ose ka arsye të besojë se pranimi i nxitjes do të përbënte shkelje të politikave dhe procedurave të organizatës punëdhënëse të palës tjetër.
- Shkallën e transparencës me të cilën është dhënë nxitja.
- Faktin nëse nxitja ka qenë kërkuar ose u kërkuar nga marrësi.
- Sjellja e njohur e mëparshme ose reputacioni i ofruesit të nxitjes.

Marrja në konsideratë e veprimeve të mëtejshme

- 250.10 A1 Në qoftë se profesionisti kontabël i punësuar bëhet i vetëdijshëm në lidhje me një nxitje të ofruar me qëllimin real ose të perceptuar për të influencuar në mënyrë të papërshtatshme sjelljen, përsëri mund të krijohen kërcënime ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore, madje edhe nëse janë përmbushur kërkesat e dhëna në paragrafët K250.7 dhe K250.8.
- 250.10 A2 Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për adresimin e këtyre kërcënimeve janë:
- Informimi i niveleve të larta të drejtimit ose i personave të ngarkuar me qeverisjen e organizatës punëdhënëse të profesionistit kontabël apo të ofruesit lidhur me ofertën.
 - Ndryshimi ose ndërprerja e marrëdhënieve të biznesit me ofertuesit.

Nxitjet që nuk kanë për qëllim influencimin e papërshtatshëm të sjelljes

- 250.11 A1 Kërkesat dhe materiali për zbatim i dhënë në kuadrin konceptual zbatohen kur një profesionist kontabël ka konstatuar se nuk ekziston një qëllim real ose i perceptuar për të ndikuar në mënyrë të

papërshtatshme në sjelljen e marrësit të nxitësit apo të një individi tjetër.

250.11 A2 Nëse një nxitje e tillë është krejt e parëndësishme dhe pa pasoja, çdo kërcënim i krijuar do të jetë në një nivel të pranueshëm.

250.11 A3 Shembuj të rrethanave kur ofrimi ose pranimi i një nxitjeje të tillë mundtë krijojë kërcënime edhe pse profesionisti kontabël ka konstatuar se nuk ka ndonjë qëllim real ose të perceptuar për të influencuar në mënyrë të papërshtatshme sjelljen, përfshijnë:

- Kërcënimet e interesit vetjak (egoizmit)
 - Një profesionisti kontabël i ofrohet nga një shitës punësimi me kohë të pjesshme.
- Kërcënimet e familjaritetit
 - Një profesionist kontabël merr rregullisht një klient ose një furnitor për ndjekjen e eventeve sportive.
- Kërcënimet e frikësimit
 - Një profesionist kontabël pranon mikpritjen, natyra e së cilës mund të perceptohet si e papërshtatshme, nëse do të zbulohet publikisht.

250.11 A4 Faktorët e përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve të krijuara nga ofrimi ose pranimi i një nxitjeje të tillë, përfshijnë të njëjtët faktorë që jepen në paragrafin 250.9 A3 për përcaktimin e qëllimit të nxitjes.

250.11 A5 Shembuj të veprimeve që mund të eliminojnë kërcënimet e krijuara nga ofrimi ose pranimi i një nxitjeje të tillë përfshijnë:

- Refuzimin ose mos ofrimin e nxitjes.
- Transferimi i përgjegjësisë për çdo vendim të lidhur me biznesin që përfshin palën tjetër tek një individ tjetër, për të cilin profesionisti kontabël nuk ka arsye të besojë se do të ishte ose do të perceptohej se ka influencuar në mënyrë të papërshtatshme në vendimmarrje.

250.11 A6 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtje për të adresuar këto kërcënime, të krijuara nga ofrimi ose pranimi i një nxitjeje të tillë përfshijnë:

- Të qenurit transparent me nivelet e larta të drejtimit ose me personat e ngarkuar me qeverisjen e organizatës punëdhënëse të profesionistit kontabël ose të palës tjetër, në lidhje me ofrimin ose pranimin e një nxitjeje.

- Regjistrimin e nxitjes në një regjistër të mbajtur nga organizata punëdhënëse e profesionistit kontabël ose e palës tjetër.
- Angazhimin e një rishikuesit të përshtatshëm, i cili përndryshe, nuk është i përfshirë në kryerjen e veprimtarisë profesionale, për rishikimin e ndonjë punë të kryer ose të vendimeve të marra nga profesionisti kontabël në lidhje me individin ose organizatën nga e cila profesionisti kontabël ka pranuar nxitjen.
- Dhurimin e nxitjes për bamirësi pas marrjes së saj, dhe komunikimin e përshtatshëm të nxitjes, për shembull, me personat e ngarkuar me qeverisjen ose individin, i cili ka ofruar nxitjen.
- Rimbursimin e kostos së nxitjes, siç është mikpritja e marrë.
- Kthimin sa më shpejt të jetë e mundur, të nxitjes, siç është një dhuratë, pasi ajo ka qenë pranuar fillimisht.

Anëtarët e drejtpërdrejtë ose të afërt të familjes

K250.12 Një profesionist kontabël do të jetë vigjilent kundrejt kërcënimeve të mundshme ndaj pajtueshmërisë së tij me parimet themelore, që krijohen nga ofrimi i një nxitje:

- (a) Nga një anëtar i drejtpërdrejtë ose i afërt i familjes së profesionistit kontabël për një palë tjetër me të cilën profesionisti kontabël kanë lidhje profesionale; ose
- (b) Për një anëtar të drejtpërdrejtë ose të afërt të familjes së profesionistit kontabël nga një palë tjetër me të cilën profesionistikontabël ka një lidhje profesionale.

K250.13 Kur profesionisti kontabël bëhet i vetëdijshëm për një nxitje që i është ofruar ose i është bërë nga një anëtar i drejtpërdrejtë ose i afërt i familjes dhe arrin në përfundimin se nxitja ka qëllim të influencojë në mënyrë të papërshtatshme sjelljen e profesionistit kontabël ose të palës tjetër, apo vlerëson se një palë e tretë e informuar dhe e arsyeshme do të kishte të ngjarë të arrinte në përfundimin se ekziston një qëllim i tillë, profesionisti kontabël do të këshillojë anëtarin e drejtpërdrejtë ose të afërt të familjes që të mos ofrojë apo pranojë nxitjen.

250.13 A1 Faktorët që jepen në paragrafin 250.9 A3 janë të përshtatshëm në përcaktimin nëse ekziston qëllimi real ose i perceptuar për të influencuar në mënyrë të papërshtatshme sjelljen e profesionistit kontabël ose të palës tjetër. Një faktor tjetër i përshtatshëm është natyra ose afërsia e marrëdhënies midis:

- (a) Profesionistit kontabël dhe anëtarit të drejtpërdrejtë ose të afërt të familjes;
- (b) Anëtarit të drejtpërdrejtë ose të afërt të familjes dhe palës tjetër; dhe
- (c) Profesionistit kontabël dhe palës tjetër.

Për shembull, ofrimi punësimit, jashtë procesit normal të rekrutimit, për bashkëshortin(en) e profesionistit kontabël nga një palë tjetër, me të cilën ai është duke negociuar një kontratë të rëndësishme, mund të tregojë për një qëllim të tillë.

- 250.13 A2 Materiali për zbatim në paragrafin 250.10 A2 është gjithashtu i përshtatshëm për adresimin e kërcënimeve që mund të krijohen kur ekziston qëllim real ose i perceptuar për të influencuar në mënyrë të papërshtatshme sjelljen e profesionistit kontabël ose të palës tjetër, madje edhe nëse anëtari i drejtpërdrejtë ose i afërt i familjes ka ndjekur këshillat e dhëna sipas paragrafit K250.13.

Zbatimi i kuadrit konceptual

- 250.14 A1 Kur profesionisti kontabël bëhet i vetëdijshëm për një nxitje të ofruar në rrethanat e adresuara në paragrafin K250.12, kërcënimet ndaj respektimit të parimeve themelore mund të krijohen kur:
- (a) Anëtari i drejtpërdrejtë ose i afërt i familjes ofron ose pranon nxitjen në kundërshtim me këshillat e profesionistit kontabël sipas paragrafit K250.13; ose
 - (b) Profesionisti kontabël nuk ka arsye të besojë se ekziston një qëllim real ose i perceptuar për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme sjelljen e profesionistit kontabël të palës tjetër.
- 250.14 A2 Materiali për zbatim në paragrafët 250.11 A1 deri 250.11 A6 është i përshtatshëm për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar këto kërcënime. Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimeve në këto rrethana, përfshijnë gjithashtu natyrën ose afërsinë e marrëdhënieve që jepen në paragrafin 250.13 A1

Konsiderata të tjera

- 250.15 A1 Nëse një profesionisti kontabël i ofrohet një nxitje nga organizata punëdhënëse në lidhje me interesat financiare, për shpërblimin dhe stimujt e lidhur me performancën, zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim i dhënë në Seksionin 240.
- 250.15 A2 Nëse një profesionist kontabël përballet me, ose bëhet i vetëdijshëm për nxitjet që mund të rezultojnë në papajtueshmëri ose në

papajtueshmëri të dyshuar me ligjet dhe rregullat nga individë të tjerë që punojnë për ose nën drejtimin e organizatës punëdhënëse, zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim i dhënë në Seksionin 260.

- 250.15 A3 Nëse një profesionist kontabël përballet me presion për të ofruar ose pranuar nxitje që mund të krijojnë kërcënime ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore, zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim i dhënë në Seksionin 270.

SEKSIONI 260

REAGIMI NDAJ PAPAJTUESHMËRISË ME LIGJET DHE RREGULLAT

Hyrje

- 260.1 Profesionistët kontabël kërkohet të jenë në pajtim me parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual që jepet në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 260.2 Një kërcënim i egoizmit ose frikësimit ndaj pajtueshmërisë me parimet e integritetit dhe sjelljes profesionale, krijohet kur profesionisti kontabël bëhet i vetëdijshëm për papajtueshmëri ose papajtueshmëri të dyshuar me ligjet dhe rregullat.
- 260.3 Një profesionist kontabël mund të ndeshet ose të vihet në dijeni të papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar me ligjet dhe rregullat gjatë kryerjes së aktiviteteve profesionale. Qëllimi i këtij seksioni është të udhëzojë profesionistin kontabël për vlerësimin e ndikimeve të kësaj çështjeje dhe për drejtimet e mundshme të veprimeve për t'ju përgjigjur papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar me:
- (a) Ligjet dhe rregullat, përgjithësisht të njohura, që kanë një efekt të drejtpërdrejtë në përcaktimin e shumave materiale dhe të informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare të klientit; dhe
 - (b) Ligjet dhe rregullat e tjera, që nuk kanë një efekt të drejtpërdrejtë në përcaktimin e shumave materiale dhe të informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare të klientit, por që pajtueshmëria me to, mund të jetë thelbësore për aspektet operative të biznesit të klientit, për aftësinë e tij për të vazhduar biznesin, ose për të shmangur penalitetet materiale.

Objektivat e profesionistit kontabël në lidhje me papajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat

- 260.4 Një shenjë dalluese e profesionit kontabël është pranimi prej tij i përgjegjësisë për të vepruar në interesin publik. Kur i përgjigjet një papajtueshmërie ose papajtueshmërie të dyshuar, objektivat e profesionistit kontabël janë:
- (a) Të jetë në pajtim me parimet themelore të integritetit dhe sjelljes etike;

- (b) Të vërë në dijeni drejtimin ose, kur është e përshtatshme, personat e ngarkuar me qeverisjen e organizatës punëdhënëse, me qëllim që ata të:
 - (i). Bëjnë të mundur korrigjimin, riparimin ose zbutjen e pasojave të papajtueshmërisë së identifikuar apo dyshuar; ose
 - (ii). Të ndalojë papajtueshmërinë kur ajo nuk ka ndodhur ende; dhe
- (c) Të ndërmarrë veprime të mëtejshme të atilla që janë të përshtatshme dhe në interes të publikut

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

260.5 A1 Papajtueshmëria me ligjet dhe rregullat (“papajtueshmëria”) përfshin aktet e mosveprimit apo të veprimit, të qëllimshme apo të paqëllimshme, të cilat janë në kundërshtim me ligjet ose rregullat e zbatueshme, të kryera nga palët në vijim:

- (a) Organizata punëdhënëse e profesionistit kontabël;
- (b) Personat e ngarkuar me qeverisjen e organizatës punëdhënëse;
- (c) Drejtimi i organizatës punëdhënëse; ose
- (d) Individë të tjerë që punojnë për, ose sipas udhëzimeve të organizatës punëdhënëse.

260.5 A2 Shembuj të ligjeve ose rregullave që adreson ky seksion përfshijnë ato që kanë të bëjnë me:

- Mashtimin, korrupsionin dhe ryshfetin.
- Pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe të ardhurat nga krimi.
- Tregjet e letrave me vlerë dhe tregtimin.
- Bankingun dhe produkte e shërbime të tjera financiare.
- Mbrojtjen e të dhënave.
- Detyrimet dhe pagesat e taksave dhe të pensioneve.
- Mbrojtjen e mjedisit.
- Shëndetin dhe sigurinë publike.

260.5 A3 Papajtueshmëria mund të rezultojë në gjoba, padi gjyqësore ose pasoja të tjera për organizatën punëdhënëse, të cilat mund të kenë një efekt material në pasqyrat e saj financiare. Më e rëndësishme, një papajtueshmëri e tillë mund të ketë ndikime të gjera në interesin publik, përsa i përket një dëmi potencialisht të konsiderueshëm për investitorët, kreditorët, punonjësit apo publikun në përgjithësi. Për qëllime të këtij seksioni, një veprim që shkakton dëm të

konsiderueshëm është ai që rezulton në pasoja negative serioze për ndonjërin nga këto palë, në terma financiarë ose jo financiarë. Shembujt përfshijnë kryerjen e një mashtrimi që rezulton në humbje të mëdha për investitorët, dhe shkelje të ligjeve dhe rregullave mjedisore, të cilat rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e punonjësve apo publikut.

- K260.6 Në disa juridiksione, ekzistojnë dispozita ligjore ose rregullatore që tregojnë mënyrën se si profesionistët kontabël duhet të adresojnë papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar. Këto dispozita ligjore ose rregullatore mund të ndryshojnë nga ose shkojnë përtej dispozitave që jepen në këtë seksion. Kur has një papajtueshmëri ose papajtueshmëri të dyshuar të tillë, profesionisti kontabël ka përgjegjësinë të sigurojë njohjen dhe kuptimin e atyre dispozitave ligjore ose rregullatore dhe të jetë në pajtim me to, përfshirë:
- (a) Çdo kërkesë për të raportuar çështjen tek një autoritet i përshtatshëm; dhe
 - (b) Çdo ndalim për të njoftuar palën përkatëse.
- 260.6 A1 Një ndalim për të njoftuar palën përkatëse mund të lindë për shembull, në zbatim të ligjeve kundër pastrimit të parave.
- 260.7 A1 Ky seksion aplikohet pavarësisht natyrës së organizatës punëdhënëse, përfshirë faktin nëse ajo është apo jo një entitet me interes publik.
- 260.7 A2 Një profesionist kontabël, i cili ndeshet ose vihet në dijeni të çështjeve që janë krejt të parëndësishme, nuk kërkohet të jetë në pajtim me këtë seksion. Nëse një çështje është krejt e parëndësishme apo jo, ky fakt duhet gjykuar nga natyra dhe ndikimi i saj, financiar ose ndryshe, mbi organizatën punëdhënëse, palët e saj të interesuara dhe publikun në përgjithësi.
- 260.7 A3 Ky seksion nuk adreson:
- (a) Sjelljen e keqe personale të palidhur me aktivitetet e biznesit të organizatës punëdhënëse; dhe
 - (b) Papajtueshmëritë nga palë të tjera të ndryshme nga ato të specifikuara në paragrafin 260.5 A1.
- Megjithatë, profesionisti kontabël mund të gjejë udhëzime të dobishme në këtë seksion, kur ai vlerëson mënyrën se si të përgjigjet në këto situata.

Përgjegjësitë e drejtimit të organizatës punëdhënëse dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen

260.8 A1 Është përgjegjësi e drejtimit të organizatës punëdhënëse, me mbikëqyrjen e personave të ngarkuar me qeverisjen, që të sigurojnë se aktivitete të biznesit të organizatës punëdhënëse janë realizuar në përputhje me ligjet dhe rregullat. Është gjithashtu, përgjegjësi e drejtimit dhe e personave të ngarkuar me qeverisjen, për të identifikuar dhe adresuar çdo papajtueshmëri nga:

- (a) Organizata punëdhënëse;
- (b) Një individ i ngarkuar me qeverisjen e organizatës punëdhënëse;
- (c) Një anëtar i drejtimit; ose
- (d) Individë të tjerë që punojnë për dhe nën drejtimin e organizatës punëdhënëse.

Përgjegjësitë e të gjithë profesionistëve kontabël

K260.9 Nëse ekzistojnë protokolle dhe procedura brenda organizatës punëdhënëse të profesionistit kontabël, të cilat synojnë të adresojnë papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar, profesionisti kontabël do t'i mbajë ato parasysh, në përcaktimin e mënyrës se si të përgjigjet ndaj një papajtueshmërie të tillë.

260.9 A1 Shumë organizata punëdhënëse kanë vendosur protokolle dhe procedura lidhur me mënyrën se si duhet të ngrihen brenda organizatës punëdhënëse çështjet e papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar. Këto protokolle dhe procedura përfshijnë për shembull, një politikë etike ose një mekanizëm të brendshëm paralajmërues. Këto protokolle dhe procedura mund të lejojnë që çështjet të raportohen në mënyrë anonime nëpërmjet kanaleve të projektuara për këtë qëllim.

K260.10 Kur një profesionist kontabël vihet në dijeni të një çështje për të cilën aplikohet ky seksion, hapat që ndërmerr profesionisti kontabël për të qenë në pajtim me këtë seksion do të ndërmerren në mënyrë të vazhdueshme. Për këtë qëllim profesionisti kontabël do të mbajë parasysh natyrën e çështjes dhe dëmin potencial ndaj interesave të organizatës punëdhënëse, investitorëve, kreditorëve, punonjësve apo publikut në përgjithësi.

Përgjegjësitë e profesionistëve kontabël të shkallës senior në biznes

260.11 A1 Profesionistët kontabël që kanë pozicionin senior në biznes ("profesionistët kontabël senior") janë drejtorët, nëpunësit ose punonjës të tjerë senior, të cilët janë në gjendje të ushtrojnë ndikim të

rëndësishëm mbi, dhe të marrin vendime lidhur me, blerjen, shpërndarjen dhe kontrollin e burimeve njerëzore, financiare, teknologjike, fizike dhe të paprekshme të organizatës punëdhënëse. Ka një pritshmëri të madhe që këta individë do të ndërmarrin çfarëdolloj veprimi që është i përshtatshëm për interesin e publikut për t'iu përgjigjur papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar, që ndryshon nga ajo e profesionistëve të tjerë kontabël brenda organizatës punëdhënëse. Kjo, për shkak të roleve, pozicioneve dhe sferës së influencës të profesionistëve kontabël senior brenda organizatës punëdhënëse.

Sigurimi i njohjes dhe kuptimit të çështjes

K260.12 Nëse, gjatë kohës së kryerjes së aktiviteteve profesionale, një profesionist kontabël senior, vihet në dijeni të informacioneve lidhur me një rast papajtueshmërie ose papajtueshmërie të dyshuar, profesionisti kontabël do të sigurojë njohjen dhe kuptimin për çështjen, përfshirë:

- (a) Natyrën e veprimit dhe rrethanat në të cilat ai ka ndodhur ose mund të ndodhë;
- (b) Zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve përkatëse për rrethanat; dhe
- (c) Një vlerësim i pasojave të mundshme për organizatën punëdhënëse, investitorët, kreditorët, punonjësit ose publikun e gjerë.

260.12 A1 Një profesionist kontabël senior pritet të zbatojë njohuritë, gjykimin profesional dhe ekspertizën, por nuk pritet të ketë një nivel të njohjes dhe të kuptimit të ligjeve dhe rregullave përtej asaj që kërkohet për rolin e profesionistit kontabël brenda organizatës punëdhënëse. Fakti nëse një akt përbën papajtueshmëri, në fund të fundit është një çështje që do ta zgjidhë gjykata ose një organizëm tjetër vendimmarrës i përshtatshëm.

260.12 A2 Në varësi të natyrës dhe rëndësisë së çështjes, profesionisti kontabël senior mund të bëjë që, ose të ndërmarrë hapa të përshtatshëm për të bërë të mundur që, çështja të investigohet së brendshmi. Gjithashtu, profesionisti kontabël mund të konsultohet, duke ruajtur konfidencialitetin, me individë të tjerë brenda organizatës punëdhënëse apo organizmit profesional, ose me një këshilltar ligjor.

Adresimi i çështjes

K260.13 Nëse profesionisti kontabël senior identifikon ose dyshon se ka ndodhur ose mund të ndodhë një papajtueshmëri, profesionisti kontabël, subjekt

i paragrafit K260.9, do të diskutojë çështjen me profesionistin kontabël superior të tij, nëse ka. Nëse profesionisti kontabël superior duket se është i përfshirë në këtë çështje, profesionisti kontabël do të diskutojë çështjen me nivelin tjetër më të lartë të autoritetit brenda organizatës punëdhënëse.

260.13 A1 Ky diskutim ka si qëllim krijimin e mundësisë për të përcaktuar mënyrën se si duhet të adresohet çështja.

K260.14 Profesionisti kontabël senior do të ndërmarrë gjithashtu, hapa të arsyeshëm për të:

- (a) Komunikuar çështjen tek personat e ngarkuar me qeverisjen;
- (b) Qenë në pajtim me ligjet dhe rregullat në fuqi, përfshirë dispozitat ligjore dhe rregullatore që udhëheqin raportimin e papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar tek një autoritet i përshtatshëm;
- (c) Bërë korrigjimin, riparimin ose zbutjen e pasojave të papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar;
- (d) Reduktuar rrezikun e ri përsëritjes; dhe
- (e) Kërkuar frenimin e ndodhjes së papajtueshmërisë nëse ajo nuk ka ndodhur ende.

260.14 A1 Qëllimi i komunikimit të çështjes me personat e ngarkuar me qeverisjen është marrja e pëlqimit të tyre në lidhje me veprimet e duhura, për t'iu përgjigjur çështjes si dhe për t'u mundësuar atyre që të përmbushin përgjegjësitë e tyre.

260.14 A2 Disa ligje dhe rregulla mund të përcaktojnë një periudhë brenda së cilës raportet për papajtueshmëri ose papajtueshmëri të dyshuar duhet t'i bëhen një autoriteti përkatës.

K260.15 Përveç përgjigjes ndaj çështjes në përputhje me dispozitat e këtij seksioni, profesionisti kontabël senior do të përcaktojë nëse nevojitet dhënie e informacionit mbi çështjen, për audituesin e jashtëm të organizatës punëdhënëse, nëse ka një të tillë.

260.15 A1 Kjo dhënie informacioni do të jetë në përputhje me detyrën ose detyrimin ligjor të profesionistit kontabël senior për të dhënë të gjithë informacionin e nevojshëm, për t'i mundësuar audituesit të kryejë auditimin.

Përcaktimi nëse ka nevojë për veprim të mëtejshëm

K260.16 Profesionisti kontabël senior do të vlerësojë përshtatshmërinë e përgjigjes së superiorëve të profesionistit kontabël dhe, nëse ka, edhe të

personave të ngarkuar me qeverisjen.

260.16 A1 Faktorët përkatës që duhen mbajtur parasysh kur vlerësohet përshtatshmëria e përgjigjes së superiorëve të profesionistit kontabël dhe nëse ka, të personave të ngarkuar me qeverisjen, përfshijnë faktin nëse:

- Përgjigja është dhënë në kohë.
- Janë marrë ose janë duke u marrë veprime për të korrigjuar, riparuar ose zbutur pasojat e ndonjë papajtueshmërie ose për të ndaluar kryerjen e ndonjë papajtueshmërie kur kjo nuk ka ndodhur akoma.
- Çështja i është paraqitur një autoriteti të duhur kur kjo është e përshtatshme dhe, nëse po, faktin nëse paraqitja e bërë duket e përshtatshme.

K260.17 Në dritën e përgjigjes së superiorëve të profesionistit kontabël senior, nëse ka të tillë, dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen, profesionisti kontabël do të përcaktojë nëse ka nevojë për veprime të mëtejshme në interes publik.

260.17 A1 Përcaktimi nëse nevojitet veprim i mëtejshëm dhe natyra e shtrirja e tij, do të varen nga disa faktorë, përfshirë:

- Kuadrin ligjor dhe rregullator.
- Urgjenca e situatës.
- Përhapja e çështjes tek e gjithë organizata punëdhënëse.
- Faktin nëse profesionisti kontabël senior vijon të ketë besim në integritetin e superiorëve të profesionistit kontabël dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen.
- Faktin nëse papajtueshmëria ose papajtueshmëria e dyshuar ka gjasa të përsëritet.
- Faktin nëse ka evidencë të besueshme për dëme thelbësore faktike ose të mundshme ndaj interesave të organizatës punëdhënëse, investitorëve, kreditorëve, punonjësve ose publikut në përgjithësi.

260.17 A2 Shembuj të rrethanave që mund ta bëjnë profesionistin kontabël senior të mos ketë më besim në integritetin e superiorëve të profesionistit kontabël dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen, përfshijnë situatat kur:

- Profesionisti kontabël dyshon ose ka evidencë të përfshirjes së tyre ose të dyshimit për t'u përfshirë në ndonjë papajtueshmëri.
- Në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe rregullatore, ata nuk kanë raportuar, ose nuk kanë autorizuar raportimin e çështjes tek një

autoritet i përshtatshëm brenda një periudhe të arsyeshme.

K260.18

Për të përcaktuar nevojën për, dhe natyrën e shtrirjen e ndonjë veprimi të mëtejshëm, profesionisti kontabël senior do të ushtrojë gjykim profesional dhe do të marrë në konsideratë faktin nëse një palë e tretë e arsyeshme dhe e mirë informuar, që i peshon të gjitha faktet dhe rrethanat specifike të disponueshme për profesionistin kontabël në një datë të dhënë, do të kishte shumë të ngjarë të arrinte në përfundimin se profesionisti kontabël ka vepruar si duhet, në përputhje me interesin publik.

260.18 A1

Veprimi i mëtejshëm që mund të beje profesionistit kontabël mund të jetë:

- Informimin e drejtimit të entitetit mëmë për çështjen në qoftë se organizata punëdhënëse është anëtare e një grupi.
- Paraqitjen e çështjes tek një autoritet i përshtatshëm madje edhe kur nuk ka kërkesa ligjore apo rregullatore për ta bërë një gjë të tillë.
- Tërheqjen nga organizata punëdhënëse.

260.18 A2

Kur profesionisti kontabël senior përcakton se tërheqja nga organizata punëdhënëse do të ishte e përshtatshme, një veprim i tillë nuk do të zëvendësonte ndërmarrjen e veprimeve të tjera që mund të ishin të nevojshëm për arritjen e objektivave të profesionistit kontabël sipas këtij seksioni. Megjithatë, në disa juridiksione, mund të ketë kufizime sa i takon veprimeve të mëtejshme që mund të bëjë profesionisti kontabël. Në këto rrethana, tërheqja mund të jetë e vetmja mënyrë veprimi në dispozicion

Kërkimi i këshillave

260.19 A1

Duke qenë se vlerësimi i çështjes mund të përfshijë analiza dhe gjykime komplekse, profesionisti kontabël senior mund të konsiderojë:

- Konsultimin e brendshëm.
- Konsultimin me një avokat ligjor për të kuptuar opsionet e profesionistit kontabël si dhe ndikimet profesionale ose ligjore të ndërmarrjes së ndonjë kursi të veçantë veprimi.
- Konsultimin bazuar në konfidencialitetin, me një organizëm rregullator ose profesional.

Përcaktimi nëse çështja duhet të paraqitet tek një autoritet i përshtatshëm

260.20 A1

Paraqitja e çështjes tek një autoritet i përshtatshëm do të ishte e

përfashtuar, po qe se kjo do të ishte në kundërshtim me ligjet dhe rregullat. Përndryshe, qëllimi i dhënies së informacioneve për çështjen është të mundësojë që një autoritet i përshtatshëm, të nisë investigimin e çështjes dhe të ndërmarrë veprime me interes publik.

260.20 A2 Vendimi nëse duhet bërë një paraqitje e tillë varet veçanërisht nga natyra dhe shtrirja e dëmit faktik ose të mundshëm që është shkaktuar ose që mund të shkaktohet nga kjo çështje, ndaj investitorëve, kreditorëve, punonjësve dhe publikut në përgjithësi. Për shembull, profesionisti kontabël senior mund të arrijë në përfundimin se paraqitja e çështjes tek një autoritet i përshtatshëm është një drejtim veprimi i duhur nëse:

- Organizata punëdhënëse është e angazhuar në ryshfet (për shembull, zyrtarë të qeverisë lokale ose të huaj, për qëllime të sigurimit të kontratave të mëdha).
- Organizata punëdhënëse është një entitet i rregulluar dhe çështja është e një rëndësie të tillë sa të kërcënojë licencën e saj për të operuar.
- Organizata punëdhënëse është e listuar në bursën e letrave me vlerë dhe çështja mund të rezultojë në pasoja negative për tregun e drejtë dhe të rregulluar të letrave me vlerë të entitetit ose të përbërëjeve të rrezik sistematik për tregjet financiare.
- Ka të ngjarë që organizata punëdhënëse do të shiste produkte, të cilat janë të dëmshme për shëndetin ose sigurinë e publikut.
- Organizata punëdhënëse i promovon klientëve të saj një skemë për t'i asistuar ata në shmangien e taksave.

260.20 A3 Përcaktimi nëse duhet bërë kjo paraqitje do të varet gjithashtu nga faktorë të jashtëm të tillë si:

- Fakti nëse ka një autoritet të përshtatshëm që është në gjendje të marrë informacion, dhe të bëjë që çështja të investigohet dhe të ndërmerren veprimet e duhura. Autoriteti i përshtatshëm do të varet nga natyra e çështjes, për shembull një rregullator i letrave me vlerë në rastin e një raportimi financiar mashtrues ose një agjent i mbrojtjes së mjedisit, në rastin e një shkeljeje të ligjeve dhe rregullave mjedisore.
- Fakti nëse ekziston mbrojtje e fuqishme dhe e besueshme nga përgjegjësia civile, kriminale ose profesionale, e mbuluar nga legjislacioni dhe rregulloret, siç janë legjislacioni ose rregulloret për paralajmërimin.
- Fakti nëse ka kërcënime faktike ose potenciale ndaj sigurisë fizike të profesionistit kontabël ose individëve të tjerë.

K260.21 Nëse profesionisti kontabël përcakton se paraqitja e çështjes tek një autoritet i përshtatshëm është një veprim i duhur për rrethanat, dhënia e këtij informacioni nuk do të konsiderohet një shkelje e detyrimit të konfidencialitetit sipas Seksionit 140 të këtij Kodi, pasi është në pajtueshmëri me paragrafin K114.1(d) të Kodit. Kur bëhet një paraqitje e tillë, profesionisti kontabël do të veprojë në mirëbesim dhe do të ushtrojë kujdes kur bën deklarata dhe pohime.

Shkelje e afërt

K260.22 Në rrethana përjashtimore, profesionisti kontabël senior mund të vihet në dijeni për një sjellje faktike ose të synuar, të atillë që profesionisti kontabël ka arsye të besojë se do të përbëjë një shkelje të afërt të një ligji apo rregulli, e cila do të shkaktonte dëm thelbësor për investitorët, kreditorët, punonjësit ose publikun në përgjithësi. Pas vlerësimit nëse do të ishte e përshtatshme që çështja të diskutohet me drejtimin ose personat e ngarkuar me qeverisjen e organizatës punëdhënëse, profesionisti kontabël do të ushtrojë gjykimin profesional për të përcaktuar nëse duhet menjëherë ta paraqesë çështjen tek një autoriteti përshtatshëm, për të parandaluar ose zbutur pasojat e një shkeljeje të afërt të ligjit apo rregullit. Në se informacioni është dhënë, ky informacion është i lejuar në zbatim të paragrafit K114.1(d) të Kodit

Dokumentimi

260.23 A1 Në lidhje me papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar, që bie brenda objektit të këtij seksioni, profesionisti kontabël senior inkurajohet të dokumentojë çështjet e mëposhtme:

- Çështjen.
- Rezultatet e diskutimeve me superiorët e profesionistit, nëse ka, dhe me personat e ngarkuar me qeverisjen dhe palë të tjera.
- Mënyrën se si superiorët e profesionistit kontabël, nëse ka, dhe personat e ngarkuar me qeverisjen, i janë përgjigjur çështjes.
- Drejtimet e veprimit që profesionisti kontabël ka marrë në konsideratë, gjykimet e bëra dhe vendimet e marra.
- Mënyrën se si profesionisti kontabël krijon bindjen se ai ka përmbushur përgjegjësinë e përcaktuar në paragrafin K260.17.

Përgjegjësitë e profesionistëve kontabël përveç profesionistëve kontabël senior

K260.24 Nëse, gjatë kryerjes së aktiviteteve profesionale, një profesionist kontabël vihet në dijeni të informacionit lidhur me një rrethanë

papajtueshmërie ose papajtueshmërie të dyshuar, profesionisti kontabël do të kërkojë të sigurojë njohjen dhe kuptimin e çështjes. Njohja dhe kuptimi do të përfshijë natyrën e veprimit dhe rrethanat në të cilat ai ka ndodhur ose mund të ndodhë.

- 260.24 A1 Nga profesionisti kontabël pritet që ai të zbatojë njohuritë, ekspertizën dhe të ushtrojë gjykimin profesional. Megjithatë, profesionisti kontabël nuk pritet të ketë një nivel të kuptimit të ligjeve dhe rregullave përtej asaj që kërkohet për rolin e profesionistit kontabël brenda organizatës punëdhënëse. Fakti nëse një akt përbën papajtueshmëri, në fund të fundit është një çështje që do ta zgjidhë gjykata ose një organizëm tjetër vendimmarrës i përshtatshëm.
- 260.24 A2 Në varësi të natyrës dhe rëndësisë së çështjes, profesionisti kontabël mund të konsultohet duke ruajtur konfidencialitetin, me të tjerët brenda organizatës punëdhënëse ose me një organizëm profesional, apo edhe me një këshilltar ligjor.
- K260.25 Nëse profesionisti kontabël identifikon ose dyshon që papajtueshmëria ka ndodhur ose mund të ndodhë, profesionisti kontabël duhet, subjekti paragrafit K260.9, të informojë një superior më të afërt për t'i mundësuar superiorit të ndërmarrë veprimin e duhur. Nëse superiorin më të afërt i profesionistit kontabël duket se është përfshirë në çështje, profesionisti kontabël do të informojë nivelin e autoritetit tjetër më lart, brenda organizatës punëdhënëse.
- K260.26 Në rrethana përjashtimore, profesionisti kontabël mund të arrijë në përfundimin se paraqitja e çështjes tek një autoritet i përshtatshëm është një drejtim veprimi i duhur. Nëse profesionisti kontabël e bën këtë sipas paragrafëve 260.20 A2 dhe A3, ky veprim do të jetë në pajtueshmëri me paragrafin K114.1(d) të këtij Kodi. Kur bëhet një paraqitje e tillë, profesionisti kontabël do të veprojë në mirëbesim dhe do të ushtrojë kujdes kur bën deklarata dhe pohime.

Dokumentimi

- 260.27 A1 Në lidhje me papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar që bie brenda objektit të këtij seksioni, profesionisti kontabël inkurajohet të dokumentojë çështjet e mëposhtme:
- Çështjen.
 - Rezultatet e diskutimeve me superiorin e profesionistit kontabël, me drejtimin dhe, nëse ka, me personat e ngarkuar me qeverisjen dhe palë të tjera.
 - Mënyrën se si superiorin e profesionistit kontabël ka reaguar ndaj

çështjes.

- Drejtimet e veprimit që profesionisti kontabël ka mbajtur parasysh, gjykimet e bëra dhe vendimet e marra.

SEKSIONI 270

PRESIONI PËR SHKELJEN E PARIMEVE THEMELORE

Hyrje

- 270.1 Profesionistëve kontabël ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120, për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 270.2 Presioni i ushtruar mbi, ose nga një profesionist kontabël, mund të krijojë një kërcënim të frikësimit ose një kërcënim tjetër, për pajtueshmërinë me një ose më shumë parime themelore. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në rrethana të tilla.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- K270.3 Një profesionist kontabël nuk do të:
- (a) Lejojë që presioni nga të tjerët të rezultojë në një shkelje të parimeve themelore; ose
 - (b) Të bëjë presion ndaj të tjerëve, kur profesionisti kontabël di ose ka arsye të besojë se kjo do të rezultonte në shkelje të parimeve themelore nga këta individë.
- 270.3 A1 Një profesionist kontabël mund të përballet me presion që krijon kërcënime ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore, për shembull një kërcënim frikësimi, kur ai ndërmerr një veprimtari profesionale. Presioni mund të jetë i qartë ose i nënkuptuar dhe mund të vijë nga:
- Brenda organizatës punëdhënëse, për shembull, nga një koleg ose një epror.
 - Një individ ose organizatë e jashtme, siç është një shitës, klient ose kreditor.
 - Objektivat dhe pritshmëritë e brendshme ose të jashtme.
- 270.3 A2 Shembuj të presionit që mund të rezultojë në kërcënime për pajtueshmërinë me parimet themelore përfshijnë:
- Presioni lidhur me konfliktin e interesit:
 - Presion nga një anëtar i familjes që bën ofertë për të vepruar si shitës ndaj organizatës punëdhënëse të profesionistit kontabël për

të zgjedhur anëtarin e familjes kundrejt një shitësi tjetër të mundshëm.

Shih gjithashtu seksionin 210, Konfliktet e interesit.

- Presioni për të ndikuar në përgatitjen ose paraqitjen e informacionit:
 - Presioni për të raportuar rezultate financiare çorientuese për të përmbushur pritshmëritë e investitorëve, analistëve ose huadhënësve.
 - Presion nga zyrtarët e zgjedhur kundrejt kontabilistëve të sektorit publik për të keqinterpretuar programe ose projekte për votuesit.
 - Presioni nga kolegët për të deklaruar gabimisht të ardhurat, shpenzimet ose normat e kthimit për të anashkaluar vendimmarrjen për projektet kapitale dhe blerjet.
 - Presion nga eprorët për të miratuar ose përpunuar shpenzime që nuk janë shpenzime legjitime të biznesit.
 - Presioni për të shtypur raportet e auditimit të brendshëm që përmbajnë gjetjet e pafavorshme.

Shih gjithashtu Seksionin 220, Përgatitja dhe Paraqitja e Informacionit.

- Presion për të vepruar pa ekspertizë ose kujdes të duhur:
 - Presioni nga eprorët për të reduktuar në mënyrë të papërshtatshme shtrirjen e punës së kryer.
 - Presion nga eprorët për të kryer një detyrë pa patur aftësi të mjaftueshme ose trajnimet ose brenda afateve joreale.
- Shih gjithashtu Seksionin 230, Ushtrimi me Ekspertizë të Mjaftueshme.

- Presioni në lidhje me interesat financiare:
 - Presion nga eprorët, kolegët ose të tjerët, për shembull, ata që mund të përfitojnë nga pjesëmarrja në marrëveshje të shpërblimeve dhe të stimujve përkatës për të manipuluar treguesit e performancës.

Shih gjithashtu Seksionin 240, Interesat financiare, Shpërblimet dhe Stimujt që lidhen me Raportimin Financiar dhe Vendimmarrjen.

- Presioni i lidhur me nxitjet:
 - Presioni nga të tjerët, qoftë i brendshëm apo i jashtëm për organizatën punëdhënëse, për të stimuluar ndikim në mënyrë të papërshtatshme në gjykimin ose procesin e vendimmarrjes së një individi ose organizate.
 - Presioni nga kolegët për të pranuar një ryshfet ose nxitje tjetër, për shembull për të pranuar dhuratat të papërshtatshme ose argëtim nga shitësit e mundshëm në një proces tenderimi.

Shih gjithashtu seksionin 250, Nxitja, duke përfshirë dhuratat dhe mikpritjen.

- Presioni lidhur me mospërputhjen me ligjet dhe rregulloret:
 - Presion për të strukturuar një transaksion për t'iu shmangur tatimeve.

Shih gjithashtu Seksionin 260, Përgjigjja ndaj Mospërputhjes me Ligjet

dhe Rregulloret.

- Presioni lidhur me nivelin e tarifave
 - Presioni i ushtruar nga një profesionist kontabël mbi një tjetër profesionist kontabël për të ofruar shërbime profesionale në një nivel tarife që nuk lejon burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme (përfshirë burimet njerëzore, teknologjike dhe intelektuale) për të kryer shërbimet në përputhje me standardet teknike dhe profesionale.

Shih gjithashtu Seksionin 330, Tarifat dhe Llojet e tjera të Shpërblimeve

270.3 A3 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimeve të krijuara nga presioni përfshijnë:

- Qëllimin e individit që ushtron presion dhe natyrën e presionit.
- Zbatimin e ligjeve, rregullave dhe standardeve profesionale sipas rrethanave.
- Kulturën dhe lidhshërinë e organizatës punëdhënëse, duke përfshirë shkallën në të cilën ata reflektojnë ose theksojnë rëndësinë e sjelljes etike dhe pritshmërinë që punonjësit të veprojnë në mënyrë etike. Për shembull, një kulturë korporate që toleron sjelljen jo etike mund të rrisë gjasat që presioni të rezultojë në një kërcënim ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore.
- Politikën dhe procedurat, nëse ka, që organizata punëdhënëse ka vendosur, të tilla si etika ose politikën e burimeve njerëzore që adresojnë presionin.

270.3 A4 Diskutimi i rrethanave që krijojnë presion dhe konsultimi me të tjerët për këto rrethana, mund të ndihmojnë profesionistin kontabël për të vlerësuar nivelin e kërcënimit. Një diskutim dhe konsultim i tillë, i cili kërkon të qenurit vigjilent ndaj parimit të konfidencialitetit, mund të përfshijë:

- Diskutimin e çështjes me individin që po ushtron presionin për të kërkuar zgjidhjen e tij.
- Diskutimin e çështjes me eprorin e profesionistit kontabël, nëse eprori nuk është individ që ushtron presionin.
- Përshkallëzimin e çështjes brenda organizatës punëdhënëse, duke përfshirë kur është e përshtatshme, shpjegimin e rreziqeve të mundshme për organizatën, për shembull me:
 - Nivelet e larta të drejtimit.
 - Audituesit e jashtëm ose të brendshëm.
 - Personat e ngarkuar me qeverisjen.
- Paraqitjen e çështjes në përputhje me politikën e organizatës punëdhënëse, përfshirë etikën dhe politikën për personat që ngrenë shqetësime paralajmëruese, duke përdorur çdo mekanizëm të vendosur, siç është një linjë etike telefonike konfidenciale.

- Konsultimin me:
 - Një koleg, epror, personel i burimeve njerëzore ose një tjetër profesionist kontabël;
 - Organet përkatëse profesionale ose rregullatore apo shoqatat e industrisë; ose
 - Një këshilltar ligjor.

270.3 A5 Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë kërcënimet e krijuara nga presioni është kërkesa e profesionistit kontabël për një ristrukturim ose ndarje të përgjegjësisë dhe detyrave të caktuara në mënyrë që profesionisti kontabël të mos përfshihet më me një individ ose entitet që ushtron presionin.

Dokumentimi

270.4 A1 Profesionisti kontabël inkurajohet të dokumentojë:

- Faktet.
- Komunikimet dhe palët me të cilat këto çështje janë diskutuar.
- Rrugët e veprimit të marra në konsideratë.
- Mënyrën se si ka qenë adresuar çështja.

PJESA 3 - PROFESIONISTËT KONTABËL NËPRAKTIKËN PUBLIKE

Faqe

Seksioni 300	Zbatimi i kuadrit konceptual – profesionistët kontabël në praktikën publike	86
Seksioni 310	Konfliktet e interesit	93
Seksioni 320	Emërimet Profesionale	100
Seksioni 321	Opinionet dytësore	105
Seksioni 330	Honoraret dhe format e tjera të pagesave	107
Seksioni 340	Nxitjet, përfshirë dhuratat dhe mikpritjen	110
Seksioni 350	Marrja në ruajtje (në kujdestari) e aktiveve të klientit	120
Seksioni 360	Reagimi ndaj papajtueshmërisë me ligjet dhe rregullat	122

PJESA 3 – PROFESIONISTET KONTABEL në PRAKTIKEN PUBLIKE

SEKSIONI 300

ZBATIMI I KUADRIT KONCEPTUAL – PROFESIONISTËT KONTABELË NË PRAKTIKËN PUBLIKE

Hyrje

- 300.1 Kjo Pjesë e Kodit përcakton kërkesat dhe materialin për zbatim për profesionistët kontabël në praktikën publike gjatë zbatimit të kuadrit konceptual të përcaktuar në Seksionin 120. Ajo nuk përshkruan të gjitha faktet dhe rrethanat, përfshirë aktivitetet profesionale, interesat dhe marrëdhëniet me të cilat një profesionist kontabël mund të vihet përballë në praktikën publike, të cilat mund të krijojnë kërcënime ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore, prandaj kuadri konceptual kërkon që profesionistët kontabël të jenë vigjilentë ndaj këtyre fakteve dhe rrethanave.
- 300.2 Kërkesat dhe materiali për zbatim për profesionistët kontabël në praktikën publike janë të përcaktuara në:
- Pjesa 3 – Profesionistët Kontabël në Praktikën Publike, Seksionet 300 në 399, e cila është e zbatueshme për të gjithë profesionistët kontabël në praktikën publike, pavarësisht faktit nëse ata ofrojnë shërbime sigurie.
 - Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë si më poshtë:
 - Pjesa 4A - Pavarësia për Angazhimet e Auditimit dhe të Rishikimit, Seksionet 400-899, të cilat zbatohen për profesionistët kontabël në praktikën publike kur kryhen angazhime të auditimit ose të rishikimit.
 - Pjesa 4B - Pavarësia për Angazhimet e Sigurisë që ndryshojnë nga Angazhimet e Auditimit dhe të Rishikimit, Seksionet 900-999, të cilat zbatohen kur kryhen angazhime të sigurisë që ndryshojnë nga angazhime të auditimit ose të rishikimit.
- 300.3 Në këtë Pjesë, termi ‘profesionist kontabël’ u referohet profesionistëve kontabël individual në praktikën publike dhe firmat e tyre.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- K300.4 Një profesionist kontabël duhet të respektojë parimet themelore të përcaktuara në Seksionin 110 dhe të zbatojë kuadrin konceptual të

përcaktuar në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet në përputhje me parimet themelore.

K300.5 Kur përballlet me një çështje etike, profesionisti kontabël do të marrë parasysh kontekstin në të cilin ka lindur ose mund të lind çështja. Kur një individ i cili është profesionist kontabël në praktikën publike kryen një veprimtari profesionale bazuar në marrëdhënien e tij me firmën, qoftë si kontraktues, punonjës ose pronar, ky individ duhet të respektojë dispozitat në Pjesën 2 që zbatohen në këto rrethana.

300.5 A1 Shembuj të situatave në të cilat dispozitat në Pjesën 2 zbatohen për një profesionist kontabël në praktikën publike përfshijnë:

- Përballja me një konflikt interesi kur është përgjegjës për zgjedhjen e një shitësi për firmën kur një anëtar i ngushtë i familjes së profesionistit kontabël mund të përfitojë financiarisht nga kontrata. Kërkesat dhe materiali për zbatim i përcaktuar në Seksionin 210 zbatohen në këto rrethana.
- Përgatitja dhe raportimi i informacionit financiar për klientin ose firmën e profesionistit kontabël. Kërkesat dhe materiali për zbatim i përcaktuar në Seksionin 220 zbatohen në këto rrethana.
- Kur profesionistit kontabël i ofrohet një nxitje, për shembull nëse një furnizues i firmës i ofron rregullisht bileta falas për evenimente sportive. Kërkesat dhe materiali për zbatim i përcaktuar në Seksionin 250 zbatohen në këto rrethana.
- Përballja me presionin nga një partner i angazhimit për të raportuar orë të pagueshme në mënyrë të pasaktë për një angazhim të klientit. Kërkesat dhe materiali për zbatim i përcaktuar në Seksionin 270 zbatohen në këto rrethana.

Identifikimi i kërcënimeve

300.6 A1 Kërcënimet ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore mund të krijohen nga një shumëllojshmëri faktesh dhe rrethanash. Kategoritë e kërcënimeve janë të përshkruara në paragrafin 120.6 A3. Më poshtë gjenden shembuj faktesh dhe rrethanash për çdo kategori kërcërimi që mund të krijojnë kërcënimet për një profesionist kontabël që ndërmerr një shërbim profesional:

- (a) Kërcënimet e Egoizmit (Interesi Vetjak)
- Një profesionist kontabël që ka një interes të drejtpërdrejtë financiar në një klient.
 - Një profesionist kontabël që përcakton një tarifë të ulët me qëllim që të sigurojë një angazhim të ri, dhe kjo tarifë është kaq e ulët sa mund ta bëjë të vështirë kryerjen e shërbimit

profesional në përputhje me standardet e zbatueshme teknike dhe profesionale për atë çmim.

- Një profesionist kontabël që ka një marrëdhënie të ngushtë biznesi me një klient.
- Një profesionist kontabël që ka akses në informacione konfidenciale që mund të përdoren për përfitime personale.
- Një profesionist kontabël që zbulon një gabim të rëndësishëm kur vlerëson rezultatet e një shërbimi të mëparshëm profesional të kryer nga një anëtar i firmës së profesionistit.

(b) Kërcënimet e Vetë rishikimit

- Një profesionist kontabël që lëshon një raport sigurimi mbi efektivitetin e funksionimit të sistemeve financiare pas implementimit të sistemeve.
- Një profesionist kontabël që ka përgatitur të dhënat origjinale të përdorura për krijimin e dokumenteve që janë përmbytja e angazhimit të sigurimit.

(c) Kërcënimet e Favorizimit (Përkrahja)

- Një profesionist kontabël që promovon interesat, ose aksionet e një klienti.
- Një profesionist kontabël që vepron si përkrahës në emër të një klienti në çështje gjyqësore ose në mosmarrëveshje me palë të treta.
- Një profesionist kontabël që bën fushatë në favor të legjislacionit në emër të një klienti.

(d) Kërcënimet e Familjaritetit

- Një profesionist kontabël që ka një anëtar të ngushtë ose të afërt të familjes i cili është drejtor ose epror i klientit.
- Një drejtor ose epror i klientit, ose një punonjës në pozicion për të ushtruar ndikim të rëndësishëm mbi objektin e angazhimit, i cili ka shërbyer së fundmi si partner i angazhimit.
- Një anëtar i grupit të auditimit që ka lidhje të gjatë me klientin e auditimit.

(e) Kërcënimet e Frikësimit

- Një profesionist kontabël që kërcënohet me largim nga klienti i angazhimit ose nga firma për shkak të një mosmarrëveshjeje lidhur me një çështje profesionale.
- Një profesionist kontabël që ndihet në presion për të qenë dakord me gjykimin e një klienti sepse klienti ka më shumë ekspertizë për çështjen në fjalë.
- Një profesionist kontabël që informohet se një ngritje e parashikuar në detyrë nuk do të ndodhë nëse profesionisti kontabël nuk bie dakord me një trajtim të papërshtatshëm kontabël.
- Një profesionist kontabël që ka pranuar një dhuratë domethënëse

nga një klient dhe kërcënohet se pranimi i kësaj dhurate do të bëhet publik.

Vlerësimi i kërcënimeve

300.7 A1 Kushtet, politikat dhe procedurat e përshkruara në paragrafin 120.6A1 dhe 120.8 A2 mund të ndikojnë në vlerësimin nëse kërcënimi për respektimin e parimeve themelore është në një nivel të pranueshëm. Këto kushte, politika dhe procedura mund të lidhen me:

- (a) Klientin dhe mjedisin e tij operativ; dhe
- (b) Firmën dhe mjedisin e saj operativ.

300.7 A2 Vlerësimi i profesionistit kontabël për nivelin e një kërcënimi ndikohet gjithashtu nga natyra dhe objekti i shërbimit profesional.

Klienti dhe mjedisi i tij operativ

300.7 A3 Vlerësimi i profesionistit kontabël për nivelin e një kërcënimi mund të ndikohet nëse klienti është:

- (a) Një klient auditimi dhe nëse klienti i auditimit është një entitet me interes publik;
- (b) Një klient sigurimi që nuk është klient i auditimit; ose
- (c) Një klient që nuk është klient sigurimi.

Për shembull, ofrimi i një shërbimi jo sigurie për një klient të auditimit që është një entitet me interes publik mund të mendohet se rezulton në një nivel më të lartë të kërcënimit për respektimin e parimit të objektivitetit në lidhje me auditimin.

300.7 A4 Struktura e qeverisjes së korporatave, përfshirë lidhësin e një klienti, mund të promovojë pajtueshmërinë me parimet themelore. Prandaj, vlerësimi i një profesionisti kontabël për nivelin e një kërcënimi mund të ndikohet gjithashtu nga mjedisi operues i një klienti. Për shembull:

- Klienti kërkon individë të përshtatshëm të ndryshëm nga drejtim për të ratifikuar ose aprovuar emërimin e një firme për të kryer një angazhim.
- Klienti ka punonjës të aftë, me përvojë dhe vjetërsi për të marrë vendime menaxheriale.
- Klienti ka zbatuar procedura të brendshme që lehtësojnë zgjedhjet objektive në tenderimin e angazhimeve të jo sigurisë.
- Klienti ka një strukturë të qeverisjes së korporatave që siguron mbikëqyrje të përshtatshme dhe komunikime në lidhje me shërbimet

e firmës.

Firma dhe mjedisi i saj operativ

300.7 A5 Vlerësimi i profesionistit kontabël për nivelin e një kërcënimi mund të ndikohet nga mjedisi i punës brenda firmës së profesionistit dhe nga mjedisi i saj operativ. Për shembull:

- Lidërsia e firmës që promovon pajtueshmërinë me parimet themelore dhe vendos pritshmërinë që anëtarët e grupit të sigurimit do të veprojnë në interes të publikut.
- Politikat ose procedurat për përcaktimin dhe monitorimin e pajtueshmërisë me parimet themelore nga i gjithë personeli.
- Kompensimi, vlerësimi i performancës dhe politikat dhe procedurat disiplinore që promovojnë pajtueshmërinë me parimet themelore.
- Menaxhimi i mbështetjes në të ardhurat e marra nga një klient i vetëm.
- Partneri i angazhimit ka autoritet brenda firmës për vendime në lidhje me pajtueshmërinë me parimet themelore, përfshirë vendimet për pranimin ose ofrimin e shërbimeve për një klient.
- Kërkesat lidhur me edukimin, trajnimin dhe përvojën.
- Proceset për të lehtësuar dhe adresuar shqetësimet ose ankesat e brendshme dhe të jashtme.

Shqyrtimi i informacionit të ri ose i ndryshimeve në fakte dhe rrethana

300.7 A6 Informacioni i ri ose ndryshimet në fakte dhe rrethana mund të:

- (a) Ndikojnë në nivelin e një kërcënimi; ose
- (b) Ndikojnë në konkluzionet e profesionistit kontabël lidhur me faktin nëse masat mbrojtëse të zbatuara vazhdojnë të adresojnë kërcënimet e identifikuara siç duhet.

Në këto situata, veprimet që tashmë janë zbatuar si masa mbrojtëse mund të mos jenë më efektive në adresimin e kërcënimeve. Prandaj, zbatimi i kuadrit konceptual kërkon që profesionisti kontabël të rivlerësojë dhe adresojë përkatësisht kërcënimet. (Shih paragrafët K120.9 dhe K120.10).

300.7 A7 Shembuj të informacionit të ri ose ndryshimeve në fakte dhe rrethana që mund të ndikojnë në nivelin e një kërcënimi përfshijnë:

- Kur zgjerohet fushëveprimi i një shërbimi profesional.
- Kur klienti bëhet një entitet i listuar ose përvetëson një njësi tjetër biznesi.
- Kur firma bashkohet me një firmë tjetër.
- Kur profesionisti kontabël është i angazhuar bashkërisht nga dy klientë dhe midis këtyre dy klientëve lind një mosmarrëveshje.

Kur ka një ndryshim në marrëdhëniet personale ose marrëdhëniet e ngushta familjare të profesionisti kontabël.

Adresimi i kërcënimeve

300.8 A1 Paragrafët K120.10 to 120.10 A2 përcaktojnë kërkesat dhe materialin për zbatim për të adresuar kërcënimet që nuk janë në një nivel të pranueshëm.

Shembuj të masave mbrojtëse

300.8 A2 Masat mbrojtëse ndryshojnë në varësi të fakteve dhe rrethanave. Shembuj të veprimeve që në rrethana të caktuara mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për adresimin e kërcënimeve përfshijnë:

- Caktimi i kohës shtesë dhe personelit të kualifikuar për detyrat e kërkuara kur një angazhim është pranuar, mund të adresojë një kërcënim interesi vetjak.
- Caktimi i një rishikuesi të përshtatshëm që nuk ishte anëtar i grupit, për të rishikuar punën e kryer ose këshilluar sipas nevojës, mund të adresojë një kërcënim vetë rishikimi.
- Përdorimi i partnerëve dhe grupeve të ndryshme të angazhimit me linja të veçanta raportimi për ofrimin e shërbimeve jo të sigurisë për një klient mund të adresojë në kërcënime të vetë rishikimit, favorizimit ose familjaritetit.
- Përfshirja e një firme tjetër për të kryer ose ri kryer një pjesë të angazhimit mund të adresojë kërcënime interesi vetjak, vetë rishikimi, favorizimi, familjariteti ose kërcënime frikësimi.
- Ndarja me klientët e informacionit lidhur me tarifa referimi ose marrëveshje komisionesh të marra për rekomandimin e shërbimeve ose produkteve, mund të adresojë kërcënime interesi vetjak.
- Ndarja e grupeve kur kanë të bëjnë me çështje të një natyre konfidenciale, mund të adresojë një kërcënim interesi vetjak.

300.8 A3 Seksionet e mbetura të Pjesës 3 dhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë përshkruajnë kërcënime që mund të shfaqen gjatë kryerjes së shërbimeve profesionale dhe përfshijnë shembuj të veprimeve që mund të adresojnë kërcënimet.

Rishikuesi i përshtatshëm

300.8 A4 Një rishikues i përshtatshëm është një profesionist me njohuritë, aftësitë, përvojën dhe autoritetin e nevojshëm për të rishikuar, në një mënyrë objektive, punën përkatëse të kryer ose shërbimin e ofruar. Një individ i tillë mund të jetë një profesionist kontabël.

Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen

- K300.9 Kur komunikon me personat e ngarkuar me qeverisjen në përputhje me Kodin, një profesionist kontabël përcakton individin(ët) e duhur brenda strukturës së qeverisjes së entitetit me të cilin të komunikojë. Nëse profesionisti kontabël komunikon me një nëngrup të personave të ngarkuar me qeverisjen, profesionisti përcakton nëse komunikimi me të gjithë personat e ngarkuar me qeverisjen është gjithashtu i nevojshëm në mënyrë që ata të informohen në mënyrën e duhur.
- 300.9 A1 Për të përcaktuar se me kë do të komunikojë, një profesionist kontabël mund të marrë në konsideratë:
- (a) Natyrën dhe rëndësinë e rrethanave; dhe
 - (b) Çështjen që duhet komunikuar
- 300.9 A2 Shembuj të një nëngrupi të personave të ngarkuar me qeverisjen përfshijnë, një komitet auditimi ose një anëtar individual i personave të ngarkuar me qeverisjen.
- K300.10** Nëse një profesionist kontabël komunikon me individë që kanë përgjegjësi drejtuese si dhe përgjegjësi qeverisëse, profesionisti duhet të jetë i bindur që komunikimi me këto individë informon në mënyrën e duhur të gjithë personat e ngarkuar në një rol qeverisë me të cilët ai do duhej të komunikonte.
- 300.10 A1 Në disa rrethana, të gjithë personat e ngarkuar me qeverisjen janë të përfshirë në administrimin e entitetit, për shembull, një biznes i vogël ku një pronar i vetëm administron entitetin dhe askush tjetër nuk ka një rol qeverisë. Në këto raste, nëse çështjet i komunikohen individit(ëve) me përgjegjësi drejtuese, dhe ata individë kanë gjithashtu përgjegjësi qeverisëse, profesionisti kontabël ka përmbushur kërkesën për të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen.

SEKSIONI 310

KONFLIKTET E INTERESIT

Hyrje

- 310.1 Profesionistëve kontabël ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të përcaktuar në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 310.2 Një konflikt interesi krijon një kërcënim për objektivitetin dhe mund të krijojë kërcënime edhe për parimet e tjera themelore. Këto kërcënime mund të krijohen kur:
- (a) Profesioni kontabël ndërmerr një aktivitet profesional për një çështje të veçantë për dy ose më shumë palë, interesat e të cilave në lidhje me këtë çështje janë në konflikt; ose
 - (b) Interesat e profesionistit kontabël në lidhje me një çështje të veçantë dhe interesat e klientit të cilit profesionisti kontabël i ofron një shërbim profesional, janë në konflikt.
- 310.2 Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual për konfliktet e interesit. Kur një profesionist kontabël ofron një shërbim auditimi, rishikimi ose shërbime të tjera të sigurisë, atij i kërkohet gjithashtu të jetë i pavarur në përputhje me *Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë*.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- K310.4 Një profesionist kontabël nuk do të lejojë një konflikt interesi që kompromenton gjykimin profesional ose të biznesit.
- 310.4 A1 Shembuj të rrethanave ku mund të lindë një konflikt interesi janë:
- Ofrimi i një shërbimi këshillimor të transaksionit një klienti i cili kërkon të sigurojë një klient të auditimit, kur firma ka marrë informacion konfidencial gjatë kryerjes së auditimit, i cili mund të jetë i rëndësishëm për transaksionin.
 - Dhënia e këshillave për dy klientë në të njëjtën kohë, kur klientët po konkurrojnë për blerjen e të njëjtës kompani dhe këshillat mund të jenë të rëndësishme për pozicionet konkurruese të palëve.
 - Ofrimi i shërbimeve për një shitës dhe një blerës në lidhje me të njëjtin transaksion.

- Përgatitja e vlerësimeve të aktiveve për dy palë të cilët janë në një pozitë kundërshtare në lidhje me aktivet.
- Përfaqësimi i dy klientëve në të njëjtën çështje, të cilët janë në një mosmarrëveshje juridike me njëri-tjetrin, si për shembull gjatë procedurave të divorcit, ose shpërbërjes së një partneriteti.
- Në lidhje me një marrëveshje licence, dhënia e një raporti sigurie për një licencues për të drejtat e parashikuara, ndërsa këshillon të licencuarin për shumat e pagueshme.
- Këshillimi i një klienti për të investuar në një biznes në të cilin, për shembull, bashkëshorti i profesionistit kontabël ka një interes financiar.
- Ofrimi i këshillave strategjike për një klient mbi pozicionin e tij konkurrues duke patur një ndërmarrje të përbashkët ose interes të ngjashëm me një konkurrent kryesor të klientit.
- Këshillimi i një klienti për blerjen e një biznesi të cilin firma është gjithashtu e interesuar ta blejë.
- Këshillimi i një klienti për blerjen e një produkti ose shërbimi ndërkohë që ka një honorar ose marrëveshje komisioni me një shitës të mundshëm të këtij produkti ose shërbimi

Identifikimi i konflikteve

Të përgjithshme

K310.5 Para se të pranojë një marrëdhënie, angazhim ose marrëveshje të re me një klient, profesionisti kontabël do të ndërmarrë hapat e arsyeshëm për të identifikuar rrethanat që mund të krijojnë një konflikt interesi, dhe si pasojë, një kërcënim për pajtueshmërinë e një apo më shumë parimeve themelore. Këto hapa përfshijnë identifikimin e:

- (a) Natyrës së interesave përkatëse dhe marrëdhënieve midis palëve të përfshira; dhe
- (b) Shërbimit dhe implikimeve të tij për palët përkatëse.

310.5 A1 Një proces efektiv i identifikimit të konflikteve ndihmon një profesionist kontabël kur ndërmerr hapat e arsyeshme për të identifikuar interesat dhe marrëdhëniet që mund të krijojnë një konflikt aktual ose potencial, para përcaktimit nëse do të pranojë angazhimin, si dhe gjatë gjithë angazhimit. Një proces i tillë përfshin çështje të identifikuar nga palë jashtme, si për shembull klientë ose klientë të mundshëm. Sa më parë të konstatohet një konflikt interesi aktual ose potencial, aq më shumë gjasa do të ketë profesionisti kontabël për të adresuar kërcënimet e krijuara nga ky konflikt interesi.

310.5 A2 Një proces efektiv për të identifikuar konflikte interesi aktuale ose potenciale duhet të marrë në konsideratë faktorë si:

- Natyra e shërbimeve profesionale të dhëna.
- Madhësia e firmës.
- Madhësia dhe natyra e klientelës.
- Struktura e firmës, për shembull numri dhe vendndodhja e zyrave.

310.5 A3 Më shumë informacion mbi pranimin e klientëve gjendet në Seksionin 320 *Emërimet profesionale*.

Ndryshimet në rrethanat

K310.6 Një profesionist kontabël duhet të jetë vigjilent për ndryshimet me kalimin e kohës, të natyrës së shërbimeve, interesave dhe marrëdhënieve që mund të krijojnë një konflikt interesi gjatë kryerjes së një angazhimi.

310.6 A1 Natyra e aktiviteteve, interesave dhe marrëdhënieve përkatëse mund të ndryshojë gjatë angazhimit. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur profesionistit kontabël i kërkohet të kryejë një angazhim në një situatë që mund të bëhet armiqësore, edhe pse fillimisht palët angazhuese mund të mos kishin qenë të përfshira në ndonjë konflikt.

Firmat rrjet

K310.7 Nëse firma është anëtar i një rrjeti, një profesionist kontabël do të marrë parasysh konfliktin e interesit që ai ka arsye të besojë se mund të ekzistojë ose të lindë për shkak të interesave dhe marrëdhënieve të një firme të rrjetit.

310.7 A1 Faktorët që duhen marrë parasysh gjatë identifikimit të interesave dhe marrëdhënieve që kanë të bëjnë me një firmë rrjeti, përfshijnë:

- Natyrën e shërbimeve profesionale të dhëna.
- Klientët të cilëve u shërben rrjeti.
- Vendndodhjet gjeografike të të gjitha palëve përkatëse.

Kërcënimet e krijuara nga konfliktet e interesit

310.8 A1 Në përgjithësi, sa më e drejtpërdrejtë të jetë lidhja midis shërbimit profesional dhe çështjes në të cilën interesat e palëve janë në konflikt, aq më shumë gjasa ka që niveli i kërcënimit të mos jetë në një nivel të pranueshëm.

310.8 A2 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të krijuar nga një konflikt interesi, përfshijnë masa që parandalojnë zbulimin e paautorizuar të informacionit konfidencial gjatë kryerjes së

shërbimeve profesionale në lidhje me një çështje të veçantë për dy ose më shumë klientë, interesat e të cilëve në lidhje me atë çështje janë në konflikt. Këto masa përfshijnë:

- Krijimin e zonave të veçanta të praktikës për funksionet e specializuara brenda firmës, të cilat mund të veprojnë si një pengesë për kalimin e informacionit konfidencial të klientit midis zonave të praktikës.
- Politikat dhe procedurat për të kufizuar aksesin në dosjet e klientëve.
- Marrëveshjet e konfidencialitetit të nënshkruara nga personeli dhe partnerët e firmës.
- Ndarjen e informacionit konfidencial fizikisht dhe në mënyrë elektronike.
- Trajnimin dhe komunikimin specifik dhe të përkushtuar.

310.8 A3 Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtje për të adresuar kërcënimet e krijuara nga një konflikt interesi përfshijnë:

- Grupet e veçanta të angazhimit të cilat duhet t'u nënshtrohen politikave dhe procedurave të qarta për ruajtjen e konfidencialitetit.
- Rishikimin e punës së kryer nga një rishikues i përshtatshëm, i cili nuk është i përfshirë në dhënien e shërbimit ose i prekur nga konflikti, për të vlerësuar nëse gjykimet dhe konkluzionet e kyçe janë të përshtatshme.

Informacionet shpjeguese dhe pëlqimi

Të përgjithshme

K310.9 Një profesionist kontabël duhet të ushtrojë gjykimin profesional për të përcaktuar nëse natyra dhe rëndësia e një konflikti interesi janë të tilla, që kërkojnë informacione shpjeguese specifike dhe pëlqim të qartë, gjatë adresimit të një kërcënimi të krijuar nga konflikti i interesit.

310.9 A1 Faktorët që duhen marrë në konsideratë për përcaktimin nëse dhënia e informacioneve shpjeguese dhe pëlqimi i qartë janë të nevojshëm, përfshijnë:

- Rrethanat që krijojnë konfliktin e interesit.
- Palët që mund të ndikohen.
- Natyrën e shqetësimeve që mund të lindin.
- Mundësinë që një çështje e veçantë të marrë një rrjedhë të paparashikuar.

- 310.9 A2 Informacioni shpjegues dhe pëlqimi mund të kenë forma të ndryshme, për shembull:
- Informacione shpjeguese të përgjithshme për klientin, në rrethanat kur, në kushtet e praktikës së zakonshme tregtare, profesionisti kontabël nuk jep shërbime ekskluzivisht për një klient të vetëm (për shembull, për një shërbim profesional dhe sektor tregu të veçantë). Kjo i mundëson klientit të sigurojë pëlqimin e përgjithshëm në përputhje me rrethanat. Për shembull, një profesionist mund të japë informacione shpjeguese të përgjithshme në termat dhe kushtet standarde për angazhimin.
 - Informacione shpjeguese specifike për klientët e ndikuar nga rrethanat e një konflikti të veçantë, në detaje të mjaftueshme për t'i mundësuar klientit të marrë një vendim të informuar në lidhje me çështjen dhe, në këtë mënyrë, të japë një pëlqim të qartë. Këto lloj informacionesh shpjeguese mund të përfshijnë një prezantim të detajuar të rrethanave dhe një shpjegim gjithëpërfshirës të masave mbrojtëse të planifikuara dhe rreziqeve të përfshira.
 - Në disa rrethana, pëlqimi mund të imponohet nga sjellja e klientit kur profesionisti kontabël ka prova të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se klientët i njohin rrethanat që në fillim dhe e kanë pranuar konfliktin e interesit, në qoftë se ata nuk kanë ndonjë kundërshtim për ekzistencën e konfliktit.
- 310.9 A3 Zakonisht është e nevojshme:
- (a) Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi natyrën e konfliktit të interesit dhe se si u adresuan kërcënimet e krijuara, për klientët e ndikuar nga konflikti i interesit; dhe
 - (b) Marrja e pëlqimit të klientëve të ndikuar për të kryer shërbimet profesionale pas zbatimit të masave mbrojtëse për të adresuar kërcënimin.
- 310.9 A4 Nëse ky informacion shpjegues ose pëlqim nuk është i shkruar, profesionisti kontabël inkurajohet të dokumentojë:
- (a) Natyrën e rrethanave që çojnë në konflikt interesi;
 - (b) Masat mbrojtëse të zbatuara për të zvogëluar kërcënimet në një nivel të pranueshëm; dhe
 - (c) Marrjen e pëlqimit.
- Kur nuk ka një pëlqim të qartë*
- K310.10 Nëse një profesionist kontabël i pavarur ka kërkuar pëlqim të qartë nga një klient sipas paragrafit K310.9 dhe pëlqimi i është refuzuar nga klienti, profesionisti kontabël i pavarur do të:

- (a) Refuzojë ose të ndërpresë kryerjen e shërbimeve profesionale që do të çonin në konflikt interesi; ose
- (b) Ndërpresë marrëdhëniet përkatëse apo të zgjidhë interesat për të eliminuar ose zvogëluar kërcënimin në një nivel të pranueshëm.

Konfidencialiteti

Të përgjithshme

- K310.11 Një profesionist kontabël do të jetë vigjilent ndaj parimit të konfidencialitetit, përfshirë kur jep informacione shpjeguese ose ndan informacione brenda firmës ose rrjetit dhe kërkon këshilla nga palët e treta.
- 310.11 A1 Nën seksioni 114 përcakton kërkesat dhe materialin për zbatim, të përshtatshëm për situatat që mund të krijojnë një kërcënim për pajtueshmërinë me parimin e konfidencialitetit.

Kur informacionet shpjeguese për të marrë pëlqimin shkelin konfidencialitetin

- K310.12 Kur dhënia e informacioneve shpjeguese të veçanta me qëllim marrjen e një pëlqimi të qartë, do të rezultonte në shkelje të konfidencialitetit, dhe për këtë arsye, ky pëlqim nuk mund të merret, firma do të pranojë ose do të vazhdojë angazhimin vetëm nëse:
- (a) Firma nuk vepron në një rol favorizues (përkrahës) për një klient, kur një gjë e tillë do të kërkonte që firma të merrte një pozicion kundërshtar kundrejt klientit tjetër në lidhje me të njëjtën çështje;
 - (b) Janë vënë në zbatim mekanizma të veçanta që ndalojnë kalimin e informacioneve konfidenciale midis grupeve të angazhimit që u shërbejnë dy klientëve; dhe
 - (c) Firma është e bindur se një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar, do të mund të arrinte në konkluzionin se është e përshtatshme që firma të pranojë ose të vazhdojë angazhimin, pasi një kufizim në aftësinë e firmës për të dhënë shërbimin do të prodhonte një rezultat disproporcional të kundërt për klientët ose palët e treta.
- 310.12 A1 Një shkelje e konfidencialitetit mund të lindë, për shembull, kur kërkohet të merret pëlqimi për:
- Kryerjen e një shërbimi të lidhur me transaksionin për një klient në lidhje me blerjen direkte të një klienti tjetër të firmës.
 - Kryerjen e një hetimi ligjor për një klient në lidhje me një mashtrim të dyshuar, kur firma ka informacion konfidencial të marrë gjatë kryerjes së një shërbimi profesional për një klient tjetër, i cili mund të jetë i përfshirë në mashtrim.

Dokumentimi

Në rrethanat e përcaktuara në paragrafin K310.12, profesionisti kontabël duhet të dokumentojë:

- (a) Natyrën e rrethanave, përfshirë rolin që profesionisti kontabël do të marrë;
- (b) Kur janë vënë në zbatim masa të veçanta që ndalojnë kalimin e informacioneve konfidenciale midis grupeve të angazhimit që u shërbejnë dy klientëve; dhe
- (c) Arsyetimin përse është e përshtatshme të pranohet angazhimi.

SEKSIONI 320

EMËRIMET PROFESIONALE

Hyrje

- 320.1 Profesionistët kontabël kërkohet të respektojnë parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të përcaktuar në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 320.2 Pranimi i një marrëdhënieje me një klient të ri ose ndryshime në një angazhim ekzistues mund të krijojnë një kërcënim ndaj pajtueshmërisë me një ose më shumë parime themelore. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për të zbatuar kuadrin konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Pranimi i klientëve dhe angazhimeve

Të përgjithshme

- 320.3 A1 Kërcënimet ndaj pajtueshmërisë me parimet e integritetit ose sjelljes profesionale mund të krijohen, për shembull, nga çështje të dyshimta në lidhje me klientin (pronarët, drejtimin ose veprimtaritë e tij). Çështje, të cilat nëse dihen mund të krijojnë një kërcënim të tillë, janë përfshirja e klientit në aktivitete të paligjshme, pandershmëria, praktika të dyshimta të raportimit financiar ose sjelle të tjera jo etike.
- 320.3 A2 Faktorë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve përfshijnë:
- Njohjen dhe kuptimin e klientit, të pronarëve, drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen si dhe të aktiviteteve të tij të biznesit.
 - Angazhimin e klientit për të adresuar çështjet e dyshimta; për shembull, nëpërmjet përmirësimit të praktikave qeverisëse të korporatës ose të kontrolleve të brendshme.
- 320.3 A3 Një kërcënim i interesit vetjak për pajtueshmërinë me parimin e kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur krijohet nëse një grup angazhimi nuk ka ose nuk mund të fitojë kompetencat për të kryer shërbimet profesionale.

320.3 A4 Faktorët që janë të rëndësishëm në vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë përfshijnë:

- Të kuptuarit si duhet i:
 - Natyrës së biznesit të klientit;
 - Kompleksitetit të veprimtarisë së tij;
 - Kërkesave të angazhimit; dhe
 - Qëllimit, natyrës dhe objektit të punës që do të kryhet.
- Njohuritë për industrinë përkatëse ose lëndën.
- Përvojën me kërkesat përkatëse rregullatore ose raportuese.
- Ekzistencën e politikave dhe procedurave të kontrollit të cilësisë, të hartuara për të dhënë siguri të arsyeshme se angazhimet pranohen vetëm kur ato mund të kryhen me kompetencë.
- Nivelin e tarifave dhe shkallen në të cilën ato kanë parasysh burimet e kërkuara, duke marrë parasysh prioritetet tregtare dhe të tregut të profesionistit kontabël.

320.3 A5 Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të interesit vetjak përfshijnë:

- Caktimin e personelit të mjaftueshëm që zotëron kompetencën e nevojshme profesionale.
- Pranimin e kryerjes së angazhimit brenda një periudhe kohe realiste.
- Përdorimin e ekspertëve, kur kjo është e nevojshme.

Ndryshimet në një emërim profesional

Të përgjithshme

K320.4 Profesionisti kontabël do të përcaktojë nëse ka ndonjë arsye për të mos pranuar angazhimin kur:

- (a) Një klient i kërkon profesionistit kontabël të zëvendësojë një tjetër profesionist kontabël;
- (b) Profesionisti kontabël mendon të marrë pjesë në një tenderim që mbahet nga një tjetër profesionist kontabël; ose
- (c) Profesionisti kontabël mendon të ndërmarrë një punë që është plotësuese ose shtesë e asaj të një tjetër profesionisti kontabël.

320.4 A1 Mund të ketë arsye për të mos pranuar një angazhim. Një arsye e tillë mund të jetë kur një kërcënim i krijuar nga faktet dhe rrethanat nuk mund të adresohet nga masat mbrojtëse të zbatuara. Për shembull, mund të ishte një kërcënim i interesit vetjak për pajtueshmërinë me parimin e kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur kur profesionisti kontabël pranon angazhimin para se ai të njohë të gjitha faktet përkatëse.

- 320.4 A2 Nëse profesionistit kontabël i kërkohet të ndërmarrë një punë e cila është plotësuese ose shtesë e punës së një profesionisti kontabël ekzistues ose paraardhës, mund të krijohet një kërcënim i interesit vetjak për respektimin e parimit të kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur, për shembull, si rezultat i informacionit jo të plotë.
- 320.4 A3 Një faktor i rëndësishëm për vlerësimin e nivelit të këtij kërcënimi është fakti nëse tenderët deklarojnë se, para pranimit të angazhimit, kërkohet të komunikohet me profesionistin kontabël ekzistues ose paraardhës. Ky komunikim i jep profesionistit kontabël të propozuar mundësinë për të pyetur nëse ka ndonjë arsye pse angazhimi nuk duhet pranuar.
- 320.4 A4 Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për të adresuar një kërcënim të tillë të interesit vetjak, përfshijnë:
- Kërkesën që profesionisti kontabël ekzistues ose paraardhës të japë informacionet që ka dijeni, të cilat sipas opinionit të këtij të fundit, profesionisti kontabël i propozuar duhet të jetë në dijeni para se të marrë vendimin nëse do të pranojë ose jo angazhimin. Për shembull, një hetim mund të zbulojë fakte të rëndësishme të panjohura më parë dhe mund të vërë në dukje mosmarrëveshje me profesionistin kontabël ekzistues ose paraardhës që mund të ndikojnë në vendimin për të pranuar emërimin.
 - Marrja e informacionit nga burime të tjera, për shembull kërkimit të informacioneve nga palët e treta ose investigime në lidhje me drejtimin e lartë apo personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit.

Komunikimi me profesionistin kontabël ekzistues ose paraardhës

- 320.5 A1 Zakonisht, një profesionist kontabël i propozuar do të ketë nevojë për lejen e klientit, mundësisht me shkrim, për të filluar diskutimet me profesionistin kontabël ekzistues ose paraardhës.
- K320.6 Nëse komunikimi me profesionistin kontabël ekzistues ose paraardhës nuk është i mundur, profesionisti kontabël i propozuar do të ndërmarrë hapa të tjerë të arsyeshëm për të siguruar informacion në lidhje me kërcënimet e mundshme

Komunikimi me profesionistin kontabël të propozuar

- K320.7** Kur një profesionisti kontabël ekzistues ose paraardhës i kërkohet t'i përgjigjet një komunikimi nga një profesionist kontabël i propozuar, profesionisti kontabël ekzistues ose paraardhës duhet:
- (a) Të veprojë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat përkatëse që drejtojnë kërkesën; dhe

(b) Të japë çdo informacion me ndershmëri dhe në mënyrë të qartë.

320.7 A1 Një profesionist kontabël ekzistues ose paraardhës është i detyruar të ruajë konfidencialitetin. Natyra e angazhimit do të përcaktojë nëse një profesionist kontabël ekzistues ose paraardhës lejohet ose kërkohet të diskutojë çështjet e një klienti me një profesionist kontabël të propozuar dhe:

- (a) Nga fakti nëse një profesionist kontabël ekzistues ose paraardhës ka leje nga klienti për këtë diskutim; dhe
- (b) Nga kërkesat ligjore dhe etike lidhur me këto komunikime dhe informacione shpjeguese, të cilat mund të ndryshojnë sipas juridiksioneve të ndryshme.

Rrethanat në të cilat një profesionisti kontabël i kërkohet ose mund t'i kërkohet të komunikojë informacione konfidenciale, ose kur kjo dhënie informacioni është e përshtatshme, janë përshkruar në paragrafin 114.1 A1 të Kodit.

Ndryshime në emërimet e auditimit ose të rishikimit

K320.8 Në rastin e një auditimi ose rishikimi të pasqyrave financiare, një profesionist kontabël do t'i kërkojë profesionistit ekzistues ose paraardhës të japë informacionet që ai ka dijeni në lidhje me faktet ose informacione të tjera, të cilat sipas opinionit të këtij të fundit, profesionisti kontabël i propozuar duhet t'i dijë përpara se të marrë vendimin nëse do të pranojë angazhimin. Me përjashtim të rrethanave që përfshijnë papajtueshmëri ose papajtueshmëri të dyshuara me ligjet dhe rregullat e përcaktuara në paragrafët K360.21 dhe K360.22:

- (a) Nëse klienti i jep pëlqimin profesionistit kontabël ekzistues ose paraardhës për të dhënë fakte ose informacione të tilla, profesionisti kontabël ekzistues ose paraardhës do të japë informacion me ndershmëri dhe qartësi; dhe
- (b) Nëse klienti nuk mundet ose refuzon t'i japë leje profesionistit kontabël ekzistues ose paraardhës për të diskutuar çështjet e klientit me profesionistin kontabël të propozuar, profesionisti kontabël ekzistues ose paraardhës do t'i komunikojë këtë fakt profesionistit të propozuar, i cili do të marrë në konsideratë këtë pamundësi ose refuzim për të vendosur nëse do të pranojë emërimin.

Vijimësia me një klient dhe një angazhim

K320.9 Për një angazhim me një klient, i cili përsëritet, një profesionist kontabël do të rishikojë në mënyrë periodike nëse do të vazhdojë me angazhimin.

- 320.9 A1 Pas pranimit mund të krijohen kërcënime potenciale për pajtueshmërinë me parimet themelore të cilat, nëse do të ishin njohur më herët, do të bënë që profesionisti kontabël të refuzonte angazhimin. Për shembull, një kërcënim i interesit vetjak ndaj respektimit të parimit të integritetit, mund të krijohej nga një menaxhim jo i duhur i fitimeve ose i vlerësimeve në bilanc.

Përdorimi i punës së një eksperti

- K320.10 Kur një profesionist kontabël synon të përdorë punën e një eksperti, ai do të vlerësojë nëse një përdorimi i tillë, është i justifikuar.
- 320.10.A1 Faktorët që duhen marrë në konsideratë kur një profesionist kontabël synon të përdorë punën e një eksperti, përfshijnë reputacionin dhe ekspertizën e ekspertit, burimet në dispozicion të ekspertit, dhe standardet profesionale dhe etike të zbatueshme për ekspertin. Ky informacion mund të merret nga lidhja e mëparshme e profesionistit me ekspertin ose nga këshillimi me të tjerët

SEKSIONI 321

OPINIONET DYTËSORE

Hyrje

- 321.1 Profesionistët kontabël kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të përcaktuar në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 321.2 Dhënia e një opinionit dytësor për një entitet që nuk është një klient ekzistues, mund të çojë në kërcënime të interesit vetjak ose kërcënimetë tjera të respektimit të një ose më shumë primeve themelore. Ky seksion përshkruan kërkesat specifike dhe materialin për zbatim të përshtatshëm për aplikimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 321.3 A1 Një profesionisti kontabël mund t'i kërkohet të japë një opinion dytësor lidhur me zbatimin e standardeve të kontabilitetit, auditimit, raportimit ose të standardeve apo primeve të tjera sipas (a) rrethanave specifike apo (b) transaksioneve të kryera nga ose në emër të një shoqërie apo entiteti që nuk është një klient ekzistues. Për shembull, mund të ketë një kërcënim ndaj kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur, në rrethanat kur opinionit dytësor nuk ka qenë bazuar në të njëjtat fakte që ishin disponibël për profesionistin kontabël ekzistues ose paraardhës, ose kur ky opinion është bazuar në evidencë të pamjaftueshme.
- 321.3 A2 Një faktor që është i përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë të interesit vetjak do të varet nga rrethanat në të cilat bëhet kërkesa për opinione dytësore dhe nga të gjitha faktet dhe supozimet e tjera të mundshme, që lidhen me shprehjen e një gjykimi profesional.
- 321.3 A3 Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë përfshijnë:
- Marrjen e informacionit, me lejen e klientit, nga profesionisti kontabël ekzistues ose paraardhës.
 - Përshkrimin e kufizimeve që rrethojnë ndonjë opinion në komunikimet me klientin.
 - Dhënien e një kopjeje të opinionit për profesionistin kontabël ekzistues ose paraardhës.

Kur leja për komunikimin nuk jepet

K321.4 Në qoftë se entiteti që kërkon opinionin dytësor nuk lejon komunikimin me profesionistin kontabël ekzistues ose të mëparshëm, profesionisti kontabël duhet të përcaktojë nëse ai mund të japë opinionin dytësor të kërkuar.

SEKSIONI 325

OBJEKTIVITETI I NJË RISHIKUESI TË CILËSISË SË ANGAZHIMIT DHE I RISHIKUESVE TË TJERË TË PËRSHTATSHËM

Hyrje

- 325.1 Profesionalistët kontabël kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të përshkruar në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 325.2 Niveli dhe natyra e honorareve dhe formave të tjera të pagesave mund të krijojnë një kërcënim të interesit vetjak për pajtueshmërinë me një ose më shumë parime themelore. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për të zbatuar kuadrin konceptual në këto rrethana.
- 325.3 Ky seksion përcakton materialin specifik për zbatim, që ka të bëjë me aplikimin e kuadrit konceptual në lidhje me objektivitetin e një rishikuesi të cilësisë së angazhimit.
- 325.4 Një rishikues i cilësisë së angazhimit është gjithashtu, një shembull i një rishikuesi të përshtatshëm siç përshkruhet në paragrafin 300.8 A4. Prandaj, materiali për zbatim në këtë seksion mund të aplikohet në rrethanat kur një profesionist kontabël emëron një rishikues të përshtatshëm për të rishikuar punën e kryer si një masë mbrojtëse për të trajtuar kërcënimet e identifikuara.

Materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 325.5 A1 Angazhimet cilësore arrihen nëpërmjet planifikimit dhe kryerjes së angazhimeve dhe raportimit mbi to në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. SNMC1 përcakton përgjegjësitë e firmës për sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë dhe kërkon nga firma të projektojnë dhe zbatojnë reagimet për të trajtuar rreziqet e cilësisë që lidhen me performancën e angazhimit. Këto reagime përfshijnë vendosjen e politikave apo procedurave që trajtojnë rishikimet e cilësisë së angazhimit në përputhje me SNMC 2.
- 325.5 A2 Një rishikues i cilësisë së angazhimit është një partner, një individ tjetër në firmë, ose një individ i jashtëm, i emëruar nga firma për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit.

Identifikimi i kërcënimeve

325.6 A1 Në vijim jepen shembujt e rrethanave kur mund të krijohen kërcënime ndaj objektivitetit të një profesionisti kontabël të emëruar si rishikues i cilësisë angazhimit:

- (a) Kërcënimi i interesit vetjak
 - Dy partnerë angazhimi shërbejnë secili si rishikues të cilësisë së angazhimit për angazhimet e njeri tjetrit
- (b) Kërcënimi i vetë rishikimit
 - Një kontabilist shërben si rishikues i cilësisë së angazhimit mbi një angazhim auditimi pasi më parë shërbeu si partner i angazhimit.
- (c) Kërcënimi i familjaritetit
 - Një kontabilist që shërben si rishikues i cilësisë së angazhimit ka një marrëdhënie të ngushtë me ose është një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së një individi tjetër që është i përfshirë në angazhim.
- (d) Kërcënimi i frikësimit
 - Një kontabilist që shërben si rishikues i cilësisë së angazhimit për një angazhim ka një linjë të drejtpërdrejtë raportimi tek partneri që ka përgjegjësinë për angazhimin.

Vlerësimi i kërcënimeve

325.7 A1 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimeve ndaj objektivitetit të një individi të emëruar si një rishikues i cilësisë së angazhimit, përfshijnë:

- Rolin dhe vjetërsinë (senioritetin) e individit.
- Natyrën e marrëdhënies së individit me të tjerët, që janë të përfshirë në angazhim.
- Kohëzgjatjen e mëparshme e përfshirjes së individit me angazhimin dhe roli i tij.
- Kohën kur individi ka qenë i përfshirë për herë të fundit në angazhimin e mëparshëm para se të emërohet rishikues i cilësisë së angazhimit dhe çdo ndryshim të mëvonshëm që është i përshtatshëm për rrethanat e angazhimit.
- Natyrën dhe kompleksitetin e çështjeve që kanë kërkuar gjykime të rëndësishme nga individi në çdo përfshirje të tij të mëparshme në angazhim.

Adresimi i kërcënimeve

325.8 A1 Shembull i një veprimi që do të eliminonte një kërcënim të frikësimit është ri caktimi i përgjegjësive të raportimit brenda firmës.

- 325.8 A2 Shembull i një veprimi që do të ishte një masë mbrojtëse për të adresuar një kërcënim të vetë rishikimit është zbatimi i një periudhë me zgjatje të mjaftueshme (një periudhë ndërprerje (cooling-off)), para se individi që ka qenë në angazhime të caktohet si një rishikues i cilësisë së angazhimit.

Periudha e ndërprerjes (cooling-off)

- 325.8 A3 SNMC 2 kërkon që firma të vendosë politika apo procedura të cilat specifikojnë , si një kusht për t'u përzgjedhur, një periudhë ndërprerje prej dy vjetësh, para se partneri i angazhimit të marrë përsipër rolin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit. Kjo shërben për të mundësuar respektimin e parimit të objektivitetit dhe kryerjen në vazhdimësi të angazhimeve cilësore.
- 325.8 A4 Periudha e ndërprerjes e kërkuar nga SNMC2 është e ndryshme nga rotacioni, dhe nuk modifikon, kërkesat e rotacionit të partnerit në seksionin 540, të cilat janë parashikuar për të trajtuar kërcënimet ndaj pavarësisë të krijuara nga lidhja e gjatë me një klient të auditimit

SEKSIONI 330

HONORARET DHE LLOJET E TJERA TË SHPËRBLIMEVE

Hyrje

- 330.1 Profesionistët kontabël kërkohet të respektojnë parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të përshkruar në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 330.2 Niveli dhe natyra e honorarit dhe marrëveshjeve të tjera të shpërblimit mund të krijojnë një kërcënim të egoizmit ndaj pajtueshmërisë me një ose më shumë parime themelore. Ky seksion përfshin materialin specifik të përshtatshëm për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Materiali për zbatim

Niveli i tarifave të honorarëve

- 330.3 A1 Niveli i tarifave të honorarëve mund të ndikojë në aftësinë e një profesionisti kontabël për të kryer shërbime profesionale në përputhje me standardet teknike dhe profesionale.
- 330.3 A2 Një profesionist kontabël mund të caktojë çfarëdo honorari që atij i duket i përshtatshëm. Caktimi i një honorari me të ulët se një profesionist kontabël tjetër, nuk është në vetvete jo-etike. Megjithatë, niveli i honorarëve të kuotuar mund të çojë në kërcënime ndaj respektimit të parimit të kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur, në qoftë se honorari është kuotuar aq i ulët sa që do të jetë vështirë që angazhimi të kryhet në pajtim me standardet profesionale dhe teknike.
- 330.3 A3 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë përfshijnë fakti::
- Nëse klienti është në dijeni të kushteve të angazhimit dhe, në veçanti, bazës mbi të cilën përcaktohen tarifat dhe shërbimet profesionale që mbulohen.
 - Nëse niveli i tarifës përcaktohet nga një palë e tretë e pavarur, si p.sh. një organ rregullator.
- 330.3 A4 Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të interesit vetjak përfshijnë:
- Rregullimin e nivelit të honorarëve ose të fushëveprimit të angazhimit.

- Rishikimin e punës së kryer nga një rishikues i përshtatshëm.

Honorarët e kushtëzuara

330.4 A1 Për disa kategori të angazhimeve të jo sigurisë përdoren gjerësisht honorarët e kushtëzuara. Megjithatë, në disa rrethana honorarët e kushtëzuara mund të krijojnë kërcënime ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore, veçanërisht një kërcënim të interesit vetjak ndaj pajtueshmërisë me parimin e objektivitetit.

330.4 A2 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimeve të tilla përfshijnë:

- Natyrën e angazhimit.
- Intervalin e vlerave të mundshme të honorarëve.
- Bazën për përcaktimin e honorarit.
- Informimin e përdoruesve të synuar për punën e kryer nga një profesionist kontabël dhe për bazën e shpërblimit.
- Politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë.
- Faktin nëse një palë e tretë e pavarur do të rishikojë përfundimin apo rezultatin e transaksionit.
- Faktin nëse niveli i honorarit është përcaktuar nga një palë e tretë dhe e pavarur, siç është një organ rregullator.

330.4 A3 Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të interesit vetjak, përfshijnë:

- Angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk është përfshirë në kryerjen e shërbimit të jo sigurisë, për të rishikuar punën e kryer nga profesionisti kontabël.
- Bërjen e një marrëveshjeje paraprake me shkrim me klientin në të cilën të përcaktohen bazat e llogaritjes së shpërblimit.

330.4 A4 Kërkesat dhe materiali për zbatim lidhur me honorarët e kushtëzuara për shërbimet e dhëna për klientët e auditimit ose rishikimit si dhe për klientët të tjerë të sigurisë, janë përshkruar në *Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë*.

Honoraret referuese ose komisionet

330.5 A1 Një kërcënim i interesit vetjak ndaj pajtueshmërisë me parimet e objektivitetit, të kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur, krijohet nëse një profesionist kontabël paguan ose merr një honorar referues ose një komision lidhur me një klient. Honorare referuese ose komisione të tilla përfshijnë, për shembull:

- Një honorar që i paguhet një profesionisti kontabël tjetër për të siguruar një klient të ri, kur klienti i cili vazhdon të jetë klient ekzistues i një profesionisti kontabël, kërkon disa shërbime të specializuara, të cilat nuk ofrohen nga ky profesionist kontabël.
- Një honorar që merret për të adresuar një klient të një profesionisti kontabël ose eksperti tjetër, kur profesionisti kontabël ekzistues nuk e kryen vetë shërbimin specifik të kërkuar nga klienti.
- Një komision që merret nga një palë e tretë (për shembull një shitës softuerësh) në lidhje me shitjen e mallrave apo shërbimeve një klienti.

330.5 A2 Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të interesit vetjak përfshijnë:

- Hartimi i një marrëveshje paraprake me klientin për komisionet lidhur me shitjen nga një palë e tretë të mallrave apo shërbimeve për klientin, mund të adresojë një kërcënim të interesit vetjak.
- Informimi i klientit lidhur me ndonjë honorar referues apo komision, paguar për ose arkëtuar nga një tjetër profesionist kontabël apo palë e tretë, për rekomandimin e shërbimeve ose mallrave, mund të adresojë një kërcënim të interesit vetjak.

Blerja ose shitja e një firme

330.6 A1 Një profesionist kontabël mund të blejë të gjithë ose një pjesë të një firme tjetër, bazuar në faktin që pagesat do t'ju bëhen individëve që e kanë pasur më parë në pronësi firmën, ose trashëgimtarëve apo agjentëve të shitjes. Këto pagesa nuk konsiderohen honorare referuese, apo komisione për qëllime të këtij seksioni.

SEKSIONI 340

NXITJET, PËRFSHIRË DHURATAT DHE MIKPRITJEN

Hyrje

- 340.1 Profesionistët kontabël kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të përshkruar në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 340.2 Ofrimi ose pranimi i nxitjeve mund të përbëjë një kërcënim të interesit vetjak, familjaritetit ose të frikësimit ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore, dhe në veçanti me parimet e integritetit, objektivitetit dhe sjelljes profesionale.
- 340.3 Ky seksion përcakton kërkesat dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrin konceptual në lidhje me ofrimin dhe pranimin e nxitjeve kur kryhen shërbime profesionale që nuk përbëjnë papajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret. Ky seksion kërkon gjithashtu që profesionistët kontabël të jenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret përkatëse kur ofrojnë ose pranojnë nxitjet.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 340.4 A1 Nxitja është një objekt, situatë ose veprim që përdoret si një mjet për të ndikuar në sjelljen e një individi tjetër, por jo domosdoshmërisht me qëllimin për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në sjelljen e këtij individi. Nxitjet mund të variojnë nga akte të vogla mikpritjeje midis profesionistëve kontabël dhe klientëve ekzistues ose të ardhshëm, deri tek veprime që rezultojnë në mosrespektim të ligjeve dhe rregulloreve. Një nxitje mund të marrë forma të ndryshme, për shembull:
- Dhuratat.
 - Mikpritja.
 - Argëtimi.
 - Donacionet politike ose bamirësie.
 - Joshjet për miqësi dhe besnikëri.
 - Punësimi ose mundësi të tjera komerciale.
 - Trajtimi preferencial, të drejtat ose privilegjet.

Nxitje të ndaluara nga ligje ose rregullore

- K340.5 Në shumë juridiksione ka ligje dhe rregullore, të tilla si ato që lidhen me

ryshfetin dhe korrupsionin, të cilat ndalojnë ofrimin ose pranimin e nxitjeve në rrethana të caktuara. Profesionisti kontabël do të sigurojë njohjen e ligjeve dhe rregulloreve përkatëse dhe do t'i respektojë ato kur ndeshet me rrethana të tilla.

Nxitjet që nuk ndalohen nga ligjet dhe rregulloret

340.6 A1 Ofrimi ose pranimi i nxitjeve që nuk janë të ndaluara nga ligjet dhe rregulloret mund të krijojnë gjithsesi kërcënime ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore.

Nxitjet me qëllim ndikimin e papërshtatshëm të sjelljes

K340.7 Një profesionist kontabël nuk duhet të ofrojë, ose të inkurajojë të tjerët të ofrojnë, nxitje që kanë ndodhur, ose të cilat profesionisti kontabël konsideron se një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar do të vlerësonte se kanë ndodhur, me qëllim ndikimin në mënyrë të papërshtatshme në sjelljen e marrësit të nxitjes ose sjelljen e një tjetër individi.

K340.8 Një profesionist kontabël nuk duhet të pranojë, ose të inkurajojë të tjerët të pranojnë, nxitje që profesionisti kontabël vlerëson se kanë ndodhur, ose ato nxitje të cilat profesionisti kontabël vlerëson se një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar do të vlerësonte se kanë ndodhur, me qëllim ndikimin në mënyrë të papërshtatshme në sjelljen e marrësit të nxitjes ose sjelljen e një individi tjetër.

340.9 A1 Një nxitje vlerësohet me ndikim i papërshtatshëm në sjelljen e një individi nëse ajo bën që individi të veprojë në mënyrë jo etike. Një ndikim i tillë i papërshtatshëm mund t'i drejtohet qoftë marrësit të nxitjes, ose një individi tjetër që ka një marrëdhënie me marrësin. Parimet themelore janë një kuadër i përshtatshëm reference për profesionistin kontabël në vlerësimin se çfarë përbën një sjellje jo etike në pjesën e profesionistit kontabël, dhe sipas rastit, për analogji, edhe nga ana e individëve të tjerë.

340.9 A2 Një shkelje e parimit themelor të integritetit ndodh kur profesionisti kontabël ofron ose pranon, apo inkurajon të tjerët të ofrojnë ose të pranojnë një nxitje, qëllimi i të cilës është të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme sjelljen e marrësit të nxitjes ose të një individi tjetër.

340.9 A3 Përcaktimi nëse ekziston qëllimi real ose i perceptuar për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme sjelljen, kërkon të ushtrohet gjyrimi profesional. Faktorët e përshtatshëm për tu marrë në konsideratë mund të përfshijnë:

- Natyrën, shpeshtësinë, vlerën dhe efektin kumulativ të nxitjes.
- Kohën kur është ofruar nxitja lidhur me çdo veprim ose vendim që ajo mund të ndikojë.
- Faktin nëse nxitja është një zakon ose praktikë kulturore sipas rrethanave, për shembull, ofrimi i një dhurate me rastin e një feste fetare ose martese.
- Faktin nëse nxitja është një pjesë ndihmëse e një aktiviteti profesional, për shembull ofrimi ose pranimit të një dreke të lidhur me një takim biznesi.
- Faktin nëse ofrimi i nxitjes është i kufizuar të një individ apo ajo i është drejtuar një grupi me të gjerë. Grupi më i gjerë mund të jetë brenda ose jashtë firmës, si për shembull, furnitorët e tjerë të klientit.
- Rolet dhe pozicionet e individëve në firmë ose individëve të klientit që ofrojnë ose u ofrohet nxitja.
- Faktin nëse profesionisti kontabël ka njohuri, ose ka arsye të besojë se pranimi i nxitjes do të përbënte shkelje të politikave dhe procedurave të klientit.
- Shkallën e transparencës me të cilën ofrohet nxitja.
- Faktin nëse nxitja u kërkua apo u porosit nga marrësi.
- Njohjen e sjelljes së mëparshme ose reputacionit të ofruesit.

Marrja në konsideratë e veprimeve të mëtejshme

340.10 A1 Nëse profesionisti kontabël bëhet i vetëdijshëm për një nxitje të ofruar me qëllim faktik ose të perceptuar për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në sjellje, kërcënimet për respektimin e parimeve themelore mund të krijohen, madje edhe nëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në paragrafët K340.7 dhe K340.8

340.10 A2 Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për trajtimin e këtyre kërcënimeve përfshijnë:

- Informimin e niveleve të larta drejtuese të firmës ose të personave të ngarkuar me qeverisjen të klientit lidhur me ofertën.
- Korrigjimin ose ndërprerjen e marrëdhënies së biznesit me klientin.

Nxitjet që nuk kanë për qëllim ndikimin e papërshtatshëm të sjelljes

340.11 A1 Kur arrin në përfundimin se nuk ekziston një qëllim real ose i perceptuar për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në sjelljen e marrësit të nxitjes apo të një individi tjetër, profesionisti kontabël zbaton kërkesat dhe materialin për zbatim, të përshkruara në kuadrin konceptual.

- 340.11 A2 Nëse një nxitje e tillë është e parëndësishme dhe pa pasoja, çdo kërcënim i krijuar do të jetë në një nivel të pranueshëm.
- 340.11 A3 Shembuj të rrethanave kur ofrimi ose pranimi i një nxitje të tillë mund të krijojë kërcënime, edhe nëse profesionisti kontabël ka konstatuar se nuk ka ndonjë qëllim real ose të perceptuar për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në sjellje, përfshijnë:
- Kërcënime të interesit vetjak
 - Profesionistit kontabël i ofrohet mikpritje nga blerësi i ardhshëm i një klienti ndërkohë që ofron shërbime të financimit të korporatës për klientin.
 - Kërcënime të familjaritetit
 - Një profesionist kontabël çon rregullisht një klient ekzistues ose të ardhshëm në ngjarje sportive.
 - Kërcënime të frikësimit
 - Një profesionist kontabël pranon mikpritjen nga një klient, natyra e së cilës mund të perceptohet si e papërshtatshme, nëse do të bëhej publike.
- 340.11 A4 Faktorë të përshtatshëm në vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve, të krijuara nga ofrimi ose pranimi i një nxitjeje të tillë, përfshijnë të njëjtët faktorë të përcaktuar në paragrafin 340.9 A3 për përcaktimin e qëllimit të nxitjes.
- 340.11 A5 Shembuj të veprimeve që mund të eliminojnë kërcënimet e krijuara nga ofrimi ose pranimi i një nxitjeje të tillë përfshijnë:
- Refuzimin ose mos ofrimin e nxitjes.
 - Transferimin e përgjegjësisë për ofrimin e çfarëdo shërbimi profesional të klientit, një individ tjetër, për të cilin profesionisti kontabël nuk ka arsye të besojë se do të ishte ose të perceptohet se do të ishte i ndikuar në mënyrë të papërshtatshme kur jep shërbimet.
- 340.11 A6 Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për të adresuar kërcënime të tilla të krijuara nga ofrimi ose pranimi i një nxitjeje të tillë përfshijnë:
- Të qenurit transparent me nivelet e larta të drejtimit të firmës ose me personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit, lidhur me ofrimin ose pranimin e një nxitjeje.
 - Regjistrimin e nxitjes në një regjistër të monitoruar nga drejtimi i lartë i firmës ose nga një individ tjetër përgjegjës për pajtueshmërinë e firmës me etikën ose në një regjistër të mbajtur nga klienti.

- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk është i përfshirë në dhënien e shërbimit profesional, për rishikimin e punës së kryer apo të vendimeve të marra nga profesionisti kontabël në lidhje me klientin prej të cilit ai ka pranuar nxitjen.
- Dhurimin e nxitjes për bamirësi pas marrjes së saj dhe informimin në mënyrë të përshtatshme për nxitjen, për shembull një anëtar të drejtimit të lartë të firmës ose individin që ofroi nxitjen.
- Rimbursimin e kostos së nxitjes së marrë, siç është mikpritja.
- Kthimin sa më shpejt të jetë e mundur të nxitjes, siç është dhurata, pasi ajo u pranuar fillimisht.

Anëtarë të ngushtë ose të afërt të familjes

K340.12 Një profesionist kontabël do të jetë vigjilent për kërcënime të mundshme ndaj pajtueshmërisë së tij me parimet themelore, të krijuara nga ofrimi i një nxitjeje:

- (a) Nga një anëtar i afërt ose i ngushtë i familjes së profesionistit kontabël për një klient ekzistues ose të ardhshëm të profesionistit kontabël.
- (b) Drejtuar një anëtari të afërt ose të ngushtë të familjes së profesionistit kontabël nga një klient ekzistues ose i ardhshëm i profesionistit kontabël.

K340.13 Kur profesionisti kontabël bëhet i vetëdijshëm për një nxitje që ofrohet për ose është ofruar nga një anëtar i afërt ose i ngushtë i familjes, dhe arrin në përfundimin se ka qëllim të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme në sjelljen e profesionistit kontabël ose të një klienti ekzistues apo të ardhshëm të profesionistit, ose vlerëson se një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar ka të ngjarë të arrijë në përfundimin se ekziston një qëllim i tillë, profesionisti kontabël duhet të këshillojë anëtarin e afërt ose të ngushtë të familjes që të mos ofrojë ose pranojë nxitjen.

340.13 A1 Faktorët e përcaktuar në paragrafin 340.9 A3 janë të përshtatshëm për përcaktimin nëse ekziston qëllimi real ose i perceptuar për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme sjelljen e profesionistit kontabël ose të klientit ekzistues apo të ardhshëm. Një faktor tjetër i përshtatshëm është natyra ose afërsia e marrëdhënies, midis:

- (a) Profesionistit kontabël dhe anëtarit të ngushtë ose të afërt të familjes;
- (b) Anëtarit të ngushtë ose të afërt të familjes dhe klientit ekzistues apo të ardhshëm; dhe
- (c) Profesionistit kontabël dhe klientit ekzistues apo të ardhshëm.

Për shembull, ofrimi i punësimit, jashtë procesit normal të rekrutimit, për bashkëshortin (en) e profesionistit kontabël nga një klient, për të cilin profesionisti është duke ofruar një vlerësim biznesi për një shitje të ardhshme, mund të jetë tregues për një qëllim të tillë.

340.13 A2 Materiali për zbatim në paragrafin 340.10 A2 është gjithashtu i përshtatshëm për adresimin e kërcënimeve që mund të krijohen kur ekziston një qëllim real ose i perceptuar për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme sjelljen e profesionistit kontabël ose të klientit ekzistues apo të ardhshëm, madje edhe nëse anëtari i ngushtë ose i afërt i familjes ka ndjekur këshillën e dhënë sipas paragrafit K340.13.

Zbatimi i kuadrit konceptual

340.14 A1 Kur profesionisti kontabël bëhet i vetëdijshëm për një nxitje të ofruar në rrethanat e trajtuara në paragrafin K340.12, kërcënimet për pajtueshmërinë ndaj parimeve themelore mund të krijohen kur:

- (a) Anëtari i afërt ose i ngushtë i familjes ofron ose pranon nxitjen në kundërshtim me këshillat e profesionistit kontabël sipas paragrafit K340.13; ose
- (b) Profesionisti kontabël nuk ka arsye të besojë se ekziston një qëllim real ose i perceptuar për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në sjelljen e tij ose të klientit ekzistues apo të ardhshëm.

340.14 A2 Materiali për zbatim në paragrafët 340.11 A1 deri 340.11 A6 është i përshtatshëm për qëllime të identifikimit, vlerësimit dhe adresimit të kërcënimeve të tilla. Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimeve në këto rrethana, përfshijnë gjithashtu, natyrën ose afërsinë e marrëdhënieve të përshkruara në paragrafin 340.13 A1.

Konsiderata të tjera

340.15 A1 Nëse profesionisti kontabël përballlet me ose vihet në dijeni të nxitjeve që mund të rezultojnë në papajtueshmëri ose papajtueshmëri të dyshuar meligjet dhe rregulloret nga një klient ose individët që punojnë për ose nën drejtimin e klientit, zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim i përshkruar në Seksionin 360.

340.15 A2 Nëse një firmë, një firmë të rrjetit ose një anëtari të ekipit të auditimit, nga një klient i auditimit i është ofruar dhuratë ose mikpritje, zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim i përshkruar në Seksionin 420.

340.15 A3 Nëse një firme ose një anëtari të ekipit të angazhimit të sigurisë, i ofrohen dhurata ose mikpritje nga një klient i këtij angazhimi, zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim, i përshkruar në Seksionin 906.

SEKSIONI 350

MARRJA NË RUAJTJE (NË KUJDESTARI) E AKTIVEVETË KLIENTIT

Hyrje

- 350.1 Profesionistët kontabël kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të përshkruar në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 350.2 Mbajtja e aktiveve të klientit krijon kërcënim të interesit vetjak ose kërcënim tjetër ndaj pajtueshmërisë me parimet e sjelljes profesionale dhe objektivitetit. Ky seksion përshkruan kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Përpara marrjes në ruajtje

- K350.5 Një profesionist kontabël nuk do të marrë në ruajtje paratë e klientit apo edhe aktive të tjera të tij, përveç rasteve kur ligji e lejon një gjë të tillë, dhe në përputhje me çdo rrethanë nën të cilën mund të zbatohet kjo marrje në ruajtje.
- K350.4 Si pjesë e procedurave të pranimit të klientit dhe angazhimit lidhur me marrjen në ruajtje të parave ose aktiveve të klientit, një profesionist kontabël do të:
- (a) bëjë verifikimet e nevojshme rreth burimeve të këtyre aktiveve; dhe
 - (b) marrë në konsideratë detyrimet përkatëse ligjore dhe rregullatore.
- 350.4 A1 Kërkesat në lidhje me burimin e aktiveve të klientit, mund të zbulojnë, për shembull, që aktivet kanë ardhur nga veprimtari të paligjshme, siç është pastrimi i parave. Në rrethana të tilla, do të krijohej një kërcënim dhe do të zbatoheshin dispozitat e Seksionit 360.

Pas marrjes në ruajtje

- K350.5 Një profesionist kontabël, të cilit i janë besuar paratë apo aktivet e tjera që u përkasin të tjerëve, duhet:
- (a) Të respektojë të gjitha ligjet dhe rregullat përkatëse për mbajtjen dhe kontabilizimin e këtyre aktiveve;
 - (b) T'i mbajë këto aktive të ndara nga aktivet personale apo të firmës;

- (c) Të përdorë këto aktive vetëm për qëllimet, për të cilat ato janë parashikuar; dhe
- (d) Të jetë i gatshëm, në çdo kohë, të kontabilizojë aktivet dhe çdo të ardhur, dividendë, apo fitime të gjeneruara, për çdo person që ka të drejta ndaj tyre.

SEKSIONI 360

REAGIMI NDAJ PAPAJTUESHMËRISË ME LIGJET DHE RREGULLAT

Hyrje

- 360.1 Profesionistët kontabël kërkohet të jenë në pajtim me parimet themelore dhe të zbatojnë kuadrin konceptual, të përshkruar në Seksionin 120, për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.
- 360.2 Një kërcënim i interesit vetjak ose i frikësimit ndaj pajtueshmërisë me parimet e integritetit dhe sjelljes profesionale, krijohet kur profesionisti kontabël bëhet i vetëdijshëm për papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar me ligjet dhe rregullat.
- 360.3 Një profesionist kontabël mund të ndeshet ose të vihet në dijeni të papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar me ligjet dhe rregullat gjatë kryerjes së një shërbimi profesional për një klient. Ky seksion udhëzon profesionistin kontabël për vlerësimin e ndikimeve të kësaj çështjeje dhe për drejtimit e mundshme të veprimeve për t'ju përgjigjur papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar me:
- (a) Ligjet dhe rregullat përgjithësisht të njohura që kanë një efekt të drejtpërdrejtë në përcaktimin e shumave materiale dhe të informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare të klientit; dhe
 - (b) Ligjet dhe rregullat e tjera, që nuk kanë një efekt të drejtpërdrejtë në përcaktimin e shumave materiale dhe të informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare të klientit, por pajtueshmëria me të cilat, mund të jetë thelbësore, për aspektet operative të biznesit të klientit, për aftësinë e tij për të vazhduar biznesin, ose për të shmangur penalitetet materiale.

Objektivat e profesionistit kontabël në lidhje me papajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret

- 360.4 Një shenjë dalluese e profesionit kontabël është pranimi prej tij i përgjegjësisë për të vepruar në interes të publikut. Kur reagon ndaj një papajtueshmërie ose papajtueshmërie të dyshuar, objektivat e profesionistit kontabël janë:
- (a) Të jetë në pajtim me parimet e integritetit dhe sjelljes profesionale;
 - (b) Të vërë në dijeni drejtimin ose, sipas rastit, personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit, duke kërkuar që ata:

- (i) Të bëjnë të mundur korrigjimin, riparimin ose zbutjen e pasojave të papajtueshmërisë së identifikuar apo dyshuar; ose
- (ii) Të ndalojnë papajtueshmërinë kur ajo ende nuk ka ndodhur; dhe
- (c) Të ndër marrë veprime të mëtejshme që janë të përshtatshme në interes të publikut.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

360.5 A1 Papajtueshmëria me ligjet dhe rregullat (“papajtueshmëria”) përfshin aktet e mosveprimit apo veprimit, të qëllimshme ose jo të qëllimshme, të cilat janë në kundërshtim me ligjet ose rregullat e zbatueshme, të kryera nga palët në vijim:

- (a) Një klient;
- (b) Personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit;
- (c) Drejtimi i klientit; ose
- (d) Individë të tjerë që punojnë për ose nën drejtimin e klientit.

360.5 A2 Shembuj të ligjeve ose rregullave që adreson ky seksion përfshijnë ato që kanë të bëjnë me:

- Mashtrimin, korrupsionin dhe ryshfetin.
- Pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe të ardhurat nga krimi.
- Tregjet e letrave me vlerë dhe tregtare.
- Bankingun dhe produkte e shërbime të tjera financiare.
- Mbrojtjen e të dhënave.
- Detyrimet dhe pagesat e taksave dhe të pensioneve.
- Mbrojtjen mjedisore.
- Shëndetin dhe sigurinë publike.

360.5 A3 Papajtueshmëria mund të rezultojë në gjoba, çështje gjyqësore ose pasoja të tjera për klientin, të cilat mund të kenë një efekt material në pasqyrat e tij financiare. Më e rëndësishmja, një papajtueshmëri e tillë mund të ketë ndikime më të gjera në interesin publik për sa i përket dëmit potencialisht të konsiderueshëm ndaj investitorëve, kreditorëve, të punësuarve ose publikut në përgjithësi. Për qëllime të këtij seksioni, një veprim që shkakton dëm të konsiderueshëm është ai që rezulton në pasoja negative serioze për ndonjërin nga këto palë në aspektin financiar ose jo financiar. Shembujt përfshijnë kryerjen e një mashtrimi që rezulton në humbje të mëdha për investitorët dhe shkelje të ligjeve

dhe rregullave mjedisore, të cilat rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e punonjësve apo publikut.

K360.6 Në disa juridiksione, ekzistojnë dispozita ligjore ose rregullatore që tregojnë mënyrën se si profesionistët kontabël duhet të adresojnë papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar. Këto dispozita ligjore ose rregullatore mund të ndryshojnë nga ose të shkojnë përtej këtij seksioni. Kur has një papajtueshmëri ose papajtueshmëri të dyshuar të tillë, profesionisti kontabël duhet të sigurojë njohjen dhe kuptimin e këtyre dispozitave dhe të jetë në pajtim me to, përfshirë:

- (a) Çdo kërkesë për të raportuar çështjen tek një autoritet i duhur; dhe
- (b) Çdo ndalim për të njoftuar klientin.

360.6 A1 Një ndalim për të njoftuar klientin mund të lindë për shembull, në zbatim të legjislacionit kundër pastrimit të parave.

370.7 A1 Ky seksion zbatohet pavarësisht natyrës së klientit, përfshirë faktin nëse ai është apo jo një entitet me interes publik.

370.7 A2 Një profesionist kontabël, i cili ndeshet ose vihet në dijeni të çështjeve që janë qartësisht pa pasoja, nuk kërkohet të jetë në pajtim me këtë seksion. Fakti nëse një çështje është qartësisht pa pasoja duhet gjykuar në lidhje me natyrën dhe ndikimin e saj, financiar ose tjetër, mbi klientin, palët e interesuara dhe publikun në përgjithësi.

360.7 A3 Ky seksion nuk adreson:

- (a) Sjelljen e keqe personale të palidhur me aktivitetet e biznesit të klientit; dhe
- (b) Papajtueshmëritë nga palë të tjera, të ndryshme nga ato të specifikuara në paragrafin 360.5 A1. Kjo përfshin, për shembull, rrethanat kur një profesionist kontabël ka qenë i angazhuar nganjë klient për të kryer një angazhim të kujdesit të duhur mbi një entitet, palë të tretë, dhe papajtueshmëria e identifikuar ose e dyshuar është kryer nga kjo palë e tretë.

Megjithatë, profesionisti kontabël mund të gjejë udhëzime të dobishmenë këtë seksion për të vlerësuar si të përgjigjet në të tilla situata.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen

360.8 A1 Drejtimi, me mbikëqyrjen e personave të ngarkuar me qeverisjen, është përgjegjës për sigurimin se aktivitetet e biznesit janë realizuar në përputhje me ligjet dhe rregullat. Drejtimi dhe personat e ngarkuar me

qeverisjen janë gjithashtu, përgjegjës për identifikimin dhe adresimin e çdo papajtueshmërie nga:

- (a) Klienti;
- (b) Një individ i ngarkuar me qeverisjen e entitetit;
- (c) Një anëtar i drejtimit; ose
- (d) Individë të tjerë që punojnë për dhe nën drejtimin e klientit.

Përgjegjësitë e të gjithë profesionistëve kontabël

K360.9 Kur një profesionist kontabël vihet në dijeni të një çështjeje për të cilën zbatohet ky seksion, hapat që ndërmerr profesionisti kontabël për të qenë në pajtueshmëri me këtë seksion duhet të merren në kohë. Gjatë ndërmarrjes së hapave me kohë, profesionisti kontabël duhet të ketë pasur parasysh natyrën e çështjes dhe dëmin potencial ndaj interesave të klientit, investitorëve, kreditorëve, punonjësve apo publikut në përgjithësi.

Auditimet e pasqyrave financiare

Sigurimi i njohjes së çështjes

K360.10 Nëse një profesionist kontabël, i angazhuar për të kryer një auditim të pasqyrave financiare, vihet në dijeni të informacioneve në lidhje me papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar, ai duhet të sigurojë një njohje të çështjes. Kjo njohje duhet të përfshijë natyrën e papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar dhe rrethanat në të cilat ajo ka ndodhur ose mund të ndodhë.

360.10 A1 Profesionisti kontabël mund të bëhet i vetëdijshëm për papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar gjatë kryerjes së angazhimit ose nëpërmjet informacionit të marrë nga palë të tjera.

360.10 A2 Profesionisti kontabël pritet që të përdorë njohuritë, ekspertizën, si dhe gjykimin profesional. Megjithatë, profesionisti kontabël nuk pritet të ketë një nivel të njohjes dhe të kuptimit të ligjeve dhe rregulloreve përtej asaj që kërkohet për të ndërmarrë angazhimin. Fakti nëse një akt përbën papajtueshmëri është, në fund të fundit, një çështje për t'u vendosura një gjykatë ose një organi tjetër i përshtatshëm vendimarrës.

360.10 A3 Në varësi të natyrës dhe rëndësisë së çështjes, profesionisti kontabël mund të konsultohet, duke ruajtur konfidencialitetin, me individë të tjerë brenda firmës, firmës së rrjetit apo organizmit profesional, ose me një këshilltar ligjor.

K360.11 Nëse profesionisti kontabël identifikon ose dyshon se ka ndodhur ose mund të ndodhë një papajtueshmëri, ai duhet të diskutojë çështjen me nivelin e përshtatshëm të drejtimit, dhe kur është e përshtatshme, me personat e ngarkuar me qeverisjen.

360.11 A1 Qëllimi i diskutimit është për të qartësuar profesionistin kontabël mbi faktet dhe rrethanat e rëndësishme të çështjes si dhe pasojat e mundshme. Diskutimi mundet gjithashtu, të nxisë drejtimin ose personat e ngarkuar me qeverisjen, të investojnë për çështjen.

360.11 A2 Përcaktimi i nivelit të duhur të drejtimit, me të cilin duhet të diskutohen çështjet, kërkon përdorimin e gjykimit profesional. Faktorët e përshtatshëm që duhet të merren parasysh përfshijnë:

- Natyrën dhe rrethanat e çështjes.
- Individët e përfshirë ose potencialisht të përfshirë.
- Mundësinë e një marrëveshjeje të fshehtë.
- Pasojat e mundshme të çështjes.
- Faktin nëse nivel i drejtimit është i aftë të investigojë për çështjen dhe për të marrë masat e nevojshme

360.11 A3 Niveli i përshtatshëm i drejtimit është zakonisht, të paktën një nivel mbi individin ose individët e përfshirë ose potencialisht të përfshirë në çështjen. Në kontekstin e një grupi, niveli i përshtatshëm mund të jetë drejtimi në një entitet që kontrollon klientin.

360.11 A4 Profesionisti kontabël mundet gjithashtu, të konsiderojë diskutimin e çështjes me audituesit e brendshëm, nëse kjo është e mundur.

K360.12 Nëse profesionisti kontabël beson se drejtimi është i përfshirë në papajtueshmëri ose papajtueshmëri të dyshuar, ai duhet të diskutojë çështjen me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Adresimi i çështjes

K360.13 Kur diskuton me drejtimin dhe, kur është e përshtatshme, me personat e ngarkuar me qeverisjen, në lidhje me papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar, profesionisti kontabël do t'i këshillojë ata të ndërmarrin veprime të përshtatshme dhe në kohën e duhur, nëse nuk i kanë bërë, për:

- (a) Të korrigjuar, riparuar ose zbutur pasojat e papajtueshmërisë;
- (b) Të ndaluar kryerjen e papajtueshmërisë, nëse ajo nuk ka ndodhur akoma; ose
- (c) Të komunikuar çështjen me një autoritet i duhur kur kjo kërkohet

me ligj ose rregullore apo kur konsiderohet e nevojshme për interesin publik.

K360.14 Profesionisti kontabël do të marrë në konsideratë faktin nëse drejtimi dhe personate ngarkuar me qeverisjen, i kuptojnë përgjegjësitë e tyre ligjore dhe rregullatore lidhur me papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar.

360.14 A1 Nëse drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen nuk kuptojnë përgjegjësitë e tyre ligjore dhe rregullatore lidhur me çështjen, profesionisti kontabël mund të sugjerojë burime të përshtatshme informacioni ose të rekomandojë që ata të marrin këshillim ligjor.

K360.15 Profesionisti kontabël do të veprojë në pajtueshmëri me:

- (a) Ligjet dhe rregulloret përkatëse, përfshirë dispozitat ligjore ose rregullatore të zbatueshme që rregullojnë raportimin e papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar tek një autoritet kompetent; dhe
- (b) Kërkesat e standardeve të auditimit, përfshirë ato që lidhen me:
 - Identifikimin dhe reagimin ndaj papajtueshmërisë, përfshirë mashtrimin.
 - Komunikimin me personat e ngarkuar me qeverisjen.
 - Marrjen në konsideratë të ndikimeve të papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar për raportimin e auditimit

360.15 A1 Disa ligje dhe rregullore mund të përcaktojnë një periudhë brenda së cilës raportet për papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar duhet t'i jepen një autoriteti kompetent.

Komunikimet në lidhje me Grupet

K360.16 Kur një profesionist kontabël bëhet i vetëdijshëm për një papajtueshmëri ose papajtueshmëri të dyshuar në lidhje me një entitet të kontrolluar të një grupi, në cilëndo nga dy situatat e mëposhtme, profesionisti do t'i komunikojë çështjen partnerit të grupit të angazhimit, përveç nëse kjo ndalohet me ligj ose rregullore:

- (a) Profesionisti kontabël kryen punën audituese në lidhje me një komponent për qëllime të auditimit të grupit; ose
- (b) Profesionisti kontabël është angazhuar për të kryer një auditim të pasqyrave financiare të një personi juridik ose njësie biznesi që është pjesë e një grupi për qëllime të ndryshme nga auditimi i grupit, për shembull një auditim ligjor.

Komunikimi me partnerin e grupit të angazhimit do të bëhet, përveç përgjigjes ndaj çështjes, në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

360.16 A1 Qëllimi i komunikimit është t'i japë mundësi partnerit të angazhimit të i grupit, të informohet për çështjen dhe të përcaktojë, në kontekstin e auditimit të grupit, nëse duhet adresuar, dhe nëse po, si ta adresojë atë në përputhje me dispozitat në këtë seksion. Kërkesa për komunikim në paragrafin K360.16 zbatohet pavarësisht nëse firma ose rrjeti i partnerit të angazhimit të grupit janë të njëjtë ose të ndryshëm nga firma ose rrjeti i profesionistit kontabël.

K360.17 Kur partneri i angazhimit të grupit bëhet i vetëdijshëm për një papajtueshmëri ose papajtueshmëri të dyshuar gjatë auditimit të pasqyrave financiare të një grupi, partneri i angazhimit të grupit do të vlerësojë nëse çështja mund të ishte e përshtatshme për:

- (a) Një ose më shumë komponentë që i nënshtrohen punës audituese për qëllime të auditimit të grupit; ose
- (b) Një ose më shumë personave juridike ose njërive të biznesit që janë pjesë e grupit dhe pasqyrat financiare të të cilëve janë subjekt i qëllimeve të auditimit të ndryshëm nga auditimi i grupit, për shembull një auditim ligjor.

Ky vlerësim do të bëhet, pavarësisht reagimit përgjigjes ndaj çështjes në kontekstin e auditimit të grupit në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

K360.18 Nëse papajtueshmëria ose papajtueshmëria e dyshuar mund të jetë e përshtatshme për një ose më shumë nga komponentët (entitetet e kontrolluara) e specifikuar në paragrafin K360.17 (a) dhe (b), partneri i angazhimit të grupit do të ndërmarrë hapa për t'u komunikuar çështjen atyre që kryejnë punën tek këto entitete të kontrolluara, përveç nëse kjo ndalohet me ligj ose rregullore. Nëse është e nevojshme, partneri i angazhimit të grupit do të kërkojë informacionet e përshtatshme (qoftë nga drejtimi, qoftë dokumentet e vëna në dispozicion të publikut), mbi faktin nëse entiteti i kontrolluar përkatës i specifikuar në paragrafin K360.17(b) është subjekt i auditimit, dhe nëse po, të përcaktohet, në masën e mundur, identiteti i audituesit.

360.18 A1 Qëllimi i komunikimit është t'u mundësojë personave përgjegjës për punën tek entitetet e kontrolluara përkatëse, që të informohen mbi çështjen dhe të përcaktojnë nëse do ta adresojnë, dhe nëse po, se si ta adresojnë në pajtueshmëri me dispozitat e këtij seksioni. Kërkesa për komunikim zbatohet pavarësisht faktit nëse firma ose rrjeti i partnerit të angazhimit të grupit është i njëjti ose i ndryshëm nga firmat ose rrjetet e

personave që kryejnë punën audituese tek entitetet e kontrolluara, personat juridike ose njësitë e biznesit.

Përcaktimi nëse nevojitet veprim i mëtejshëm

K360.19 Profesionisti kontabël do të vlerësojë përshtatshmërinë e përgjigjes së drejtimit dhe, nëse është e mundur, edhe të personave të ngarkuar me qeverisjen.

360.19 A1 Faktorët përkatës që duhet të mbahen parasysh kur vlerësohet përshtatshmëria e reagimit të drejtimit dhe, nëse është e mundur, edhe të personave të ngarkuar me qeverisjen, përfshijnë faktin nëse:

- Reagimi është bërë në kohë.
- Papajtueshmëria ose papajtueshmëria e dyshuar është hetuar siç duhet.
- Janë ndërmarrë ose po ndërmerren veprime për të korrigjuar, riparuar ose zbutur pasojat e ndonjë papajtueshmërie.
- Janë marrë ose janë duke u marrë veprime për të ndaluar kryerjen e ndonjë papajtueshmërie kur kjo nuk ka ndodhur akoma.
- Janë marrë ose janë duke u marrë hapa për të zvogëluar rrezikun e ri përsëritjes, për shembull, kontrole ose trajnime shtesë.
- Papajtueshmëria ose papajtueshmëria e dyshuar i është paraqitur një autoriteti të duhur kur kjo është e përshtatshme dhe, nëse po, faktin nëse paraqitja e bërë duket e përshtatshme.

K360.20 Në varësi të reagimit të drejtimit, dhe nëse është e mundur, të personave të ngarkuar me qeverisjen, profesionisti kontabël do të përcaktojë nëse ka nevojë për veprime të mëtejshme në interes të publikut.

360.20 A1 Përcaktimi nëse nevojitet veprim i mëtejshëm, dhe natyra e shtrirja e tij, do të varen nga disa faktorë, përfshirë:

- Kuadrin ligjor dhe rregullator.
- Urgjencën e çështjes.
- Përhapjen e çështjes në të gjithë klientin.
- Faktin nëse profesionisti kontabël vijon të ketë besim në integritetin e drejtimit, dhe kur është e mundur, të personave të ngarkuar me qeverisjen.
- Faktin nëse papajtueshmëria ose papajtueshmëria e dyshuar ka gjasa të përsëritet.
- Faktin nëse ka evidencë të besueshme për dëme të konsiderueshme aktuale ose të mundshme ndaj interesave të entitetit, investitorëve, kreditorëve, punonjësve ose publikut në përgjithësi.

360.20 A2 Shembuj të rrethanave që mund ta bëjnë profesionistin kontabël të mos ketë më besim në integritetin e drejtimit dhe kur është e mundur, të personave të ngarkuar me qeverisjen, përfshijnë situatat kur:

- Profesionisti kontabël dyshon ose ka evidencë të përfshirjes së tyre ose, të dyshimit për përfshirje në ndonjë papajtueshmëri.
- Profesionisti kontabël është i vetëdijshëm se ata kanë njohuri për një papajtueshmëri të tillë dhe, në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe rregullatore, nuk kanë raportuar, ose nuk kanë autorizuar raportimin e çështjes tek një autoritet i duhur brendanë periudhe të arsyeshme

K360.21 Kur përcakton nevojën, natyrën dhe shtrirjen e veprimit të mëtejshëm, profesionisti kontabël do të ushtrojë gjykimin profesional. Në këtë përcaktim, profesionisti kontabël do të marrë në konsideratë faktin nëse një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar do të arrinte në përfundimin se profesionisti kontabël ka vepruar në përputhje me interesin publik.

360.21 A1 Veprimi i mëtejshëm, që profesionistit kontabël mund të ndërmarre përfshin:

- Paraqitjen e çështjes tek një autoritet i duhur edhe kur nuk ka kërkesa ligjore apo rregullatore për ta bërë një gjë të tillë.
- Tërheqjen nga angazhimi dhe marrëdhënia profesionale kur kjo lejohet nga ligji ose rregulloret.

360.21 A2 Tërheqja nga angazhimi dhe marrëdhënia profesionale nuk mund të zëvendësojë marrjen e veprimeve të tjera që mund të jenë të nevojshme për arritjen e objektivave të profesionistit kontabël sipas këtij seksioni. Gjithsesi, në disa juridiksione, mund të ketë kufizime sa i takon veprimeve të mëtejshme që mund të bëjë profesionisti kontabël. Në të tilla rrethana, tërheqja mund të jetë e vetmja mënyrë veprimi në dispozicion.

K360.22 Kur profesionisti kontabël është tërhequr nga marrëdhënia profesionale, në përputhje me paragrafët K360.20 dhe 360.21 A1, profesionisti kontabël me kërkesë të profesionistit të propozuar, në përputhje me paragrafin K320.8, do të sigurojë të gjitha faktet përkatëse dhe informacionet e tjera në lidhje me pajtueshmërinë e identifikuar ose të dyshuar për profesionistin e propozuar. Profesionisti kontabël paraardhës do ta bëjë këtë, edhe në rrethanat e trajtuara në paragrafin K320.8 (b) kur klienti nuk mundet ose refuzon t'i japë leje profesionistit paraardhës për të diskutuar çështjet e klientit me profesionistin e propozuar, përveç nëse kjo ndalohej me ligj ose rregullore.

360.22 A1 Faktet dhe informacionet e tjera që duhet të sigurohen janë ato, për të cilat sipas opinionit të audituesit paraardhës, profesionisti kontabël i propozuar duhet të jetë në dijeni përpara se të marrë vendimin nëse do të pranojë angazhimin e auditimit. Seksioni 320 adreson komunikimet nga profesionistët kontabël të propozuar

K360.23 Nëse profesionisti kontabël i propozuar nuk mund të komunikojë me profesionistin paraardhës, ai do të ndërmarrë hapat e arsyeshëm për të siguruar informacion mbi rrethanat e ndryshimit të emërimit, përmes mënyrave të tjera.

360.23 A1 Mënyra të tjera për të siguruar informacion lidhur me rrethanat e ndryshimit të emërimit përfshijnë kërkimin e informacioneve nga palët e treta ose investigimet e drejtimit apo të personave të ngarkuar me qeverisjen.

360.24 A1 Për vlerësimin e çështjes mund të përfshihen analiza komplekse dhe gjykime, ku profesionisti kontabël mund të marrin në konsideratë:

- Këshillimin e brendshëm
- Këshillimin me një avokat ligjor për të kuptuar opsionet e profesionistit kontabël dhe pasojat profesionale ose ligjore të ndërmarrjes së ndonjë veprimi të veçantë.
- Këshillimin, në kushtet e konfidencialitetit, me një organ rregullator ose profesional.

Përcaktimi nëse çështja duhet të paraqitet tek një autoritet i duhur

360.25 A1 Paraqitja e çështjes tek një autoritet i duhur do të përjashtojë, nëse kjo paraqitje do të ishte në kundërshtim me ligjet dhe rregullat. Përndryshe, qëllimi i dhënies së informacioneve për çështjen është të mundësojë që një autoritet i duhur, të nisë investigimin e çështjes dhe të ndërmarrë veprime në interes të publikut

360.25 A2 Përcaktimi nëse duhet bërë një paraqitje e tillë varet veçanërisht nga natyra dhe shtrirja e dëmit aktual ose të mundshëm që është shkaktuar ose mund të shkaktohet nga kjo çështje, ndaj investitorëve, kreditorëve, punonjësve dhe publikut në përgjithësi. Për shembull, profesionisti kontabël mund të arrijë në përfundimin se paraqitja e çështjes tek një autoritet i duhur është një veprimi i duhur nëse:

- Entiteti është i angazhuar në ryshfet (për shembull, zyrtarë të qeverisë lokale ose të huaj për qëllime të sigurimit të kontratave të majme).
- Entiteti është i rregulluar me ligj dhe çështja është e një rëndësie të

tillë, sa të kërcënojnë licencën e tij për të operuar.

- Entiteti është i listuar në bursën e letrave me vlerë dhe çështja mund të rezultojë në pasoja të pafavorshme për tregun e drejtë dhe të rregulluar të letrave me vlerë të entitetit ose të përbëjë një rrezik sistematik për tregjet financiare.
- Ka të ngjarë që entiteti të shesë produkte, të cilat janë të dëmshme për shëndetin ose sigurinë e publikut.
- Entiteti është duke promovuar tek klientët e tij një skemë për t'i asistuar ata në shmangien e taksave.

360.25 A3 Përcaktimi nëse duhet bërë një paraqitje e tillë do të varet gjithashtu, nga faktorë të jashtëm, të tillë si:

- Fakti nëse ka një autoritet të duhur që të jetë në gjfandje të marrë informacion, dhe të bëjë që çështja të investigohet dhe të ndërmerren veprime. Autoriteti i duhur do të varet nga natyra e çështjes, për shembull një rregullator i letrave me vlerë në rastin e një raportimi financiar mashtrues ose një agent i mbrojtjes së mjedisit, në rastin e një shkeljeje të ligjeve dhe rregullave mjedisore.
- Fakti nëse ekziston mbrojtje e fuqishme dhe e besueshme nga përgjegjësia civile, kriminale ose profesionale, apo hakmarrja, e parashikuar nga legjislacioni dhe rregulloret, siç janë legjislacioni ose rregulloret për mbrojtjen e personave që ngrënë zërin (whistle-blowing).
- Nëse ka kërcënime aktuale ose potenciale ndaj sigurisë fizike të profesionistit kontabël ose individëve të tjerë.

K360.26 Nëse profesionisti kontabël përcakton se paraqitja e papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar tek një autoritet i duhur është një veprim i duhur për rrethanat, dhënia e këtij informacioni lejohet sipas paragrafit K114.1(d) të Kodit. Kur bëhet një paraqitje e tillë, profesionisti kontabël do të veprojë në mirëbesim dhe do të ushtrojë kujdes për deklaratat dhe pohimet që bën. Profesionisti kontabël do të konsiderojë gjithashtu nëse është i përshtatshëm informimi i klientit mbi qëllimet e profesionistit kontabël, përpara paraqitjes së çështjes.

Shkelje e afërt

K360.27 Në rrethana përjashtimore, profesionisti kontabël mund të vihet në dijeni për sjellje aktuale ose të synuar, që profesionisti kontabël ka arsye të besojë se do të përbëjë një shkelje të pritshme të një ligji apo rregulli, e cila do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm për investitorët, kreditorët, punonjësit ose publikun në përgjithësi. Pasi të ketë shqyrtuar së pari, nëse do të ishte e përshtatshme që çështja të diskutohet me drejtimin ose

personat e ngarkuar me qeverisjen e entitetit, profesionisti kontabël do të ushtrojë gjykimin profesional për të përcaktuar nëse duhet ta paraqesë menjëherë çështjen tek një autoritet i duhur, për të parandaluar ose zbutur pasojat e një shkeljetë tillë të pritshme. Një paraqitje e tillë është e lejuar nga paragrafi K114.1(d) i Kodit.

Dokumentimi

K360.28 Në lidhje me një veprim të papajtueshmërisë ose të papajtueshmërisë së dyshuar që është brenda objektit të këtij seksioni, profesionisti kontabël do të dokumentojë:

- Mënyrën sesi drejtimi, dhe nëse është e mundur, personat e ngarkuar me qeverisjen, i janë përgjigjur çështjes.
- Drejtimet e veprimit që profesionisti kontabël ka marrë në konsideratë, gjykimet e bëra dhe vendimet e marra, duke mbajtur parasysh testin e palës së tretë të arsyeshme dhe të informuar.
- Mënyrën sesi profesionisti kontabël krijon bindjen se ai ka përmbushur përgjegjësinë e përcaktuar në paragrafin K360.20.

360.28 A1 Ky dokumentim bëhet përveç plotësimit të kërkesave të dokumentimit, sipas standardeve të zbatueshme të auditimit. Për shembull, SNA-të kërkojnë që një profesionist kontabël që kryen një auditim të pasqyrave financiare:

- Të përgatisë dokumentimin e mjaftueshëm për të mundësuar një kuptim të çështjeve të rëndësishme që lindin gjatë auditimit, përfundimeve të arritura dhe gjykimeve profesionale të rëndësishme që çuan në arritjen e këtyre përfundimeve;
- Të dokumentojë diskutimet e çështjeve të rëndësishme me drejtimin, personat e ngarkuar me qeverisjen, dhe të tjerë, përfshirë natyrën e çështjeve të rëndësishme të diskutuara, si dhe kur dhe me kë u zhvilluan këto diskutime; dhe
- Të dokumentojë papajtueshmëritë e identifikuara ose të dyshuara, si dhe rezultatet e diskutimit me drejtimin, dhe kur është e mundur, me personat e ngarkuar me qeverisjen dhe palët e tjera jashtë entitetit.

Shërbimet profesionale të ndryshme nga auditimet e pasqyrave financiare

Sigurimi i kuptimit të çështjes dhe adresimi i saj tek drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen

K360.29 Nëse një profesionist kontabël i angazhuar për të kryer një shërbim profesional të ndryshëm nga auditimi i pasqyrave financiare vihet në dijeni të informacionit në lidhje me papajtueshmërinë ose

papajtueshmërinë e dyshuar, ai do të kërkojë të sigurojë një kuptim të çështjes. Kjo kuptueshmëri do të përfshijë natyrën e papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar dhe rrethanat në të cilat ajo ka ndodhur ose mund të ndodhë.

360.29 A1 Nga profesionisti kontabël pritet që të zbatojë njohuritë, gjykimin profesional dhe ekspertizën. Megjithatë, nga profesionisti kontabël nuk pritet të ketë një nivel të njohurive të ligjeve dhe rregulloreve përtej asaj që kërkohet për kryerjen e shërbimit profesional për të cilin ai është angazhuar. Fakti nëse një akt përbën papajtueshmëri, në fund të fundit, është një çështje që do ta zgjidhë gjykata ose një organ tjetër i përshtatshëm vendimmarrës.

360.29 A2 Në varësi të natyrës dhe rëndësisë së çështjes, profesionisti kontabël mund të konsultohet, duke ruajtur konfidencialitetin, me të tjerët brenda firmës, rrjetit të firmës ose me një organizëm profesional, apo edhe me një këshilltar ligjor.

K360.30 Nëse profesionisti kontabël identifikon ose dyshon që papajtueshmëria ka ndodhur ose mund të ndodhë, ai do të diskutojë çështjen me nivelin e përshtatshëm të drejtimit. Nëse profesionisti kontabël ka akses me personat e ngarkuar me qeverisjen, ai do të diskutojë gjithashtu këto çështje me ta, kur kjo është e mundur.

360.30 A1 Qëllimi i diskutimit është për të qartësuar profesionistin kontabël mbi faktet dhe rrethanat e rëndësishme të çështjes si dhe pasojat e mundshme. Diskutimi mundet gjithashtu, të nxisë drejtimin ose personat e ngarkuar me qeverisjen të hetojnë çështjen.

360.30.A2 Niveli i duhur i drejtimit me të cilin duhet të diskutohet është çështje e gjyimit profesional. Faktorët e përshtatshëm që duhet të merren parasysh përfshijnë:

- Natyrën dhe rrethanat e çështjes.
- Individët e përfshirë ose potencialisht të përfshirë.
- Mundësinë e një marrëveshjeje të fshehtë.
- Pasojat e mundshme të çështjes.
- Faktin nëse nivel i drejtimit është i aftë të investigojë mbi çështjen dhe të marrë masat e nevojshme.

Komunikimi i çështjes me audituesin e jashtëm të entitetit

K360.31 Nëse profesionisti kontabël kryen një shërbim jo auditimi për:

- (a) Një klient auditimi të firmës; ose

- (b) Një entitet të kontrolluar të një klienti të auditimit të firmës, profesionisti kontabël do të komunikojë papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar me firmën, përveç nëse kjo ndalohet nga ligji ose rregulloret. Komunikimi do të bëhet në përputhje me protokollet dhe procedurat e firmës. Në mungesë të këtyre protokolleve, do të komunikohet drejtpërdrejt me partnerin e angazhimit të auditimit.

K360.32 Nëse profesionisti kontabël kryen një shërbim jo auditimi për:

- (a) Një klient auditimi të një firme të rrjetit; ose
(b) Një entitet të kontrolluar të një klienti auditimi të firmës së rrjetit,

profesionisti kontabël do të konsiderojë nëse do të komunikojë papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar me firmën e rrjetit. Komunikimi do të bëhet në përputhje me protokollet dhe procedurat e rrjetit. Në mungesë të protokolleve dhe procedurave të tilla, komunikimi do të bëhet drejtpërdrejt me partnerin e angazhimit të auditimit.

K360.33 Nëse profesionisti kontabël kryen një shërbim jo auditimi për një klient që nuk është:

- (a) Një klient auditimi i firmës ose i një firme të rrjetit; apo
(b) Një entitet i kontrolluar të një klienti auditimi të firmës ose të një firme të rrjetit,

profesionisti kontabël do të vlerësojë nëse do të komunikojë papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar firmës që është auditues i jashtëm i klientit, nëse ka të tillë.

Faktorë të përshtatshëm për t'u marrë në konsideratë

360.34 A1 Faktorët e përshtatshëm për t'u marrë në konsideratë për sa i përket komunikimit, në përputhje me paragrafët K360.31 – K360.33 përfshijnë:

- Faktin nëse ky komunikim do të ishte në kundërshtim me ligjin ose rregulloret.
- Faktin nëse ka kufizime mbi paraqitjen e imponuar nga një agjenci rregullatore ose prokuror në një investigim në vazhdim mbi papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar.
- Faktin nëse qëllimi i angazhimit është investigimi i papajtueshmërisë së dyshuar brenda entitetit për t'i mundësuar atij të ndërmarrë veprimet e duhura.
- Faktin nëse drejtimi ose personat e ngarkuar me qeverisjen kanë

informuar tashmë audituesin e jashtëm të entitetit mbi çështjen.

- Materialitetin e mundshëm të çështjes për auditimin e pasqyrave financiare të klientit ose, kur çështja lidhet me një entitet të kontrolluar të një grupi, materialitetin e tij të mundshëm për auditimin e pasqyrave financiare të grupit.

Qëllimi i komunikimit

360.35 A1 Në rrethanat e adresuara në paragrafët K360.31 – K360.33, qëllimi i komunikimit është të mundësojë informimin e partnerit të angazhimit të auditimit mbi papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar, dhe të përcaktojë nëse do adresojë, dhe nëse po, se si ta adresojë atë në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

Vlerësimi nëse nevojitet veprim i mëtejshëm

K360.36 Profesionisti kontabël do të vlerësojë nëse nevojitet veprim i mëtejshëm në interes të publikut.

360.36 A1 Fakti nëse nevojitet veprim i mëtejshëm, si dhe natyra dhe shtrirja e tij, varet nga faktorët e mëposhtëm:

- Kuadri ligjor dhe rregullator.
- Përshtatshmëria dhe koha e reagimit të drejtimit dhe, kur është e mundur, e personave të ngarkuar me qeverisjen.
- Urgjenca e situatës.
- Përfshirja e drejtimit ose personave të ngarkuar me qeverisjen në këtë çështje.
- Mundësia e dëmtimit të konsiderueshëm të interesave të klientit, investitorëve, kreditorëve, punonjësve ose publikut të gjerë.

360.36 A2 Veprime të mëtejshme të profesionistit kontabël mund të përfshijnë:

- Paraqitja e çështjes tek një autoritet i duhur, edhe nëse kjo nuk kërkohet nga ligji ose rregulloret.
- Tërheqja nga angazhimi dhe marrëdhënia profesionale, nëse kjo lejohet nga ligji ose rregulloret.

360.36 A3 Kur konsiderohet nëse çështja do t'i paraqitet një autoriteti të duhur, faktorët e rëndësishëm që duhen marrë parasysh përfshijnë:

- Faktin nëse kjo do të ishte në kundërshtim me ligjin ose rregulloret.
- Faktin nëse ka kufizime të imponuara në lidhje me paraqitjen e çështjes nga një agjenci rregullatore ose prokuror në një investigim në vazhdim e sipër mbi papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar.

- Faktin nëse qëllimi i angazhimit është investigimi i papajtueshmërisë së dyshuar brenda entitetit për të mundësuar marrjen e veprimt të duhur.

K360.37 Nëse profesionisti kontabël përcakton se paraqitja e papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar tek një autoritet i duhur është veprimi i duhur për rrethanat, kjo paraqitje është e lejueshme në përputhje me paragrafin K114.1 (d) të Kodit. Kur bën një paraqitje të tillë, profesionisti kontabël do të veprojë me mirëbesim dhe do të tregojë kujdes kur të bëjë deklaratat dhe pohimet. Profesionisti kontabël do të konsiderojë gjithashtu, nëse është i nevojshëm informimi i klientit mbi qëllimet e profesionistit kontabël, përpara se të paraqitet çështja.

Shkelje e afërt

K360.38 Në rrethana përjashtimore, profesionisti kontabël mund të bëhet i vetëdijshëm për sjellje aktuale ose të synuar që profesionisti ka arsye të besojë se do të përbënte një shkelje të pritshme të një ligji ose rregulli, e cila do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm për investitorët, kreditorët, punonjësit ose publikun e gjerë. Pasi të ketë shqyrtuar së pari nëse do të ishte e përshtatshme të diskutohej me drejtimin ose personat e ngarkuar me qeverisjen e entitetit, profesionisti kontabël do të ushtrojë gjykimin profesional për të përcaktuar nëse dotë ishte e përshtatshme që çështja t'i paraqitej menjëherë një autoriteti të duhur për të parandaluar ose zbutur pasojat e kësaj shkeljeje. Nëse paraqitja e çështjes është bërë, kjo është e lejueshme në përputhje me paragrafin K114.1 (d) të Kodit.

Kërkimi i këshillave

360.39 A1 Profesionisti kontabël mund të marrë në konsideratë:

- Këshillimin e brendshëm.
- Sigurimin e këshillimit ligjor për të kuptuar ndikimet profesionale dhe ligjore të ndërmarrjes së një drejtimi të veçantë veprimi.
- Këshillimin mbi bazën e konfidencialitetit me një organ profesional ose rregullator.

Dokumentimi

360.40 A1 Për sa i përket papajtueshmërisë ose papajtueshmërisë së dyshuar, që është brenda objektit të këtij seksioni, profesionisti kontabël inkurajohet të dokumentojë:

- Çështjen.
- Përfundimet e diskutimeve me drejtimin, dhe kur është e mundur, me personat e ngarkuar me qeverisjen dhe palët e tjera.

- Mënyrën se si drejtimi, dhe kur është e mundur, personat e ngarkuar me qeverisjen i janë përgjigjur çështjes.
- Drejtimet e veprimeve të marra në konsideratë nga profesionisti kontabël dhe vendimet e marra.
- Mënyrën sesi profesionisti kontabël ka krijuar bindjen se ai ka përmbushur përgjegjësinë e përcaktuar në paragrafin K360.36.

STANDARDET NDERKOMBETARE TË PAVARESISE
(PJESET 4A DHE 4 B)
PJESA 4A – PAVARESIA PE AUDITIMET DHE ANGAZHIMET E
RISHIKIMIT

	Faqe
Seksioni 400	141
Zbatimi i Kuadrit Konceptual për Pavarësinë për Auditimet dhe angazhimet e rishikimit	
Seksioni 405	160
Auditimet e Grupit	
Seksioni 410	171
Honoraret	
Seksioni 411	187
Kompensimi dhe Politikat e Vlerësimit	
Seksioni 420	189
Dhuratat dhe Mikpritja	
Seksioni 430	190
Paditë Gjyqësore Aktuale ose të Kërcënuara	
Seksioni 510	192
Interesat Financiare	
Seksioni 511	198
Huatë dhe Garancitë	
Seksioni 520	200
Marrëdhëniet e Biznesit	
Seksioni 521	202
Marrëdhëniet Familjare dhe Personale	
Seksioni 522	206
Shërbimet e Kohëve të Fundit me një Klient të Auditimit	
Seksioni 523	208
Shërbimi në Rolin e Drejtorit apo Nëpunësit tek një Klient i Auditimit	
Seksioni 524	210
Punësimi tek një Klient i Auditimit	
Seksioni 525	214
Caktimet e Përkohshme të Personelit	
Seksioni 540	216
Lidhja e Gjatë e Personelit (Përfshirë Rotacionin e Ortakut) me një Klient të Auditimit	
Seksioni 600	223
Dhënia e Shërbimeve të Jo sigurisë për një Klient të Auditimit	
N/Seksioni 601	234
Shërbimet Kontabël dhe të Mbajtjes së Kontabilitetit	
N/Seksioni 602	237
Shërbimet Administrative	
N/Seksioni 603	238
Shërbimet e Vlerësimit	
N/Seksioni 604	240
Shërbimet Tatimore	
N/Seksioni 605	250
Shërbimet e Auditimit të Brendshëm	
N/Seksioni 606	254
Shërbimet e Sistemeve të Teknologjisë	
N/Seksioni 607	256
Shërbimet e Mbështetjes Gjyqësore	
N/Seksioni 608	260
Shërbimet Ligjore	
N/Seksioni 609	263
Shërbimet e Rekrutimit	

N/Seksioni 610	Shërbimet Financiare të Korporatës	265
Seksioni 800	Raportet mbi Pasqyrat Financiare për Qëllime të Veçanta që Përfshijnë një Kufizim në Përdorim dhe në Shpërndarje (Angazhimet e Auditimit dhe Rishikimit)	268

PJESA 4A – PAVARËSIA PËR ANGAZHIMET E AUDITIMIT DHE TË RISHIKIMIT

SEKSIONI 400

ZBATIMI I KUADRIT KONCEPTUAL PËR PAVARËSINË PËR ANGAZHIMET E AUDITIMIT DHE RISHIKIMIT

Hyrje

Të përgjithshme

- 400.1 Është në interesin e publikut dhe kërkohet nga Kodi që profesionistët kontabël në praktikën publike të jenë të pavarur kur kryejnë angazhime të auditimit ose të rishikimit.
- 400.2 Kjo pjesë zbatohet si për angazhimet e auditimit ashtu edhe për ato të rishikimit përveç nëse shprehet ndryshe. Termat “auditim”, “ekip auditimi”, “angazhim auditimi”, “klient auditimi” dhe “raport auditimi” përdoren njëjloj edhe për rishikimin, ekip i rishikimit, angazhim i rishikimit, klient i rishikimit e raport i angazhimit të rishikimit
- 400.3 Në këtë Pjesë, termi “profesionist kontabël” i referohet profesionistëve kontabël individualë në praktikën publike dhe firmave të tyre.
- 400.4 SNMC 1 kërkon që një firmë të hartojë dhe të zbatojë një sistem të menaxhimit të cilësisë për auditimet ose rishikimet e pasqyrave financiare të kryera nga firma. Si pjesë e këtij sistemi të menaxhimit të cilësisë, SNMC 1 kërkon nga firma të vendosë objektiva për cilësinë që trajtojnë përmbushjen e përgjegjësiave në përputhje me kërkesat etike përkatëse, përfshirë ato që lidhen me pavarësinë. Sipas SNMC 1, kërkesat etike përkatëse janë ato që lidhen me firmën, personelin e saj dhe, sipas rastit, të tjerët që i nënshtrohen kërkesave për pavarësinë që ju nënshtrohen angazhimet e firmës dhe firma. SNA-të dhe SNAR-të përcaktojnë përgjegjësitë për partnerët e angazhimit dhe grupet e angazhimit respektivisht, në nivelin e angazhimeve të auditimit dhe të rishikimit. Shpërndarja e përgjegjësiave brenda një firme do të varet nga madhësia, struktura dhe organizimi i saj. Një pjesë e madhe e dispozitave të kësaj Pjesë nuk përshkruajnë përgjegjësinë specifike të individëve të një firme për veprimet e lidhura me pavarësinë, por në vend të kësaj i referohen “firmës” për lehtësi reference. Një firmë i ngarkon përgjegjësinë operacionale për respektimin e kërkesave për pavarësinë një individi në përputhje me SNMC1. Përveç kësaj, një profesionist kontabël individ mbetet përgjegjës për pajtueshmërinë me të gjitha dispozitat që zbatohen

për aktivitetet, interesat dhe marrëdhëniet e atij profesionisti kontabël.

400.5 Pavarësia lidhet me parimet e objektivitetit dhe integritetit. Ajo përfshin:

- (a) Pavarësinë e Mendimit – gjendja e të menduarit, që lejon shprehjen e një konkluzioni pa u ndikuar nga influencat që kompromentojnë gjykimin profesional, me anën e të cilës bëhet e mundur që një individ të veprojë me integritet dhe të ushtrojë objektivitetin dhe skepticizmin profesional.
- (b) Pavarësinë në Dukje (Aparencë) – mënjanimi i fakteve dhe rrethanave që janë kaq të rëndësishme, sa që një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar, e cila peshon të gjitha faktet dhe rrethanat specifike, do të mund të arrinte në përfundimin se është kompromentuar integriteti, objektiviteti ose skepticizmi profesional i një firme apo të një anëtarit të grupit të auditimit.

Në këtë Pjesë, kur një individ ose firmë u referohet si “të pavarur”, kjodo thotë se individit ose firma është në pajtim me dispozitat e kësaj Pjese.

400.6 Gjatë kryerjes së angazhimeve të auditimit, Kodi kërkon që firmat të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore dhe të jenë e pavarura. Kjo Pjesë përfshin kërkesat specifike dhe materialin shpjegues për zbatimin e kuadrit konceptual dhe ruajtjen e pavarësisë gjatë kryerjes së këtyre angazhimeve. Kuadri konceptual në Seksionin 120 zbatohet për pavarësinë, e cila lidhet me parimet themelore të dhëna në Seksionin 110. Seksioni 405 përshkruan kërkesat specifike dhe materialin e aplikimit të zbatueshëm në një auditim të grupit

400.7 Kjo pjesë përshkruan:

- (a) Faktet dhe rrethanat, përfshirë aktivitetet profesionale, interesat dhe marrëdhëniet, që krijojnë ose mund të krijojnë kërcënime për pavarësinë;
- (b) Veprime të mundshme, përfshirë masat mbrojtje, që mund të jenë të përshtatshme për të adresuar këto kërcënime; dhe
- (c) Disa situata, kur kërcënimet nuk mund të eliminohen ose kur nuk ka masa mbrojtëse, për t'i zvogëluar ato në një nivel të pranueshëm.

Grupi (ekipi) i angazhimit dhe grupi i auditimit

400.8 Kjo pjesë vlen për të gjithë anëtarët e ekipit të auditimit, duke përfshirë anëtarët e ekipit të angazhimit.

400.9 Një ekip angazhimi për një angazhim auditimi përfshin të gjithë partnerët dhe stafin e firmës që kryejnë punë auditimi për angazhimin, dhe çdo individ tjetër që kryen procedura të auditimit të cilët janë nga:

- (a) Një firmë e rrjetit;
- (b) Një firmë që nuk është një firmë e rrjetit, ose një ofrues tjetër shërbimi.

Për shembull, një individ nga një firmë audituese e një entiteti të kontrolluar që kryen procedurat e auditimit mbi informacionin financiar të një komponenti për qëllime të një auditimi të grupit është anëtar i ekipit të angazhimit për auditimin e grupit.

400.10 Në SNMC 1, një ofrues shërbimi përfshin një individ ose organizatë të jashtme për firmën, të cilët ofrojnë një burim që përdoret në kryerjen e angazhimeve. Ofruesit e shërbimeve përjashtojnë firmën, një firmë rrjeti ose strukturat apo organizime të tjera në rrjet.

400.11 Një angazhim auditimi mund të përfshijë ekspertë brenda firmës, ose ekspertë të angazhuar nga firma, një firmë e rrjetit, ose një firmë audituese e një entiteti të kontrolluar, jashtë rrjetit të një firme audituese të grupit, të cilët ndihmojnë në angazhim. Në varësi të rolit të individëve, ata mund të jenë anëtarë të ekipit të angazhimit ose të ekipit të auditimit. Për shembull:

- Individët me ekspertizë në një fushë të specializuar të kontabilitetit ose auditimit, të cilët kryejnë procedurat e auditimit, janë anëtarë të ekipit të angazhimit. Këto përfshijnë, për shembull, individë me ekspertizë në trajtimin kontabël të të ardhurave të tatueshme ose në analizimin e informacionit kompleks të prodhuar nga mjetet dhe teknikat e automatizuara me qëllim identifikimin e marrëdhënieve të pazakonta ose të papritura.
- Individët brenda firmës, ose të angazhuar nga firma që kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi rezultatin e angazhimit të auditimit nëpërmjet konsultimit lidhur me çështje teknike ose specifike të sektorit, transaksionet apo ngjarjet që kanë të bëjnë me angazhimin janë anëtarë të ekipit të auditimit, por jo anëtarë të ekipit të angazhimit.

Megjithatë, individët që janë ekspertë të jashtëm nuk janë as anëtarë të ekipit të angazhimit dhe as të ekipit të kontrollit

400.12 Nëse angazhimi i auditimit i nënshtrohet një rishikimi të cilësisë së angazhimit, rishikuesi i cilësisë së angazhimit dhe çdo individ tjetër që kryen rishikimin e cilësisë së angazhimit janë anëtarë të ekipit të auditimit, por jo anëtarë të ekipit të angazhimit.

Entitetet me interes publik

400.13 Disa nga kërkesat dhe materiali për zbatim i dhënë në këtë Pjesë reflektojnë shtrirjen e interesit publik në entitete të caktuara që përkufizohen si entitete me interes publik. Firmat inkurajohen të

përcaktojnë nëse do të trajtojnë entitete të tjera, ose disa kategori të entiteteve, si entitete me interes publik, për faktin që ato kanë një numër të madh dhe të shumëllojshëm të palëve të interesuara. Faktorët që duhen marrë në konsideratë përfshijnë:

- Natyrën e biznesit, si për shembull, mbajtja e aktiveve në një kapacitet mirëbesimi për një numër të madh palësh të interesuara. Shembujt mund të përfshinin institucionet financiare, siç janë bankat, shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve.
- Madhësinë.
- Numrin e punonjësve

Raportet që përfshijnë një kufizim në përdorim dhe shpërndarje

400.14 Një raport auditimi mund të përfshijë një kufizim në përdorim dhe shpërndarje. Në këtë rast dhe nëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në Seksionin 800, kërkesat e pavarësisë në këtë Pjesë mund të modifikohen sipas kërkesave që jepen në Seksionin 800.

Angazhimet e sigurisë, të ndryshme nga angazhimet e auditimit dhe rishikimit

400.15 Standardet e pavarësisë për angazhimet e sigurisë, të ndryshme nga angazhimet e auditimit dhe rishikimit, janë dhënë në Pjesën 4B – *Pavarësia për Angazhimet e Sigurisë, të Ndryshme nga Angazhimet e Auditimit dhe Rishikimit*.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

K400.16 Një firmë që kryen një angazhim auditimi do të jetë e pavarur.

K400.17 Firma do të zbatojë kuadrin konceptual të përshkruar në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë në lidhje me një angazhim auditimi.

Ndalimi i marrjes përsipër së përgjegjësi drejtuese

K400.18 Një firmë ose një firmë rrjeti nuk do të marrë përsipër përgjegjësinë e menaxhimit për një klient auditimi.

400.18 A1 Përgjegjësitë e drejtimit përfshijnë kontrollin, udhëheqjen dhe menaxhimin e një entiteti, duke përfshirë marrjen e vendimeve në lidhje me blerjen, vendosjen dhe kontrollin e burimeve njerëzore, financiare, teknologjike, fizike dhe jo materiale.

400.18 A2 Kur një firmë ose një firmë rrjeti merr përsipër një përgjegjësi menaxhimi për një klient auditimi, krijohen kërcënime të vetë-rishikimit, interesit vetjak dhe familjaritetit. Marrja përsipër e një përgjegjësie menaxhimi mund të krijojë gjithashtu, një kërcënim ligjor, sepse firma ose firma e rrjetit bëhet shumë e lidhur me pikëpamjet dhe interesat e drejtimit.

400.18 A3 Përcaktimi nëse një aktivitet është përgjegjësi e drejtimit varet nga rrethanat dhe kërkon ushtrimin e gjykimit profesional. Shembuj të aktiviteteve që do të ishin konsideruar përgjegjësi të drejtimit përfshijnë:

- Përcaktimin e politikave dhe drejtimit strategjik.
- Punësimin ose shkarkimin i punonjësve.
- Drejtimin dhe marrjen e përgjegjësisë për veprimet e punonjësve në lidhje me punën e tyre për subjektin.
- Autorizimin i transaksioneve.
- Kontrollin ose administrimin e llogarive ose investimeve bankare.
- Përcaktimin se cilat rekomandime të firmës ose firmës së rrjetit ose palëve të tjera të treta do të zbatohen. Raportimi tek personat e ngarkuar me qeverisjen në emër të drejtimit.
- Marrjen përsipër të përgjegjësisë për:
 - Përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.
 - Projektimin, zbatimin, monitorimin ose mbajtjen e kontrollit të brendshëm

400.18 A4 Në varësi të pajtueshmërisë me paragrafin R400.14, këshillimi dhe dhënia e rekomandimeve për të ndihmuar ekipin drejtues të një klienti të auditimit në përmbushjen e përgjegjësive të tij nuk përbën marrje përsipër të përgjegjësisë së drejtimit. Këshillimi dhe dhënia e rekomandimeve për një klient auditimi mund të krijojë një kërcënim vetë-rishikimi dhe trajtohet në Seksionin 600.

K400.19 Kur kryen një aktivitet profesional për një klient auditimi, firma duhet të sigurohet që ekipi drejtues i klientit ndërmerr të gjitha gjykimet dhe vendimet që janë qartësisht përgjegjësi të tyre. Kjo përfshin që firma të sigurohet se menaxhimi i klientit:

- (a) Cakton një individ që zotëron aftësi, njohuri dhe përvojë të përshtatshme për të qenë përgjegjës në çdo kohë për vendimmarrjen e klientit dhe për të mbikëqyrur aktivitetet. Një individ i tillë, mundësisht pjesë e ekipit drejtues kryesorë, kupton:
- (i) Objektivat, natyrën dhe rezultatet e aktiviteteve; dhe
 - (ii) Përgjegjësitë respektive të klientit, firmës ose firmën së rrjetit.

- Megjithatë, individit nuk i kërkohet të zotërojë ekspertizën për të kryer ose ri-kryer aktivitetet në fjalë.
- (b) Siguron mbikëqyrjen e aktiviteteve dhe vlerëson përshtatshmërinë e rezultateve të aktiviteteve të kryera për qëllimin e klientit.
 - (c) Pranon përgjegjësinë për veprimet, nëse ka, që do të ndërmerren si rezultat i aktiviteteve.

Entitetet e lidhura

K400.20 Sipas përkufizimit, një klient auditimi që është entitet i listuar përfshin të gjitha entitetet e tij të lidhura. Për të gjitha entitetet e tjera, referimet e një klienti të auditimit në këtë Pjesë përfshijnë entitete të lidhura mbi të cilat klienti ka kontroll të drejtpërdrejtë. Kur grupi i auditimit njihet ose ka arsye të besojë se një marrëdhënie ose rrethanë që përfshin ndonjë entitet tjetër të lidhur të klientit është i përshtatshëm për vlerësimin e pavarësisë së firmës nga klienti, grupi i auditimit do të përfshijë këtë entitet të lidhur kur ai identifikon, vlerëson dhe adreson kërcënimet ndaj pavarësisë.

[Paragrafët 400.21 deri në 400.29 janë lënë qëllimisht bosh]

Periudha gjatë së cilës kërkohet pavarësia

K400.30 Pavarësia, siç kërkohet nga kjo Pjesë, do të mbahet gjatë:

- (a) Periudhës së angazhimit; dhe
- (b) Periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare.

400.30 A1 Periudha e angazhimit fillon kur grupi i auditimit nis kryerjen e auditimit. Periudha e angazhimit përfundon kur lëshohet raporti i auditimit. Kur angazhimi është i një natyre të përsëritur, periudha përfundon në kohën më të vonë të njoftimit nga secila palë se marrëdhënia profesionale ka përfunduar, ose kur lëshohet raporti përfundimtar i auditimit.

K400.31 Nëse një entitet bëhet klient auditimi gjatë ose pas periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare për të cilën firma do të shprehë një opinion, firma do të përcaktojë nëse ekziston një kërcënim ndaj pavarësisë që krijohet nga:

- (a) Marrëdhëniet financiare ose të biznesit me klientin e auditimit gjatë ose pas periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare, por përpara pranimin të angazhimit të auditimit; ose
- (b) Shërbimet e ofruara klientit të auditimit nga firma ose një firmë rrjeti në periudhat e mëparshme të pasqyrave financiare.

400.31 A1 Kërcënimet ndaj pavarësisë krijohen nëse një shërbim jo-sigurie i është

dhënë një klienti auditimi gjatë ose pas periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare, por përpara se grupi i auditimit të fillojë të kryejë auditimin dhe shërbimi nuk do të lejohej gjatë periudhës së angazhimit.

400.31 A2 Një faktor që duhet marrë në konsideratë në rrethana të tilla është nëse rezultatet e shërbimit të dhënë mund të jenë pjesë ose të ndikojnë në të informacionin kontabël, kontrollet e brendshme mbi raportimin financiar ose pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion.

400.31 A3 Shembuj të veprimeve që mund të përbëjnë masa mbrojtëse për të adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë përfshijnë:

- Mos-çaktimin si anëtarë të ekipit të angazhimit, të profesionistëve që kane kryer shërbimin e jo- sigurisë.
- Përfshirjen e një rishikuesi të përshtatshëm për të rishikuar punën e auditimit ose shërbimin e jo-sigurisë sipas rastit.
- Angazhimin e një firme tjetër jashtë rrjetit për të vlerësuar rezultatet e shërbimit të jo-sigurisë ose çaktimi i një firme tjetërjashtë rrjetit për të ri-kryer shërbimin e jo-sigurisë, në masën e nevojshme për t'i mundësuar firmës tjetër, të marrë përgjegjësinë për shërbimin.

400.31 A4 Një kërcënim ndaj pavarësisë i krijuar nga dhënia një shërbimi jo- sigurie nga një firmë ose një firmë rrjeti përpara periudhës së angazhimit të auditimit ose përpara periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion, eliminohet ose reduktohet në një nivel të pranueshëm nëse rezultatet e një shërbimi të tillë janë përdorur ose zbatuar në një periudhë të audituar nga një firmëtjetër.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

K400.32 Një firmë nuk do të pranojë emërimin si auditues i një entiteti me interes publik të cilit firma ose firma e rrjetit i ka dhënë një shërbim jo- sigurie përpara këtij emërimi, i cili mund të krijojë një kërcënim vetë-rishikimi në lidhje me pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion përveç rasteve kur:

- (a) Dhënia e këtij shërbimi ndërpritet përpara fillimit të periudhës së angazhimit të auditimit;
- (b) Firma merr masa për të kanalizuar çdo kërcënim ndaj pavarësisë së saj; dhe
- (c) Firma përcakton se, sipas pikëpamjes së një pale të tretë të arsyeshme dhe të informuar, çdo kërcënim ndaj pavarësisë së firmës është eliminuar ose do të eliminohet ose reduktohet në një nivel të pranueshëm.

400.32 A1 Veprimet, të cilat nga një palë e tretë e arsyeshme dhe informuar mund të vlerësohen se eliminojnë ose reduktojnë në një nivel të pranueshëm çdo kërcënim ndaj pavarësisë të krijuar nga dhënia e shërbimeve të jo-sigurisë për një entitet me interes publik përpara emërimit si auditues i atij entiteti, përfshijnë faktin që:

- Rezultatet e shërbimit i janë nënshtruar procedurave të auditimit gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vitit të kaluar nga një firmë paraardhëse.
- Firma angazhon një profesionist kontabël, i cili nuk është anëtar i firmës që shpreh opinion për pasqyrat financiare, për të kryer një rishikim të angazhimit të parë të auditimit të prekur nga kërcënimet i vetë-rishikimit në përputhje me objektivin e një rishikimi të cilësisë së angazhimit.
- Njësia me interes publik angazhon një firmë tjetër jashtë rrjetit të saj, për:
 - (i) Vlerësimin e rezultateve të shërbimit të jo-sigurisë; ose
 - (ii) Të ri-kryer shërbimin,

në masën e nevojshme për t'i mundësuar firmës tjetër të marrë përgjegjësi për rezultatit e shërbimit.

[Paragrafët 400.33 deri 400.39 janë lenë qëllimisht bosh]

Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen

400.40 A1 Paragrafët K300.9 dhe K300.10 japin kërkesat për sa i përket komunikimit me personat e ngarkuar me qeverisjen.

400.40 A2 Edhe kur nuk kërkohet nga Kodi, nga standardet e zbatueshme profesionale, nga ligji apo rregullat, inkurajohet të bëhet një komunikim i rregullt midis firmës dhe organeve të ngarkuara me qeverisjen e klientit të auditimit në lidhje me marrëdhëniet dhe për të tjera çështje që, sipas mendimit të firmës, mund të lidhen në mënyrë të arsyeshme me pavarësinë. Ky komunikim ju jep mundësi organeve të ngarkuara me qeverisjen të:

- (a) Marrin parasysh gjykimet e firmës në identifikimin dhe vlerësimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë;
- (b) Vlerësojnë mënyrën se janë adresuar kërcënimet përfshirë përshtatshmërinë e masave mbrojtëse disponibël dhe mund të zbatohen; dhe
- (c) Ndërmarrin veprimet e duhura.

Kjo metodë mund të jetë veçanërisht e dobishme në rastin e kërcënimeve

të frikësimit dhe të familjaritetit.

[Paragrafët 400.41 deri në 400.49 janë lënë qëllimisht bosh]

Firmat rrjet

400.50 A1 Për të rritur aftësinë e tyre për të dhënë shërbime profesionale, firmat shpesh formojnë struktura të mëdha me firma dhe entitete të tjera. Nëse këto struktura të mëdha krijojnë ose jo një rrjet varet nga fakte dhe rrethana të veçanta. Kjo nuk varet nga fakti nëse firmat dhe entitetet janë ligjërisht të veçanta dhe të dallueshme.

K400.51 Një firmë rrjet do të jetë e pavarur nga klientët e auditimit të firmave të tjera brenda rrjetit, siç përcaktohet nga kjo Pjese.

400.51 A1 Kërkesat për pavarësinë në këtë pjesë që zbatohen për një firmë të rrjetit zbatohen për çdo entitet që përmbush kriteret e përkufizimit të një firme të rrjetit. Nuk ka nevojë që entiteti të përmbushë kriteret e përkufizimit të një firme. Për shembull, një praktikë e konsulencës ose praktike profesionale ligjore, mund të jetë një firmë rrjet por jo një firmë.

K400.52 Kur lidhet me një strukturë më të madhe të firmave dhe entiteteve të tjera, një firmë do të:

- (a) Ushtrojë gjykimin profesional për të përcaktuar nëse nga kjo strukturë më e madhe është krijuar një rrjet;
- (b) Vlerësojë nëse një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar do të mund të arrijë në përfundimin se entitetet janë të lidhura në një mënyrë të atillë që tregon se ekziston një rrjet; dhe
- (c) Aplikojë këtë gjykim me koherencë për të gjithë këtë strukturë të madhe.

K400.53 Kur vlerëson nëse nga një strukturë më e madhe firmash dhe entitetesh të tjera është krijuar një rrjet, një firmë do të arrijë në përfundimin se ekziston një rrjet kur një strukturë e tillë më e madhe ka për qëllim bashkëpunimin dhe:

- (a) Synon në mënyrë të qartë realizimin e fitimit ose ndarjen e kostos midis entiteteve brenda strukturës. (Shih paragrafin 400.53 A2);
- (b) Entitetet brenda strukturës ndajnë në mënyrë të përbashkët pronësinë, kontrollin apo menaxhimin. (Shih paragrafin 400.53 A3);
- (c) Entitetet brenda strukturës ndajnë politika dhe procedura të përbashkëta të kontrollit të cilësisë. (Shih paragrafin 400.53 A4);
- (d) Entitetet brenda strukturës ndajnë një strategji të përbashkët të biznesit. (Shih paragrafin 400.53 A5);

- (e) Entitetet brenda strukturës ndajnë përdorimin e emrit të përbashkët. (Shih paragrafin 400.53 A6, 400.53 A7); ose
- (f) Entitetet brenda strukturës ndajnë një pjesë të konsiderueshme të burimeve profesionale. (Shih paragrafët 400.53 A8, 400.53 A9).

400.53 A1 Mund të ketë marrëveshje të tjera midis firmës dhe entiteteve brenda një strukture më të madhe që përbën një rrjet, përveç marrëveshjeve të përshkruara në paragrafin më sipër K 400.53. Megjithatë, një strukturë e madhe mund të ketë për qëllim vetëm lehtësimin e referimit të punës, çka në vetvete nuk përmbush kriterin e nevojshëm për t'u konsideruar një rrjet.

400.53 A2 Ndarja e kostove të parëndësishme në vetvete nuk krijon një rrjet. Përveç kësaj, në qoftë se ndarja është e kufizuar vetëm për ato kosto që lidhen me zhvillimin e metodologjive të auditimit, manualeve ose të kurseve të trajnimit, në vetvete nuk do të krijonte një rrjet. Më tej, një shoqërizim (lidhje) mes një firme dhe një entiteti tjetër të pa lidhur, për të ofruar bashkërisht një shërbim apo për të zhvilluar një produkt, në vetvete nuk krijon një rrjet. (Shih paragrafin K400.53(a)).

400.53 A3 Pronësia, kontrolli apo menaxhimi i përbashkët mund të arrihet përmes kontratës ose mjeteve të tjera. (Shih paragrafin K400.53(b)).

400.53 A4 Politika dhe procedura të përbashkëta për kontrollin e cilësisë janë ato të projektuara, të zbatuara dhe të monitoruara në të gjithë strukturën e madhe. (Shih paragrafin K400.53(c)).

400.53 A5 Ndarja e një strategjie të përbashkët të biznesit përfshin një marrëveshje me entitetet për të arritur objektiva strategjike të përbashkëta. Një entitet nuk është një firmë rrjet thjesht sepse bashkëpunon me një entitet tjetër vetëm për t'ju përgjigjur së bashku një kërkesë për një propozim për ofrimin e një shërbimi profesional. (Shih paragrafin K400.53(d)).

400.53 A6 Një emër i përbashkët (brand name) përfshin inicialet e zakonshme ose një emër të përbashkët. Një firmë konsiderohet se përdor një emër të përbashkët, po qe se ajo përfshin, për shembull, emrin e përbashkët si pjesë të emrit të firmës, kur një ortak i firmës nënshkruan një raport të auditimit. (Shih paragrafin K400.53(e)).

400.53 A7 Edhe pse një firmë nuk bën pjesë në një rrjet dhe nuk përdor një emër të përbashkët si pjesë e emrit të firmës, ajo mund të krijojë përshtypjen se i përket një rrjeti, në qoftë se në shkresat ose në materialet promovuese, i referohet firmës, që është anëtare e një shoqate të firmave. Për rrjedhojë, nëse nuk tregohet kujdesi i duhur përta i përket mënyrës se si një firmë e përshkruan këtë anëtarësi, mund të krijohet një perceptim se firma i përket një rrjeti. (Shih paragrafin K400.53(e)).

400.53 A8 Burimet profesionale përfshijnë:

- Sistemet e përbashkëta që ju mundësojnë firmave për të shkëmbyer informacione, siç janë të dhënat e klientit, faturimet dhe regjistrimet e kohës së punës.
- Ortakët dhe stafin.
- Departamentet teknike që konsultohen për çështje teknike apo çështje të sektorëve ekonomikë të veçantë, për transaksionet apo ngjarjet për angazhimet e sigurisë.
- Metodologjinë e auditimit ose manualët e auditimit.
- Kurset e trajnimit dhe mjediset e tyre. (Shih paragrafin K400.53(f)).

400.53 A9 Përcaktimi nëse burimet profesionale të përbashkëta janë të rëndësishme varet nga rrethanat. Për shembull:

- Burimet e përbashkëta janë kufizuar në metodologjinë e përbashkët të auditimit apo në manualët e auditimit, pa shkëmbim të personelit apo të informacioneve të klientit ose të tregut. Në këto rrethana, nuk ka gjasa që burimet e përbashkëta të jenë të rëndësishëm. E njëjta gjë vlen edhe për përpjekjet për një trajnim të përbashkët.
- Burimet e përbashkëta përfshijnë shkëmbimin e personelit ose të informacionit, siç është rasti kur personeli merret nga një grup i përbashkët, ose kur brenda strukturës së madhe është krijuar një departament i përbashkët teknik për t'ju ofruar firmave pjesëmarrëse këshilla teknike, të cilat duhet të ndiqen nga ana e tyre. Në këto rrethana, një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar, ka shumë gjasa të arrijë në përfundimin që burimet e përbashkëta janë të rëndësishme. (Shih paragrafin K400.53(f)).

K400.54 Nëse një firmë shet një komponent të veprimtarisë së saj, dhe për një periudhë të kufizuar kohe entiteti i ri vazhdon të përdorë të gjithë emrin, ose një element të emrit të firmës ose rrjetit, entitetet përkatëse do të përcaktojnë mënyrën se si të bëjnë të ditur se ato nuk janë firma rrjet, kur ato paraqesin veten e tyre për palët e jashtme.

400.54 A1 Marrëveshja e shitjes ndonjëherë parashikon që, për një periudhë të kufizuar kohe, komponenti i shitur mund të vazhdojë të përdorë të gjithë ose një pjesë të emrit të firmës, ose të rrjetit edhe pse ai nuk është më i lidhur me firmën ose rrjetin. Në rrethana të tilla, ndërsa dy entitetet mund të realizojnë kryerjen e shërbimeve nën një emër të përbashkët, faktet janë të tilla që ato nuk i përkasin një strukturë të madhe që synon bashkëpunimin dhe, për këtë arsye, nuk janë firma të rrjetit.

[Paragrafët 400.55 deri në 400.59 janë lënë qëllimisht bosh]

Dokumentimi i përgjithshëm i pavarësisë për angazhimet e auditimit dhe rishikimit

K400.60 Një firmë do të dokumentojë përfundimet në lidhje me pajtueshmërinë me kërkesat e pavarësisë, si dhe thelbin e diskutimeve përkatëse, që mbështesin këto konkluzione. Veçanërisht:

- (a) Kur zbatohen masat mbrojtëse për të adresuar një kërcënim, firma do të dokumentojë natyrën e kërcënimit dhe masat mbrojtëse që janë zbatuar; dhe
- (b) Kur një kërcënim ka kërkuar analizë të rëndësishme dhe firma ka arritur në përfundimin se kërcënimi ishte në një nivel të pranueshëm, firma do të dokumentojë natyrën e kërcënimit dhe arsyetimin për përfundimin e arritur.

400.60 A1 Dokumentimi jep evidencë lidhur me gjykimet e bëra nga firma për formimin e konkluzioneve në lidhje me pajtueshmërinë me këtë pjesë. Mungesa e dokumentacionit nuk është një përcaktues i faktit nëse një firmë e ka konsideruar një çështje të caktuar dhe as e faktit nëse firma është e pavarur.

[Paragrafët 400.61 deri në 400.69 janë lënë qëllimisht bosh]

Shkrirjet dhe blerjet

Kur një shkrirje e klientit krijon një kërcënim

400.70 A1 Një entitet mund bëhet një palë e lidhur e një klienti të auditimit si rezultat i një shkrirjeje ose blerjeje. Interesat dhe marrëdhëniet e mëparshme dhe të tanishme të një firme ose firme rrjeti me entitetin e lidhur mund të krijojnë një kërcënim ndaj pavarësisë, dhe si rrjedhojë, ndaj aftësisë së firmës për të vazhduar një angazhim auditimi.

K400.71 Në rrethanat e dhëna në paragrafin 400.70 A1,

- (a) Firma do të identifikojë dhe vlerësojë interesat e mëparshme dhe të tanishme dhe marrëdhëniet me entitetin e lidhur të cilat, duke patur parasysh masat mbrojtëse në dispozicion, mund të ndikojnë në pavarësinë e saj dhe për këtë arsye, në aftësinë e saj për të vazhduar angazhimin e auditimit pas datës së hyrjes në fuqi të shkrirjes ose blerjes; dhe
- (b) Sipas paragrafit K400.72, firma do të ndërmarrë hapat e nevojshme që, në datën e hyrjes në fuqi të shkrirjes ose blerjes, të ndërpresë interesat apo marrëdhëniet aktuale që nuk janë të lejuara sipas këtij Kodi.

K400.72 Si një përjashtim i paragrafit K400.71(b), nëse një interes apo marrëdhënie aktuale nuk mund të ndërpritet në mënyrë të arsyeshme deri në datën e hyrjes në fuqi të bashkimit ose blerjes, firma do të:

- (a) Vlerësojë kërcënimin e krijuar nga ky interes ose kjo marrëdhënie; dhe
- (b) Diskutojë me organet e ngarkuara me qeverisjen për arsyet pse interesi apo marrëdhënia nuk mund të ndërpritet në mënyrë të arsyeshme në datën e hyrjes në fuqi të bashkimit ose blerjes dhe të vlerësojë rëndësinë e kërcënimit.

400.72 A1 Në disa rrethana, një interes apo marrëdhënie që krijon një kërcënim nuk mund të ndërpritet në mënyrë të arsyeshme deri në datën e hyrjes në fuqi të bashkimit ose blerjes. Kjo mund të ndodhë kur firma ofron një shërbim të jo sigurisë për entitetin e lidhur, dhe entiteti i lidhur nuk është në gjendje të kryejë një tranzicion të rregullt të shërbimit tek një tjetër ofrues deri në datën e hyrjes në fuqi.

400.72 A2 Faktorët që lidhen me vlerësimin e nivelit të kërcënimit të krijuar nga shkrirjet ose blerjet në rrethanat kur ka interese dhe marrëdhënie që nuk mund të ndërpritet në mënyrë të arsyeshme, përfshijnë:

- Natyrën dhe rëndësinë e interesit apo të marrëdhënies.
- Natyrën dhe rëndësinë e marrëdhënies me palën e lidhur (për shembull, nëse entiteti i lidhur është një degë apo një shoqëri mëmë).
- Periudhën e kohës që nevojitet deri sa interesi apo marrëdhënia të ndërpritet në mënyrë të arsyeshme.

K400.73 Nëse, pas diskutimit të përcaktuar në paragrafin K400.72(b), organet e ngarkuara me qeverisjen kërkojnë që firma të vazhdojë si auditues, firma do ta bëjë këtë gjë vetëm nëse:

- (a) Interesi ose marrëdhënia do të ndërpritet në mënyrë të arsyeshme sa më shpejt që të jetë e mundur dhe, në të gjitha rastet brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të bashkimit ose blerjes;
- (b) Çdo individ i cili ka një interes ose marrëdhënie të tillë, përfshirënjë interes që ka lindur nga kryerja e një shërbimi të jo sigurisë që nuk do të ishte i lejuar sipas Seksionit 600 dhe nën seksioneve të tij, nuk do të ishte një anëtar i grupit të angazhimit për auditimin, ose individ i përgjegjës për kontrollin e cilësisë së angazhimit; dhe
- (c) Sipas nevojës, do të zbatohen masat e përshtatshme kalimtare dhe do të diskutohet me organet e ngarkuara me qeverisjen.

400.73 A1 Shembuj të masave kalimtare përfshijnë:

- Caktimin e një profesionisti kontabël për rishikimin, sipas nevojës, të auditimit apo të shërbimit të jo sigurisë.
- Caktimin e një profesionisti kontabël, i cili nuk është anëtar i firmës që shpreh opinionin mbi pasqyrat financiare, për të kryer një rishikim që është ekuivalent me një rishikim për kontrollin e cilësisë së angazhimit.
- Angazhimin e një tjetër firme për të vlerësuar rezultatet e shërbimit të jo sigurisë ose angazhimin e një firme tjetër për ri- kryerjen e shërbimit të jo sigurisë në masën e nevojshme që i jep mundësinë firmës tjetër për të marrë përgjegjësinë për shërbimin

K400.74 Firma mund të ketë realizuar një pjesë të konsiderueshme të punës së auditimit para hyrjes në fuqi të bashkimit ose blerjes dhe, mund të jetë në gjendje të kryejë procedurat e auditimit të mbetura brenda një periudhe kohe të shkurtër. Në këto rrethana, nëse organet e ngarkuara me qeverisjen i kërkojnë firmës të përfundojë auditimin duke vazhduartë këtë një interes apo marrëdhënie të identifikuar në paragrafin 400.70 A1, firma do ta bëjë këtë vetëm nëse:

- (a) Ka vlerësuar rëndësinë e kërcënimit të krijuar nga një interes ose marrëdhënie e tillë dhe e ka diskutuar vlerësimin me organet e ngarkuara me qeverisjen;
- (b) Vepron në përputhje me kërkesat e dhëna në paragrafin K400.73(a) deri në (c); dhe
- (c) Pushon të jetë auditues jo më vonë se data kur është lëshuar raporti i auditimit.

Nëse objektiviteti mbetet i kompromentuar

K400.75 Edhe në qoftë se mund të plotësohen të gjitha kërkesat e paragrafëve K400.71 deri në K400.74, firma do të vlerësojë nëse rrethanat e identifikuar në paragrafin 400.70 A1 krijojnë një kërcënim që nuk mund të adresohet, sa që objektiviteti do të ishte i kompromentuar. Nëse është kështu, firma do të pushojë të jetë audituesi.

Dokumentimi

K400.76 Firma do të dokumentojë:

- (a) Çdo interes apo marrëdhënie që është identifikuar në paragrafët 400.70 A1, që nuk do të ndërpritej nga data e hyrjes në fuqi të bashkimit ose blerjes dhe arsyet pse marrëdhëniet apo interesat nuk do të ndërpritehin;
- (b) Masat kalimtare të aplikuara;
- (c) Rezultatet e diskutimeve me personat e ngarkuar me qeverisjen; dhe

- (d) Arsyetimin pse interesat dhe marrëdhëniet e mëparshme dhe aktuale nuk krijojnë një kërcënim të atillë që objektiviteti të ishte kompromentuar.

[Paragrafët 400.77 deri në 400.79 janë lënë qëllimisht bosh.]

Shkelja e një dispozite të pavarësisë për angazhimet e auditimit dhe të rishikimit

Kur një Firmë Identifikon një Shkelje

K400.80 Kur firma vlerëson se ka ndodhur një shkelje e një kërkesë të kësaj Pjese, firma do të:

- (a) Ndërpresë, pezullojë ose eliminojë interesin apo marrëdhënien që ka shkaktuar shkeljen dhe do të adresojë pasojat e shkeljes;
- (b) Vlerësojë nëse ka kërkesa ligjore ose rregullatore që zbatohen për shkeljen, dhe nëse po:
 - (i) të respektojë këto kërkesa; dhe
 - (ii) të konsiderojë raportimin e shkeljes tek një organizëm anëtar, tek autoriteti përkatës rregullator ose mbikëqyrës, nëse një raportim i tillë është një praktikë e zakonshme, ose është pritshëm në juridiksionin përkatës;
- (c) Komunikojë menjëherë shkeljen në pajtim me politikat dhe procedurat e saj, tek:
 - (i) ortaku i angazhimit;
 - (ii) personat që kanë përgjegjësi për politikat dhe procedurat që lidhen me pavarësinë;
 - (iii) personelin përkatës brenda firmës dhe kur është e nevojshme, rrjetin; dhe
 - (iv) ata që janë subjekt i kërkesave të pavarësisë në Pjesën 4A, të cilët duhet të ndërmarrin veprimin e duhur;
- (d) Vlerësojë rëndësinë e shkeljes dhe ndikimin e saj në objektivitetin dhe aftësinë për të lëshuar një raport auditimi; dhe
- (e) Në varësi të rëndësisë së shkeljes, të përcaktojë:
 - (i) Nëse duhet ndërprerë angazhimi; ose
 - (ii) Nëse është e mundur ndërmarrja e veprimeve që adresojnë në mënyrë të kënaqshme pasojat e shkeljes, dhe nëse do të ndërmerret një veprim i tillë dhe ai është i përshtatshëm për rrethanat.

Kur bën këtë vlerësim firma do të përdorë gjykimin profesional dhe dotë marrë parasysh mundësinë nëse një palë e tretë e arsyeshme dhe e mirë informuar do të mund të arrijë në përfundimin se objektiviteti i firmës është kompromentuar dhe për këtë arsye, firma nuk do të ishte në gjendje të lëshojë një raport auditimi.

400.80 A1 Një shkelje e një dispozite të kësaj Pjesë mund të ndodhë edhe pse firma ka një sistem të menaxhimit të cilësisë për të adresuar kërkesat e pavarësisë. Për shkak të shkeljes mund të jetë e nevojshme të përfundohet angazhimi i auditimit.

400.80 A2 Rëndësia dhe ndikimi i një shkeljeje mbi objektivitetin dhe aftësinë e firmës për të lëshuar një raport auditimi do të varen nga faktorë të tillë, si:

- Natyra dhe kohëzgjatja e shkeljes.
- Numri dhe natyra e shkeljeve të mëparshme që lidhen me angazhimin aktual të auditimit.
- Nëse një anëtar i grupit të auditimit ka patur dijeni për interesat ose marrëdhëniet që kanë shkaktuar shkeljen.
- Nëse individ i që ka shkaktuar shkeljen është një anëtar i grupit të auditimit apo një individ tjetër për të cilin ka kërkesa për pavarësinë.
- Nëse shkelja lidhet me një anëtar të grupit të auditimit, roli i këtij individ.
- Nëse shkelja është shkaktuar nga dhënia e një shërbimi profesional, ndikimi i këtij shërbimi nëse ka, në regjistrimet kontabël ose shumat e regjistruara në pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion.
- Shkalla e shtrirjes së rreziqeve të interesit vetjak (egoizmit), përkrahjes, frikësimit dhe rreziqeve të tjera të krijuara nga shkelja.

400.80 A3 Në varësi të rëndësisë së shkeljes, shembuj të veprimeve që mund të ndërmerret firma për adresimin e shkeljes në mënyrë të kënaqshme, përfshijnë:

- Largimin e individit përkatës nga grupi i auditimit.
- Përdorimin e individëve të ndryshëm për kryerjen e një rishikimi shtesë të punës audituese të ndikuar ose për të ri kryer këtë punë në masën e nevojshme.
- Dhënien e rekomandimit që klienti i auditimit të angazhojë një firmë tjetër për të rishikuar ose ri kryer punën audituese të ndikuar deri në shkallën që shihet e nevojshme.
- Në qoftë se shkelja lidhet me një shërbim të jo sigurisë që ka ndikim në regjistrimet kontabël ose në shumën që është regjistruar në pasqyrat financiare, angazhimi i një firme tjetër për të vlerësuar rezultatet e shërbimit të jo sigurisë, ose angazhimin e një firme tjetër për të ri kryer shërbimin e sigurisë deri në masën që është e nevojshme për të mundësuar firmën tjetër të marrë përgjegjësi për shërbimin

K400.81 Në qoftë se firma arrin në përfundimin se nuk mund të ndërmerret ndonjë veprim që adreson në mënyrë të kënaqshme pasojat e shkeljes, ajo do të

informojë, sa më shpejt të jetë e mundur, personat e ngarkuar me qeverisjen dhe do të ndërmerren hapat e nevojshme për të ndërprerë angazhimin e auditimit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Kur ligji ose rregulli nuk e lejon ndërprerjen, firma do të veprojë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të raportimit dhe të dhënies së informacioneve shpjeguese.

K400.82 Në qoftë se firma arrin në përfundimin se mund të ndërmerren veprime për të adresuar në mënyrë të kënaqshme pasojat e shkeljes, ajo do të diskutojë me personat e ngarkuar me qeverisjen:

- (a) Rëndësinë e shkeljes, përfshirë natyrën dhe kohëzgjatjen;
- (b) Si ka ndodhur shkelja dhe si është identifikuar ajo;
- (c) Veprimin e ndërmarrë apo që propozohet të ndërmerret dhe mënyrën se si ky veprim do të adresojë në mënyrë të kënaqshme pasojat e shkeljes dhe të bëjë të mundur që firma të lëshojë një raport auditimi;
- (d) Konkluzionin, se sipas gjykimit profesional të firmës, nuk është kompromentuar objektiviteti dhe arsyetimi përkatës për këtë konkluzion; dhe
- (e) Çdo hap që firma ka propozuar ose ndërmarrë për të zvogëluar ose shmangur rrezikun e ndodhjes së shkeljeve në të ardhmen.

Këto diskutime do të bëhen sa më shpejt të jetë e mundur, përveç rastit kur nga personat e ngarkuar me qeverisjen është caktuar një afat specifik për raportime të shkeljeve më pak të rëndësishme.

Komunikimi i shkeljeve me personat e ngarkuar me qeverisjen

400.83 A1 Paragrafët K300.9 dhe K300.10 përcaktojnë kërkesat lidhur me komunikimin me personat e ngarkuar me qeverisjen.

K400.84 Në lidhje me shkeljet, firma do të komunikojë me shkrim me personat e ngarkuar me qeverisjen:

- (a) Të gjitha çështjet e trajtuara në pajtim me paragrafin K400.82 dhe, do të sigurojë pëlqimin e personave të ngarkuar me qeverisjen se janë ndërmarrë ose do të ndërmerren veprime, me qëllim trajtimin në mënyrë të kënaqshme të pasojave të shkeljes; dhe
- (b) Një përshkrim të:
 - (i) politikave dhe procedurave të firmës që lidhen me shkeljen të cilat synojnë t'i japin firmës sigurinë e arsyeshme se është ruajtur pavarësia; dhe
 - (ii) çdo hap të ndërmarrë apo që propozohet të ndërmerret nga firma për të zvogëluar ose shmangur rrezikun që shkeljet të përsëriten.

K400.85 Nëse personat e ngarkuar me qeverisjen nuk mendojnë se veprimi i propozuar nga firma në përputhje me paragrafin K400.80(e)(ii) adreson në mënyrë të kënaqshme pasojat e shkeljes, firma do të ndërmarrë hapat e nevojshme për të ndërprerë angazhimin e auditimit, në pajtim me paragrafin K400.81.

Shkeljet përpara se të ishte lëshuar raporti i mëparshëm i auditimit

K400.86 Nëse shkelja ka ndodhur përpara se të lëshohej raporti i mëparshëm i auditimit, firma do të respektojë dispozitat e Pjesës 4A për vlerësimin e rëndësisë së shkeljes dhe ndikimin e saj në objektivitetin dhe aftësinë e firmës për të lëshuar një raport auditimi në periudhën aktuale.

K400.87 Gjithashtu, firma do të:

- (a) Konsiderojë ndikimin e shkeljes, nëse ka të tillë, mbi objektivitetin e firmës në lidhje me raportet e auditimit të lëshuara më parë dhe mundësinë e tërheqjes së këtyre raporteve të auditimit; dhe
- (b) Diskutojë çështjen me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Dokumentimi

K400.88 Për të qenë në pajtim me kërkesat në paragrafët K400.80 deri në K400.87, firma do të dokumentojë:

- (a) Shkeljen;
- (b) Veprimet e ndërmarra;
- (c) Vendimet kryesore të marra;
- (d) Të gjitha çështjet e diskutuara me personat e ngarkuar me qeverisjen; dhe
- (e) Ndonjë diskutim të bërë me organizmin profesional ose një organizëm rregullator apo autoritet mbikëqyrës.

K400.89 Nëse firma vijon me angazhimin e auditimit, ajo do të dokumentojë:

- (a) Konkluzionin, se në gjykimin profesional të firmës, nuk është kompromentuar objektiviteti; dhe
- (b) Arsyetimin përse ajo ka ndërmarrë veprimet që adresojnë në mënyrë të përshtatshme pasojat e shkeljes të atilla që firma të mund të lëshojë një raport auditimi.

SEKSIONI 405

AUDITIMET E GRUPIT

Hyrje

- 405.1 Seksioni 400 kërkon që një firmë të jetë e pavarur kur kryen një angazhim auditimi, dhe të zbatojë kuadrin konceptual në seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar kërcënimet ndaj pavarësisë. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin për zbatim që lidhet me aplikimin e kuadrit konceptual gjatë kryerjes së një angazhimi të auditimit të grupit.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 405.2 A1 Për një auditim të pasqyrave financiare të grupit zbatohen SNA-të. SNA 600 (i rishikuar) trajton konsiderata të veçanta të cilat zbatohen për një auditim të pasqyrave financiare të grupit, duke përfshirë edhe rastin kur marrin pjesë audituesit e komponentit (entitetit të kontrolluar). SNA 600 (i rishikuar) kërkon nga partneri i angazhimit i grupit të marrë përgjegjësinë për konfirmimin nëse audituesit e entitetit të kontrolluar i kuptojnë dhe do të veprojnë në pajtim me kërkesat përkatëse etike, përfshirë ato që lidhen me pavarësinë, që zbatohen për auditimin e grupit. Në këtë seksion janë specifikuar kërkesat për pavarësinë të referuara në SNA 600 (i rishikuar), ose në standardet e tjera përkatëse të auditimit, të zbatueshme për auditimet e grupit, të cilat janë ekuivalente me SNA 600 (i rishikuar).
- 405.2 A2 Një firmë audituese e një entiteti të kontrolluar (komponenti) që merr pjesë në një angazhim të auditimit të grupit, mund të lëshojë një opinion auditimi të veçantë mbi pasqyrat financiare të klientit të auditimit që në këtë rast është klienti entitet i kontrolluar i grupit (komponentit). Në varësi të rrethanave, firma audituese e komponentit mund të ketë nevojë të respektojë kërkesa të ndryshme të pavarësisë kur kryen punën e auditimit për një auditim të grupit dhe veçmas lëshon një opinion auditimi mbi pasqyrat financiare të klientit të auditimit që është komponenti i grupit, për qëllime statusore, rregullatore apo të tjera.

Komunikimi midis një firme të audituesve të grupit dhe një firme të audituesve të komponentit

- K405.3 SNA 600 (i rishikuar) kërkon nga partneri i angazhimit të grupit të

marrë përgjegjësinë për ta bërë një auditues të komponentit të vetëdijshëm për kërkesat etike përkatëse që janë të zbatueshme duke pasur parasysh natyrën dhe rrethanat e angazhimit të auditimit të grupit. Kur e bën firmën e audituesit të komponentit, të vetëdijshme për kërkesat etike përkatëse, firma e audituesve të grupit duhet të komunikojë informacionin e nevojshëm në kohën e duhur, për t'i mundësuar firmës së audituesit të komponentit të përmbushë përgjegjësitë e saj sipas këtij seksioni.

405.3 A1 Shembuj të çështjeve që firma e audituesve të grupit mund të komunikojë, përfshijnë:

- Faktin nëse klienti i auditimit grup është një entitet me interes publik dhe kërkesat etike përkatëse të zbatueshme për angazhimin e auditimit të grupit.
- Entitetet e lidhura dhe komponentët e tjerë brenda klientit të auditimit të grupit që janë të përshtatshme për vlerësimin e pavarësisë, të zbatueshme për firmën e audituesve të komponentit përbërës dhe anëtarëve të ekipit të auditimit të grupit brenda, ose të angazhuar nga kjo firmë.
- Periudhën kohore gjatë së cilës firma e audituese e komponentit është e detyruar të jetë e pavarur.
- Faktin nëse një partner auditues që kryen punë në komponent për qëllime të auditimit të grupit është një partner kryesor auditimi për auditimin e grupit.

K405.4 SNA 600 (i rishikuar) kërkon gjithashtu që partneri i angazhimit të grupit t'i kërkojë audituesit të komponentit të komunikojë nëse ky i fundit, ka respektuar kërkesat etike përkatëse, përfshirë ato që lidhen me pavarësinë, që zbatohen për angazhimin e auditimit të grupit. Për qëllimet e këtij seksioni, një kërkesë e tillë përfshin komunikimin e:

- (a) Çdo çështje pavarësie që kërkon gjykim të rëndësishëm; dhe
- (b) Në lidhje me këto çështje, konkluzionet e firmës së audituesve të komponentit, nëse kërcënimet për pavarësinë e saj, janë në një nivel të pranueshëm dhe të arsyeshme për këtë konkluzion.

405.4 A1 Nëse një çështje, që tregon se ekziston një kërcënim për pavarësinë, vjen në vëmendjen e partnerit të angazhimit të grupit, SNA 220 (i rishikuar) kërkon që partneri i angazhimit të grupit të vlerësojë kërcënimin dhe të ndërmarrë veprimet e duhura.

Konsiderata për pavarësinë që zbatohen për individët

Anëtarët e ekipit të auditimit të grupit brenda, ose të angazhuar nga një firmë e

audituesve të grupit dhe firmat e saj të rrjetit

K405.5 Anëtarët e ekipit të auditimit të grupit brenda ose të angazhuar nga firma audituese e grupit dhe firmat e rrjetit të saj duhet të jenë të pavarura nga klienti i auditimit grup, në përputhje me kërkesat e kësaj Pjese që janë të zbatueshme për ekipin e auditimit.

Anëtarë të tjerë të ekipit të auditimit të grupit

K405.6 Anëtarët e ekipit të auditimit të grupit brenda, ose të angazhuar nga një firmë audituese e komponentit, jashtë rrjetit të firmës së audituesve të grupit, duhet të jenë të pavarur nga:

- (a) Klienti i auditimit komponent;
- (b) Entiteti mbi pasqyrat financiare të grupit të të cilit firma audituese e grupit shpreh një opinion;
- (c) Çdo entitet mbi të cilin entiteti në nën paragrafin (b) ka kontroll direkt ose indirekt, me kusht që ky entitet të ketë kontroll direkt ose indirekt mbi klientin e auditimit komponent

në përputhje me kërkesat e kësaj Pjese që janë të zbatueshme për ekipin e auditimit.

K450.7 Në lidhje me entitetet ose komponentët e lidhur brenda klientit të auditimit grup, përveç atyre të mbuluara në paragrafin R405.6, një anëtar i ekipit të auditimit të grupit brenda, ose i angazhuar nga një firmë audituese e komponentit jashtë rrjetit të firmës së audituesve të grupit, duhet të njoftojë firmën audituese të komponentit për çdo marrëdhënie apo rrethanë që individit di, ose ka arsye të besojë, se mund të krijojë një kërcënim për pavarësinë e tij në kontekstin e auditimit të grupit.

405.7 A1 Shembuj të marrëdhënieve ose rrethanave që përfshijnë individin ose ndonjë nga anëtarët e afërt të familjes së individit, sipas rastit, që janë relevante për vlerësimin nga individit, kur respektohen kërkesat në paragrafin R405.7 janë:

- Një interes financiar indirekt ose material në një entitet që ka kontroll mbi klientin e auditimit grup, nëse klienti i auditimit grup është material për këtë entitet (shih seksionin 510)
- Një kredi ose garanci që përfshin: (shih seksionin 511)
 - Një entitet që nuk është bankë apo institucion i ngjashëm, përveç nëse kredia ose garancia nuk është jo-materiale;
 - Një bankë apo institucion i ngjashëm, përveç nëse kredia ose

garancia nuk bëhet sipas procedurave, kritereve dhe kushteve normale të huadhënies.

- Një marrëdhënie biznesi që është domethënëse ose që përfshin një interes financiar material (shih seksionin 520).
- Një anëtar i afërt i familjes, i cili është: (shih seksionin 521)
 - Një drejtor ose oficer i një entiteti; ose
 - Një punonjës në një pozicion që ushtron ndikim të rëndësishëm mbi përgatitjen e regjistrave kontabël ose të pasqyrave financiare të një entiteti.
- Rasti i një individi që shërben si, ose kohet e fundit ka shërbyer si: (shih seksionin 522 dhe seksionin 523)
 - Një drejtor ose zyrtar i një entitetit;
 - Një punonjës në një pozicion që ushtron ndikim të rëndësishëm mbi përgatitjen e regjistrave kontabël ose të pasqyrave financiare të një entiteti.

K450.8 Me marrjen e njoftimit siç është përcaktuar në paragrafin R405.7, firma audituese e komponentit duhet të vlerësojë dhe trajtojë çdo kërcënim për pavarësinë të krijuar nga marrëdhënia ose rrethanat e individit.

Konsiderata për pavarësinë të zbatueshme për një firmë të audituesit të grupit

K405.9 Një firmë audituese e grupit duhet të jetë e pavarur nga klienti i auditimit grup në përputhje me kërkesat e kësaj Pjese që janë të zbatueshme për një firmë.

Konsiderata për pavarësinë të zbatueshme për firmat rrjet të një firme të audituesit të grupit

K405.10 Një firmë rrjeti e firmës audituese të grupit duhet të jetë e pavarur nga klienti i auditimit grup në përputhje me kërkesat e kësaj Pjese që janë të zbatueshme për një firmë rrjeti.

Konsiderata për pavarësinë të zbatueshme për firmat audituese të komponentit jashtë një rrjeti të firmës të audituesit të grupit

Për të gjithë klientët e auditimit grup

K405.11 Një firmë audituese e komponentit jashtë rrjetit të firmës së audituesit të grupit do të:

- (a) jetë e pavarur nga klienti i auditimit komponent në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Pjesë që janë të zbatueshme për

- një firmë në lidhje me të gjithë klientët e auditimit;
- (b) zbatojë kërkesat përkatëse në paragrafët R510.4(a), R510.7 dhe R510.9 në lidhje me interesat financiare në entitetin mbi pasqyrat financiare të grupit të të cilit firma audituese e grupit shpreh një opinion; dhe
 - (c) zbatojë kërkesat përkatëse në seksionin 511 në lidhje me kreditë dhe garancitë që përfshijnë entitetin mbi pasqyrat financiare të grupit të të cilit firma audituese e grupit shpreh një opinion.

K405.12 Kur një firmë audituese e komponentit jashtë rrjetit të firmës së audituesit të grupit e di, ose ka arsye të besohet se e di që një marrëdhënie ose rrethanë që përfshin klientin e auditimit grup, përtej atyre të trajtuara në paragrafin R405.11(b) dhe c), është e përshtatshme për vlerësimin e pavarësisë së firmës së audituesit të komponentit nga klienti i auditimit komponent, firma e audituesit të komponentit do të mbajë parasysh këtë marrëdhënie ose rrethanë kur identifikon, vlerëson dhe trajton kërcënimet ndaj pavarësisë.

405.13 Kur një firmë audituese e komponentit jashtë rrjetit të firmës së audituesit të grupit njih, ose ka arsye të besojë, se një marrëdhënie ose rrethanë e një firme brenda rrjetit të firmës së audituesit të komponentit me klientin e auditimit komponent ose klientin e auditimit grup, krijojnë një kërcënim për pavarësinë e firmës së audituesit komponent, firma e audituesit komponent duhet të vlerësojë dhe trajtojë çdo kërcënim të tillë.

Periudha gjatë të cilës kërkohet pavarësia

405.14 A1 Referencat në pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit në paragrafët R400.30 dhe 400.30 A1, kur zbatohen në këtë seksion, nënkuptojnë respektivisht pasqyrat financiare të grupit dhe raportin e auditimit mbi pasqyrat financiare të grupit.

Klientët e auditimit Grup që nuk janë entitete me interes publik

K405.15 Kur klienti i auditimit të grupit nuk është një entitet me interes publik, një firmë audituese e komponentit jashtë rrjetit të firmës audituese të grupit duhet të jetë e pavarur nga klienti i auditimit komponent në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Pjesë, të cilat janë të zbatueshme për klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik për qëllime të auditimit të grupit.

405.15 A1 Kur një firmë audituese e komponentit jashtë rrjetit të firmës së audituesit të grupit kryen gjithashtu një angazhim auditimi, për një klient të auditimit komponent, që është një entitet me interes publik,

për arsye të tjera të ndryshme nga auditimi i grupit, për shembull, një auditim statutor, për këtë angazhim bazohet në kërkesat për pavarësinë që janë të përshtatshme për klientët e auditimit që janë entitete me interes publik.

Klientët e auditimit grup që janë entitete me interes publik

Shërbimet e jo-sigurisë

K405.16 Subjekt i paragrafit R405.17, kur klienti i auditimit grup është një entitet me interes publik, një firmë e audituesit të komponentit jashtë rrjetit të firmës së audituesit të grupit duhet të respektojë dispozitat e seksionit 600 që janë të zbatueshme për entitetet me interesit publik në lidhje me ofrimin e shërbimeve të jo-sigurisë për klientin e auditimit komponent.

405.16 A1 Kur klienti i auditimit grup është një entitet me interes publik, një firmë e audituesit të komponentit jashtë rrjetit të firmës së audituesit të grupit nuk lejohet, për shembull:

- Të japë shërbime të kontabilitetit dhe të regjistrimeve kontabël për një klient të auditimit komponent që nuk është një entitet me interes publik (shih nën seksionin 601).
- Hartimi i sistemit të teknologjisë së informacionit, ose një aspekt i tij, për një klient auditimi komponent që nuk është një entitet me interes publik ku një sistem i tillë i teknologjisë së informacionit gjeneron informacion për regjistrat e kontabilitetit ose pasqyrat financiare të klientit të auditimit komponent (shih nën seksionin 606).
- Të veprojë në rolin e avokatit për një klient të auditimit komponent, që nuk është një entitet me interes publik, në zgjidhjen e një mosmarrëveshje ose një çështje gjyqësore përpara një gjykate (shih nën seksionin 608).

405.16 A2 Informacioni financiar, mbi të cilin një firmë e audituesit të komponentit jashtë rrjetit të firmës së audituesit të grupit, kryen procedurat e auditimit, është i përshtatshëm për vlerësimin e kërcënimit të vetë rishikimit, që mund të krijohet nga ofrimi i një shërbimi të jo-sigurisë nga firma e audituesit të komponentit, dhe për këtë arsye, aplikohet seksioni 600. Për shembull, nëse procedurat e auditimit të firmës së audituesit të komponentit janë të kufizuara në një element të veçantë, siç është inventari, rezultatet e çdo shërbimi të jo-sigurisë që janë pjesë ose ndikojnë në regjistrimet kontabël ose në informacionin financiar që lidhet me kontabilitetin për, ose kontrollat e brendshme mbi, inventarin, janë të përshtatshme për vlerësimin e

kërcënimit të vetë rishikimit

K405.17 Si një përjashtim nga paragrafi R405.16, një firmë audituese e komponentit, jashtë rrjetit të firmës së audituesit të grupit, mund të ofrojë një shërbim të jo-sigurisë, që nuk është i ndaluar sipas seksionit 600 për një klienti të auditimit komponent, pa komunikuar informacion në lidhje me shërbimin e propozuar të jo sigurisë tek personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit të auditimit - grup ose pa marrë pëlqimin e tyre në lidhje me ofrimin e këtij shërbimi siç trajtohet nga paragrafët R600.21 deri në R600.24.

Partnerët kryesorë të auditimit

K405.18 Partneri i angazhimit të grupit duhet të përcaktojë nëse një partner auditimi që kryen punën e auditimit në një komponent për qëllime të auditimit të grupit është një partner kryesor i auditimit për auditimin e grupit. Nëse po, partneri i angazhimit të grupit do të:

- (a) Komunikojë vendimin për atë individ; dhe
- (b) Tregojë:
 - (i) Në rastin e të gjithë klientëve të auditimit grup, se individit është subjekt i paragrafit R411.4, dhe
 - (ii) Në rastin e klientëve të auditimit grup, të cilët janë entitete me interes publik, se individit është gjithashtu, subjekt i paragrafëve R524.6, R540.5(c) dhe R540.21

405.18 A1 Një partner kryesor i auditimit merr vendime apo gjykime kyçe për çështje të rëndësishme në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të grupit mbi të cilat firma e audituesit të grupit shpreh një opinion në auditimin e grupit.

Ndryshimet në komponentët (entitetet e kontrolluara)

Per të gjithë klientët e auditimit grup

405.19 Kur një entitet që nuk është një entitet i lidhur, bëhet një komponent brenda klientit të auditimit grup, firma e audituesit të grupit do të zbatojë paragrafët R400.71 në R400.76.

Ndryshimet në firmat e audituesit të komponentit (entitetit të kontrolluar)

Për të gjithë klientët e auditimit grup

405.20 A1 Mund të ketë rrethana në të cilat firma e audituesit të grupit i kërkon një firmë tjetër për të kryer punën e auditimit si një firmë e audituesit të komponentit gjatë ose pas periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare të grupit, për shembull për shkak të një bashkimi apo blerje të klientit. Mund të krijohet një kërcënim për pavarësinë e firmës së audituesit të komponentit nga:

- (a) Marrëdhëniet financiare ose të biznesit të firmës së audituesit të komponentit me klientin e auditimit komponent gjatë ose pas periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare të grupit, por para se firma e audituesit të komponentit të pranojë të kryejë punën e auditimit;
- (b) Shërbimet e mëparshme të ofruara për klientin e auditimit komponent nga firma e audituesit të komponentit.

405.20 A2 Paragrafët 400.31 A1 deri në A3 përmban materialin për zbatim që është i aplikueshëm për vlerësimin, nga një firmë e audituesit të komponentit, e kërcënimeve për pavarësinë, nëse një shërbim i jo-sigurisë do të kishte qenë ofruar nga firma e audituesit të komponentit për klientin e auditimit komponent, gjatë ose pas periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare të grupit, por para se firma e audituesit të komponentit të fillojë të kryejë punën e auditimit për qëllime të auditimit të grupit, dhe shërbimi nuk do ishte i lejuar gjatë periudhës së angazhimit.

405.20 A3 Paragrafi 400.31 A4 përmban materialin për zbatim që është i aplikueshëm për vlerësimin, nga një firmë e audituesit të komponentit, e kërcënimeve për pavarësinë nëse një shërbim i jo-sigurisë do të kishte qenë ofruar nga firma e audituesit të komponentit tek klienti i auditimit komponent përpara periudhës së mbuluar pasqyrat financiare të grupit.

Klientët e auditimit grup që janë entitete me interes publik

405.21 A1 Paragrafët R400.32 dhe 400.32 A1 janë të zbatueshëm kur një firmë e audituesit të komponentit pranon të kryejë punë auditim për qëllime të auditimit të grupit në lidhje me një klient të auditimit grup, që është një entitet me interes publik, nëse firma e audituesit të komponentit ka ofruar më parë një shërbim të jo -sigurisë për klientin e auditimit komponent.

405.21 A2 Paragrafët R600.25 dhe 600.25 A1 janë të zbatueshëm në lidhje me një shërbim të jo sigurisë të ofruar, aktualisht ose më parë, nga një firmë audituese e komponentit, për një klient të auditimit komponent, kur klienti i auditimit grup, bëhet më pas një entitet me interes publik.

Shkelja e një dispozite për pavarësinë në një firmë të audituesit të komponentit

405.22 A1 Një shkelje e një dispozite të këtij seksioni mund të ndodhë pavarësisht se një firmë audituese e komponentit ka një sistem të menaxhimit të cilësisë të hartuar për të trajtuar kërkesat për pavarësinë. Paragrafët R405.23 deri në R405.29 janë të përshtatshme për përcaktimin nëse një firmë e audituesit të grupit do të ishte në gjendje të përdorte punën e një firme të audituesit të komponentit, në rast se në firmën e audituesit të komponentit ka ndodhur një shkelje.

405.22 A2 Në rastin e shkeljes në një firmë të audituesit të komponentit, brenda rrjetit të firmës së audituesve të grupit, paragrafët R400.80 deri R400.89 zbatohen sipas rastit, edhe për firmën e audituesit të grupit në lidhje me auditimin e grupit.

Kur një firmë e audituesit të komponentit identifikon një shkelje

K405.23 Në qofte se një firmë e audituesit të komponentit arrin në përfundimin se ka ndodhur një shkelje e këtij seksioni, audituesi i komponentit:

- (a) Do të ndërpresë, pezullojë ose eliminojë interesin ose marrëdhënien që krijoi shkeljen dhe do të trajtojë pasojat e shkeljes;
- (b) Do të vlerësojë rëndësinë e shkeljes dhe ndikimin e saj në objektivitetin dhe aftësinë e firmës së audituesit të komponentit për të kryer punën e auditimit për qëllime të auditimit të grupit;
- (c) Në varësi të rëndësisë së shkeljes, do të përcaktojë nëse është e mundur të ndërmerren veprime që trajtojnë në mënyrë të kënaqshme pasojat e shkeljes dhe, nëse një veprim i tillë mund të ndërmerret dhe është i përshtatshëm në rrethanat;
- (d) Do të komunikojë menjëherë me shkrim shkeljen tek partneri i angazhimit të grupit, duke përfshirë vlerësimin e firmës së audituesit të komponentit mbi rëndësinë e shkeljes dhe çdo veprim të propozuar ose të ndërmarrë për të trajtuar pasojat e shkeljes.

405.23 A1 Paragrafët 400.80 A2 dhe A3 përmbajnë materialin për zbatim që ka të bëjë me vlerësimin e firmës së audituesit të komponentit për rëndësinë dhe ndikimin e shkeljes në objektivitetin dhe aftësinë e firmës së audituesit të komponentit për të lëshuar një opinion apo përfundim mbi punën e auditimit të kryer në komponent për qëllime të auditimit të grupit dhe vlerësimin e saj për ndonjë veprim që mund të ndërmerret për të trajtuar në mënyrë të kënaqshme pasojat e shkeljes.

K405.24 Me marrjen e komunikimit të shkeljes nga firma e audituesit të

komponentit, partneri i angazhimit të grupit duhet:

- (a) Të rishikojë vlerësimin e firmës së audituesit të komponentit mbi rëndësinë e shkeljes dhe ndikimin e saj në objektivitetin e firmës së audituesit të komponentit dhe çdo veprim që mund të jetë ose është ndërmarrë për të trajtuar pasojat e shkeljes;
- (b) Të vlerësojë aftësinë e firmës së audituesit të grupit për të përdorur punën e firmës së audituesit të komponentit për qëllime të auditimit të grupit;
- (c) Të përcaktojë nevojën për ndonjë veprim të mëtejshëm.

K 405.25 Për aplikimin e paragrafit R405.24, partneri i angazhimit të grupit duhet të ushtrojë gjykimin profesional dhe të marrë parasysh nëse një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar do të kishte gjasa të arrinte në përfundimin se objektiviteti i firmës së audituesit të komponentit është kompromentuar, dhe për këtë arsye, firma e audituesit të grupit nuk është në gjendje të përdorë punën e firmës së audituesit të komponentit për qëllime të auditimit të grupit.

405.25 A1 Nëse partneri i angazhimit të grupit vlerëson se firma e audituesit të komponentit i ka trajtuar pasojat e shkeljes në mënyrë të kënaqshme, dhe nuk kompromentohet objektiviteti i firmës së audituesit të komponentit, firma e audituesit të grupit mund të vazhdojë të përdorë punën e firmës së audituesit të komponentit për auditimin e grupit. Në disa rrethana, partneri i angazhimit të grupit mund të përcaktojë se duhen kryer veprime të tjera për të trajtuar shkeljen në mënyrë të kënaqshme, me qëllim që të përdoret puna e firmës së audituesit të komponentit. Shembuj të këtij veprimi janë përfshirja e firmës së audituesit të grupit në kryerjen e procedurave specifike mbi fushat e ndikuara nga shkelja ose kërkesa që firma e audituesit të komponentit të kryejë punën e duhur të korrigjimit në zonat e prekura.

405.25 A2 SNA 600 (i rishikuar) përcakton se, nëse ka pasur një shkelje nga një auditues i komponentit dhe shkelja nuk është trajtuar në mënyrë të kënaqshme, audituesi i grupit nuk mund të përdorë punën e atij audituesi të komponentit. Në këto rrethana, partneri i angazhimit të grupit mund të gjejë mjete të tjera për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit mbi informacionin financiar të klientit të auditimit komponent. Shembuj të veprimeve janë përfshirja e firmës së audituesit të grupit në kryerjen e punës së nevojshme të auditimit mbi informacionin financiar të klientit të auditimit komponent, ose kërkesa që një firmë tjetër e audituesit të komponentit të kryejë këtë punë auditimi.

Diskutime me personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit të auditimit Grup

405.26 A1 Në lidhje me shkeljet e një firme të audituesit të komponentit brenda rrjetit të firmës së audituesit të grupit, zbatohet paragrafi R400.84.

K405.27 Në lidhje me shkeljet e një firme të audituesit të komponentit, e cila është jashtë rrjetit të firmës së audituesit të grupit, firma e audituesit të grupit diskuton me personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit të auditimit grup:

- (a) Vlerësimin e firmës së audituesit të komponentit mbi rëndësinë dhe ndikimin e shkeljes në objektivitetin e firmës së audituesit të komponentit, përfshirë natyrën dhe kohëzgjatjen e shkeljes, dhe veprimin që mund të jetë ose është ndërmarrë;
- (b) Nëse:
 - (i) Veprimi do të trajtojë ose ka trajtuar pasojat e shkeljes në mënyrë të kënaqshme;
 - (ii) Firma e audituesit të grupit do të përdorë mjete të tjera për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit mbi informacionin financiar të klientit të auditimit komponent.

Ky diskutim do të bëhet sa më parë të jetë e mundur, përveç nëse nga personat e ngarkuar me qeverisjen është përcaktuar në mënyrë specifike një afat për raportimin e shkeljeve më pak të rëndësishme.

K405.28 Firma e audituesit të grupit do të komunikojë me shkrim tek personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit të auditimit grup të gjithë çështjet e diskutuara në përputhje me paragrafin R405.27 dhe të marrë pëlqimin e personave të ngarkuar me qeverisjen se është ose mund të jetë ndërmarrë veprimi për të trajtuar pasojat e shkeljes në mënyrë të kënaqshme.

K405.29 Nëse personat e ngarkuar me qeverisjen nuk kanë të njëjtin mendim se veprimi që mund të jetë ose i ndërmarrë do të kishte trajtuar në mënyrë të kënaqshme pasojat e shkeljes në firmën e audituesit të komponentit, firma e audituesit të grupit nuk do të përdorë punën e kryer nga firma e audituesit të komponentit për qëllime të auditimit të grupit.

SEKSIONI 410

HONORARET (TARIFAT E PAGESËS)

Hyrje

- 410.1** Firmave u kërkohet të respektojnë parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të përshkruar në seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 410.2** Seksioni 330 përshkruan materialin për zbatim që lidhet me aplikimin e kuadrit konceptual ku niveli dhe natyra e honorarëve dhe marrëveshjeve të tjera të shpërblimit, mund të krijojnë një kërcënim të interesit vetjak për pajtueshmërinë me një ose më shumë nga parimet themelore. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin për zbatim që lidhet me aplikimin e kuadrit konceptual për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar kërcënimet ndaj pavarësisë, që rrjedhin nga honorarët e faturuara për klientët e auditimit.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 410.3 A1** Tarifat për shërbimet profesionale zakonisht negocohen dhe paguhen nga një klient auditimi dhe mund të krijojnë kërcënime për pavarësinë. Kjo praktikë përgjithësisht njihet dhe pranohet nga përdoruesit e synuar të pasqyrave financiare.
- 410.3 A2** Kur klienti i auditimit është një njësi ekonomike me interes publik, palët e interesuara kanë më shumë pritshmëri në lidhje me pavarësinë e firmës. Duke qenë se transparenca mund të shërbejë për të informuar më mirë pikëpamjet dhe vendimet e atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe një gamë të gjerë palësh të interesuara, ky seksion parashikon paraqitjen e informacionit të lidhur me tarifatat si për ata që janë të ngarkuar me qeverisjen ashtu edhe për palët e interesuara në përgjithësi në lidhje me klientët e auditimit që janë entitete me interes publik.
- 410.3 A3** Për qëllimet e këtij seksioni, tarifatat e auditimit përfshijnë tarifatat ose lloje të tjera shpërblimi për një auditim ose rishikim të pasqyrave financiare. Kur flitet për tarifa për auditimin e pasqyrave financiare, ato nuk përfshijnë tarifatat për një auditim të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta ose një rishikim të pasqyrave financiare. (Ref: Para.R410.23(a), 410.25 A1 dhe R410.31(a)).

Honoraret (tarifat) e paguara nga një klient auditimi

- 410.4 A1 Kur tarifat negociohen dhe paguhen nga një klient auditimi, kjo krijon një kërcënim të interesit vetjak dhe mund të krijojë një kërcënim frikësimi për pavarësinë.
- 410.4 A2 Zbatimi i kuadrit konceptual kërkon që përpara se një firmë ose firmë rrjeti të pranojë një auditim ose ndonjë angazhim tjetër për një klient auditimi, firma të përcaktojë nëse kërcënimet ndaj pavarësisë, të krijuara nga tarifat e propozuara për klientin janë në një nivel të pranueshëm. Zbatimi i kuadrit konceptual kërkon gjithashtu që firma të rivlerësojë kërcënime të tilla kur faktet dhe rrethanat ndryshojnë gjatë periudhës së angazhimit për auditimin.
- 410.4 A3 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimeve të krijuara kur tarifat për një auditim ose ndonjë angazhim tjetër paguhen nga klienti i auditimit përfshijnë:
- Nivelin e tarifave dhe shkallen në të cilën ato kanë parasysh burimet e kërkuara, duke marrë parasysh prioritetet tregtare dhe të tregut të firmës.
 - Çdo lidhje ndërmjet tarifave për auditimin dhe atyre për shërbimet të tjera përveç auditimit dhe madhësisë relative të të dy elementeve.
 - Shtrirjen e çdo varësie ndërmjet nivelit të tarifës dhe rezultatit të shërbimit.
 - Faktin nëse tarifa është për shërbimet që do të ofrohen nga firma ose njëfirmë rrjeti.
 - Nivelin e tarifës në kuadër të shërbimit që do të ofrohet nga firma ose një firmë rrjeti.
 - Strukturën operative dhe angazhimet e kompensimit të firmës dhe firmës së rrjetit.
 - Rëndësinë e klientit, ose të një pale të tretë që i referon klientit, firmës, firmës së rrjetit, partnerit ose zyrës.
 - Natyrën e klientit, për shembull, nëse klienti është një entitet me interes publik.
 - Marrëdhënien e klientit me entitetet e ndërlidhura të cilave u ofrohen shërbime të tjera përveç auditimit, për shembull kur njësia ekonomike e lidhur është një entitet motër.
 - Përfshirjen e personave të ngarkuar me qeverisjen në emërimin e audituesit dhe marrëveshjen për tarifat, dhe theksi që ata dhe drejtuesit e klientit i vendosin cilësisë së auditimit dhe nivelit të përgjithshëm të tarifave.
 - Faktin nëse niveli i tarifës përcaktohet nga një palë e tretë e pavarur, sip.sh. një organ rregullator.

- Faktin nëse cilësia e punës audituese të firmës i nënshtrohet rishikimit nga një pale e tretë e pavarur, siç është një organ mbikëqyrës.

410.4 A4 Kushtet, politikat dhe procedurat e përshkruara në paragrafin 120.15 A3 (veçanërisht ekzistenca e një sistemi të menaxhimit të cilësisë të krijuar dhe zbatuar nga firma në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë të publikuara nga IAASB) mund të ndikojnë gjithashtu, në vlerësimin nëse kërcënimet ndaj pavarësisë janë në një nivel të pranueshëm

410.4 A5 Kërkesat dhe materiali për zbatim që pasojnë, identifikojnë rrethanat që mund të kenë nevojë të vlerësohen më tej, kur të përcaktohet nëse kërcënimet janë në një nivel të pranueshëm. Për ato rrethana, materiali për zbatim përfshin shembuj të faktorëve shtesë, të cilët mund të jenë të rëndësishëm në vlerësimin e kërcënimeve.

Niveli i tarifave (honorareve) të auditimit

410.5 A1 Përcaktimi i tarifave që duhet t'i ngarkohen një klienti auditimi, qoftë për auditim apo shërbime të tjera, është një vendim biznesi i firmës duke marrë parasysh faktet dhe rrethanat që lidhen me atë angazhim specifik, si edhe kërkesat e standardeve teknike dhe profesionale.

410.5 A2 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të interesit vetjak dhe kërcënimeve të frikësimit të krijuara nga niveli i tarifës së auditimit të paguar nga klienti i auditimit përfshijnë:

- Arsyetimin tregtar të firmës për tarifën e auditimit.
- Faktin nëse është ushtruar apo po ushtrohet presion i panevojshëm nga klienti për të ulur tarifën e auditimit.

410.5 A3 Shembuj të veprimeve që mund të përbëjnë masa mbrojtëse për të adresuar kërcënime të tilla përfshijnë:

- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk merr pjesë në angazhimin e auditimit, për të vlerësuar arsyeshmërinë e tarifës së propozuar, duke patur parasysh qëllimin dhe kompleksitetin e angazhimit.
- Përfshirjen e një rishikuesi të përshtatshëm për të rishikuar punën e kryer dhe i cili nuk ka marrë pjesë në angazhimin e auditimit.

Ndikimi i shërbimeve të tjera që i ofrohen një klienti auditimi

K410.16 Në varësi të paragrafit R410.7, një firmë nuk do të lejojë që tarifa e

auditimit të ndikohet nga ofrimi, nga firma ose një firmë rrjeti, i shërbimeve të tjera përveç auditimit për një klient auditimi.

410.16 A1 Tarifa e auditimit zakonisht pasqyron një kombinim çështjesh, të tilla si ato të identifikuar në paragrafin 410.23A1. Megjithatë, ofrimi i shërbimeve të tjera për një klient auditimi nuk është një arsye e duhur në përcaktimin e tarifës së auditimit.

K410.7 Si përjashtim nga paragrafi K410.6, gjatë përcaktimit të tarifës së auditimit, firma mund të marrë në konsideratë kursimin e arritur si rezultat i përvojës që rrjedh nga ofrimi i shërbimeve të ndryshme nga auditimi për një klient auditimi.

Honoraret (Tarifat) e kushtëzuara

410.8 A1 Tarifat e kushtëzuara janë tarifa të llogaritura mbi një bazë të paracaktuar në lidhje me rezultatin e një transaksioni ose rezultatin e shërbimeve të kryera. Një tarifë e kushtëzuar e ngarkuar përmes një ndërmjetësi është një shembull i një tarife të kushtëzuar tërthorazi. Në këtë seksion, një tarifë nuk konsiderohet si e kushtëzuar nëse përcaktohet nga një gjykatë ose një autoritet tjetër publik.

K410.9 Një firmë nuk duhet të ngarkojë drejtpërdrejt ose tërthorazi një tarifë të kushtëzuar për një angazhim auditimi.

K410.10 Një firmë ose firmë rrjeti nuk do të ngarkojë drejtpërdrejt ose tërthorazi një tarifë të kushtëzuar për një shërbim jo-sigurie të ofruar për një klient auditimi, nëse:

- (a) Tarifa ngarkohet nga firma që shpreh opinion për pasqyrat financiare dhe tarifa është materiale ose pritët të jetë materiale për atë firmë;
- (b) Tarifa ngarkohet nga një firmë rrjeti që merr pjesë të konsiderueshme të auditimit dhe tarifa është materiale ose pritët të jetë materiale për atë firmë; ose
- (c) Rezultati i shërbimit të jo-sigurisë, dhe për rrjedhojë shuma e tarifës, varet nga një gjykim i ardhshëm ose aktual në lidhje me auditimin e një shume materiale në pasqyrat financiare.

410.10 A1 Paragrafët R410.9 dhe R410.10 përjashtojnë një firmë ose një firmë rrjeti të hyjë në marrëveshje të caktuara tarifash të kushtëzuara me një klient auditimi. Edhe nëse një marrëveshje për tarifat e kushtëzuara nuk përjashtohet kur ofrohet një shërbim jo-sigurie për një klient auditimi, ai mund të ndikojë sërish në nivelin e kërcënimit të interesit vetjak.

410.10 A2 Faktorët që janë të rëndësishëm në vlerësimin e nivelit të një kërcënimitë tillë përfshijnë

- Gamen e shumave të mundshme të tarifave.
- Faktin nëse një autoritet i duhur përcakton rezultatin nga i cili varet tarifa e kushtëzuar.
- Dhënien e informacioneve për përdoruesit e synuar të punës së kryer nga firma dhe bazën e shpërblimit.
- Natyrën e shërbimit.
- Efektin e ngjarjes ose transaksionit në pasqyrat financiare.

410.10 A3 Shembuj veprimesh që mund të përbëjnë masa mbrojtëse për të trajtuar një kërcënim të tillë të interesit vetjak përfshijnë:

- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk ka qenë i përfshirë në dhënien e shërbimit të jo-sigurisë, për të rishikuar punën e kryer.
- Bërjen e një marrëveshjeje paraprake me shkrim me klientin për bazën e llogaritjes së shpërblimit.

Honoraret (Tarifat) gjithsej – Përqindja e tarifave për shërbime të tjera përveç auditimit dhe tarifës së auditimit

410.11 A1 Niveli i kërcënimit të interesit vetjak mund të ndikohet kur një pjesë e madhe e tarifave të aplikuara nga firma ose firmat e rrjetit për një klient auditimi vlerësohen duke ofruar për klientin, shërbime të ndryshme nga auditimi, për shkak të shqetësimeve për humbjen e mundshme të angazhimit të auditimit ose shërbimeve të tjera. Rrethana të tilla mund të krijojnë gjithashtu një kërcënim frikësimi. Një konsideratë e mëtejshme është një perceptim që firma ose firma e rrjetit do të fokusohet në marrëdhënien jo audituese, e cila mund të krijojë një kërcënim për pavarësinë e audituesit.

410.11 A2 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve përfshijnë:

- Raportin e tarifave për shërbime të tjera përveç auditimit, me tarifën e auditimit
- Kohëzgjatjen, gjatë së cilës ka ekzistuar një pjesë e madhe e tarifave për shërbime të ndryshme nga auditimi, ndaj tarifës së auditimit
- Natyrën, qëllimin dhe qëllimet e shërbimeve të ndryshme nga auditimi, duke përfshirë:
 - Nëse janë shërbime të përsëritura.
 - Nëse ligji apo rregulli i detyron shërbimet të jenë kryer nga

firma.

- 410.11 A3 Shembuj veprimesh që mund të përbëjnë masa mbrojtëse për të trajtuar këto kërcënime të interesit vetjak ose frikësimit përfshijnë:
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk është i përfshirë në auditim ose në shërbimin tjetër të jo-auditimit, me qëllim rishikimin e punës së auditimit.
 - Reduktimin e nivelit të shërbimeve të ndryshme nga auditimi, të dhëna për klientin e auditimit.

Honoraret (Tarifat) gjithsej – Tarifat e prapambetura

- 410.12 A1 Gjatë periudhës së angazhimit të auditimit niveli i kërcënimit të interesit vetjak mund të ndikohet nëse tarifat e pagueshme nga një klient auditimi për auditimin ose shërbimet e tjera përveç auditimit, mbeten të pashlyera përtej afateve të pagesës.
- 410.12 A2 Në përgjithësi pritet që firma të marrë pagesën e tarifave të tilla përpara se të lëshojë raportin e auditimit.
- 410.12 A3 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë të interesit vetjak përfshijnë:
- Rëndësinë e tarifave të pashlyera për firmën.
 - Kohëzgjatjen gjatë së cilës tarifat janë të pashlyera ose në vonesë.
 - Vlerësimin nga firma të aftësive dhe vullnetit të klientit të auditimit për të paguar tarifat e vonuara.
- 410.12 A4 Shembuj të veprimeve që mund të përbëjnë masa mbrojtëse për të adresuar një kërcënim të tillë përfshijnë:
- Marrjen e pagesës së pjesshme të tarifave në vonesë.
 - Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk ka marrë pjesë në angazhimin e auditimit, për të rishikuar punën audituese.
- K410.13 Kur një pjesë e konsiderueshme e tarifave që duhet të paguhet nga një klient auditimi mbeten të papaguara për një kohë të gjatë, firma duhet të vlerësojë:
- (a) Nëse tarifat me vonesë pagese mund të jenë ekuivalente me një kredi për klientin, rast në të cilin janë të zbatueshme kërkesat dhe materiali për zbatim të përshkruara në seksionin 511; dhe
 - (b) Nëse është e përshtatshme që firma të riemërohet ose vazhdojë

angazhimin e auditimit.

Honoraret (Tarifat) gjithsej – Varësia nga honorarët (tarifat)

Të gjithë klientët e auditimit

- 410.14 A1 Kur për firmën që shpreh opinionin, tarifat totale të gjeneruara nga një klient auditimi, përfaqësojnë një pjesë të madhe të tarifave totale të asaj firme, varësia dhe shqetësimi për humbjen e mundshme të tarifave nga auditimi dhe shërbime të tjera prej këtij klienti, ndikojnë në nivelin e kërcënimit të interesit vetjak dhe krijojnë një kërcënim frikësimi.
- 410.14 A2 Në llogaritjen e tarifave totale të firmës, firma mund të përdorë informacionin financiar të disponueshëm nga viti financiar i mëparshëm dhe të vlerësojë shumën e tarifës bazuar në atë informacion nëse është e përshtatshme.
- 410.14 A3 Faktorët që janë të rëndësishëm në vlerësimin e nivelit të kërcënimeve të tilla të interesit vetjak dhe frikësimit përfshijnë:
- Strukturën operative e firmës.
 - Faktin nëse firma pritet të krijojë një portofol klientësh në mënyrë të tillë që të zvogëlojë ndonjë element varësie nga klienti i auditimit.
- 410.14 A4 Shembuj të veprimeve që mund të përbëjnë masa mbrojtëse për të adresuar kërcënime të tilla përfshijnë:
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm që nuk është anëtar i firmës për rishikimin e punës së auditimit.
 - Reduktimin e fushës së shërbimeve të ndryshme, të dhëna klientit të auditimit përveç auditimit.
 - Rritjen e bazës së klientëve të firmës për të reduktuar varësinë nga klienti.
 - Rritjen e shtrirjes së shërbimeve të ofruara për klientët e tjerë.
- 410.14 A5 Një kërcënim interesi vetjak ose kërcënim krijohet kur tarifat e gjeneruara nga një firmë prej një klienti auditimi përfaqësojnë një pjesë të madhe të të ardhurave të një ortaku ose një zyre të firmës.
- 410.14 A6 Faktorët që janë të rëndësishëm në vlerësimin e nivelit të kërcënimeve të tilla përfshijnë:
- Rëndësinë cilësore dhe sasiore e klientit të auditimit për ortakun ose zyrën.

- Shkallën në të cilën kompensimi i ortakut, ose i ortakëve në zyrë, varet nga tarifat e gjeneruara nga klienti.

410.14 A7 Shembuj të veprimeve që mund të përbëjnë masa mbrojtëse për të adresuar kërcënime të tilla të interesit vetjak ose frikësimit përfshijnë:

- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm i cili nuk ka qenë i përfshirë në angazhimin e auditimit për rishikimin e punës audituese.
- Garantimin që kompensimi i ortakut të mos ndikohet ndjeshëm nga tarifat e gjeneruara nga klienti.
- Reduktimin e fushës së shërbimeve të tjera përveç auditimit të ofruara nga ortakut ose zyra për klientin e auditimit.
- Rritjen e bazës së klientëve të ortakut ose zyrës për të reduktuar varësinë nga klienti.
- Rritjen e shtrirjes së shërbimeve të ofruara nga ortakut ose zyra për klientët e tjerë.

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

K410.15 Kur për secilin prej pesë viteve të njëpasnjëshme tarifat totale nga një klient auditimi, që nuk është një entitet me interes publik përfaqësojnë, ose ka të ngjarë të përfaqësojnë, më shumë se 30% të tarifave totale të marra nga firma, firma do të përcaktojë nëse një nga veprimet në vijim mund të përbëjë masë mbrojtjeje për të reduktuar kërcënimet e krijuara, në një nivel të pranueshëm, dhe nëse po, të zbatojë këtë masë:

- (a) Para se të jepet opinionin e auditimit për vitin e pestë mbi pasqyrat financiare, të ketë një profesionist kontabël, i cili nuk është anëtar i firmës që shpreh opinionin për pasqyrat financiare, që të rishikojë punën e auditimit të vitit të pestë; ose
- (b) Pasi të jetë lëshuar opinionin e auditimit për pasqyrat financiare të vitit të pestë dhe përpara se të jepet opinionin e auditimit për pasqyrat financiare të vitit të gjashtë, të angazhohet një profesionist kontabël, i cili nuk është anëtar i firmës që shpreh opinionin mbi pasqyrat financiare, ose i një organi profesional, për rishikimin e punës së auditimit të vitit të pestë..

K410.16 Nëse tarifat totale të përshkruara në paragrafin K410.15 vazhdojnë të kalojnë 30%, firma do të përcaktojë çdo vit nëse ndonjë nga veprimet në paragrafin K410.15, të aplikuar për angazhimin e vitit përkatës mund të përbëjë një masë mbrojtjeje për të adresuar kërcënimet e krijuara nga totali i tarifave të marra prej firmës nga klienti, dhe nëse po, ta zbatojë atë masë.

- K410.17 Kur dy ose më shumë firma janë të angazhuara për të kryer një auditim të pasqyrave financiare të klientit, përfshirja e firmës tjetër në auditim mund të konsiderohet çdo vit si një veprim i barabartë me atë në paragrafin K410.15 (a), nëse:
- (a) Rrethanat e trajtuara nga paragrafi K410.15 zbatohen për vetëm njërin nga firmat që shpreh opinionin e auditimit; dhe
 - (b) Çdo firmë kryen punë të mjaftueshme për të marrë një përgjegjësi të plotë individuale për opinionin e auditimit.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

- K410.18 Kur për secilin nga dy vitet e njëpasnjëshme tarifat totale nga një klient auditimi që është entitet me interes publik përfaqësojnë, ose ka të ngjarë të përfaqësojnë, më shumë se 15% të tarifave totale të marra nga firma, firma do të përcaktojë nëse, përpara se opinionin e auditimit që lëshohet për pasqyrat financiare të vitit të dytë, një rishikim, në përputhje me objektivin e një rishikimi të cilësisë së angazhimit, i kryer nga një profesionist kontabël i cili nuk është anëtar i firmës që shpreh opinionin për pasqyrat financiare (“rishikim para publikimit”) mund të përbëjë një masë mbrojtjeje për të reduktuar kërcënimet në një nivel të pranueshëm, dhe nëse po, ta zbatojë atë masë

- K410.19 Kur dy ose më shumë firma janë të angazhuara për të kryer një auditim të pasqyrave financiare të klientit, përfshirja e firmës tjetër në auditim mund të konsiderohet çdo vit si një veprim, në koherencë me atë në paragrafin K410.18, nëse:
- (a) Rrethanat e trajtuara nga paragrafi K410.18 zbatohen për vetëm njërin nga firmat që shpreh opinionin e auditimit; dhe
 - (b) Çdo firmë kryen punë të mjaftueshme për të marrë një përgjegjësi të plotë individuale për opinionin e auditimit.

- K410.20 Në varësi të paragrafit K410.21, nëse rrethanat e përshkruara në paragrafin K410.18 vazhdojnë për pesë vite radhazi, firma do të ndërpresë angazhimin si auditues pasi të jetë lëshuar opinionin e auditimit për vitin e pestë.

- K410.21 Si përjashtim nga paragrafi K410.20, firma mund të vazhdojë të jetë e angazhuar si audituese pas pesë vitesh radhazi nëse ka një arsye bindëse për ta bërë këtë duke pasur parasysh interesin publik, me kusht që:
- (a) Firma të konsultohet me një organ rregullator ose profesional në juridiksionin përkatës dhe të marrë miratimin se vazhdimi i firmës si auditues do të ishte në interesin publik; dhe

- (b) Përpara se të publikohet opinioni i auditimit për pasqyrat financiare të vitit të gjashtë dhe të çdo viti pasardhës, firma angazhon një profesionist kontabël, i cili nuk është anëtar i firmës që shpreh opinionin mbi pasqyrat financiare, për të kryer një rishikim paraprak.

410.21 A1 Një faktor që mund të krijojë një arsye bindëse është mungesa e firmave alternative të qëndrueshme për të kryer angazhimin e auditimit, duke pasur parasysh natyrën dhe vendndodhjen e biznesit të klientit.

Transparenca e informacionit në lidhje me tarifat për klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

Komunikimi rreth informacionit të lidhur me tarifat me personat e ngarkuar me qeverisjen

410.22 A1 Komunikimi nga firma i informacionit të lidhur me tarifat (si për auditimin ashtu edhe për shërbimet e tjera përveç auditimit) me personat e ngarkuar me qeverisjen ndihmon në vlerësimin e tyre në lidhje me pavarësinë e firmës. Komunikimi efektiv në këtë drejtim lejon gjithashtu një shkëmbim të hapur të dyanshëm të pikëpamjeve dhe informacionit, për shembull, pritshmëritë që mund të kenë personat e ngarkuar me qeverisjen në lidhje me qëllimin dhe shtrirjen e punës së auditimit dhe ndikimin në tarifën e auditimit.

Honoraret (Tarifat) për Auditimin e Pasqyrave Financiare

K410.23 Në varësi të paragrafit R410.24, firma do të komunikojë në kohën e duhur me personat e ngarkuar me qeverisjen e një klienti auditimi që është një njësi ekonomike me interes publik:

- (a) Tarifat e paguara ose që i paguhen firmës ose firmave të rjetit për auditimin e pasqyrave financiare për të cilat firma shpreh një opinion; dhe
- (b) Nëse kërcënimet e krijuara nga niveli i këtyre tarifave janë në një nivel të pranueshëm, dhe nëse jo, ndonjë veprim që firma ka ndërmarrë ose propozon të ndërmarrë për të reduktuar kërcënimet e tilla në një nivel të pranueshëm.

410.23 A1 Objektivi i këtij komunikimi është të sigurojë sfondin dhe kontekstin e tarifave për auditimin e pasqyrave financiare mbi të cilat firma shpreh një opinion, për t'u mundësuar atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen të marrin në konsideratë pavarësinë e firmës. Natyra dhe shtrirja e çështjeve që do të komunikohen do të varen nga faktet dhe rrethanat dhe mund të përfshijnë për shembull:

- Rrethana që ndikojnë në nivelin e tarifave të tilla si:
 - Shkalla, kompleksiteti dhe shtrirja gjeografike e operacioneve të klientit të auditimit.
 - Koha e shpenzuar ose që pritët të shpenzohet nëpërpjesëtim me qëllimin dhe kompleksitetin e auditimit.
 - Kostoja e burimeve të tjera të përdorura ose të shpenzuara në kryerjen e auditimit.
 - Cilësia e mbajtjes së të dhënave dhe proceseve financiare për përgatitjen e deklaratave.
 - Cilësia e mbajtjes së të dhënave dhe proceseve në përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Rregullimet e tarifave të propozuara ose të zbatuara gjatë periudhës së auditimit, dhe arsyet për çdo rregullim të tillë.
- Ndryshimet në ligje dhe rregullore dhe/ose standarde profesionale të rëndësishme për auditimin që kanë ndikuar në ndryshimin e tarifave.

410.23 A2 Firma inkurajohet që të japë një informacion të tillë sa më shpejt të jetë e mundur dhe sipas rastit, komunikon rregullimet e propozuara.

K410.24 Si përjashtim nga paragrafi K410.23, firma mund të vendosë që të mos komunikojë informacionin e përcaktuar në paragrafin K410.23 personave të ngarkuar me qeverisjen e një entiteti që është (drejtpërdrejt ose tërthorazi) në pronësi të plotë të një entiteti tjetër me interes publik, me kusht që:

- (a) Entiteti është konsoliduar në pasqyrat financiare të grupit përgatitur nga entiteti tjetër me interes publik; dhe
- (b) Firma ose një firmë rrjeti shpreh një opinion mbi pasqyrat financiare të grupit.

Honoraret (Tarifat) për shërbime të tjera

K410.25 Në varësi të paragrafit R410.27, firma do të komunikojë në kohën e duhur me personat e ngarkuar me qeverisjen e një klienti auditimi që është një entitet me interes publik në lidhje me:

- (a) Tarifat, të ndryshme nga ato të paraqitura në paragrafin K410.23 (a), të zbatuara ndaj klientit për ofrimin e shërbimeve nga firma ose një firmë rrjeti, gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare, për të cilat firma shpreh një opinion. Për këtë qëllim, këto tarifa do të përfshijnë vetëm tarifat e ngarkuara ndaj klientit dhe subjekteve të lidhura me të, mbi të cilat klienti ka kontroll direkt ose indirekt; në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara mbi të cilat firma do të shprehë një opinion; dhe;

- (b) Siç përcaktohet në paragrafin 410.11 A1, kur firma ka identifikuar se ka një ndikim në nivelin e kërcënimit të interesit vetjak ose se ekziston një kërcënim frikësimi ndaj pavarësisë, të krijuar nga përqindja e tarifave për shërbime të ndryshme nga auditimi, në lidhje me tarifën e auditimit:
- (i) Nëse kërcënime të tilla janë në një nivel të pranueshëm; dhe
 - (ii) Nëse jo, çdo veprim që firma ka ndërmarrë ose i propozon marrë për të reduktuar kërcënimet e tilla në një nivel të pranueshëm.

410.25 A1 Objektivi i një komunikimi të tillë është të sigurojë sfondin dhe kontekstin e tarifave për shërbime të tjera për t'u mundësuar personave të ngarkuar me qeverisjen të marrin në konsideratë pavarësinë e firmës. Natyra dhe shtrirja e çështjeve që do të komunikohen do të varen nga faktet dhe rrethanat dhe mund të përfshijnë për shembull:

- Shumen e tarifave për shërbime të tjera që kërkohen me ligj ose rregullore.
- Natyrën e shërbimeve të tjera të ofruara dhe tarifat e lidhura me to.
- Informacion mbi natyrën e shërbimeve të ofruara sipas një politike të përgjithshme të miratuar nga personat e ngarkuar me qeverisjen dhe tarifat përkatëse.
- Përqindjen e tarifave të përmendura në paragrafin K410.25(a) ndaj totalit të tarifave të ngarkuara nga firma dhe firmat e rrjetit për auditimin e pasqyrave financiare për të cilat firma shpreh një opinion.

K410.26 Firma do të përfshijë në komunikimin e kërkuar nga paragrafi K410.25(a) tarifat, të ndryshme nga ato të paraqitura në paragrafin K410.23(a), të aplikuar me çdo njësi tjetër të lidhur mbi të cilën klienti i auditimit ka kontroll të drejtpërdrejt ose të tërthortë për ofrimin e shërbimeve nga firma ose një firmë rrjeti, kur firma e di, ose ka arsye të besojë, se tarifat e tilla janë të rëndësishme për vlerësimin e pavarësisë së firmës.

410.26 A1 Faktorët që firma mund të marrë parasysh kur të përcaktojë nëse tarifat, të ndryshme nga ato të zbuluara sipas paragrafit K410.23(a), që u ngarkohen entiteteve të tjera të lidhura, individualisht dhe në total, për ofrimin e shërbimeve nga firma ose një firmë rrjeti, janë të përshtatshme për vlerësimin e pavarësisë së firmës, përfshijnë:

- Shkallen e përfshirjes së klientit të auditimit në emërimin e firmës ose firmës së rrjetit për dhënien e këtyre shërbimeve, duke përfshirë negocimin e tarifave.
- Rëndësinë e tarifave të paguara nga entitetet e tjera të lidhura me

firmën ose një firmë rrjeti.

- Përqindjen e tarifave nga entitetet e tjera të lidhura me tarifat e paguara nga klienti.

K410.27 Si përjashtim nga paragrafi R410.25, firma mund të vendosë që të mos komunikojë informacionin e përcaktuar në paragrafin K410.25 personave të ngarkuar me qeverisjen e një entiteti që është (drejtpërdrejt ose tërthorazi) në pronësi të plotë nga një entitet tjetër me interes publik, me kusht që:

- (a) Entiteti është konsoliduar në pasqyrat financiare të grupit përgatitur nga ai subjekt tjetër me interes publik; dhe
- (b) Firma ose një firmë rrjeti shpreh një opinion mbi ato pasqyra financiare të grupit.

Varësia nga honorari (tarifa)

410.28 Kur tarifat gjithsej nga një klient auditimi që është një entitet me interes publik përfaqësojnë, ose ka të ngjarë të përfaqësojnë, më shumë se 15% të tarifave gjithsej të marra nga firma, firma duhet të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen:

- (a) Këtë fakt dhe faktin nëse kjo situatë ka të ngjarë të vazhdojë;
- (b) Masat mbrojtëse të aplikuara për të adresuar kërcënimet e krijuara, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, përdorimin e një rishikimi para lëshimit të raportit (Ref: Paragrafi K410.18); dhe
- (c) Çdo propozim për të vazhduar si auditues sipas paragrafit K410.21

Zbulimi publik i informacionit të lidhur me tarifat

410.29 A1 Në funksion të interesit publik në auditimet e subjekteve me interes publik është e dobishme që palët e interesuara të kenë një pasqyrë të qartë në lidhje me marrëdhëniet profesionale midis firmës dhe klientit të auditimit, të cilat në mënyrë të arsyeshme mund të mendohet se janë të rëndësishme për vlerësimin e pavarësisë së firmës. Në një numër të gjerë juridiksionesh, ekzistojnë tashmë kërkesa në lidhje me deklarimin e tarifave nga një klient auditimi si për auditimin ashtu edhe për shërbime të ndryshme nga auditimi i paguar dhe i pagueshëm për firmën dhe firmat e rrjetit. Shpalosje të tilla shpesh kërkojnë ndarjen e tarifave për shërbime të tjera përveç auditimit në kategori të ndryshme.

K410.30 Nëse ligjet dhe rregulloret nuk kërkojnë që një klient auditimi të japë informacion për honorarët (tarifat) e auditimit, honorarët (tarifat) për

shërbime të ndryshme nga auditimi të paguara ose të pagueshme për firmën dhe firmat e rrjetit dhe informacionin në lidhje me varësinë nga honorarët (tarifat), firma do të diskutojë me personat e ngarkuar me qeverisjen e një klienti auditimi që është një entitet me interes publik:

- (a) Përfitimin për palët e interesuara të klientit që bën paraqitje të tilla, të cilat nuk kërkohen nga ligjet dhe rregulloret në një mënyrë që gjykohet e përshtatshme, duke marrë parasysh kohën dhe aksesin e informacionit; dhe
- (b) Informacionin që mund të përmirësojë të kuptuarit e përdoruesve për tarifat e paguara ose të pagueshme dhe ndikimin e tyre në pavarësinë e firmës.

410.30 A1 Shembuj informacioni në lidhje me tarifat që mund të përmirësojnë kuptimin e përdoruesve për tarifat e paguara ose të pagueshme dhe ndikimin e tyre në pavarësinë e firmës përfshijnë:

- Informacionin krahasues të tarifave të vitit të kaluar për auditim dhe shërbime të tjera përveç auditimit.
- Natyrën e shërbimeve dhe tarifat shoqëruese të tyre siç shpjegohet në paragrafin R410.31(b).
- Masat mbrojtëse të zbatuara, kur tarifat gjithsej nga klienti përfaqësojnë ose ka të ngjarë të përfaqësojnë më shumë se 15% të tarifave totale të marra nga firma.

K410.31 Pas diskutimit me personat e ngarkuar me qeverisjen, siç përcaktohet në paragrafin K410.30, në masën që klienti i auditimit, i cili është një entitet me interes publik nuk paraqet informacionet shpjeguese përkatëse, sipas paragrafit K410.32, firma duhet të shpjegoje publikisht:

- (a) Tarifat e paguara ose të pagueshme për firmën dhe firmat e rrjetit për auditimin e pasqyrave financiare për të cilat firma shpreh një opinion;
- (b) Tarifat, të ndryshme nga ato të shpjeguara në pikën (a), që i ngarkohen klientit për ofrimin e shërbimeve nga firma ose një firmë rrjeti gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare, për të cilat firma shpreh një opinion. Për këtë qëllim, këto tarifa do të përfshijnë vetëm tarifat që i ngarkohen klientit dhe subjekteve të lidhura me të mbi të cilat klienti ka kontroll të drejtpërdrejt ose të tërthortë të cilat janë të konsoliduara në pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion;
- (c) Çdo tarifë, përveç atyre të shpalosura në (a) dhe (b), të ngarkuar për çdo subjekt tjetër të lidhur, mbi të cilin klienti i auditimit ka kontroll të drejtpërdrejt ose të tërthortë për ofrimin e shërbimeve nga firma ose një firmë rrjeti kur firma e di, ose ka arsye të

besojë, se këto tarifa janë të rëndësishme për vlerësimin e pavarësisë së firmës; dhe

- (d) Nëse është rasti, faktin që tarifa gjithsej të marra nga firma prej klientit të auditimit përfaqëson, ose ka të ngjarë të përfaqësojnë, më shumë se 15% e totalit të tarifave të marra nga firma për dy vite radhazi, dhe vitin që u krijua për herë të parë kjo situatë.

410.31 A1 Firma mund të prezantojë gjithashtu, informacione të tjera në lidhje me tarifën, i cili do të përmirësojë kuptimin e përdoruesve për tarifën e paguar ose të pagueshme dhe pavarësinë e firmës, siç janë shembujt e përshkruar në paragrafin 410.30 A1.

430.31 A2 Faktorët që firma mund të mbaje parasysh kur bën përcaktimin të kërkuara nga paragrafi K410.31(c) janë përcaktuar në paragrafin 410.26 A1.

410.31 A3 Kur firma paraqet informacion lidhur me tarifën, në përputhje me paragrafin R410.31, firma mund të japë informacion në një mënyrë që konsiderohet e përshtatshme duke marrë parasysh kohën dhe aksesin në informacion të palëve të interesuara, për shembull:

- Në faqen e internetit të firmës.
- Në raportin e transparencës së firmës.
- Në një raport të cilësisë së auditimit.
- Nëpërmjet komunikimit të synuar me aktorë të veçantë, për shembull një letër drejtuar aksionarëve.
- Në raportin e audituesit.

K410.32 Si përjashtim nga paragrafi K410.31, firma mund të vendosë të mos paraqesë publikisht informacionin e përcaktuar në paragrafin K410.31 në lidhje me:

- (a) Një entitet mëmë që përgatit gjithashtu, pasqyrat financiare të grupit, me kusht që firma ose një firmë rrjeti të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare të grupit; ose
- (b) Një entitet (drejtpërdrejt ose tërthorazi) në pronësi të plotë nga një entitet tjetër me interes publik, me kusht që:
- (i) Entiteti është konsoliduar në pasqyrat financiare të grupit përgatitur nga entiteti tjetër me interes publik;
 - (ii) Firma ose një firmë rrjeti shpreh një opinion mbi këto pasqyra financiare të grupit.

Kërkesat mbi klientët e rishikimit

K410.33 Ky seksion përcakton kërkesat për një firmë për të komunikuar

informacionin e lidhur me tarifën e një klienti auditimi që është një njësi ekonomike me interes publik dhe për të shpalosur publikisht informacionin e lidhur me tarifat në masën që klienti nuk e zbulon këtë informacion. Si një përjashtim nga këto kërkesa, firma mund të vendosë të mos komunikojë ose të bëjë publike një informacion të tillë kur një klient objekt rishikimi nuk është gjithashtu klient auditimi.

SEKSIONI 411

POLITIKAE E KOMPENSIMIT DHE VLERËSIMIT

Hyrje

- 411.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 411.2 Politikat e vlerësimit ose të kompensimit të një firme mund të krijojnë një kërcënim të egoizmit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhematerialin për zbatimin e kuadrit konceptual në të tilla rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 411.3 A1 Kur një anëtar i grupit të auditimit vlerësohet ose kompensohet për shitjen e shërbimeve të jo sigurisë për klientin e auditimit, niveli i kërcënimit të egoizmit do të varet nga:
- (a) Pjesa e kompensimit të individit apo e vlerësimit të performancës së tij, e bazuar në shitjen e këtyre shërbimeve;
 - (b) Roli i individit në grupin e auditimit, dhe
 - (c) Fakti nëse shitja e këtyre shërbimeve influencon vendimet për promovimin.
- 411.3 A2 Shembuj të veprimeve që mund të eliminojnë një kërcënim të tillë të egoizmit, përfshijnë:
- Rishikimin e planit të kompensimit ose të procesit të vlerësimit për këtë individ.
 - Largimin e këtij individi nga grupi i auditimit.
- 411.3 A3 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të egoizmit do të ishte angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për të rishikuar punën e anëtarit të grupit të auditimit.
- K411.4 Një firmë nuk do të vlerësojë ose shpërblejë një ortak kryesor të auditimit bazuar në suksesin e tij në shitjen e shërbimeve të jo

sigurisë për klientin e auditimit të ortakut. Kjo kërkesë nuk ndalon marrëveshjet normale të ndarjes fitimit midis ortakëve të një firme.

SEKSIONI 420

DHURATAT DHE MIKPRITJA

Hyrje

- 420.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 420.2 Pranimi i dhuratave dhe mikpritjes nga një klient auditimi mund të krijojë një kërcënim të egoizmit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin për zbatimin e kuadrit konceptual në të tilla rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

- K420.3 Një firmë, një firmë rrjet ose një anëtar i grupit të auditimit nuk do të pranojë dhurata apo mikpritje, përveç nëse vlera e tyre është e vogël dhe krejt e parëndësishme.
- 420.3 A1 Kur një firmë, një firmë rrjet ose anëtar i grupit të auditimit, ofron ose pranon një nxitje për ose nga një klient i auditimit, do të zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatimin i dhënë në Seksionin 340 dhe papajtueshmëria me këto kërkesa mund të krijojë kërcënime ndaj pavarësisë.
- 420.3 A2 Kërkesat e dhëna në Seksionin 340 lidhur me ofrimin ose pranimin e nxitjeve nuk lejojnë që një firmë, firmë rrjet ose anëtar i grupit të auditimit, të pranojnë dhurata dhe mikpritje, kur qëllimi i tyre është të influencojnë në mënyrë të padrejtë sjelljen, madje edhe nëse vlera e tyre është e vogël dhe krejt e parëndësishme.

SEKSIONI 430

PADITË GJYQËSORE AKTUALE OSE TË KËRCËNUARA

Hyrje

- 430.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë
- 430.2 Kur ndodh, ose kur ka të ngjarë të ndodhë një padi gjyqësore me një klient të auditimit krijohen kërcënimet e egoizmit dhe të frikësimit. Ky seksion përcakton materialin përkatës specifik për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 430.3 A1 Marrëdhënia midis drejtimit të klientit dhe anëtarëve të grupit të auditimit duhet të jetë e karakterizuar nga një sinqeritet dhe informim i plotë në lidhje me të gjitha aspektet e operacioneve të biznesit të klientit. Padia gjyqësore aktuale apo e kërcënuar midis një klienti të auditimit dhe firmës, firmës rrjet, ose një anëtari të grupit të auditimit, mund të rezultojë në pozicione kundërshtuese. Këto pozicione kundërshtuese mund të kenë ndikim në vullnetin e drejtimit për të dhënë informacione shpjeguese të plota, dhe krijojnë kërcënimet e egoizmit dhe të frikësimit.
- 430.3 A2 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë, përfshijnë:
- Materialitetin e padisë gjyqësore.
 - Faktin nëse padia gjyqësore ka të bëjë me një angazhim të mëparshëm të auditimit.
- 430.3 A3 Në qoftë se padia gjyqësore përfshin një anëtar të grupit të auditimit, njëshembull i një veprimi që mund të eliminojë kërcënime të tilla të egoizmit dhe frikësimit, është largimi i këtij individi nga grupi i auditimit.
- 430.3 A4 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e kërcënimeve të tilla të egoizmit dhe frikësimit është

angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për të rishikuar punën e kryer

SEKSIONI 510

INTERESAT FINANCIARE

Hyrje

- 510.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 510.2 Mbajtja e një interesi financiar në një klient auditimi mund të krijojë një kërcënim të egoizmit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 510.3 A1 Një interes financiar mund të mbahet direkt ose indirekt përmes një ndërmjetësi (për shembull, një investim i përbashkët kolektiv, investim në pasuri të paluajtshme ose një trust). Përcaktimi nëse këto interesa financiare janë të drejtpërdrejta do të varet nga fakti nëse përfituesi ka kontroll mbi ndërmjetësin ose aftësi për të influencuar vendimet e tij të investimit. Nga ana tjetër, kur përfituesi i interesit financiar nuk ka kontroll mbi ndërmjetësin ose aftësi për të influencuar vendimet e tij të investimit, Kodi e përshkruan interesin financiar si një interes financiar indirekt (të tërthortë).
- 510.3 A2 Ky seksion përmban referenca ndaj “materialitetit” të një interesi financiar. Në përcaktimin nëse një interes i tillë është material për një individ, mund të merret parasysh vlera neto e kombinuar e individit dhe anëtarëve të drejtpërdrejtë të familjes së individit.
- 510.3 A3 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të vetë rishikimit të krijuar nga një interes financiar tek një klient auditimi, përfshijnë:
- Rolin e individit që ka interesa financiare.
 - Faktin nëse interesi financiar është i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë.
 - Materialitetin e interesit financiar.

Interesat financiare të mbajtura nga firma, një firmë rrjeti, anëtarët e grupit të auditimit dhe të tjerët

- K510.4 Subjekt i paragrafit K510.5, një interes financiar i drejtpërdrejtë ose një interes financiar material jo i drejtpërdrejtë tek një klient i auditimit nuk do të mbahet nga:
- (a) Firma ose një firmë rrjeti;
 - (b) Një anëtar i grupit të auditimit ose një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së tij;
 - (c) Çdo ortak tjetër në zyrën në të cilën një ortak i angazhimit punon në lidhje me angazhimin e auditimit, ose çdo anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së ortakut tjetër; ose
 - (d) Çdo ortak ose punonjës drejtimi që ofron shërbime jo auditimi për klientin e auditimit, përveç atyre, përfshirja e të cilëve është minimale, ose anëtarëve të drejtpërdrejtë të familjes së këtij individi.
- 510.4A1 Zyra në të cilën ortaku i angazhimit kryen punën në lidhje me angazhimin e auditimit nuk është domosdoshmërisht zyra në të cilën ortaku është emëruar. Prandaj, kur ortaku i angazhimit është i vendosur në një zyrë të ndryshme nga ajo e anëtarëve të tjerë të grupit të auditimit, për të përcaktuar se në cilën zyrë ortaku e kryen auditimin, duhet të përdoret gjykimi profesional.
- K510.5 Si një përjashtim nga paragrafi K510.4, një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes, i identifikuar në nën paragrafët K510.4(c) ose (d) mund të mbajë një interes financiar të drejtpërdrejtë ose një interes material jo të drejtpërdrejtë tek një klient auditimi, me kusht që:
- (a) Anëtari i familjes të ketë marrë interesin financiar për shkak të të drejtave të punësimit, për shembull, përmes skemave të pensionit ose pjesëmarrjes në opSION me aksione dhe, kur është e nevojshme, firma adreson kërcënimin e krijuar nga interesi financiar; dhe
 - (b) Anëtari i familjes shet ose heq dorë sa më shpejt të jetë e mundur nga interesi financiar, kur anëtari i familjes ka ose fiton të drejtën për ta bërë këtë, ose në rastin e një opsioni të aksioneve, të drejtën për të ushtruar opsionin.

Interesat financiare në një entitet që kontrollon një klient auditimi

- K510.6 Kur një entitet ka një interes kontrollues tek një klient auditimi dhe klienti është material për entitetin, as firma, as një firmë rrjeti, as një anëtar i grupit të auditimit dhe as një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes

së këtij individ i nuk duhet të ketë një interes financiar të drejtpërdrejtë ose interes material jo të drejtpërdrejtë në këtë entitet.

Interesat financiare të mbajtura si administrator i besuar

K510.7 Paragrafi K510.4 do të zbatohet gjithashtu për një interes financiar tek një klient auditimi, i mbajtur në një trust për të cilin firma, firma e rrjetit ose individ i vepron si administrator i besuar, përveç nëse:

- (a) Asnjëri nga sa më poshtë është një përfitues i trustit: administratori i besuar, anëtar i grupit të auditimit, ose ndonjë nga individët e drejtpërdrejtë të familjes, firma ose një firmë rrjet;
- (b) Interesi tek klienti i auditimit i mbajtur nga trusti nuk është material për trustin;
- (c) Trusti nuk është në gjendje të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi klientin e auditimit; dhe
- (d) Asnjë nga sa më poshtë nuk mund të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në ndonjë vendim investimi që përfshin një interes financiar tek klienti i auditimit: administratori i besuar, anëtar i grupit të auditimit dhe asnjë nga anëtarët e drejtpërdrejtë të familjes të atij individ, firmës ose një firme rrjeti.

Interesat financiare të përbashkëta me një klient të auditimit

- K510.8
- (a) Një firmë, firmë rrjet ose një anëtar i grupit të auditimit, ose një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së atij individ i nuk duhet të mbajë një interes financiar tek një entitet kur një klient i auditimit ka gjithashtu, një interes financiar në atë entitet, përveç nëse:
 - (i) Interesat financiare janë jo materiale për firmën, firmën e rrjetit, anëtarin e grupit të auditimit dhe anëtarin e drejtpërdrejtë të familjes së tij, si dhe për klientin e auditimit, kur kjo është e mundur; ose
 - (ii) Klienti i auditimit nuk mund të ushtrojë influencë të konsiderueshme mbi entitetin.
 - (b) Para se një individ, i cili ka një interes financiar, siç është përshkruar në paragrafin K510.8(a), të mund të bëhet anëtar i grupit të auditimit, individ i ose anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së tij ose do të:
 - (i) zgjidhë interesin; ose
 - (ii) zgjidhë një pjesë të interesit, të mjaftueshme, në mënyrë që interesi i mbetur të mos jetë më material.

Interesat financiare të marra në mënyrë të paqëllimshme

510.9 Nëse një firmë, një firmë rrjet, ose ortak apo një punonjës i firmës ose i firmës rrjet, ose një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së atij individ, përfiton një interes financiar të drejtpërdrejtë ose një interes financiar material jo të drejtpërdrejtë, në një klient të auditimit, për shembull, nëpërmjet një trashëgimie, dhurate apo si rezultat i një shkrirjeje, ose në rrethana të ngjashme dhe interesi, përndryshe sipas këtij seksioni, nuk do të ishte i lejuar të mbahej, atëherë:

- (a) Nëse interesi është marrë nga firma, ose një firmë rrjet, ose nga një anëtar i grupit të auditimit, ose një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së individit, interesi financiar duhet të zgjidhet menjëherë, ose në rastin kur interesi financiar është një interes material jo i drejtpërdrejtë ai duhet të zgjidhet deri në një nivel të mjaftueshëm, të atillë që interesi i mbetur të mos jetë më material; ose
- (b) (i) Nëse interesi është marrë nga një individ, i cili nuk është një anëtar i grupit të auditimit, ose nga një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së individit, interesi financiar do të zgjidhet sa më shpejt të jetë e mundur, ose në rastin kur interesi financiar është një interes material jo i drejtpërdrejtë ai duhet të zgjidhet deri në një nivel të mjaftueshëm, të atillë që interesi i mbetur të mos jetë më material; dhe
(ii) Në pritje të zgjidhjes së interesit financiar, kur kjo kërkohet, firma do të adresojë rrezikun e krijuar.

Interesat financiare – rrethana të tjera

Anëtar i drejtpërdrejtë i familjes

510.10 A1 Një kërcënim i egoizmit, familjaritetit ose frikësimit mund të krijohet kur një anëtar i grupit të auditimit, ose një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së këtij individ, ose firma, ose një firmë rrjet, ka një interes financiar në një entitet, kur një drejtor, një zyrtar ose pronar kontrolluesi klientit të auditimit, dihet gjithashtu, që ka një interes financiar në këtë entitet.

510.10 A2 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë, përfshijnë:

- Rolin e individit në grupin e auditimit.
- Faktin nëse pronësia e entitetit është e ngushtë apo e gjerë.
- Faktin nëse interesi i jep investitorit mundësinë për të kontrolluar ose për të influencuar ndjeshëm mbi entitetin.

- Materialitetin e interesit financiar

510.10 A3 Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë një kërcënim të tillë të egoizmit, familjaritetit ose frikësimit, do të ishte largimi, nga grupi i auditimit, i anëtarit të grupit të auditimit që ka interes financiar.

510.10 A4 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të egoizmit do të ishte angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për të rishikuar punën e anëtarit të grupit të auditimit.

Anëtar i afërt i familjes

510.10 A5 Një kërcënim i egoizmit mund të krijohet nëse një anëtar i grupit të auditimit di se një anëtar i afërt i familjes ka një interes financiar të drejtpërdrejtë ose një interes financiar jo të drejtpërdrejtë material në klientin e auditimit

510.10 A6 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë, përfshijnë:

- Natyrën e marrëdhënies midis anëtarit të grupit të auditimit dhe anëtarit të afërt të familjes.
- Faktin nëse interesi financiar është i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë.
- Materialitetin e interesit financiar për anëtarin e afërt të familjes.

510.10 A7 Shembuj të veprimeve që mund të eliminojnë një kërcënim të tillë të egoizmit përfshijnë:

- Zgjidhjen, sa më shpejt të jetë e mundur, e të gjithë interesave financiare nga anëtari i afërt i familjes, ose zgjidhja e pjesshme e një interesi financiar jo të drejtpërdrejtë, deri në nivelin që interesi i mbetur të mos jetë më material.
- Largimin e individit nga grupi i auditimit

510.10 A8 Një shembull veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për të adresuar një interes të tillë të egoizmit, është angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për të rishikuar punën e anëtarit të grupit të auditimit.

Individët e tjerë

510.10 A9 Një kërcënim i egoizmit mund të krijohet nëse një anëtar i grupit të auditimit është në dijeni se një interes financiar tek klienti i auditimit

mbahet nga individë të tillë, si:

- Ortakët dhe të punësuarit profesionalë të firmës ose firmës rrjet, përveç atyre që nuk u lejohet të mbajnë interesa të tillë financiare sipas paragrafit K510.4, apo anëtarëve të drejtpërdrejtë të familjes së tyre.
- Individët me një marrëdhënie të ngushtë personale me një anëtar të grupit të auditimit.

510.10 A10 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë, përfshijnë:

- Strukturën organizative, të shfrytëzimit dhe të raportimit të firmës.
- Natyrën e marrëdhënies midis individit dhe anëtarit të grupit të auditimit.

510.10 A11 Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë një kërcënim të tillë të egoizmit është largimi nga grupi i auditimit i anëtarit të grupit të auditimit me marrëdhënie personale.

510.10.A12 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të egoizmit, përfshijnë:

- Përfshirjen e anëtarit të grupit të auditimit nga çdo vendimmarrje e rëndësishme në lidhje me angazhimin e auditimit.
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm për të bërë rishikimin e punës së anëtarit të grupit të auditimit.

Plani i përfitimit të pensionit të një firme ose firmës rrjet

510.10 A13 Një kërcënim i egoizmit mund të krijohet nëse një plan i përfitimit të pensionit tek një firmë ose firmë rrjet ka një interes financiar të drejtpërdrejtë ose një interes jo të drejtpërdrejtë tek një klient i auditimit.

SEKSIONI 511

HUATË DHE GARANCITË

Hyrje

- 511.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 511.2 Një hua ose një garanci e një huaje me një klient të auditimit, mund të krijojë një kërcënim të egoizmit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin për zbatimin e kuadrit konceptual në të tilla rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 511.3 A1 Ky seksion përmban referenca ndaj “materialitetit” të një huaje ose garancie. Për të përcaktuar nëse një hua ose garanci e tillë është materiale për një individ, mund të merret parasysh vlera neto e kombinuar e individit dhe anëtarëve të drejtpërdrejtë të familjes së individit.

Huat dhe garancitë me një klient auditimi

- K511.4 Një firmë, një firmë rrjet, një anëtar i grupit të auditimit, ose ndonjëri nga anëtarët e drejtpërdrejtë të familjes së individit nuk do të japin ose garantojnë një hua për një klient të auditimit, përveç nëse huaja ose garancia nuk është materiale për:
- (a) Firmën, firmën rrjet ose, sipas rastit, për individin që jep huan ose garancinë; dhe
 - (b) Klientin.

Huat dhe garancitë me një klient auditimi që është një bankë ose institucioni ngjashëm

- K511.5 Një firmë, një firmë rrjet, një anëtar i grupit të auditimit apo një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së atij individit nuk do të pranojë një hua ose një garanci të një huaje nga një klient që është një bankë ose një institucion i ngjashëm, përveç nëse huaja ose garancia është dhënë

sipas procedurave, kushteve dhe kërkesave normale të kredi dhënies.

- 511.5 A1 Shembuj të huave, përfshijnë huamarrjet për blerje shtëpie, zbulimet bankare, huat për blerje veturash dhe për tepricat e kartave të kreditit.
- 511.5 A2 Edhe nëse huaja ose garancia është dhënë sipas procedurave, kushteve dhe kërkesave normale të kredi dhënies, huaja mund të krijojë një kërcënim të egoizmit nëse ajo është materiale për klientin e auditimit apo për firmën që e merr atë.
- 511.5 A3 Një shembull i një veprimi që mund të ishte një masë mbrojtëse për të adresuar një kërcënim të tillë të egoizmit, do të ishte rishikimi i punës nga një rishikues i përshtatshëm, i cili nuk është një anëtar i grupit të auditimit, nga një firmë rrjet që nuk është një përfitues i huas.

Depozitat ose llogaritë e brokerimit

- K511.6 Një firmë, një firmë rrjet, një anëtar i grupit të auditimit ose një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së atij individi nuk duhet të ketë depozita ose llogari brokerimi me një klient auditimi, që është një bankë ose një institucion i ngjashëm, përveç nëse depozita ose llogaria mbahet nën kushtet dhe kërkesat normale tregtare.

Huat dhe garancitë me një klient auditimi që nuk është një bankë ose institucion i ngjashëm

- K511.7 Një firmë, një firmë rrjet, një anëtar i grupit të auditimit ose një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së ngushtë të këtij individi nuk duhet të pranojë një hua ose një garanci huaje nga një klient auditimi, i cili nuk është një bankë ose institucion i ngjashëm, përveç nëse huaja ose garancia e dhënë është jo materiale për:
- (a) \
 - (b) Firmën, firmën e rrjetit, ose, sipas rastit, për individin që merr huan ose garancinë; dhe
 - (c) Klientin.

SEKSIONI 520

MARRËDHËNIE E BIZNESIT

Hyrje

- 520.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 520.2 Një marrëdhënie e ngushtë biznesi me një klient të auditimit ose drejtimin e tij, mund të krijojë një kërcënim të egoizmit ose të frikësimit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 520.3 A1 Ky seksion përmban referenca ndaj “materialitetit” të një interesi financiar dhe “rëndësisë” së një marrëdhënieje biznesi. Për të përcaktuar nëse një interes i tillë financiar është material për një individ, mund të merret parasysh vlera neto e kombinuar e individit dhe anëtarëve të drejtpërdrejtë të familjes të individit.
- 520.3 A2 Shembuj të një marrëdhënieje të ngushtë biznesi që lind nga një marrëdhënie tregtare ose interesa të përbashkëta financiare, përfshijnë:
- Ekzistencën e një interesi financiar në një sipërmarrje të përbashkët me klientin ose me një pronar kontrollues, drejtor, zyrtar ose individë të tjerë, të cilët kryejnë veprimtari të drejtimin të lartë për atë klient.
 - Marrëveshjet për të kombinuar një apo më shumë shërbime ose produkte të firmës ose të një firme rrjet, me një ose më shumë shërbime apo produkte të klientit dhe tregtimi i paketës me referim tek të dyja palët.
 - Marrëveshjet e shpërndarjes ose të marketingut, sipas të cilave firma shpërndan ose tregon produktet apo shërbimet e klientit ose klienti shpërndan apo tregon produktet ose shërbimet e firmës ose një firme rrjet.

Marrëdhëniet e biznesit me firmën, firmën e rrjetit, një anëtar të grupit të auditimit ose anëtar të familjes së ngushtë

- K520.4 Një firmë, një firmë rrjet ose një anëtar i grupit të auditimit nuk do të ketë

një marrëdhënie të ngushtë biznesi me një klient të auditimit ose me drejtimin e tij, përveç nëse çdo interes financiar është jo material dhe marrëdhënia e biznesit është e parëndësishme për klientin ose drejtimin e tij, dhe firmën, firmën e rrjetit ose anëtarin e grupit të auditimit, kur kjo është e zbatueshme.

- 520.4 A1 Një marrëdhënie e ngushtë biznesi midis një anëtarit të grupit të auditimit, ose një anëtarit të drejtpërdrejtë të familjes së atij individi, dhe klientit të auditimit apo drejtimin të tij, mund të krijojë kërcënime të egoizmit ose kërcënime të frikësimit

Interesat e përbashkëta në entitetet që zotërohen ngushtësisht (nga pak ortakë)

- K520.5 Një firmë, një firmë rrjet, një anëtar i grupit të auditimit ose ndonjëri nga anëtarët e drejtpërdrejtë të familjes së individit nuk do të kenë një marrëdhënie biznesi që përfshin mbajtjen e një interesi në një entitet të zotëruar ngushtësisht, kur klienti i auditimit ose një drejtor apo zyrtar i klientit, ose ndonjë grup i tyre, mban gjithashtu, një interes në atë entitet, përveç nëse:

- (a) Marrëdhënia e biznesit është e parëndësishme për firmën, firmën rrjet, ose sipas rastit për individin dhe për klientin;
- (b) Interesi financiar është jo material për investitorin ose grupin e investitorëve; dhe
- (c) Interesi financiar nuk i jep investitorit, ose grupit të investitorëve, mundësinë për të kontrolluar entitetin e zotëruar ngushtësisht (nga pak ortakë).

Blerja e mallrave ose shërbimeve

- 520.6 A1 Blerja e mallrave dhe shërbimeve nga një klient i auditimit nga një firmë ose një firmë rrjet, nga një anëtar i grupit të auditimit, ose një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së këtij individi, në përgjithësi nuk krijon një kërcënim për pavarësinë, po që se transaksioni është bërë në rrjedhën normale të biznesit dhe në mënyrë të lirë. Megjithatë, këto transaksioneve mund të jenë të një natyre apo shkalle të atillë që mund të krijojnë një kërcënim të egoizmit.

- 520.6 A2 Shembuj të veprimeve që mund të eliminojnë kërcënime të tilla të egoizmit, përfshijnë:

- Eliminimin ose reduktimin e madhësisë së transaksionit.
- Largimin e individit nga grupi i auditimit.

SEKSIONI 521

MARRËDHËNIET FAMILJARE DHE PERSONALE

Hyrje

- 521.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 521.2 Marrëdhëniet familjare ose personale me stafin e klientit mund të krijojnë një kërcënim të egoizmit, familjaritetit ose frikësimit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 521.3 A1 Marrëdhëniet familjare dhe personale midis një anëtari të grupit të auditimitose një drejtori, apo zyrtari ose disa të punësuarve (në varësitë rolit të tyre) të klientit të auditimit mund të krijojnë një kërcënim të egoizmit, të familjaritetit ose të frikësimit.
- 521.3 A2 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë, përfshijnë:
- Përgjegjësitë individuale të grupit të auditimit.
 - Rolin e anëtarit të familjes ose të individëve të tjerë brenda klientit dhe afërsia e marrëdhënies.

Anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së një anëtari të grupit të auditimit

- 521.4 A1 Një kërcënim i egoizmit, familjaritetit ose frikësimit krijohet kur një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së anëtarit të grupit të auditimit është një punonjës në një pozicion ku mund të ushtrojë influencë të rëndësishme mbi pozicionin financiar, performancën financiare ose flukset e parasë të klientit.
- 521.4 A2 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë, përfshijnë:
- Pozicionin që mbahet nga anëtar i drejtpërdrejtë i familjes.

- Rolin e anëtarit të grupit të auditimit.

- 521.4 A3 Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë një kërcënim të tillë të egoizmit, familjaritetit ose frikësimit është largimi i individit nga grupi i auditimit.
- 521.4 A4 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të egoizmit, familjaritetit ose frikësimit është strukturimi i përgjegjësive të grupit të auditimit në mënyrë që anëtari i grupit të auditimit të mos merret me çështjet që janë përgjegjësi e anëtarit të drejtpërdrejtë të familjes.
- K521.5 Një individ nuk do të marrë pjesë si një anëtar i grupit të auditimit kur një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së individit:
- (a) Është një drejtor ose zyrtar i klientit të auditimit;
 - (b) Është një punonjës në një pozicion që ushtron influencë të rëndësishme mbi përgatitjen e regjistrave kontabël ose të pasqyrave financiare, për të cilat firma do të shprehë një opinion; ose
 - (c) Ishte në një pozicion të tillë gjatë periudhës së mbuluar nga angazhimi apo pasqyrat financiare.

I afërt i familjes së një anëtari të grupit të auditimit

- 521.6 A1 Një kërcënim i egoizmit, familjaritetit ose frikësimit krijohet kur një anëtar i afërt i familjes së një anëtari të grupit të auditimit është:
- (a) Një drejtor ose zyrtar i klientit të auditimit; ose
 - (b) Një punonjës në një pozicion që ushtron influencë të rëndësishme mbi përgatitjen e regjistrave kontabël ose të pasqyrave financiare të klientit, për të cilat firma do të shprehë një opinion.
- 521.6 A2 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë, përfshijnë:
- Natyrën e marrëdhënies midis anëtarit të grupit të auditimit dhe anëtarit të afërt të familjes.
 - Pozicioni që mbahet nga anëtari i afërt i familjes.
 - Roli i anëtarit të grupit të auditimit.
- 521.6 A3 Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë një kërcënim të tillë të egoizmit, familjaritetit ose frikësimit është largimi i individit nga grupi i auditimit

521.6 A4 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të egoizmit, familjaritetit ose frikësimit është strukturimi i përgjegjësive të grupit të auditimit në mënyrë që anëtarit i grupit të auditimit të mos merret me çështjet që janë përgjegjësi e anëtarit të afërt të familjes.

Marrëdhënie të tjera të një anëtarit të grupit të auditimit

K521.7 Një anëtar i grupit të auditimit do të konsultohet në përputhje me politikat dhe procedurat e firmës, nëse anëtarit i grupit të auditimit ka marrëdhënie të ngushta me një person që nuk është një anëtar i drejtpërdrejtë ose i afërt i familjes, por është:

- (a) Një drejtor ose zyrtar i klientit; ose
- (b) Një i punësuar në një pozitë që ushtron influencë të rëndësishme mbi përgatitjen e regjistrave kontabël ose të pasqyrave financiare të klientit, për të cilat firma do të shprehë një opinion.

521.7 A1 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të egoizmit, familjaritetit ose frikësimit, të krijuar nga një marrëdhënie e tillë, përfshijnë:

- Natyrën e marrëdhënies midis individit dhe anëtarit të grupit të auditimit.
- Pozicionin që individit mban tek klienti.
- Rolin e anëtarit të grupit të auditimit.

521.7 A2 Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë një kërcënim të tillë të egoizmit, të familjaritetit ose të frikësimit, është largimi i individit nga grupi i auditimit.

521.7 A3 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të egoizmit, familjaritetit ose frikësimit, është strukturimi i përgjegjësive të grupit të auditimit në mënyrë që anëtarit i grupit të auditimit të mos merret me çështjet që janë brenda përgjegjësisë së individit me të cilin anëtarit i grupit të auditimit ka një marrëdhënie të afërt.

Marrëdhëniet e ortakëve dhe punonjësve të firmës

K521.8 Ortakët dhe punonjësit e firmës do të konsultohen në përputhje me politikat dhe procedurat e firmës në qoftë se ata vihen në dijeni të një marrëdhënieje personale ose familjare midis:

- (a) Një ortaku apo punonjësi të firmës ose firmës rrjet, që nuk është

një anëtar i grupit të auditimit; dhe

- (b) Një drejtori ose zyrtari të klientit të auditimit apo të një punonjësi të klientit të auditimit në një pozicion që ushtron influencë të rëndësishme mbi përgatitjen e regjistrave kontabël ose të pasqyrave financiare të klientit, për të cilat firma do të shprehë një opinion.

521.8 A1 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të egoizmit, familjaritetit ose frikësimit, të krijuar nga një marrëdhënie e tillë, përfshijnë:

- Natyrën e marrëdhënies që ekziston midis ortakut apo punonjësit të firmës dhe drejtorit ose zyrtarit apo punonjësit të klientit.
- Shkalla e ndërveprimit të ortakut ose punonjësit të firmës me grupin e auditimit.
- Pozicionin e ortakut apo punonjësit brenda firmës.
- Pozicionin që individi mban tek klienti.

521.8 A2 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për adresimin e kërcënimeve të tilla të egoizmit, familjaritetit ose frikësimit janë:

- Strukturimi i përgjegjësive të ortakut ose të punonjësit për të zvogëluar çdo influencë të mundshme mbi angazhimin e auditimit.
- Angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për të rishikuar punën e kryer.

SEKSIONI 522

SHËRBIMET E KOHËVE TË FUNDIT NË NJË KLIENTTË AUDITIMIT

Hyrje

- 522.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 522.2 Fakti që një anëtar i grupit të auditimit ka shërbyer së fundmi si drejtor ose zyrtar, ose si punonjës i klientit të auditimit, mund të krijojë një kërcënim të egoizmit, vetë rishikimit ose familjaritetit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Shërbimi gjatë periudhës së mbuluar nga raporti i auditimit

- K522.3 Grupi i auditimit nuk do të përfshijë një individ, i cili gjatë periudhës së mbuluar nga raporti i auditimit:
- (a) Ka shërbyer si drejtor ose zyrtar i klientit të auditimit; ose
 - (b) Ka qenë një punonjës në një pozicion që ushtron influencë të rëndësishme mbi përgatitjen e regjistrave kontabël ose të pasqyrave financiare të klientit, për të cilat firma do të shprehë një opinion

Shërbimi para periudhës së mbuluar nga raporti i auditimit

- 522.4 A1 Një kërcënim i egoizmit, vetë rishikimit ose familjaritetit mund të krijohet kur, para periudhës së mbuluar nga raporti i auditimit, një anëtar i grupit të auditimit:
- (a) Ka shërbyer si drejtor ose zyrtar i klientit të auditimit; ose
 - (b) Ka qenë një punonjës në një pozicion që ushtron influencë të rëndësishme mbi përgatitjen e regjistrave kontabël ose të pasqyrave financiare të klientit, për të cilat firma do të shprehë një opinion.

Për shembull, një kërcënim do të mund të krijohej nëse një vendim i marrë ose punë e kryer nga individ i në periudhën e mëparshme, kur ishte i punësuar nga klienti, do të vlerësohet në periudhën aktuale si pjesë e angazhimit aktual të auditimit.

- 522.4 A2 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve, përfshijnë:
- Pozicioni që individ i ka mbajtur tek klienti i auditimit.
 - Periudha e kohës që ka kaluar që nga momenti kur individ i ndërpreu marrëdhëniet me klientin.
 - Roli i anëtarit të grupit të auditimit.
- 522.4 A3 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e kërcënimeve të tilla të egoizmit, vetë rishikimit ose familjaritetit është angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për të rishikuar punën e kryer nga anëtari i grupit të auditimit.

SEKSIONI 523

SHËRBIMI SI NJË DREJTOR OSE ZYRTAR I NJË KLIENTI TË AUDITIMIT

Hyrje

- 523.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 523.2 Shërbimi si një drejtor ose zyrtar i një klienti të auditimit krijon kërcënime të vetë rishikimit dhe të egoizmit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Shërbimi si drejtor ose zyrtar

- K523.3 Një ortak ose i punësuar i firmës ose një firme rrjet nuk do të shërbejësi një drejtor ose zyrtar i një klienti të auditimit të firmës.

Shërbimi si sekretar i kompanisë

- K523.4 Një ortak apo punonjës i firmës ose i një firme rrjet nuk do të shërbejësi sekretar i kompanisë për një klient të auditimit, përveç nëse:
- (a) Kjo praktikë lejohet sipas ligjit vendas, nga rregullat profesionale ose të praktikës;
 - (b) Menaxhimi merr vetë të gjitha vendimet përkatëse; dhe
 - (c) Detyrat dhe aktivitetet e kryera do të kufizohen në ato të natyrës rutinë dhe administrative, të tilla si përgatitja e procesverbaleve të mbledhjeve dhe mbajtja e deklaratave ligjore
- 523.4 A1 Pozicioni i Sekretarit të kompanisë ka implikime të ndryshme në juridiksione të ndryshme. Detyrat mund të variojnë që nga detyra administrative, të tilla si menaxhimi i personelit, mbajtja e të dhënave të kompanisë dhe regjistrave, deri tek detyra të tjera, siç janë dhënia e sigurisë se kompania vepron në pajtim me rregulloret apo dhënia e këshillave mbi çështjet e qeverisjes së korporatave. Në përgjithësi, ky pozicion shikohet se nënkupton një lidhje të ngushtë me entitetin. Për këtë arsye, një kërcënim krijohet nëse një ortak ose punonjës i firmës ose firmës rrjet shërben si sekretar i kompanisë për një klient auditimi. (Më shumë informacion në lidhje me ofrimin e shërbimeve të jo

sigurisë për një klient të auditimi është dhënë në Seksionin 600, Ofrimi i shërbimeve të jo sigurisë për një klient auditimi.)

SEKSIONI 524

PUNËSIMI TEK KLIENTI I AUDITIMIT

Hyrje

- 524.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 524.2 Marrëdhëniet e punës me një klient auditimi mund të krijojnë kërcënimet e egoizmit, familjaritetit ose frikësimit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të gjithë klientët e auditimit

- 524.3 A1 Një kërcënim i familjaritetit ose frikësimit mund të krijohet nëse ndonjë nga individët e mëposhtëm kanë qenë anëtarë të grupit të auditimit ose ortakë të firmës ose firmës rrjet:
- Një drejtor ose zyrtar i klientit të auditimit.
 - Një punonjës në një pozicion që ushtron influencë të rëndësishme mbi përgatitjen e regjistrave kontabël ose të pasqyrave financiare të klientit, për të cilat firma do të shprehë një opinion.

Kufizimet për një ish ortak ose anëtar të grupit të auditimit

- K524.4 Firma do të sigurohet se nuk vazhdon të ekzistojë një lidhje e rëndësishme midis firmës ose firmës rrjet dhe:
- (a) Një ish ortak, i cili i është bashkuar një klienti të auditimit të firmës; ose
 - (b) Një ish anëtar i grupit të auditimit, i cili i është bashkuar klientit të auditimit, nëse cilido prej tyre është bashkuar klientit të auditimit si:
 - (c) Një drejtor ose zyrtar; ose
 - (d) Një punonjës në një pozicion që ushtron influencë të rëndësishme mbi përgatitjen e regjistrave kontabël ose të pasqyrave financiare të klientit, për të cilat firma do të shprehë një opinion.

Një lidhje e rëndësishme midis firmës ose firmës rrjet dhe

individit vijon të mbetet, përveç nëse:

- (a) Individi nuk ka të drejtë për ndonjë përfitim ose pagesë nga firma, ose firma rrjet që nuk janë në përputhje me marrëveshje të fiksuara në mënyrë të parapërcaktuar;
- (b) Çdo shumë që i detyrohet individit nuk është materiale për firmën ose firmën rrjet; dhe
- (c) Individi nuk do të vazhdojë të marrë pjesë ose të duket se do të marrë pjesë në aktivitetet e biznesit të firmës ose aktivitetet profesionale.

524.4 A1 Edhe nëse përmbushen kërkesat e paragrafit K524.4, përsëri mund të lindë një kërcënim i familjaritetit ose frikësimit.

524.4 A2 Një kërcënim i familjaritetit ose frikësimit mund të krijohet nëse një ish ortak i firmës ose firmës rrjet, i është bashkuar më parë një entiteti në një nga pozicionet e përshkruara në paragrafin 524.3 A1 dhe entiteti më pas bëhet një klient i auditimit i firmës.

524.4 A3 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve, përfshijnë:

- Pozicionin që individi ka marrë tek klienti i auditimit.
- Ndonjë përfshirje që individi do të ketë në grupin e auditimit.
- Periudhën e kohës që ka kaluar që nga momenti i fundit kur individi ishte anëtar i grupit të auditimit ose ortak i firmës apo i firmës rrjet.
- Pozicionin e mëparshëm i individit brenda grupit të auditimit apo firmës, apo firmës rrjet, për shembull, nëse individi ka qenë përgjegjës për mbajtjen e kontakteve të rregullta me drejtuesit, ose personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit.

524.4 A4 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për adresimin e kërcënimeve të tilla të familjaritetit ose frikësimit përfshijnë:

- Modifikimin e planit të auditimit.
- Caktimin në grupin e auditimit e atyre individëve të cilët kanë përvojë të mjaftueshme në lidhje me individët që i janë bashkuar klientit.
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm për të rishikuar punën e ish anëtarit të grupit të auditimit.

Anëtarët e grupit të auditimit që hyjnë në marrëdhënie punë me një klient

K524.5 Një firmë ose një firmë rrjet do të ketë politika dhe procedura që ju kërkojnë anëtarëve të grupit të auditimit të njoftojnë firmën ose firmën

rrjet kur hyjnë në negociata punësimi me një klient auditimi.

- 524.5 A1 Një kërcënim i egoizmit krijohet kur një anëtar i grupit të auditimit merr pjesë në angazhimin e auditimit duke ditur se anëtari i grupit të auditimit do t'i ose mund t'i bashkohet klientit në të ardhmen.
- 524.5 A2 Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë një kërcënim të tillë të egoizmit do të ishte largimi i individit nga grupi i auditimit.
- 524.5 A3 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të egoizmit është angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për të rishikuar gjykime të rëndësishme të bëra nga ai individ kur ishte pjesë e grupit.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

Ortakët kryesorë të auditimit

K524.6 Subjekt i paragrafit K524.8, në qoftë se një individ i cili ka qenë ortak kryesor i auditimit i bashkohet një klienti të auditimit që është një entitet me interes publik, siç është:

- (a) Një drejtor ose zyrtar; ose
- (b) Një punonjës në një pozicion që ushtron influencë të rëndësishme mbi përgatitjen e regjistrave kontabël ose të pasqyrave financiare të klientit, për të cilat firma do të shprehë një opinion,

pavarësia kompromentohet përveç nëse, individ i nuk vijon të jetë ortak kryesor i auditimit:

- (i) Klienti i auditimit ka publikuar pasqyrat financiare të audituara që mbulojnë një periudhë prej jo më pak se dymbëdhjetë muaj; dhe
- (ii) Individ i nuk ka qenë një anëtar i grupit të auditimit në lidhje me auditimin e këtyre pasqyrave financiare.

Ortak drejtues i lartë (senior) ose menaxher i lartë i firmës (drejtori ekzekutiv ose ekuivalenti i tij)

K524.7 Subjekt i paragrafit K524.8, në qoftë se një individ, i cili ka qenë ortaku drejtues i lartë (senior) ose menaxher i lartë i firmës (Drejtori Ekzekutiv ose ekuivalenti i tij) i bashkohet një klienti të auditimit që është një entitet me interes publik, në pozicione të tilla si:

- (a) Një drejtor ose zyrtar i entitetit; ose
- (b) Një punonjës në një pozicion që ushtron influencë të rëndësishme mbi përgatitjen e regjistrave kontabël ose të pasqyrave financiare

mbi të cilat firma do të shprehë një opinion,
pavarësia kompromentohet, përveç nëse kanë kaluar dymbëdhjetë muaj
që nga koha kur individi ishte ortakut senior ose menaxher i lartë i firmës
(Drejtori Ekzekutiv ose ekuivalenti i tij).

Kombinimet e biznesit

K524.8 Si përjashtim nga paragrafët K524.6 and K524.7, pavarësia nuk kompromentohet në qoftë se, rrethanat që jepen në këto paragrafë, lindin si rrjedhojë e një kombinimi biznesi dhe:

- (a) Pozicioni nuk ka qenë fituar në kuadrin e kombinimit të biznesit
- (b) Çdo përfitim ose pagesë që i detyrohej ish-ortakut nga firma ose firma rrjet, është shlyer në mënyrë të plotë, përveç nëse ka qenë bërë në përputhje me marrëveshjet e fiksuara të paracaktuara dhe çdo shumë borxh ndaj ortakut nuk është materiale sipas rastit për firmën ose firmën rrjet;
- (c) Ish ortakut nuk do vazhdojë të marrë pjesë ose të duket se merr pjesë në aktivitetet e biznesit ose në aktivitetet profesionale të firmës; dhe
- (d) Firma diskuton për pozicionin e mbajtur nga ish ortakut me klientin e auditimit me personat e ngarkuar me qeverisjen.

SEKSIONI 525

CAKTIMET E PËRKOHSHME TË PERSONELIT

Hyrje

- 525.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120, për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 525.2 Huazimi i personelit për një klient të auditimit mund të krijojë një kërcënim të vetë rishikimit, favorizimit ose familjaritetit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 525.3 A1 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për adresimin e kërcënimeve të krijuara nga huazimi i personelit nga një firmë ose firmë rrjet, për një klient të auditimit përfshijnë:
- Kryerjen e një rishikimi shtesë të punës së kryer nga personeli i huazuar, për të adresuar një kërcënim të vetë rishikimit.
 - Mos përfshirjen e personelit të huazuar në grupin e auditimit për të adresuar një kërcënim të familjaritetit ose favorizimit.
 - Mosdhënien e përgjegjësisë së auditimit për personelin e huazuar për ndonjë funksion ose aktivitet që personeli ka kryer gjatë caktimit të tij si personel i përkohshëm për të adresuar një kërcënim të vetë rishikimit.
- 525.3 A2 Kur nga huazimi i personelit nga një firmë ose firmë rrjet për një klient të auditimit krijohen kërcënimet të familjaritetit dhe favorizimit, të atilla që firma ose firma rrjet lidhet shumë ngushtë me pikëpamjet dhe interesat e drejtimit, shpesh nuk ka masa mbrojtëse në dispozicion.
- K525.4 Një firmë ose një firmë rrjeti nuk duhet t'i huazojë personel një klienti auditimi, përveç rastit kur firma ose firma e rrjetit sigurohet që:
- (a) Një ndihmë e tillë ofrohet vetëm për një periudhë të shkurtër kohe;
 - (b) Ky personel nuk do të marrë përsipër përgjegjësitë e drejtuesve dhe klienti i auditimit do të jetë përgjegjës për drejtimin dhe

- mbikëqyrjen e aktiviteteve të këtij personeli;
- (c) Çdo kërcënim ndaj pavarësisë së firmës ose firmës së rrjetit që lind nga shërbimet profesionale të ndërmarra nga ky personel eliminohet ose zbatohen masa mbrojtëse për të reduktuar këtë kërcënim në një nivel të pranueshëm; dhe
 - (d) Ky personel nuk do të ndërmarrë ose nuk do të përfshihet në shërbime profesionale që firmës ose firmës së rrjetit i ndalohej të kryejë nga ky kod.

SEKSIONI 540

LIDHJA E GJATË E PERSONELIT TË LARTË (PËRFSHIRË ROTACIONIN E ORTAKUT) ME NJË KLIENT TË AUDITIMIT

Hyrje

- 540.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 540.2 Kur një individ është i përfshirë në një angazhim auditimi për një periudhë kohe të gjatë, mund të krijohen kërcënime të egoizmit dhe familjaritetit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të Gjithë klientët e auditimit

- 540.3 A1 Edhe pse njohja e një klienti të auditimit dhe mjedisit të tij është thelbësor për cilësinë e auditimit, një kërcënim familjariteti mund të krijohet si rezultat i lidhjes së gjatë të një individi, si anëtar i grupit të auditimit, me:
- (a) Klientin e auditimit dhe operacionet e tij;
 - (b) Drejtimin e lartë të klientit të auditimit; ose
 - (c) Pasqyrat financiare mbi të cilat firma do të shprehë një opinion ose informacionin financiar, që formon bazën e pasqyrave financiare.
- 540.3 A2 Një kërcënim i egoizmit mund të krijohet si rezultat i shqetësimit të një individi për humbjen e një klienti të vjetër ose të një interesi për të mbajtur një marrëdhënie të ngushtë personale me një anëtar të drejtimittë lartë ose me personat e ngarkuar me qeverisjen. Një kërcënim i tillë mund të influencojë në mënyrë të papërshtatshme gjykimin e individit.
- 540.3 A3 Faktorët përkatës për vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve të familjaritetit ose egoizmit, përfshijnë:
- (a) Në lidhje me individin:
 - Kohëzgjatja e përgjithshme e marrëdhënies së individit me klientin, përfshirë faktin nëse kjo lidhje kishte ekzistuar ndërkohë që individi ishte në një firmë të mëparshme.

- Sa kohë individi ka qenë një anëtar i grupit të angazhimit, si dhe natyra e roleve të kryera.
 - Masa në të cilën puna e individit ka qenë drejtuar, rishikuar dhe mbikëqyrur nga një personel më i lartë.
 - Masa në të cilën individi, për shkak të vjetërsisë së tij, ka aftësinë të influencojë rezultatit e auditimit, për shembull duke marrë vendime të rëndësishme ose duke drejtuar punën e anëtarëve të tjerë të grupit të angazhimit.
 - Afërsia e marrëdhënies personale të individit me drejtimin e lartë ose personat e ngarkuar me qeverisjen.
 - Natyra, shpeshtësia dhe shtrirja e ndërveprimit midis individit dhe drejtimit të lartë ose personave të ngarkuar me qeverisjen.
- (b) Në lidhje me klientin e auditimit:
- Natyra ose kompleksiteti i çështjeve kontabël dhe të raportimit financiar të klientit dhe fakti nëse ato kanë ndryshuar.
 - Fakti nëse ka patur ndryshime të kohëve të fundit në drejtimin e lartë ose personat e ngarkuar me qeverisjen.
 - Fakti nëse ka patur ndonjë ndryshim strukturor në organizatën e klientit që ndikon në natyrën, shpeshtësinë dhe shtrirjen e ndërveprimeve të individit me drejtimin e lartë ose me personat e ngarkuar me qeverisjen.

540.3 A4 Kombinimi i dy ose më shumë faktorëve mund të rrisë ose të zvogëlojë rëndësinë e kërcënimeve. Për shembull, kërcënimet e familjaritetit të krijuara me kalimin e kohës nga marrëdhënia gjithnjë e më e ngushtë midis një individi dhe një anëtari të drejtimit të lartë të klientit, do të zvogëloheshin me largimin e këtij anëtari të drejtimit të lartë të klientit.

540.3 A5 Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë kërcënimet e familjaritetit dhe të egoizmit të krijuara nga përfshirja e një individi në një angazhim të auditimit për një periudhë kohe të gjatë, do të ishte rotacioni i individit nga grupi i auditimit.

540.3 A6 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për adresimin e këtyre kërcënimeve të familjaritetit dhe egoizmit përfshijnë:

- Ndryshimin e rolit të individit në grupin e auditimit ose të natyrës dhe shtrirjes së detyrave që kryen individi.
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk ishte anëtar i grupit të auditimit për rishikimin e punës së individit.
- Kryerjen në mënyrë të rregullt të rishikimeve të pavarura të jashtme ose të brendshme të cilësisë së angazhimit.

K540.4 Nëse një firmë vendos se niveli i kërcënimeve mund të adresohet vetëm me anë të rotacionit të individit nga grupi i auditimit, firma do të përcaktojë një periudhë të përshtatshme kohe gjatë së cilës individi nuk do të:

- (a) Jetë anëtar i grupit të angazhimit për angazhimin e auditimit;
- (b) Ofrojë kontroll të cilësisë për angazhimin e auditimit; ose
- (c) Ushtrorë influencë të drejtpërdrejtë në rezultatin e angazhimit të auditimit.

Kjo periudhë do të jetë e mjaftueshme për të lejuar adresimin e kërcënimeve të familjaritetit dhe egoizmit. Në rastin e një entiteti me interes publik do të zbatohen gjithashtu paragrafët K540.5 –K540.20

Klientët e Auditimit që janë Entitete me Interes Publik

K540.5 Në përputhje me paragrafët K540.7 deri në K540.9, në lidhje me auditimin e një entiteti me interes publik, një individ nuk do të kryejë asnjë nga rolet e mëposhtme, ose një kombinim të këtyre roleve, për më shumë se shtatë vjet (periudha “time-on”):

- (a) Ortak i angazhimit;
- (b) Individ i caktuar si përgjegjës për rishikimin e kontrollit të cilësisë së angazhimit; ose
- (c) Ndonjë rol tjetër kryesor si ortak kryesor i auditimit.

Pas këtyre 7 vjetëve, individ i do të ketë një periudhë ndërprerje (“cooling-off”) në përputhje me dispozitat e paragrafëve K540.11 deri në K540.19.

K540.6 Për llogaritjen e periudhës shtatë-vjeçare, numërimi i viteve nuk do të rinisë përveç nëse individ i ndalon së shërbyeri në një nga pozicionet e përcaktuara në paragrafin K540.5(a) deri në (c) për një periudhë minimale kohe. Kjo periudhë minimale është periudha në vijim e barabartë me të paktën periudhën e ndërprerjes të përcaktuar në përputhje me paragrafët K540.11 deri në K540.13, siç zbatohet për pozicionin në të cilin individ i shërbeu në vitin para ndërprerjes së kësaj përfshirjeje.

540.6 A1 Për shembull, një individ i cili ka shërbyer si ortak i angazhimit për katër vite të ndjekura nga tre vite pushim, mund të shërbejë si ortak kryesor i angazhimit për tre vite të tjera (që plotësojnë shtatë vite kumulative). Pas kësaj, ky individ duhet të bëjë një periudhë ndërprerje në përputhje me paragrafin K540.14.

K540.7 Si përjashtim për paragrafin K540.5, ortakët kryesorë të auditimit

vazhdimësia e të cilëve është veçanërisht e rëndësishme për cilësinë e auditimit, mundet që në raste të rralla, për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të firmës, dhe me pëlqimin e personave të ngarkuar me qeverisjen, të lejohen të shërbejnë edhe një vit shtesë si ortakë kryesorë të auditimit, për sa kohë që kërcënimin për pavarësinë mund të eliminohet ose të zvogëlohet në një nivel të pranueshëm.

540.7 A1 Për shembull, një ortak kryesor i auditimit mund të vazhdojë në atë rol në grupin e auditimit për deri në një vit shtesë në rrethanat kur, për shkak të ngjarjeve paparashikuara, nuk ka qenë e mundur të bëhet një rotacion i kërkuar, siç mund të ishte rasti, për shkak të sëmundjes serioze të ortakut të angazhimit të parashikuar. Në këto rrethana, firma duhet të diskutojë me personat e ngarkuar me qeverisjen për arsyet, pse rotacioni i planifikuar nuk mund të bëhet dhe për nevojën për ndonjë masë mbrojtëse për të zvogëluar ndonjë kërcënim të krijuar.

K540.8 Në qoftë se një klient i auditimit bëhet një entitet me interes publik, në përcaktimin e afatit të rotacionit, një firmë do të mbajë parasysh kohën gjatë të cilës individi i ka shërbyer klientit të auditimit, si një ortak kryesor i auditimit, përpara se klienti të bëhet një entitet me interes publik. Në qoftë se individi i ka shërbyer klientit të auditimit, si një ortak kryesor i auditimit për pesë vjet me radhë ose më pak, kur klienti bëhet entitet me interes publik, numri i viteve që individi mund të vazhdojë të shërbejë klientit në këtë rol para rotacionit nga angazhimi, është shtatë vjet minus numrin e viteve të shërbyera më parë. Si një përjashtim nga paragrafi K540.5, në qoftë se individi i ka shërbyer klientit të auditimit si një ortak kryesor i auditimit për gjashtë ose më shumë vjet me radhë, kur klienti bëhet një entitet me interes publik, individi mund të vazhdojë të shërbejë në këtë kapacitet, me pëlqimin e personave të ngarkuar me qeverisjen, për një maksimum prej dy vite të tjera para rotacionit të tij nga angazhimi.

K540.9 Kur një firmë ka vetëm disa njerëz me njohuritë dhe përvojën e nevojshme për të shërbyer si ortakë kryesorë të auditimit në auditimin e një entiteti me interes publik, rotacioni i ortakëve kryesorë të auditimit mund të mos jetë një masë mbrojtëse në dispozicion. Si një përjashtim nga paragrafi K540.5, në qoftë se një organ rregullator i pavarur në juridiksionin përkatës, ka bërë një përjashtim për rotacionin e ortakut në rrethana të tilla, një individ, në përputhje me këtë përjashtim, mund të mbetet një ortak kryesor i auditimit për më shumë se shtatë vjet. Kjo me kusht që organi rregullator i pavarur të ketë specifikuar zbatimin e kërkesave të tjera, siç është për shembull kohëzgjatja që ortaku kryesor i auditimit mund të jetë i përjashtuar nga rotacioni ose një rishikim i rregullt i jashtëm i pavarur.

Konsiderata të tjera në lidhje me kohën e shërbimit (“time-on”)

- K540.10 Kur vlerëson kërcënimet e krijuara nga lidhja e gjatë e një individi menjë angazhim auditimi, një firmë do të vlerësojë veçanërisht rolet e ndërmarra si dhe kohëzgjatjen e lidhjes së individit me angazhimin e auditimit përpara se individi të bëhej një ortak kryesor i auditimit.
- 540.10 A1 Mund të ketë situata në të cilat firma, gjatë zbatimit të kuadrit konceptual, arrin në përfundimin se nuk është e përshtatshme që një individ i cili është një ortak kryesor i auditimit, të vazhdojë në atë rol, edhe pse kohëzgjatja e shërbimit si ortak kryesor i auditimit është më pak se shtatë vjet.

Periudha e ndërprerjes

- K540.11 Në qoftë se individi ka vepruar si ortak i angazhimit për shtatë vjet me radhë,periudha e ndërprerjes do të jetë pesë vite të njëpasnjëshme.
- K540.12 Kur individi është caktuar si përgjegjës për rishikimin e kontrollit të cilësisë të angazhimit dhe ka vepruar në këtë kapacitet për shtatë vjet, periudhae ndërprerjes do të jetë tre vite të njëpasnjëshme.
- K540.13 Në qoftë se individi ka vepruar si një ortak kryesor i auditimit në kapacitetetë ndryshme nga ato të përcaktuara në paragrafët K540.11 dhe K540.12për shtatë vjet rresht, periudha e ndërprerjes do të jetë dy vite të njëpasnjëshme.
- 540.14 A1 Kërkesat e rotacionit të partnerit në këtë seksion janë të dallueshme nga, dhe nuk modifikojnë, periudhën e ndërprerjes (cooling – off,) të kërkuar nga SNMC 2 si kusht i pranueshmërisë përpara se partneri i angazhimit të mund të marrë rolin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit (shih paragrafin 325.8 A4)

Shërbimi në një kombinim të roleve si ortak kryesor i auditimit

- K540.15 Në qoftë se individi ka vepruar në një kombinim të roleve si ortak kryesor i auditimit dhe ka shërbyer si ortak i angazhimit për katër ose më shumë vite rresht, periudha e ndërprerjes do të jetë tre vite të njëpasnjëshme
- K540.16 Në përputhje me paragrafin K540.16(a), nëse individi ka vepruar në një kombinim të roleve si ortak kryesor i auditimit dhe ka shërbyer si ortaku kryesor i auditimit përgjegjës për rishikimin e kontrollit të cilësisë për katër ose më shumë vjet, periudha e ndërprerjes do të jetë tre vite të njëpasnjëshme

K540.17 Në qoftë se një individ ka vepruar në një kombinim të roleve të ortakut të angazhimit dhe rishikimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit për katër ose më shumë vjet, periudha e ndërprerjes:

- (a) Si një përjashtim i paragrafit K540.15, do të jetë pesë vite të njëpasnjëshme kur individ i ka qenë ortak i angazhimit për tre ose më shumë vjet; ose
- (b) Do të jetë tre vite të njëpasnjëshme në rastin e një kombinimi tjetër

K540.18 Në qoftë se individ i ka vepruar në çfarëdo kombinimi të roleve si ortak kryesor i auditimit, të ndryshme nga ato të adresuara në paragrafët K540.14 deri në K540.16, periudha e ndërprerjes do të jetë dy vite të njëpasnjëshme.

Shërbimi tek një firmë e mëparshme

K540.19 Kur përcaktohet numri i viteve që një individ ka qenë një ortak kryesor i auditimit siç tregohet në paragrafin K540.5, kohëzgjatja e marrëdhënies, kur është e nevojshme, do të përfshijë kohën gjatë së cilës individ i ka qenë ortak kryesor i auditimit në atë angazhim të një firmë e mëparshme.

Periudha më të shkurtra të ndërprerjes të vendosura nga ligji ose rregullat

K540.20 Kur një organ legjislativ ose rregullator (apo një organizatë e autorizuar ose e njohur nga një organ legjislativ ose rregullator) ka përcaktuar një periudhë ndërprerje për një ortak angazhimi më pak se pesë vite të njëpasnjëshme, më e larta e kësaj periudhe ose tre vjet mund të zëvendësohet për periudhën e ndërprerjes prej pesë vitesh të njëpasnjëshme të specifikuar në paragrafët K540.11, K540.14 dhe K540.16 (a), me kusht që periudha e zbatueshme (“time-on”) të mos kalojë shtatë vjet.

(Paragrafi R540.20 nuk do të jetë më efektiv për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë me datën 15 dhjetor 2023 dhe pas kësaj date.)

Kufizimet në veprimtaritë gjatë periudhës së ndërprerjes

540.21 Gjatë periudhës përkatëse të ndërprerjes, individ i nuk do të:

- (a) Jetë anëtar i grupit të auditimit dhe as të kryejë kontroll të cilësisë për angazhimin e auditimit;
- (b) Këshillohet me grupin e auditimit ose klientin në lidhje me çështje, transaksione, ose ngjarje teknike ose specifike të industrisë që

ndikojnë në angazhimin e auditimit (me përjashtim të diskutimeve me grupin e auditimit të kufizuara në punën e ndërmarrë ose përfundimet e arritura në vitin e fundit të periudhës “time-on” të individit, kur kjo është e lidhur me auditimin);

- (c) Jetë përgjegjës për udhëheqjen ose koordinimin e shërbimeve profesionale të dhëna nga firma ose një firmë e rrjetit për klientin e auditimit, ose për mbikëqyrjen e marrëdhënies së firmës ose një firme rrjet me klientin e auditimit;
- (d) Ndërmarrë ndonjë rol ose veprimtari tjetër që nuk përmendet më lart, në lidhje me klientin e auditimit, duke përfshirë dhënien e shërbimeve të jo sigurisë që do të rezultonte në një individ:
 - (i) Te ketë ndërveprim të shpeshtë ose të rëndësishëm me drejtimin e lartë ose personat e ngarkuar me qeverisjen; ose
 - (ii) Te ushtroje influencë të drejtpërdrejtë mbi rezultatin e angazhimit të auditimit.

540.21 A1 Dispozitat e paragrafit K540.20 nuk kanë për qëllim t’i ndalojnë individit ndërmarrjen e një roli lidhësi në firmë, ose në një firmë rrjet, siç janë drejtuesi i lartë ose menaxheri i lartë (drejtori ekzekutiv ose ekuivalenti).

SEKSIONI 600

DHËNIA E SHËRBIMEVE TË JOSIGURISË PËR NJË KLIENT TË AUDITIMIT

Hyrje

- 600.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura, dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120, për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 600.2 Firmat dhe firmat rrjet, mund të japin për klientët e tyre të auditimit një gamë të gjerë të shërbimeve të jo sigurisë, të cilat janë në përputhje me aftësitë dhe ekspertizën e tyre. Dhënia e shërbimeve të jo sigurisë për klientët e auditimit, mund të krijojë kërcënime ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore si dhe kërcënime ndaj pavarësisë.
- 600.3 Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë kur jepen shërbime të jo sigurisë për klientët e auditimit. Nën seksionet në vijim përcaktojnë kërkesa specifike dhe materialin përkatës për zbatim kur një firmë ose firmë rrjet jep disa shërbime të jo sigurisë, për klientët e auditimit, si dhe japin indikacion për llojet e kërcënimeve që mund të krijohen si rrjedhojë e këtyre shërbimeve. Disa nga nën seksionet përfshijnë kërkesa që ndalojnë shprehimisht një firmë ose një firmë rrjet në dhënien e disa shërbimeve për një klient të auditimit, në disa rrethana, pasi kërcënimet e krijuara nuk mund të adresohen me anë të zbatimit të masave mbrojtëse.
- 600.4 Disa nën seksione përfshijnë kushte që shprehimisht ndalojnë një firmë ose firmë rrjeti që të ofrojë disa shërbime ndaj një klienti auditimi sepse kërcënimet që mund të krijohen nuk mund të eliminohen dhe masat parandaluese të marra nuk mund të zbatohen e të reduktojnë kërcënimet në një nivel të pranueshëm.
- 600.5 Praktikat e reja të biznesit, evoluimi i tregjeve financiare dhe ndryshimet në teknologji janë disa nga zhvillimet që e bëjnë të pamundur hartimin e një liste gjithëpërfshirëse të shërbimeve të jo- sigurisë që firmat dhe rrjetet e firmave mund të kryejnë për një klient auditimi. Kuadri konceptual dhe parashikimet e përgjithshme në këtë seksion zbatohen kur një firmë i propozon një klienti që të ofrojë shërbime jo-sigurie për të cilat nuk ka kërkesa specifike dhe nuk kërkohen materiale për zbatim.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

Dispozita ligjore ose rregullatore në lidhje me shërbimet e jo-sigurisë

600.6 A1 Paragrafët K100.6 deri të 100.7 A1 parashikojnë kushtet dhe japin materialin për zbatim që lidhen me pajtueshmërinë me Kodin. Nëse në një juridiksion të caktuar ka ligje dhe rregulla që lidhen me dhënien e shërbimeve të jo-sigurisë për klientët e auditimit, të cilat ndryshojnë ose shkojnë përtej atyre që janë përcaktuar në këtë seksion, firmat që japin shërbime të jo – sigurisë ndaj të cilave këto dispozita zbatohen, duhet të jetë në dijeni të këtyre ndryshimeve dhe të veprojnë në pajtim me dispozitat me të forta.

Rreziku i marrjes përsipër të përgjegjësisë të menaxhimit kur jepen shërbime të jo – sigurisë

600.7 A1 Kur një firmë ose firmë rrjeti jep shërbime të jo –sigurisë për një klient të auditimit, ekziston rreziku që firma ose firma rrjet do të marrin përgjegjësi menaxhimi, përveç rasteve kur firma ose firma rrjet është e bindur se janë përmbushur kushtet e parashikuara në paragrafin R400.19.

Pranimi i një angazhimi për të dhënë shërbime të jo – sigurisë

K600.8 Përpara se një firmë ose firmë rrjeti të japë shërbime të jo – sigurisë për një klient të auditimit, firma do të zbatojë kuadrin konceptual për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e çdo kërcënimi ndaj pavarësisë që mund të krijohet nga dhënia e këtij shërbimi.

Identifikimi dhe vlerësimi i kërcënimeve

Të gjithë klientët e auditimit

600.9 A1 Një përshkrim i kategorive të kërcënimeve që mund të lindin kur një firmë ose firmë rrjeti ofron shërbime të jo – sigurisë për një klient të auditimit, është dhënë në paragrafin 120.6 A3.

600.9 A2 Faktorët që janë të përshtatshëm për identifikimin e kërcënimeve të ndryshme që mund të krijohen nga dhënia e shërbimit të jo-sigurisë për një klient të auditimit dhe vlerësimi i nivelit të këtyre kërcënimeve përfshijnë:

- Natyrën, objektivin, përdorimin e synuar dhe qëllimin e shërbimit.
- Mënyrën në të cilën shërbimi do të jepet, për shembull, personeli që do të përfshihet dhe vendndodhja e tyre.

- Mjedisi ligjor dhe rregullator në të cilin do të jepet shërbimi.
- Faktin nëse klienti është entitet me interes publik.
- Nivelin e ekspertizës së menaxhimit dhe punonjësve të klientit në lidhje me llojin e shërbimit që jepet.
- Shkallen në të cilën klienti përcakton çështje të rëndësishme për gjykim. (Ref: Para.K40018 to K 400.19).
- Faktin nëse rezultati i shërbimit do të ndikojë regjistrimet ose çështjet kontabël që reflektohen në pasqyrat financiare, për të cilat firma do të shprehë një opinion dhe nëse kjo ndodh:
 - Shtirjen deri në të cilën rezultati i shërbimit do të ketë një efekt material në pasqyrat financiare.
 - Shkallën e subjektivitetit në përcaktimin e shumave të nevojshme ose trajtimin e atyre çështjeve që reflektohen në pasqyrat financiare.
- Natyrën dhe shtirjen e ndikimit të shërbimit, nëse ka ndonjë ndikim, mbi sistemet që gjenerojnë informacioni, i cili formon një pjesë të rëndësishme të:
 - Regjistrave kontabël ose pasqyrave financiare të klientit për të cilat firma do të shprehë një opinion.
 - kontrolleve të brendshme mbi raportimin financiar.
- Shkallen e mbështetjes që mund të vendoset në rezultatin e shërbimit si pjesë e auditimit.
- Tarifa që lidhet me dhënien e shërbimit të jo –sigurisë.

600.9 A3 Nën seksionet 601 – 610 përfshijnë shembuj të faktorëve shtesë që janë të përshtatshëm për identifikimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë të krijuara nga dhënia e disa shërbimeve të jo-sigurisë dhe vlerësimi i nivelit të këtyre kërcënimeve.

Materialiteti në lidhje me pasqyrat financiare

600.10 A1 Materialiteti është një faktor i përshtatshëm për vlerësimin e kërcënimeve të krijuara nga dhënia e një shërbimi të jo-sigurisë për një klient të auditimit. Nën seksionet 601-610 i referohen materialitetit në lidhje me pasqyrat financiare të një klienti auditimi. Koncepti i materialitetit në lidhje me një auditim është trajtuar në SNA 320, *Materialiteti në Planifikimin dhe Kryerjen e një Auditimi*, dhe në lidhje me një rishikim në SNAR 2400 (i rishikuar), *Angazhimet në Rishikimin e Pasqyrave financiare historike*. Përcaktimi i materialitetit përfshin ushtrimin e gjykimit profesional dhe ndikohet nga faktorë sasiore dhe cilësorë. Ai ndikohet gjithashtu nga perceptimet e nevojave të përdoruesve për informacion financiar.

600.10 A2 Aty ku Kodi shprehimisht ndalon dhënien e shërbimit të jo – sigurisë ndaj një klienti auditimi, një firmë ose firmë rrjeti nuk lejohet të japë këtë

shërbim, pavarësisht materialitetit të rezultatit të një shërbimi të jo – sigurisë në pasqyrat financiare për të cilat firmado të japë një opinion.

Dhënia e këshillave dhe rekomandimeve

600.11 A1 Dhënia e këshillave dhe rekomandimeve mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit. Për të vlerësuar nëse dhënia e këshillave dhe rekomandimeve krijon një kërcënim të vetë-rishikimit, duhet t'i referohemi përcaktimit në paragrafin K600.14. Kur klienti i auditimit nuk është një entitet me interes publik dhe identifikohet një kërcënim vetë-rishikimi, firmës i kërkohet të zbatojë kuadrin konceptual për vlerësimin dhe trajtimin e kërcënimit. Nëse klienti i auditimit është një entitet me interes publik, zbatohen paragrafët R600.16 dhe R600.17.

Shërbimet e shumëfishta të jo-sigurisë të dhëna për njëjtin klient të auditimit

K600.12 Kur një firmë ose firmë rrjeti jep shërbime të jo-sigurisë për një klient të auditimit, përveç kërcënimeve të krijuara nga secili shërbim veç e veç, firma duhet të marrë në konsideratë edhe faktin nëse efekti i kombinuar i këtyre shërbimeve krijon ose ndikon në krijimin e një kërcënimi ndaj pavarësisë.

600.12 A1 Përveç sa përcaktohet në paragrafin 600.9 A2, faktorë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimeve ndaj pavarësisë, të krijuara nga dhënia e shërbimeve të shumëfishta të sigurisë për një klient të auditimit, mund të jene:

- Efekti i kombinuar i dhënies së shërbimeve të shumëfishta rrit nivelin e kërcënimit të krijuar nga çdo shërbim, të vlerësuar individualisht.
- Efekti i kombinuar i dhënies së shumë shërbimeve rrit nivelin e çdo kërcënimi që rrjedh nga marrëdhënia e përgjithshme me një klient auditimi.

Kërcënimet e vetë-rishikimit

600.13 A1 Kur një firmë ose firmë rrjeti jep një shërbim të jo-sigurisë për një klient të auditimit, mund të ekzistojë rreziku që firma të auditojë punën e vet ose të firmës rrjet, duke çuar në këtë mënyrë në një kërcënim të vetë-rishikimit. Një kërcënim i vetë-rishikimit është një kërcënim që një firmë ose një firmë rrjet, nuk do të vlerësojë në mënyrën e duhur rezultatet e një gjykimi të mëparshëm të bëra ose të një aktiviteti të kryer nga një individ brenda firmës ose firmës së rrjetit si pjesë e një shërbimi të jo –sigurisë në të cilin ekipi i auditimit do të bazohet kur formon një gjykim si pjesë e një auditimi.

K600.14 Përpara se të japë një shërbim të jo-sigurisë për një klient të auditimit, një firmë ose firmë rrjeti do të vlerësojë nëse dhënia e atij shërbimi mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit, duke vlerësuar nëse ka ndonjë rrezik që:

- (a) Rezultatet e shërbimit do të krijojnë ose ndikojnë mbi regjistrimet kontabël, kontrollet e brendshme mbi raportimin financiar ose pasqyrat financiare për të cilat firma do të japë një opinion; dhe
- (b) Gjatë auditimit të këtyre pasqyrave financiare për të cilat firma do të japë një opinion, ekipi i auditimit do të vlerësojë ose do bazohet mbi gjykimet e bëra ose aktivitetet e firmës ose firmës rrjet, kur ato kanë dhënë shërbimin.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

600.15 A1 Kur një klient auditimi është një entitet me interes publik, palët e interesuara kanë më shumë pritshmëri në lidhje me pavarësinë e firmës. Këto pritshmëri më të larta janë të përshtatshme për testin e palës se trete të informuar dhe të arsyeshme që përdoret për vlerësimin e një kërcënimi të vetë-rishikimit të krijuar nga dhënia e shërbimeve të jo-sigurisë për një klient të auditimit që është një entitet me interes publik.

600.15 A2 Kur dhënia e një shërbimi të jo-sigurisë një klienti auditimi që është entitet me interes publik krijon një kërcënim vetë-rishikimi, ky kërcënim nuk mund të eliminohet dhe nuk mund të zbatohen masat mbrojtëse për të reduktuar rrezikun e këtij kërcënimi në një nivel të pranueshëm.

Kërcënimet e vetë-rishikimit

K600.16 Një firmë ose firmë rrjeti nuk do të japin një shërbim të jo – sigurisë për një klient të auditimit që është një entitet me interes publik nëse kryerja e këtij shërbimi mund të krijojë një kërcënim vetë-rishikimi në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion (Ref: Para. 600.13 A1 dhe R600.14).

Dhënia e këshillave dhe rekomandimeve

K600.17 Si përjashtim nga paragrafit R600.16, një firmë ose firmë rrjeti mund të japë këshilla dhe rekomandime për një klient auditimi që është entitet me interes publik në lidhje me informacione ose çështje që lindin gjatë auditimit, me kushtin që firma:

- (a) Të mos marrë përsipër përgjegjësi menaxhimi (shih :paragrafët K400.18 dhe K400.19); dhe
- (b) Të zbatojë kuadrin konceptual për identifikimin, vlerësimin dhe

trajtimin e kërcënimeve, përveç kërcënimeve të vetë-rishikimit, ndaj pavarësisë që mund të krijohen nga dhënia e këshillës.

600.17 A1 Shembuj të këshillave dhe rekomandimesh që mund të jepen në lidhje me informacionin dhe çështjet që dalin gjatë një auditimi përfshijnë:

- Këshillim mbi standardet e raportimit financiar ose politikat kontabël dhe kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare.
- Këshillim mbi përshtatshmërinë e kontrollit financiar dhe kontabël dhe metodat e përdorura në përcaktimin e shumave që përfshihen në pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese.
- Propozimin e rregullimeve për regjistrimet në ditar si rrjedhojë e zbulimeve të auditimit.
- Diskutimi i gjetjeve për kontrollin e brendshëm mbi raportimin financiar, proceset dhe rekomandimet për përmirësim.
- Diskutimi mbi zgjidhjen e problemeve të rakordimeve kontabël.
- Këshillimi në lidhje me pajtueshmërinë me politikat kontabël të grupit

Trajtimi i kërcënimeve

Të gjithë klientët e auditimit

600.18 A1 Paragrafët K120.10 deri në 120.10A2 përfshijnë një kërkesë dhe materialin për zbatim të cilat janë të përshtatshme për trajtimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë, duke përfshirë një përshkrim të masave mbrojtëse.

600.18 A2 Kërcënimet ndaj pavarësisë, të krijuara nga dhënia e një shërbimi të jo sigurisë ose shërbimeve të shumëfishta për një klient të auditimit ndryshojnë në varësi të fakteve dhe rrethanave të angazhimit të auditimit dhe natyrës së shërbimit. Këto kërcënime mund të trajtohen duke zbatuar masa mbrojtëse ose duke rregulluar objektin e shërbimit të propozuar.

600.18 A3 Shembuj të veprimeve që mund të konsiderohen masa mbrojtëse për trajtimin e këtyre kërcënimeve përfshijnë:

- Angazhimin e profesionistëve që nuk janë pjesë e grupit të auditimit për kryerjen e shërbimit.
- Përfshirjen e një rishikuesi të përshtatshëm që nuk ka qenë i përfshirë në dhënien e shërbimit, për të rishikuar auditimin ose shërbimin e kryer.
- Marrjen e një autorizimi paraprak mbi rezultatin e shërbimit nga një autoritet kompetent (për shembull autoritetet tatimore).

600.18 A4 Për reduktimin e kërcënimeve që krijohen nga dhënia e një shërbimi jo-sigurie për një klient auditimi në një nivel të pranueshëm , mund të mos ketë masat mbrojtëse të disponueshme. Në këtë situatë zbatimi i kuadrit konceptual kërkon nga firma që:

- (a) Të përshtatë objektin e shërbimit të propozuar për të eliminuar rrethanat që krijojnë kërcënimet;
- (b) Të refuzojë ose ndërpresë shërbimin që krijojnë kërcënimet, të cilat nuk mund të eliminohen ose reduktohen në një nivel të pranueshëm; ose
- (c) Të ndërpresë angazhimin e auditimit.

Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen në lidhje me shërbimet e jo-sigurisë

Te gjithë klientët e auditimit

600.19 A1 Paragrafët 400.40 A1 dhe 400.40 A2 lidhen me komunikimet e firmës me personat e ngarkuar me qeverisjen në lidhje me dhënien e shërbimeve të jo-sigurisë.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

600.20 A1 Paragrafët K600.21 deri të K600.23 kërkojnë që një firmë të komunikojë me personat e ngarkuar për qeverisjen e një entiteti me interes publik, përpara se firma ose firma rrjet të japë shërbime të jo-sigurisë për entitetet brenda strukturës së shoqërisë, në të cilën entiteti publik është pjesë në atë masë sa mund të krijojë një kërcënim për pavarësinë e firmës nga entiteti me interes publik. Qëllimi i komunikimit është t'ju japë mundësi personave të ngarkuar me qeverisjen e entitetit me interes publik që të bëjnë një mbikëqyrje efektive të pavarësie së firmës që auditon pasqyrat financiare të entitetit me interes publik.

600.20 A2 Për të lehtësuar përmbushjen e këtyre kushteve, një firmë mund të bjerë dakord me personat e ngarkuar me qeverisjen e entitetit me interes publik, një proces që parashikon se me kë dhe kur një firmë duhet të komunikojë. Ky proces mund të:

- Përcaktojë procedurën për dhënien e informacionit rreth një shërbimi të jo-sigurisë të propozuar që mund të jetë mbi bazën e një angazhimi individual, nën një politikë të përgjithshme, ose në ndonjë baze tjetër për të cilën është rënë dakord.
- Identifikojë entitetet ndaj të cilave do të zbatohet procedura, që mund të përfshijë entitete të tjera me interes publik brenda strukturës së korporatës.
- Identifikojë çdo shërbim që mund t'ju jepet entiteteve të parashikuara

në paragrafin K600.21 pa miratim specifik nga personat e ngarkuar me qeverisjen, nëse bien dakord si parim i përgjithshëm që këto shërbime nuk do të konsiderohen të ndaluara në bazë të këtij seksioni dhe nuk krijojnë kërcënime ndaj pavarësisë së firmës, ose nëse kur ndonjë kërcënim i tillë krijohet, ai do të jetë në një nivel të pranueshëm.

- Të përcaktojë mënyrën se si personat e ngarkuar me qeverisjen e disa entiteteve me interes publik, brenda të njëjtës strukturë shoqërie, kanë përdorur këtë autoritet për miratimin e shërbimeve që janë për t'u dhënë.
- Të përcaktojë procedurën që duhet të ndiqet, ku dhënia e informacionit të nevojshëm për personat e ngarkuar me qeverisjen, për të vlerësuar nëse një shërbim i propozuar mund të krijojë një kërcënim ndaj pavarësisë së firmës, është i ndaluar ose kufizohet nga standardet profesionale, ligjet ose rregulloret, apo mund të rezultojë në zbulimin e informacionit të ndjeshëm ose konfidencial.
- Të specifikojë mënyrën se si mund të zgjidhen çështjet që nuk parashikohen nga procesi.

K600.21 Përpara se një firmë që auditon pasqyrat financiare të një entiteti me interes publik ose një firmë rrjeti të pranojë një angazhim për të ofruar një shërbim të jo-sigurisë për:

- (A) Atë entitet me interes publik
- (B) Çdo entitet që kontrollon, drejtpërdrejt ose indirekt, atë entitet me interes publik
- (C) Çdo entitet që është i kontrolluar drejtpërdrejt ose indirekt nga ai entitet me interes publik

firma, përveçse kur është trajtuar tashmë kur ka një proces të rënë dakord me personat e ngarkuar me qeverisjen, do të:

- (a) Informojë personat e të ngarkuarit me qeverisjen e entitetit me interes publik, se firma ka vlerësuar se dhënia e shërbimit:
 - (i) Nuk është e ndaluar;
 - (ii) Nuk do të krijojë një kërcënim për pavarësinë e firmës si auditues i entitetit me interes publik apo që çdo kërcënim i identifikuar është në një nivel të pranueshëm ose, nëse jo, do të eliminohet ose reduktohet në një nivel të pranueshëm; dhe
- (b) Japë informacion personave të ngarkuar me qeverisjen e entitetit me interes publik për t'ju bere të mundur që ata të bëjnë një vlerësim të informuar rreth ndikimit të dhënies së shërbimit në pavarësinë e firmës.

600.21 A1 Shembuj të informacionit që mund t'ju jepet personave të ngarkuar me

qeverisjen e entiteteve me interes publik në lidhje me një shërbim të jo-sigurisë, përfshijnë informacionet për:

- Natyrën dhe objektin e shërbimit që do të jepet.
- Bazën dhe shumën e tarifës së propozuar.
- Bazën e vlerësimit të firmës se kërcënimet janë në një nivel të pranueshëm ose, nëse jo, për veprimet që firma ose firma rrjet do të ndërmarrë për të eliminuar ose reduktuar kërcënimet ndaj pavarësisë në një nivel të pranueshëm, kur firma ka identifikuar ndonjë kërcënim ndaj pavarësisë që mund të krijohet nga dhënia e shërbimit të propozuar,
- Faktin nëse efekti i kombinuar i dhënies se shërbimeve të shumëfishta krijon kërcënime ndaj pavarësisë ose ndryshon nivelin e kërcënimeve të identifikuara më herët.

K600.22 Një firmë ose firmë rrjet nuk duhet të japë shërbime jo-sigurie për entitetet e referuara në paragrafin K600.21, përveç nëse personat që janë të ngarkuar me qeverisjen e entiteteve me interes publik kanë rënë dakord ose sipas një procesi të miratuar nga personat e ngarkuar me qeverisjen apo edhe në lidhje me një shërbim të veçantë, me:

- (a) Konkluzionin e firmës se dhënia e shërbimit nuk do të krijojë një kërcënim ndaj pavarësisë së firmës si auditues i entitetit me interes publik, ose që çdo kërcënim i identifikuar është në një nivel të pranueshëm ose, nëse jo, ai do të eliminohet apo reduktohet në një nivel të pranueshëm; dhe
- (b) Dhënien e atij shërbimi

K600.23 Si përjashtim nga paragrafët K600.21 dhe K600.22, kur sipas standardeve profesionale të zbatueshme, ligjeve ose rregullave të tjera, një firmë i ndalohet që të japë informacion në lidhje me shërbimin e propozuar të jo-sigurisë për personat e ngarkuar me qeverisjen e entiteteve me interes publik ose kur dhënia e këtij informacioni do të çonte në zbulimin e informacionit sensitiv ose konfidencial, firma mund të japë shërbimin e propozuar, me kushtin që::

- (a) Firma e jep këtë informacion pa shkelur detyrimet e veta ligjore ose profesionale;
- (b) Firma informon personat e ngarkuar me qeverisjen e entitetit me interes publik se dhënia e shërbimit nuk do të krijojë një kërcënim për pavarësinë e firmës nga entiteti me interes publik, ose çdo kërcënim i identifikuar është në një nivel të pranueshëm apo nëse jo, ai do të eliminohet ose reduktohet në një nivel të pranueshëm; dhe
- (c) Personat e ngarkuar me qeverisjen nuk kundërshtojnë konkluzionet e firmës në pikën (b).

K600.24 Firma ose firma rrjet, pasi ka marrë në konsideratë çdo çështje të ngritur nga personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit të auditimit që është entitet me interes publik, ose nga entiteti i referuar paragrafin R600.21 që është marrësi i shërbimit të propozuar, do të refuzojë shërbimin e jo-sigurisë, ose do të ndërpresë angazhimin e auditimit, nëse:

- (a) Firma ose firma rrjet nuk është e lejuar të japë ndonjë informacion për personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit të auditimit që është entitet me interes publik, përveç nëse, kjo situatë është e trajtuar në një proces të rënë dakord me herët me personat e ngarkuar me qeverisjen; ose
- (b) Personat e ngarkuar me qeverisjen e një klienti auditimi që është entitet me interes publik nuk bien dakord me konkluzionin e firmës se dhënia e shërbimit nuk do të krijojë një kërcënim ndaj pavarësisë së firmës nga klienti ose që çdo kërcënim i identifikuar është në një nivel të pranueshëm apo, nëse jo, ai do të eliminohet ose reduktohet në një nivel të pranueshëm.

Klienti i auditimit që më vonë shndërrohet në një Entitet me Interes Publik

K600.25 Një shërbim i jo-sigurisë i dhënë, aktualisht ose më herët, nga një firmë ose firmë rrjeti për një klient të auditimit cenon pavarësinë e firmës kur klienti shndërrohet në një entitet me interes publik, përveç nëse:

- (a) Shërbimi i mëparshëm i jo-sigurisë përputhet me dispozitat e këtij seksioni që lidhen me klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik;
- (b) Shërbimet e jo-sigurisë që janë në proces dhe nuk janë të lejuara nga seksioni në fjalë, për klientët e auditimit që janë entitete me interes publik, do të përfundojnë përpara, osenëse kjo nuk është e mundur, sa më shpejt të jetë e mundur, pasi klienti të behet një entitet me interes publik;
- (c) Firma dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit që shndërrohet në entitet me interes publik bien dakord të ndërmarrin hapa të mëtijshëm për të trajtuar kërcënimet ndaj pavarësisë që nuk janë në një nivel të pranueshëm.

600.25 A1 Shembuj të veprimeve që firma mund të rekomandojë ndaj klientit të auditimit, përfshijnë angazhimin e një firme tjetër për të:

- Rishikuar ose përsëritur punën audituese deri në masën që është e nevojshme.
- Vlerësuar rezultatet e shërbimit të jo-sigurisë ose përsëritjen e shërbimit të jo-sigurisë deri në masën që është e nevojshme për të mundësuar firmën tjetër të mbajë përgjegjësi mbi shërbimin.

Konsiderata për disa entitete të lidhura

Ky seksion përfshin kërkesat që i ndalojnë firmës ose firmës së rrjetit të japë disa shërbime të jo-sigurisë për klientët e auditimit. Si përjashtim ndaj këtyre kërkesave dhe kërkesave në paragrafin K400.18, një firmë ose firmë rrjeti mund të marrë përsipër përgjegjësi menaxheriale ose të japë disa shërbime të jo-sigurisë, që përndryshe do të ishin të ndaluara për entitetet e lidhura me klientin që jepen në vijim, për të cilët firma do të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare:

- (a) Një entitet që ka kontroll të drejtpërdrejt ose jo të drejtpërdrejt mbi klientin;
- (b) Një entitet me interes financiar të drejtpërdrejt tek klienti, nëse ky entitet ka influencë domethënëse mbi klientin dhe interesi i entitetit ndaj klientit në fjalë është material; ose
- (c) Një entitet që është nën kontroll të përbashkët me klientin, nëse të gjitha kushtet si më poshtë janë përmbushur:
 - (i) Firma ose rrjeti i firmave nuk shpreh një opinion mbi pasqyrat financiare të entitetit të lidhur;
 - (ii) Firma ose rrjeti i firmave nuk ngarkohet me përgjegjësi menaxheriale të drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt për entitetin për pasqyrat financiare të të cilit firma do të shprehë një opinion;
 - (iii) Shërbimet nuk krijojnë një kërcënim të vetë-rishikimit; dhe
 - (iv) Firma i trajton kërcënimet e tjera të krijuara nga dhënia e këtyre shërbimeve, të cilat nuk janë në një nivel të pranueshëm.

Dokumentimi

600.27 A1 Dokumentimi i konkluzioneve të firmës në lidhje me pajtueshmërinë me këtë seksion sipas paragrafëve K400.60 dhe 400.60A1 mund të përfshijë:

- Elementët kyç të kuptimit të natyrës së shërbimit të jo - sigurisë për t'u dhënë dhe, nëse dhe në ç'mënyrë shërbimi mund të ndikojë pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion.
- Natyrën e çdo kërcënimi ndaj pavarësisë, që krijohet nga dhënia e shërbimit për klientin e auditimit, përfshirë rastin kur rezultatet e shërbimit do të jenë subjekt i procedurave të auditimit.
- Masën e përfshirjes së menaxhimit në dhënien dhe mbikëqyrjen e shërbimit të propozuar të jo-sigurisë.
- Çdo masë mbrojtëse që zbatohet ose veprime të tjera që ndërmerren për trajtimin e një kërcënimi ndaj pavarësisë.
- Arsyetimin e firmës për të përcaktuar se shërbimi nuk është i ndaluar dhe se çdo kërcënim i identifikuar ndaj pavarësisë është në një nivel

të pranueshëm.

- Në lidhje me dhënien e një shërbimi të propozuar të jo - sigurisë për entitete e referuara në paragrafin K600.21, hapat e ndërmarrë për të qenë në pajtim me paragrafët K600.21 deri të K600.23.

N/SEKSIONI 601 – SHËRBIME TË KONTABILITETIT DHE REGJISTRIMEVE KONTABËL

Hyrje

Përveç kërkesave specifike dhe materialit për zbatim në këtë nën seksion, kërkesat dhe materiali për zbatim në paragrafët 600.1 deri 600.27 A1 janë të përshtatshme për zbatimin e kuadrit konceptual kur, për klientin e auditimit jepen shërbime kontabël dhe të mbajtjes së kontabilitetit

Kërkesa dhe materiali për zbatim

Te përgjithshme

601.2 A1 Menaxhimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. Këto përgjegjësi përfshijnë:

- Përcaktimin e politikave kontabël dhe trajtimin kontabël në përputhje me këto politika.
- Përgatitjen ose ndryshimin e dokumenteve bazë ose të dhënave fillestare, në formë elektronike ose formë tjetër, evidentimin e kryerjes së një transaksioni. Shembujt përfshijnë:
 - Urdhrat e blerjes.
 - Të dhënat e listë-pagesave.
 - Porositë e klientëve.
- Regjistrimin fillestar ose ndryshimin e regjistrimit në ditarin e llogarive.
- Përcaktimin ose miratimin e klasifikimit kontabël të transaksioneve.

Përshkrimi i shërbimit

601.3 A1 Shërbimet e kontabilitetit dhe regjistrimeve kontabël përfshijnë njëgamë të gjerë shërbimesh, duke përfshirë:

- Përgatitjen e regjistrimeve kontabël ose pasqyrave financiare.

- Regjistrimin e transaksioneve.
- Dhënien e shërbimeve që lidhen me listë-pagesat.
- Zgjidhja e problemeve të rakordimit të llogarive.
- Konvertimi i deklaratave financiare ekzistuese nga një kuadër i raportimit financiar në një tjetër.

Kërcënimet e mundshme që lindin nga dhënia e shërbimeve të kontabilitetit dhe regjistrimeve kontabël

Të gjithë klientët e auditimit

601.4 A1 Dhënia e shërbimeve të kontabilitetit dhe regjistrimeve kontabël një klienti të auditimit krijon një kërcënim vetë-rishikimi, kur ekziston rreziku që rezultatet e shërbimeve do të ndikojnë në regjistrimet kontabël ose pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion, .

Klientët e auditimi që nuk janë entitete me interes publik

K601.5 Një firmë ose firmë rrjet nuk do t'i japë një klienti të auditimit, që nuk është një entitet me interes publik, shërbime të kontabilitetit dhe regjistrimeve kontabël, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare mbi të cilat firma do të shprehë një opinion, ose të informacionit financiar që formon bazën e këtyre pasqyrave financiare, përveç nëse:

- (a) Shërbimet janë të një natyre rutine ose mekanike; dhe
- (b) Firma trajton kërcënimet që nuk janë në një nivel të pranueshëm.

601.5 A1 Shërbimet e kontabilitetit dhe të regjistrimeve kontabël që janë rutine ose mekanike:

- (a) Përfshijnë informacion, të dhëna ose materiale mbi të cilat klienti ka bere gjykime dhe ka marrë vendime që mund të jenë të nevojshme.
- (b) Nuk kërkojnë ose kërkojnë shumë pak gjykim profesional.

601.5 A2 Shembuj të shërbimeve që mund të konsiderohen rutine ose mekanike përfshijnë:

- Përgatitjen e llogaritjeve të listë-pagesave ose raporteve të bazuara në të dhënat origjinale, për miratim dhe pagesë nga klienti.
- Regjistrimin e transaksioneve që përsëriten, për të cilat shumat janë lehtësisht të përcaktueshme me anë të dokumenteve dhe të dhënave origjinale, të tilla si një faturë e shërbimeve utilitare, ku klienti ka përcaktuar ose miratuar klasifikimin e duhur në llogari.
- Llogaritjen e amortizimit për aktivet afatgjata materiale, kur klienti përcakton politikën kontabël dhe vlerëson jetën e dobishme dhe

vlerat e mbetura.

- Postimin e transaksioneve të koduara nga klienti në librin kryesor.
- Postimin e regjistrimeve të aprovuara prej klientit nga ditari në bilancin vërtetues.
- Përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në informacionin e bilancit vërtetues të aprovuar nga klienti dhe. përgatitjen e shënimeve përkatëse shpjeguese, bazuar në të dhënat e aprovuara nga klienti.

Një firmë ose firmë rrjet mund të ofrojë shërbime të tilla ndaj klientëve të auditimit që nuk janë entitete me interes publik, me kushtin që firma ose firma rrjet të veprojë në përputhje me kërkesat e paragrafit K400.19, për të garantuar që nuk merr përsipër përgjegjësi të menaxhimit në lidhje me shërbimin dhe me kërkesat në paragrafin R601.5(b).

601.5 A3 Shembuj të veprimeve që mund të konsiderohen masa mbrojtëse në trajtimin e një kërcënimi të vetë-rishikimit, të krijuar gjatë dhënies të shërbimeve të kontabilitetit dhe regjistrimeve kontabël të një natyre rutine ose mekanike ndaj një klienti auditimi që nuk është entitet publik, përfshijnë:

- Angazhimin e profesionistëve që nuk janë pjesë e grupit të auditimit për kryerjen e shërbimit.
- Angazhimin e një rishikuesi me ekspertizë të përshtatshme që nuk ka qenë anëtar i grupit të auditimit, për të rishikuar punën e auditimit ose shërbimin e kryer.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

K601.6 Një firmë ose firmë rrjet nuk do të japë shërbime kontabiliteti dhe të regjistrimeve kontabël për një klient auditimi që është entitet me interes publik .

K601.7 Si një përjashtim nga paragrafi K601.6, një firmë ose një firmë rrjeti mund të përgatisë pasqyra financiare të detyrueshme për një entitet të lidhur me interes publik, sipas nën paragrafëve (c) ose (d) të përcaktimit të një entiteti të lidhur, me kusht që:

- (a) Është publikuar raporti i auditimit për pasqyrat financiare të grupit të një entiteti me interes publik;
- (b) Firma ose firma rrjet nuk merr përsipër përgjegjësi menaxhimi dhe zbaton kuadrin konceptual për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë;
- (c) Firma ose firma rrjet nuk përgatit regjistrimet kontabël që janë në themel të pasqyrave financiare të entitetit të lidhur dhe këto pasqyra financiare janë bazuar mbi informacionin e miratuar nga

- klienti; dhe
- (d) Pasqyrat financiare të detyrueshme të entitetit të lidhur nuk do të formojnë bazën e pasqyrave financiare të ardhshme të grupit financiar të atij entiteti me interes publik.

N/SEKSIONI 602 – SHËRBIMET ADMINISTRATIVE

Hyrje

- 602.1 Përveç materialit specifik për zbatim të përcaktuar në këtë nën seksion, kriteret dhe materialet për zbatim në paragrafët 600.1 deri 600.27 A1 janë të përshtatshme për zbatimin e kuadrit konceptual kur jepen shërbimet administrative.

Materiali për zbatim

Përshkrimi i shërbimit

- 602.2 A1 Shërbimet administrative përfshijnë dhënien e ndihmës klientëve të auditimit në detyrat e tyre rutinë apo mekanike brenda rrjedhës normale të operacioneve.
- 602.2 A2 Shembuj të shërbimeve administrative përfshijnë:
- Shërbimet e përpunimit të teksteve dhe formatimit të dokumenteve.
 - Përgatitjen e formularëve administrativë ose ligjorë për aprovim nga klienti.
 - Dorëzimin e këtyre formularëve sipas udhëzimeve të klientit.
 - Monitorimin e datave të paraqitjes së deklaratave të detyrueshme dhe këshillimin e një klienti të auditimit në lidhje me këto data.

Kërcënime potenciale nga zbatimi i shërbimeve administrative

Të gjithë klientët e auditimit

- 602.3 A1 Dhënia e shërbimeve administrative për një klient të auditimit zakonisht nuk përbën kërcënim kur këto shërbime janë rutinë dhe kërkojnë pak ose aspak gjykim profesional

N/SEKSIONI 603 – SHËRBIMET E VLERËSIMIT

Hyrje

- 603.1 Përveç kërkesave specifike dhe materialit për zbatim në këtë nën seksion, për zbatimin e kuadrit konceptual kur jepen shërbime vlerësimi për një

klient auditimi është i përshtatshëm edhe materiali i zbatueshëm dhe kërkesat në paragrafët 600.1 - 600.27 A1

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Përshkrimi i shërbimit

- 603.2 A1 Një vlerësim përfshin kryerjen e supozimeve në lidhje me zhvillimet e ardhshme, zbatimin e metodologjive dhe të teknikave të duhura, dhe kombinimi i të dyjave, për të llogaritur një vlerë të caktuar, ose një varg të vlerave, për një aktiv, një detyrim ose për të gjithë entitetin.
- 603.2 A2 Nëse një firmë ose një firmë rrjet kërkohet të kryejë një vlerësim për të ndihmuar një klient të auditimit në lidhje me raportimin e detyrimeve të tij tatimore ose, për qëllime të planifikimit tatimor, dhe rezultatet evlerësimit nuk kanë ndikim në regjistrimet kontabël, ose pasqyrat financiare, përveç atyre përmes regjistrimeve në ditar që kanë të bëjnë me tatimet, në lidhje me këto shërbime do të zbatohet materiali për zbatim i dhënë në paragrafët 604.17 A1 deri në 604.19 A1

Kërcënimet potenciale që lindin nga zbatimi i shërbimeve të vlerësimit

Të gjithë klientët e auditimit

- 603.3 A1 Dhënia e një shërbimi vlerësimi për një klient të auditimit mund të krijojë një kërcënim vetë-rishikimi kur ekziston një rrezik se rezultatet e shërbimit do të ndikojnë regjistrimet kontabël ose pasqyrat financiare mbi të cilat firma do të shprehë një opinion. Gjithashtu, ky shërbim mund të krijojë një kërcënim të favorizimit.
- 603.3 A2 Faktorë të përshtatshëm për identifikimin e kërcënimeve të vetë - rishikimit ose favorizimit, të krijuara nga dhënia e shërbimeve të vlerësimit për një klient të auditimit, dhe për vlerësimin e niveleve të këtyre kërcënimeve, përfshijnë:
- Përdorimin dhe qëllimin e raportit të vlerësimit.
 - Faktin nëse raporti i vlerësimit do të bëhet publik.
 - Shkallën në të cilën metodologjia e vlerësimit bazohet në ligje ose rregullore, precedentë të tjerë ose praktikë të vendosur.
 - Shkallën e përfshirjes së klientit në përcaktimin dhe aprovimin e metodologjisë së vlerësimit dhe çështje të tjera të rëndësishme të gjykimit.
 - Shkallën e subjektivitetit të natyrshëm në elementin përkatës, për vlerësimet që përfshijnë metodologji standarde ose të përcaktuara.
 - Faktin nëse vlerësimi do të ketë një efekt material në pasqyrat

financiare.

- Shtrirjen e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare në lidhje me vlerësimin.
- Paqëndrueshmëria e shumave të përfshira si rrjedhojë e varësisë nga ngjarjet e ardhshme..

Kur është identifikuar një kërcënim i vetë-rishikimit për një klient të auditimit që është entitet me interes publik, zbatohet paragrafi K603.5.

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

603.3 A3 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për të adresuar kërcënimet e vetë-rishikimit ose favorizimit, të krijuara nga dhënia e një shërbimi vlerësimi për një klient auditimi që nuk është një entitet me interes publik, përfshijnë:

- Angazhimin e profesionistëve që nuk janë pjesë e grupit të auditimit për të kryer shërbimin, mund të trajtojë kërcënimet e vetë-rishikimit ose të favorizimit.
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm që nuk ka qenë i përfshirë në dhënien e shërbimit për të rishikuar punën e audituesit ose shërbimin e dhënë, mund të trajtojë një kërcënim vetë-rishikimit.

K603.4 Një firmë ose firmë rrjeti nuk do të japë shërbime vlerësimi një klienti auditimi që nuk është entitet me interes publik në qofte se:

- (a) Vlerësimi përfshin një shkallë të larte subjektiviteti; dhe
- (b) Vlerësimi do të ketë një efekt material mbi pasqyrat financiare mbi të cilat firma do të shprehe një opinion.

K603.4 A1 Disa vlerësime nuk kanë përfshijnë një shkallë të larte subjektiviteti. Kjo është e dukshme veçanërisht kur vlerësimet janë të mbështetur në akte ligjore dhe rregullatore, ose kur teknikat dhe metodologjitë për t'u përdorur bazohen në standarde përgjithësisht të pranura ose janë përshtatur nga ligji ose rregulli. Në këto rrethana rezultatet ose vlerësimi i bërë nga dy ose më shumë palë nuk ka mundësi të ndryshojnë materialisht.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

Kërcënimet e Vetë-rishikimit

K603.5 Një firmë ose firmë rrjeti nuk do të japë shërbime vlerësimi për një klient të auditimit që është një entitet me interes publik, nëse dhënia e këtij shërbimi vlerësimi mund të krijojë një kërcënim vetë-rishikimit (Parag. R600.14 dhe RF600.16).

Kërcënimet e favorizimit

- 603.5 A1 Shembulli i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për të adresuar një kërcënim të favorizimit të krijuar nga dhënia e i një shërbimi të vlerësimit për një klient që është entitet me interes publik, është përdorimi i profesionistëve që nuk janë pjesë e grupit të auditimit për kryerjen e shërbimit.

NËNSEKSIONI 604 – SHËRBIMET TATIMORE

Hyrje

- 604.1 Përveç kërkesave specifike dhe materialit për zbatim në këtë nën seksion, për zbatimin e kuadrit konceptual, kur jepet një shërbim tatimor për një klient auditimi, janë të përshtatshëm edhe kërkesat dhe materiali për zbatim në paragrafët 600.1 deri 600.27 A1

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Përshkrimi i shërbimit

- 604.2 A1 Shërbimet tatimore përfshijnë një gamë të gjerë shërbimesh, ku bëjnë pjesë:
- Përgatitja e deklaratave tatimore.
 - Llogaritjet e tatimeve për qëllime të përgatitjes së regjistrimeve në ditar.
 - Shërbime të këshillimit tatimor.
 - Shërbimet e planifikimit tatimor.
 - Shërbimet tatimore që përfshijnë vlerësime.
 - Asistenca në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tatimore.
- 604.2 A2 Është e mundur që të merren në konsideratë shërbime tatimore në terma më të gjerë siç janë planifikimi tatimor ose pajtueshmëria. Megjithatë këto shërbime shpesh janë të ndërlidhura në praktikë dhe, mund të kombinohen me lloje të tjera të shërbimeve të jo-sigurisë që jepen nga firma, siç janë shërbimet për financat e korporatës. Rrjedhimisht, nuk është mundur të kategorizohen në mënyrë të përgjithshme kërcënimet që rrjedhin nga shërbime tatimore specifike.

Kërcënimet e mundshme që rrjedhin nga dhënia e shërbimeve tatimore

- 604.3 A1 Dhënia e shërbimeve tatimore një klienti auditimi mund të krijojë një kërcënim të vetë rishikimit, kur ka një rrezik që rezultatet e shërbimeve do të ndikojnë në regjistrimet e kontabilitetit ose pasqyrat financiare, mbi

të cilat firma do të shprehë një opinion. Këto shërbime mund të krijojnë dhe kërcënime favorizimit.

604.3 A2 Faktorët që janë të përshtatshëm për identifikimin e kërcënimeve të vetë rishikimit ose të favorizimit, të krijuara nga dhënia e ndonjë shërbimi tatimor për një klient të auditimit dhe vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve përfshijnë:

- Karakteristikat e veçanta të angazhimit;
- Nivelin e ekspertizës tatimore të të punësuarve të klientit;
- Sistemin me të cilin autoritetet tatimore vlerësojnë dhe administrojnë tatimin në fjalë dhe roli i firmës ose firmës rrjet në proces
- Kompleksiteti i regjimit përkatës tatimor dhe niveli i gjykimit të nevojshëm për zbatimin e tij.

Te gjithë klientët e auditimit

K604.4 Një firmë ose firmë rrjet nuk do të japë një shërbim tatimor ose të rekomandojë një transaksion për një klient të auditimit, nëse shërbimi ose transaksioni lidhet me marketingun, planifikimin ose shprehjen e opinionit në favor të një trajtimi tatimor që fillimisht ka qenë rekomanduar, direkt ose indirekt, nga firma ose firma rrjet, dhe një qëllim domethënës i trajtimit tatimor ose transaksionit është shmangia e tatimeve, përveç nëse firma ka besim të plotë se trajtimi i propozuar bazohet në ligjin ose rregullin e zbatueshëm, që ka të ngjarë të prevalojnë.

604.4 A1 Përveç nëse trajtimi tatimor është i bazuar në ligjin dhe rregullin e zbatueshëm, për të cilat firma ka besim të plotë që do të prevalojnë, dhënia e një shërbimi të jo-sigurisë të përshkruar në paragrafin K604.4 krijon kërcënime të egoizmit, vetë-rishikimit dhe favorizimit, të cilat nuk mund të eliminohen dhe masat mbrojtëse nuk mund të zbatohen për reduktimin e këtyre kërcënimeve në një nivel të pranueshëm.

A. Përgatitja e deklaratës tatimore

Përshkrimi i Shërbimit

604.5 A1 Shërbimet e përgatitjes së deklaratave tatimore përfshijnë:

- Ndihmën që ju jepet klientëve në raportimin e detyrimeve të tyre tatimore përmes hartimit dhe plotësimit të informacionit, përfshirë shumën e tatimit për t'u paguar (zakonisht në format të standardizuar) që kërkohet të dorëzohet pranë autoriteteve tatimore përkatëse.
- Këshillimi për trajtimin e deklaratave tatimore të transaksioneve të

viteve të kaluara.

- Përgjigje në emër të klientit të auditimit ndaj kërkesave të autoriteteve tatimore për informacione shtesë dhe analiza (për shembull dhënia e shpjegimeve dhe mbështetjes teknike për qasjen e ndërmarrë).

Kërcënime potenciale që lindin nga përgatitja e deklaratës tatimore

Të gjithë klientët e auditimit

604.6 A1 Dhënia e shërbimit të përgatitjes së deklaratës tatimore, zakonisht nuk krijon një kërcënim sepse:

- (a) Shërbimet e përgatitjes së deklaratës tatimore bazohen në informacionin historik dhe në parim përfshijnë analizën dhe përgatitjen e këtij informacioni historik sipas legjislacionit të zbatueshëm tatimor, duke përfshirë precedentët dhe praktikën e vendosur; dhe
- (b) Deklaratat tatimore janë objekt i çdo procesi rishikimi ose miratimi që autoritetet tatimore konsiderojnë të përshtatshëm.

B. Llogaritjet tatimore më qëllimin e përgatitjessë regjistrimeve kontabël në ditar

Përshkrimi i shërbimit

604.7 A1 Shërbimet e llogaritjeve tatimore përfshijnë përgatitjen e llogaritjeve të detyrimeve ose aktiveve tatimore aktuale dhe të shtyra për qëllime të përgatitjes së regjistrimeve kontabël në ditar që mbështetin ë aktiveve ose detyrimet tatimore në pasqyrat financiare të klientit të auditimit.

Kërcënime të mundshme që lindin nga shërbimet e llogaritjes së taksave

Të gjithë klientët e auditimit

604.8 A1 Përgatitja e llogaritjeve për tatimet aktuale ose të shtyra (ose aktiveve) për një klient të auditimit me qëllim përgatitjen e regjistrimeve kontabël që mbështetin këto teprica, krijon një kërcënim vetë-rishikimit.

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

604.9 A1 Përveç faktorëve në paragrafin 604.3 A2, një faktor që është i përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimit të vetë-rishikimit, të krijuar gjatë përgatitjes së llogaritjeve të tilla për një klient auditimi, është fakti nëse llogaritja mund të ketë një efekt material në pasqyrat financiare mbi të cilat firma do të shprehe një opinion.

604.9 A2 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për të adresuar një kërcënim të tillë vetë-rishikimit, kur klienti i auditimit nuk është një entitet me interes publik përshijnë:

- Përdorimin e profesionistëve që nuk janë anëtarë të ekipit të auditimit për të kryer shërbimin.
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm i cili nuk është përfshirë në dhënien e shërbimit për të rishikuar punën e auditimit ose shërbimit të kryer.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

K604.10 Një firmë ose një firmë rrjet nuk duhet të përgatisë llogaritjet e detyrimeve (ose aktiveve) tatimore aktuale dhe të shtyra për një klient auditimi që është një entitet me interes publik. (Ref: Para. K600.14 dhe K600.16).

C. Shërbime këshillimi tatimor dhe shërbime të tjera planifikimi tatimor

Përshkrim i shërbimit

604.11 A1 Këshillimi tatimor dhe shërbimet e planifikimit tatimor përfshijnë një gamë të gjerë shërbimesh siç janë këshillimi i klientit të auditimit mbi strukturimin e punëve në një mënyrë eficiente të trajtimit të tatimeve ose këshillim mbi zbatimin e një ligji tatimor ose rregulloreje

Kërcënime të mundshme që lindin nga ofrimi i këshillimit dhe planifikimit tatimor

Te gjithë klientët e auditimit

604.12 A1 Dhënia e shërbimeve të këshillimit dhe planifikimit tatimor një klienti të auditimit mund të krijojë një kërcënim vetë-rishikimi kur ekziston rreziku që rezultatet e shërbimeve do të ndikojnë regjistrimet kontabël ose pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion. Këto shërbime mund të krijojnë dhe një kërcënim të favorizimit.

604.12 A2 Dhënia e shërbimeve të këshillimit tatimor dhe planifikimit të tatimeve nuk do të krijojnë ndonjë kërcënim vetë-rishikimi nëse këto shërbime:

- (a) Mbështeten nga autoritetet tatimore ose precedentë të tjerë;
- (b) Janë bazuar në një praktikë të krijuar (e përdorur gjerësisht dhe që nuk është kundërshtuar nga autoritetet tatimore); ose
- (c) Janë bazuar në legjislacionin tatimor që ka të ngjarë të prevalojë.

604.12 A3 Përveç paragrafit 604.3 A2, faktorët që janë të përshtatshëm për

identifikimin e kërcënimeve vetë-rishikimit ose favorizimit të krijuara nga dhënia e shërbimeve të këshillimit dhe planifikimit tatimor për klientët e auditimit dhe vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve, përfshijnë:

- Shkallën e subjektivitetit që ka përcaktimi i trajtimit të duhur për këshillën tatimore në pasqyrat financiare.
- Faktin nëse trajtimi tatimor është i mbështetur nga një rregullim, ose përndryshe, ka qenë interpretuar qartë nga autoriteti tatimor përpara përgatitjes së pasqyrave financiare.
- Shkallen deri në të cilën rezultati i një këshillimi tatimor mund të ketë një ndikim material mbi pasqyrat financiare.

Kur identifikohet një kërcënim i vetë-rishikimit për një klient auditimi që është një entitet me interes publik, zbatohet paragrafi R604.15.

Kur efektiviteti i këshillimit tatimor varet nga një trajtim apo paraqitje kontabël e veçantë

K604.13 Një firmë ose firmë rrjet nuk do të japë shërbime këshillimi dhe të planifikimit tatimor për një klient të auditimit kur:

- (a) Efektiviteti i këshillave tatimore varet nga një trajtim ose paraqitje kontabël e veçantë në pasqyrat financiare, dhe
- (b) Ekipi i auditimit ka dyshime të arsyeshme për përshtatshmërinë e trajtimit ose për paraqitjen kontabël përkatës sipas kuadrit përkatës të raportimit financiar.

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

604.14 A1 Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtje për të adresuar kërcënimet e vetë-rishikimit ose të favorizimit të krijuara nga dhënia e këshillimit tatimor dhe shërbimeve të planifikimit tatimor një klienti të auditimit, që nuk është entitet me interes publik, përfshijnë:

- Angazhimin e profesionistëve që nuk janë pjesë e ekipit të auditimit në kryerjen e shërbimit, mund të adresojë kërcënimet e vetë-rishikimit ose favorizimit.
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk ka qenë i përfshirë në dhënien e shërbimit, për rishikimin e punës audituese ose të shërbimit të kryer, mund të adresojë një kërcënim vetë-rishikimit.
- Marrjen e një vërtetimi paraprak nga autoritetet tatimore në lidhje me detyrimet, mund të adresojë kërcënimet e vetë-rishikimit ose favorizimit.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

Kërcënimet vetë-rishikimit

K604.15 Një firmë ose firmë rrjet nuk do të japë shërbime të këshillimit ose planifikimi për tatimet për një klient të auditimit që është entitet me interes publik nëse dhënia e këtyre shërbimeve mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit (Para. K600.14, K600.16, 604.12 A2).

Kërcënimet e favorizimit

604.15 A1 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të favorizimit që krijohet nga dhënia e shërbimeve të këshillimit dhe planifikimit tatimor për një klient të auditimit që është një entitet me interes publik, përfshijnë:

- Angazhimin e profesionistëve që nuk janë pjesë e ekipit të auditimit për të kryer shërbimin.
- Marrjen e një vërtetimi paraprak nga autoritetet tatimore në lidhje me detyrimet tatimor.

D. Shërbimet tatimore që përfshijnë vlerësime

Përkrahimi Shërbimit

604.16 A1 Dhënia e shërbimeve tatimore që përfshijnë vlerësimet mund të jetë e nevojshme të behet në një sërë rrethanash, duke përfshirë:

- Transaksionet e bashkimit dhe përthithjes.
- Ristrukturimet e grupit dhe riorganizimet e shoqërive tregtare.
- Studime të transferimit të çmimeve.
- Marrëveshjet e shpërblimit që bazohen në aksione.

Kërcënimet të mundshme që lindin nga ofrimi i shërbimeve tatimore ku përfshihen vlerësimet

Të Gjithë Klientët e Auditimit

604.17 A1 Kryerja e një vlerësimi për qëllime tatimore për një klient të auditimit mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit kur ekziston rreziku që rezultatet e shërbimit do të ndikojnë në regjistrimet kontabël ose pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion. Një shërbim i tillë mund të krijojë edhe një kërcënim favorizimi.

- 604.17 A2 Kur një firmë ose një firmë rrjet kryen një vlerësim për qëllime tatimore, duke asistuar një klient auditimi në lidhje me detyrimet e tij për raportim tatimor ose për qëllime planifikimi tatimor, rezultati i vlerësimit mund:
- (a) Të mos ketë ndikim në regjistrimet kontabël ose pasqyrat financiare përveç se nëpërmjet regjistrimeve kontabël që lidhen me tatimet. Në këto situata, do të zbatohen kushtet dhe materiali për zbatim që përshkruhet në këtë nën seksion.
 - (b) Të ndikojë në regjistrimet kontabël ose pasqyrat financiare në mënyra që nuk kufizohen në të regjistrimet kontabël që lidhen me tatimet, për shembull nëse vlerësimi të çon drejt rivlerësimit të aktiveve. Në këto situata, do të zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim që përshkruhen në nën seksionin 603 lidhur me shërbimet e vlerësimit.
- 604.17 A3 Kryerja e një vlerësimi për qëllime tatimore për një klient të auditimit nuk do të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit nëse:
- (a) Hipotezat bazë, janë përcaktuar me ligj ose me rregulla, ose ato janë të pranuar gjerësisht; ose
 - (b) Teknikat dhe metodologjitë për t'u përdorur janë të mbështetura në standardet përgjithësisht të pranuar, ose janë të përshkruara në ligj ose rregulla, dhe vlerësimi i nënshtrohet rishikimit të jashtëm nga një autoritet tatimor ose autoritet i ngjashëm rregullator.

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

- 604.18 A1 Një firmë ose një firmë rrjet mund të kryejë një vlerësim për qëllime tatimore për një klient auditimi që nuk është një entitet me interes publik kur rezultatet e vlerësimit ndikojnë vetëm regjistrimet kontabël ose pasqyrat financiare përmes regjistrimeve kontabël në ditar, që lidhen me tatimet. Si rregull, kjo nuk do të krijojte kërcënime nëse efekti në pasqyrat financiare është jo-material ose vlerësimi, që përfshihet në deklaratën tatimore ose dokumente të tjera, i nënshtrohet rishikimit të jashtëm nga një autoritet tatimor ose autoritete të ngjashme rregullatore.
- 604.18 A2 Nëse vlerësimi që kryhet për qëllime tatimore nuk është objekt i një rishikimi të jashtëm dhe efekti është material në pasqyrat financiare, për identifikimin e kërcënimeve të vetë-rishikimit ose të favorizimit të krijuara nga dhënia e këtyre shërbimeve për një klient të auditimit, që nuk është një entitet me interes publik, dhe për vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve, përveç kërkesave në paragrafin 604.3 A2, mbahen parasysh edhe faktorët e mëposhtëm:

- Shkalla deri në të cilën metodologjia e vlerësimit mbështetet nga

- legjislatiioni tatimor, precedentët ose praktika e vendosur.
- Shkalla e subjektivitetit e pranishme në vlerësim.
- Besueshmëria dhe periudha kohore e përcaktuar

604.18 A3 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për të adresuar këto kërcënime për një klient auditimi që nuk është entitet me interes publik përfshijnë:

- Përdorimin e profesionistëve që nuk kanë qenë pjese e ekipit të auditimit për kryerjen e shërbimit mund të adresojë kërcënimet e vetë-rishikimit ose të favorizimit.
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm që nuk ka qenë i përfshirë në dhënien e shërbimit për rishikimin punës së auditimit ose shërbimit të kryer, mund të adresojë një kërcënim të vetë-rishikimit.
- Marrja e një vërtetimi paraprak në lidhje me detyrimet, nga autoritetet tatimore mund të adresojë kërcënimet e vetë-rishikimit ose të favorizimit.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

Kërcënimet e vetë-rishikimit

K604.19 Një firmë ose një firmë rrjet nuk do të kryejë një vlerësim për qëllime tatimore për një klient auditimi që është një entitet me interes publik nëse ofrimi i këtij shërbimi mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimi (Parag. K600.14, K600.16, 604.17 A3).

Kërcënimet e favorizimit

604.19 A1 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse ndaj kërcënimeve të favorizimit, të krijuara nga kryerja e një vlerësimi për qëllime tatimore për një klient auditimi që është një entitet me interes publik përfshijnë:

- Përdorimin e profesionistëve që nuk janë pjesë e ekipit të auditimit për kryerjen e shërbimit.
- Marrja e një vërtetimi nga organet tatimore që vërteton përmbushjen nga klienti të detyrimeve tatimore

E. Asistenca në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tatimore

Përshkrimi i shërbimit

604.20 A1 Një shërbim i jo-sigurisë për të dhëne asistencë ndaj një klienti auditimi në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tatimore mund të lindi nga një vlerësim i autoriteteve tatimore për llogaritjen dhe trajtimin e tatimeve. Ky shërbim

mund të përfshijë për shembull, dhënien e asistencës kur autoritetet tatimore kanë njoftuar klientin se janë refuzuar argumentet mbi një çështje të veçantë dhe autoritetet tatimore ose klienti e referojnë çështjen për zgjidhje në një procedure formale gjyqësore.

Kërcënimet që lindin nga dhënia e asistencës në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tatimore

Të gjithë klientët e auditimit

Dhënia e ndihmës në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje tatimore për një klient të auditimit, mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit kur ekziston rreziku që rezultatet e shërbimit mund të ndikojë në regjistrimet kontabël ose pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion. Njëshërbim i tillë mund të krijojë një kërcënim të favorizimit.

604.22 A1 Përveç atyre që është evidentuar në paragrafin 604.3 A2, faktorët që janë të përshtatshëm për identifikimin e kërcënimeve të vetë-rishikimit ose të favorizimit, të krijuara nga asistenca për një klient të auditimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tatimore, dhe vlerësimi i nivelit të këtyre kërcënimeve, përfshijnë:

- Rolin që luan drejtimi në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
- Shkallën me të cilën rezultati i mosmarrëveshjes do të ketë një efekt material në pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion.
- Faktin nëse këshilla e dhënë nga firma ose firma rrjet është objekt i mosmarrëveshjes tatimore.
- Shkallën në të cilën çështja është e mbështetur në legjislacionin tatimor apo rregullimin tatimor, në precedentët e tjerë, apo në praktikën e vendosur.
- Faktin nëse çështja do të shqyrtohet në mënyrë publike.

Kur evidentohet një kërcënim i vetë-rishikimit për një klient auditimi që është entitet me interes publik, zbatohet paragrafi R.604.24.

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

604.23 A1 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për të adresuar kërcënimet e vetë-rishikimit ose të favorizimit të krijuara nga ndihma e një klienti të auditimi që nuk është një entitet me interes publik për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tatimore, përfshijnë:

- Përdorimin e profesionistëve, të cilët nuk janë anëtarë të grupit të auditimit, për kryerjen e shërbimit mund të adresojë kërcënimet e

vetë-rishikimit ose favorizimit.

- Angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk ka qenë i përfshirë në dhënien e shërbimit, për të për të rishikuar punën e auditimit ose shërbimin e kryer, mund të adresojë një kërcënim të vetë-rishikimit

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

Kërcënime të vetë-rishikimit

K604.24 Një firmë ose firmë rrjet nuk do të japë asistencë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tatimore për një klient të auditimit, që është entitet me interes publik, nëse kjo asistencë mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit (Parag. K600.14 dhe K600.16).

Kërcënime favorizimit

604.24 A1 Shembull i një veprimi që mund të jetë masë mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të favorizimit për një klient të auditimit, që është entitet me interes publik, është angazhimi për kryerjen e shërbimit, i profesionistëve që nuk janë pjesë ekipit të auditimit.

Zgjidhja e çështjeve tatimore duke përfshirë angazhimin si avokat përpara njëgjykatë

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

K604.25 Një firmë ose një firmë rrjet nuk do të japë shërbime tatimore që përfshijnë ndihmën në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tatimore për një klient auditimi që nuk është entitet me interes publik, nëse:

- (a) Shërbimet përfshijnë të vepruarit në rolin e avokatit për klientin e auditimit përpara një gjykatë për zgjidhjen e një çështje tatimore; dhe
- (b) Shumat e përfshira janë materiale në pasqyrat financiare mbi të cilat firma do të shprehë një opinion

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

K604.26 Një firmë ose një firmë rrjet nuk do të japë shërbime tatimore që përfshijnë ndihmën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tatimore për një klient të auditimit, që është entitet me interes publik, nëse shërbimet përfshijnë të vepruarin për klientin e auditimit si avokat përpara një gjykatë.

604.27 A1 Paragrafët R604.25 dhe R604.26 nuk e përjashtojnë një firmë ose firmë

rrjeti nga kryerja e një roli këshillues të vazhdueshëm në lidhje me çështjet që janë paraqitur përpara një gjykate, si për shembull:

- Përgjigjet për çështje specifike.
- Paraqitja e shumave faktike ose dëshmime për punën e kryer.
- Ndihma për klientin në analizimin e çështjeve tatimore të lidhura me rastin.

604.27 A2 Mënyra e trajtimit të çështjeve tatimore nëpërmjet “gjykatës” varet nga juridiksioni përkatës.

NËNSEKSIONI 605 – SHËRBIMET E AUDITIMIT TËBRENDSHËM

Hyrje

605.1 Përveç kërkesave specifike dhe materialit për zbatimit në këtë nën seksion, për zbatimin e kuadrit konceptual kur jepet një shërbim i auditimit të brendshëm për një klient të auditimit, janë të përshtatshme edhe kërkesat dhe materiali për zbatim në paragrafët 600.1 deri në 600.27 A1

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Përshkrimi i shërbimit

605.2 A1 Shërbimet e auditimit të brendshëm përfshijnë një gamë të gjerë aktivitetesh dhe mund të përfshijnë ndihmën e klientit të auditimit në kryerjen e një ose më shumë aspekteve të aktiviteteve të tij të auditimit të brendshëm. Aktivitetet e auditimit të brendshëm mund të përfshijnë:

- Monitorimin e kontrollit të brendshëm – rishikimin e kontrolleve, monitorimin e operacioneve të tyre rekomandimin për përmirësimet e tyre.
- Ekzaminimin e informacionit financiar dhe operativ nëpërmjet
 - Rishikimit të mjeteve të përdorura për të identifikuar, matur, klasifikuar dhe raportuar informacionin financiar dhe operativ.
 - Kërkimi specifik për artikujt individualë, duke përfshirë testimin e detajuar të transaksioneve, tepricave dhe procedurave.
- Rishikimi i ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve operative duke përfshirë aktivitetet jo financiare të entitetit.
- Rishikimi i përputhshmërisë me:
 - Ligjet, rregulloret dhe kërkesat e tjera të jashtme.
 - Politikat e menaxhimit, direktivat dhe kërkesat e tjera të brendshme.

605.2 A2 Objekti dhe objektivat e aktiviteteve të auditimit të brendshëm ndryshojnë shumë dhe varen nga madhësia dhe struktura e entitetit dhe kërkesat e personave të ngarkuar me qeverisjen si dhe nevojat dhe pritshmëritë e menaxhimit. Meqenëse ato mund të përfshijnë çështje që janë operacionale në natyrë, ato nuk lidhen domosdoshmërisht me çështje që do të jenë subjekt i vlerësimit në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare.

Rreziku i marrjes së përgjegjësisë së menaxhimit gjatë dhënies së një shërbimi të auditimit të brendshëm

K605.3 Paragrafi K400.13 përjashton një firmë ose një firmë rrjet nga marrja përsipër e përgjegjësisë së menaxhimit. Kur jep një shërbim të auditimit të brendshëm për një klient auditimi, firma duhet të jetë e kënaqur që:

- (a) Klienti cakton një burim të përshtatshëm dhe kompetent, i cili raporton tek personat e ngarkuar me qeverisjen, për te:
 - (i) Qenë përgjegjës gjatë gjithë kohës për aktivitetet e auditimit të brendshëm; dhe
 - (ii) Pranuar përgjegjësinë për projektimin, zbatimin, monitorimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm;
- (b) Klienti rishikon, vlerëson dhe miraton qëllimin, rrezikun dhe shpeshësinë e shërbimeve të auditimit të brendshëm;
- (c) Klienti vlerëson përshtatshmërinë e shërbimeve të auditimit të brendshëm dhe gjetjet që rezultojnë nga performanca e tyre;
- (d) Klienti vlerëson dhe përcakton se cilat rekomandime që rezultojnë nga shërbimet e auditimit të brendshëm duhet të zbatohen dhe menaxhon procesin e zbatimit; dhe
- (e) Klienti raporton tek personat e ngarkuar me qeverisjen gjetjet dhe rekomandimet e rëndësishme që rezultojnë nga shërbimet e auditimit të brendshëm.

605.3 A1 Kryerja e një pjese të aktiviteteve të auditimit të brendshëm të klientit e rrit mundësinë që individët brenda firmës ose firmës rrjet që jep shërbime të auditimit të brendshëm do të marrin përsipër një përgjegjësi menaxhimi.

605.3 A2 Shembuj të shërbimeve të auditimit të brendshëm që përfshijnë marrjen përsipër të përgjegjësisë së menaxhimit përfshijnë:

- Përcaktimin e politikave të auditimit të brendshëm ose drejtimin strategjik të aktiviteteve të auditimit të brendshëm.
- Drejtimin dhe marrjen e përgjegjësisë për veprimet e punonjësve të auditimit të brendshëm të entitetit.
- Marrjen e vendimit se cilat rekomandime që rezultojnë nga

- aktiviteteve të auditimit të brendshëm, do të zbatohen
- Raportimi, në emër të menaxhimit, i rezultateve të aktiviteteve të auditimit të brendshëm tek personat e ngarkuar me qeverisjen
- Kryerja e procedurave që janë pjesë e kontrollit të brendshëm, të tilla si rishikimi dhe miratimi i ndryshimeve në të drejtat e aksesit të të dhënave të punonjësve.
- Marrja e përgjegjësisë për projektimin, zbatimin, monitorimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm.
- Kryerja shërbimeve të auditimit të brendshëm në mënyrë të eksternalizuar (me outsourcing) (ose të kontraktuara nga jashtë), të cilat përfshijnë të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të funksionit të auditimit të brendshëm, ku firma ose firma rrjet është përgjegjëse për përcaktimin e objektit të punës së auditimit të brendshëm; dhëmund të ketë përgjegjësi për një ose më shumë nga çështjet e përmendura më sipër.

Kërcënimet e mundshme që dalin nga ofrimi i Shërbimeve të Auditimit të Brendshëm

Të gjithë klientët e auditimit

- 605.4 A1 Dhënia e shërbimeve të auditimit të brendshëm për një klient auditimi mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit, kur ekziston rreziku që rezultatet e shërbimeve të ndikojnë në auditimin e pasqyrave financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion.
- 605.4 A2 Kur një firmë përdor punën e një funksioni të auditimit të brendshëm në një angazhim auditimi, SNA-të kërkojnë kryerjen e procedurave për të vlerësuar përshtatshmërinë e kesaj pune. Në mënyrë të ngjashme, kur një firmë ose një firmë rrjet pranon një angazhim për të dhënë shërbime të auditimit të brendshëm për një klient auditimi, rezultatet e këtyre shërbimeve mund të përdoren në kryerjen e auditimit të jashtëm. Kjo mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit sepse ekipi i auditimit mund të përdorë rezultatet e shërbimit të auditimit të brendshëm për qëllime të angazhimit të auditimit pa:
- (a) Bere vlerësimin e duhur të këtyre rezultateve; ose
 - (b) Ushtruar të njëjtin nivel të skepticizmi profesional siç do të ushtrohej kur puna e auditimit të brendshëm të kryhej nga individë që nuk janë anëtarë të firmës
- 605.4 A3 Faktorët që janë të përshtatshëm për identifikimin e një kërcënimi të vetë-rishikimit të krijuar nga dhënia e shërbimeve të auditimit të brendshëm për një klient të auditimit dhe për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë, përfshijnë:

- (a) Materialitetin e shumave të lidhura me pasqyrat financiare.
- (b) Rrezikun e anomalisë së pohimeve të lidhura me këto shuma të pasqyrave financiare.
- (c) Shkallen e mbështetjes që ekipi i angazhimit do të vendosë në punën e shërbimit të auditimit të brendshëm.

Kur identifikohet një kërcënim i vetë-rishikimit për një klient të auditimit që është një entitet me interes publik, zbatohet paragrafi R605.6.

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

- 605.5 A1 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për të trajtuar një kërcënim të vetë-rishikimit të krijuar nga dhënia e një shërbimi të auditimit të brendshëm për një klient të auditimit që nuk është një entitet me interes publik, është përfshirja e profesionistëve që nuk janë anëtarët e ekipit të auditimit për të kryer shërbimin.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

- K605.6 Një firmë ose një firmë rrjet nuk duhet të japë shërbime të auditimit të brendshëm për një klient të auditimit që është entitet me interes publik kur dhënia e këtyre shërbimeve mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit. (Ref: Para. K600.14 dhe K600.16).

- 605.6 A1 Shembuj të shërbimeve që sipas paragrafit K605.6 janë të ndaluara, përfshijnë shërbimet e auditimit të brendshëm që kanë të bëjnë me:
- Kontrollat e brendshme mbi raportimin financiar.
 - Sistemet e kontabilitetit financiar që gjenerojnë informacion për të dhënat kontabël të klientit ose pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion.
 - Shumat ose informacionet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion.

NËNSEKSIONI 606 – SHËRBIMET E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Hyrje

- 606.1 Për zbatimin e kuadrit konceptual kur jepet një shërbim i sistemeve të teknologjisë së informacionit (IT) për një klient auditimi, përveç kërkesave specifike dhe materialit për zbatim në

këtë nën seksion, janë të përshtatshme edhe kërkesat dhe materiali për zbatim në paragrafët 600.1 deri në 600.27 A1

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Përshkrimi i shërbimit

606.2 A1 Shërbimet që lidhen me sistemet e IT-së përfshijnë projektimin ose zbatimin e sistemeve harduerike ose softuerike. Sistemet e IT-së mund:

- (a) Të mbledhin të dhëna të përgjithshme burimore;
- (b) Të jenë pjesë e kontrollit të brendshëm mbi raportimin financiar; ose
- (c) Të gjenerojë informacion që ndikon në regjistrimet kontabël ose pasqyrat financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese përkatëse.

Megjithatë, sistemet e TI-së mund të përfshijnë gjithashtu çështje që nuk kanë lidhje me regjistrimet kontabël të klientit të auditimit ose me kontrollin e brendshëm mbi raportimin financiar ose pasqyrat financiare.

Rreziku i marrjes së përgjegjësisë së menaxhimit gjatë dhënies të një shërbimi të sistemeve TI-së

K606.3 Paragrafi K400.18 përjashton një firmë ose një firmë rrjet që të marrë përsipër përgjegjësinë e menaxhimit. Kur jep shërbime të sistemeve të IT-së për një klient auditimi, firma ose firma e rrjetit duhet të ketë bindjen që:

- (a) Klienti pranon përgjegjësinë e tij për krijimin dhe monitorimin e një sistemi të kontrolleve të brendshme;
- (b) Klienti i cakton përgjegjësinë për të marrë të gjitha vendimet e menaxhimit në lidhje me projektimin dhe zbatimin e sistemit të harduerit ose softuerit një punonjësi kompetent, preferohet brenda grupit të drejtuesve kryesorë;
- (c) Klienti merr të gjitha vendimet e menaxhimit në lidhje me procesin e projektimit dhe zbatimit;
- (d) Klienti vlerëson përshtatshmërinë dhe rezultatet e projektimit dhe zbatimit të sistemit; dhe;
- (e) Klienti është përgjegjës për funksionimin e sistemit (harduare ose softuere) dhe për të dhënat që ai përdor ose gjeneron.

Kërcënimet e mundshme që lindin nga dhënia e shërbimeve të sistemeve të TI-se

Të gjithë klientët e auditimit

- 606.4 A1 Dhënia e shërbimeve të sistemeve të IT-së për një klient auditimi mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit kur ekziston rreziku që rezultatet e shërbimeve të ndikojnë në auditimin e pasqyrave financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion.
- 606.4 A2 Dhënia e shërbimeve të mëposhtme të sistemeve të IT-së për një klient të auditimit, zakonisht nuk krijon një kërcënim për sa kohë që individët brenda firmës ose firmës rrjet nuk marrin përsipër përgjegjësinë e menaxhimit:
- (a) Projektimi ose zbatimi i sistemeve të IT-së që nuk kanë lidhje me kontrollin e brendshëm mbi raportimin financiar;
 - (b) Projektimi ose zbatimi i sistemeve të IT-së që nuk gjenerojnë informacione që përbëjnë pjesë të regjistrimeve kontabël ose pasqyrave financiare; dhe
 - (c) Përdorimi i një softueri “standard” të kontabilitetit ose të raportimit të informacionit financiar që nuk është zhvilluar nga firma ose firma rrjet, nëse personalizimi i kërkuar për të përbushur nevojat e klientit nuk është i rëndësishëm.
- 606.4 A3 Faktorët që janë të përshtatshëm për identifikimin e një kërcënimi të vetë-rishikimit të krijuar nga dhënia e një shërbimi të sistemeve të IT-së një klienti auditimi dhe për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë, përfshijnë:
- Natyrën e shërbimit.
 - Natyrën e sistemeve të IT-së të klientit dhe shkallen në të cilën shërbimi i sistemeve të IT-së ndikon ose ndër vepron me regjistrimet kontabël të klientit, kontrollet e brendshme mbi raportimin financiar ose pasqyrat financiare.
 - Shkallen e mbështetjes që do të vendoset në sistemet e veçanta të IT-së si pjesë e auditimit.

Kur ka qenë identifikuar një kërcënim i vetë-rishikimit për një klient të auditimit, që është një entitet me interes publik, zbatohet paragrafi K606.6.

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

- 606.5 A1 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për të trajtuar një kërcënim të vetë-rishikimit, të krijuar nga dhënia e një shërbimi të sistemeve të IT-së për një klient të auditimit, që nuk është entitet me interes publik, është përdorimi, për të kryer shërbimin, i profesionistëve që nuk janë anëtarë të ekipit të auditimit.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

- 606.6 A1 Një firmë ose një firmë rrjet nuk do të japë shërbime të sistemeve të IT-së për një klient auditimi që është entitet me interes publik nëse ofrimi i shërbimeve të tilla mund të krijojë një kërcënim vetë-rishikimi (Ref: Para. R600.14 dhe R600.16)
- 606.6 A2 Shembuj të shërbimeve që janë të ndaluara për shkak se shkaktojnë një kërcënim të vetë-rishikimit përfshijnë ato që kanë të bëjnë me projektimin ose zbatimin e sistemeve të IT-së, të cilat:
- Janë pjesë e kontrollit të brendshëm mbi raportimin financiar; ose
 - Gjenerojnë informacion për regjistrat kontabël të klientit ose pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion.

NËNSEKSIONI 607 – SHËRBIMET NDIHMËSE PËR PROCESET GJYQËSORE

Hyrje

- 607.1 Për zbatimin e kuadrit konceptual kur jepet një shërbim mbështetës për çështje gjyqësore për një klient auditimi, përveç kërkesave specifike dhe materialit për zbatim në këtë nën seksion, janë të përshtatshme edhe kërkesat dhe materiali për zbatim në paragrafët 600.1 deri në 600.27 A1

Kërkesat dhe Materiali për Zbatim

Përshkrimi i Shërbimit

- 607.2 A1 Shërbimet mbështetëse të çështjeve gjyqësore mund të përfshijnë aktivitete të tilla si:
- Ndihma me menaxhimin dhe marrjen e dokumenteve.
 - Te vepruarit si dëshmitar, përfshirë një dëshmitar ekspert.
 - Llogaritja e dëmeve të vlerësuara ose shumave të tjera që mund të bëhen të arkëtueshme ose të pagueshme si rezultat i një procesi gjyqësor ose mosmarrëveshje tjetër ligjore
 - Shërbimet e investigimit ose verifikimit

Kërcënimet e mundshme që dalin nga ofrimi i shërbimeve mbështetëse për çështje gjyqësore

Të gjithë klientët e auditimit

- 607.3 A1 Dhënia e shërbimeve mbështetëse për çështjet gjyqësore për një klient të auditimit mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit, kur ekziston

rrezikuqë rezultatet e shërbimeve do të ndikojnë në regjistrimet kontabël ose pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion. Shërbimetë tilla mund të krijojnë gjithashtu një kërcënim të favorizimit.

607.4 A1 Faktorët që janë të përshtatshëm për identifikimin e kërcënimeve të vetë - rishikimit ose të favorizimit, që krijohen nga dhënia e shërbimeve të mbështetjes për çështje gjyqësore për një klient të auditimit dhe të vlerësimit nivelit të këtyre kërcënimeve, përfshijnë:

- Mjedisin ligjor dhe rregullator në të cilin është dhënë shërbimi.
- Natyrën dhe karakteristikat e shërbimit.
- Shkallën në të cilën rezultati i shërbimit të mbështetjes për çështjet gjyqësore, mund të përfshijë vlerësimin me çmuarje, ose mund të ndikojë në çmuarjen e dëmeve ose shumave të tjera që mund të kenë një efekt material në pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion.

Kur identifikohet një kërcënim i vetë-rishikimit për një klient të auditimit që është një entitet me interes publik, zbatohet paragrafi K607.6.

607.4 A2 Nëse një firmë ose një firmë rrjet jep një shërbim të mbështetjes për çështje gjyqësore për një klient të auditimit dhe shërbimi mund të përfshijë vlerësimin me çmuarje, ose mund të ndikojë në çmuarjen e dëmeve ose shumave të tjera që ndikojnë në pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion, zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim të përshkruara në nën seksionin 603 në lidhje me shërbimet e vlerësimit.

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

607.5 A1 Një shembull i një veprimi që mund të ishte një masë mbrojtëse për të trajtuar një kërcënim të vetë-rishikimit ose të përkrahjes, të krijuar nga dhënia e një shërbimi të mbështetjes për çështje gjyqësore për një klient të auditimit që nuk është një entitet me interes publik, është përdorimi i një profesionisti, i cili nuk ka qenë anëtar i ekipit të auditimit, për të kryer shërbimin.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

Kërcënimet e vetë-rishikimit

K607.6 Një firmë ose një firmë rrjet nuk do të japë shërbime mbështetëse për çështje gjyqësore për një klient auditimi që është një entitet me interes publik nëse dhënia e këtyre shërbimeve mund të krijojte një kërcënim të vetë-rishikimit. (Ref: Para. K600.14 dhe K600.16).

- 607.6 A1 Një shembull i një shërbimi që është i ndaluar për shkak se mund të krijonte një kërcënim të vetë-rishikimit, është dhënia e këshillave në lidhje me një proces gjyqësor ku ekziston rreziku që rezultati i shërbimit të ndikojë në shumën e ndonjë provizionit ose në shumën të tjera në pasqyrat financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion.

Kërcënimet e favorizimit

- 607.6 A2 Një shembull i një veprimi që mund të ishte një masë mbrojtëse për të trajtuar një kërcënim të favorizimit, të krijuar nga dhënia e një shërbimi të mbështetjes gjyqësore për një klient të auditimit që është një entitet me interes publik, është përdorimi i një profesionisti, i cili nuk ka qenë anëtar i ekipit të auditimit, për të kryer shërbimin.

Roli si dëshmitar

Të gjithë klientët e auditimit

- 607.7 A1 Një profesionist brenda firmës ose firmës së rrjetit mund të japë dëshmi në një gjykatë si dëshmitar i faktit ose si dëshmitar ekspert.
- (a) Dëshmitar i faktit është një individ që jep evidenca para një gjykate bazuar në njohuritë e tij ose të saj të drejtpërdrejta për faktet ose ngjarjet.
 - (b) Një dëshmitar ekspert është një individ që jep evidence, që përfshin opinionet për çështjet, përpara një gjykate bazuar në ekspertizën e tij individuale.
- 607.7 A2 Një kërcënim ndaj pavarësisë nuk krijohet kur një individ, në lidhje me një çështje që përfshin një klient auditimi, vepron si dëshmitar i faktit dhe, gjatë kësaj dëshmie, jep një opinion brenda fushës së ekspertizës së tij individuale në përgjigje të një pyetje të bëre gjatë dhënies së provave faktike.
- 607.7 A3 Kërcënimi i favorizimit që krijohet kur veprohet si dëshmitar ekspert në emër një klienti të auditimit është në një nivel të pranueshëm nëse një firmë ose një firmë rrjet është:
- (a) caktuar nga një gjykatë për të vepruar si dëshmitar ekspert në një çështje që përfshin një klient; ose;
 - (b) angazhuar për të këshilluar ose vepruar si dëshmitar ekspert në lidhje me një veprim të një klase (ose një veprim përfaqësues të grupit ekuivalent) me kusht që:
 - (i) Klientët e auditimit të firmës përbëjnë më pak se 20% të anëtarëve të klasës ose grupit (në numër dhe në vlerë);

- (ii) Asnjë klient i auditimit nuk është caktuar të udhëheqë klasën ose grupin; dhe
- (iii) Asnjë klient i auditimit nuk është i autorizuar nga klasa ose grupi për të përcaktuar natyrën dhe qëllimin e shërbimeve që do të jepen nga firma ose kushtet sipas të cilave do të kryhen këto shërbime.

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

607.8 A1 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për të trajtuar një kërcënim të favorizimit për një klient të auditimit që nuk është entitet me interes publik, është përdorimi i një profesionisti, i cili nuk është dhe nuk ka qenë anëtar i ekipit të auditimit, për të kryer shërbimin.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

K607.9 Një firmë ose një firmë rrjet, ose një individ brenda një firme ose një firme rrjet, nuk do të veprojë, për një klient auditimi që është një entitet me interes publik, si dëshmitar ekspert në një çështje, përveç rrethanave të përshkruara në paragrafin 607.7 A3.

NËNSEKSIONI 608 – SHËRBIMET LIGJORE

Hyrje

608.1 Për zbatimin e kuadrit konceptual kur jepet një shërbim ligjor për një klient të auditimit, përveç kërkesave specifike dhe materialit për zbatim në këtë nën seksion, janë të përshtatshme edhe kërkesat dhe materiali për zbatim në paragrafë 600.1 deri në 600.27 A1.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Përshkrimi i Shërbimit

608.2 A1 Shërbimet ligjore përkufizohen si shërbime për të cilat individ i jep shërbimet duhet:

- (a) Të ketë trajnimin e nevojshëm ligjor për të praktikuar jurisprudencën; ose
- (b) Të jetë pranuar për të ushtruar profesionin e avokatit para gjykatave të juridiksionit në të cilin këto shërbime do të jepen.

608.2 A2 Ky nën seksion trajton në mënyrë specifike:

- Dhënien e këshillave ligjore.
- Te vepruarit si këshilltar i përgjithshëm
- Te vepruarit në rolin e avokatit.

Kërcënimet e mundshme që burojnë nga ofrimi i shërbimeve ligjore

Të gjithë klientët e auditimit

608.3 A1 Dhënia e shërbimeve ligjore për një klient të auditimit mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit, kur ekziston rreziku që rezultatet e shërbimeve të ndikojnë në regjistrimet kontabël ose pasqyrat financiare, për të cilat firma do të shprehë një opinion. Shërbime të tilla mund të krijojnë gjithashtu, një kërcënim të favorizimit.

A. Ofrimi i këshillave juridike

Përshkrimi i shërbimi

608.4 A1 Në varësi të juridiksionit, dhënia e këshillave ligjore mund të përfshijë një gamë të gjerë dhe të larmishme fushash shërbimi, duke përfshirë shërbimet e korporatave dhe ato tregtare për klientët e auditimit, të tillasi:

- Mbështetje kontraktore.
- Mbështetja e një klienti auditimi në ekzekutimin e një transaksioni.
- Bashkimet dhe blerjet.
- Mbështetja dhe asistimi i departamentit të brendshëm ligjor të klientit të auditimit.
- Vlerësimi (due diligence) ligjor dhe ristrukturimi.

Kërcënimet e mundshme që burojnë nga dhënia e këshillave ligjore

Të gjithë klientët e auditimit

608.5 A1 Faktorët që janë të përshtatshëm për identifikimin e kërcënimeve të vetë-rishikimit ose të favorizimit, që krijohen nga dhënia e këshillave ligjore përnjë klient të auditimit dhe, vlerësimi i nivelit të këtyre kërcënimeve përfshijnë:

- Materialitetin e çështjes specifike në lidhje me pasqyrat financiare të klientit.
- Komplexitetin e çështjes ligjore dhe shkallen e gjykimit tënevojshëm për të dhënë shërbimin.

Kur është identifikuar një kërcënim i vetë-rishikimit për një klient i

auditimit, që është një entitet me interes publik, zbatohet paragrafi K608.7.

608.5 A2 Shembuj të këshillimeve ligjore që mund të krijojnë një kërcënim të vetë-rishikimit përfshijnë:

- Vlerësimin me çmuarje të një humbjeje të mundshme nga një padi për qëllime të regjistrimit të një provizioni në pasqyrat financiare të klientit.
- Interpretimin e provizioneve të kontratave që mund të çonin në detyrimet e reflektuara në pasqyrat financiare të klientit.

608.5 A3 Negocimi në emër të një klienti të auditimit, mund të krijojë një kërcënim të favorizimit ose mund të rezultojë në marrjen e një përgjegjësie menaxhimi nga firma apo firma e rrjetit.

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

608.6 A1 Shembuj të veprimeve që mund të ishin masa mbrojtëse për të adresuar kërcënimet e vetë-rishikimit ose të përkrahjes, të krijuara nga dhënia e këshillave ligjore për një klient të auditimi që nuk është një entitet me interes publik, përfshijnë:

- Shfrytëzimi i profesionistëve që nuk janë anëtarë të ekipit të auditimit për të kryer shërbimin, mund të adresojë një kërcënim të vetë-rishikimit ose të favorizimit.
- Përfshirja e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk ka qenë i përfshirë në dhënin e shërbimit për të rishikuar punën e auditimit ose shërbimin e kryer, mund të adresojë një kërcënim të vetë-rishikimit.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

Kërcënimet e vetë-rishikimit

K608.7 Një firmë ose një firmë rrjet nuk duhet të japë këshilla ligjore për një klient të auditimit, që është një entitet me interes publik, nëse dhënia e një shërbimi të tillë mund të krijojë një kërcënim vetë-rishikimi. (Ref: Para. K600.14 dhe K600.16).

Kërcënimet e favorizimit

608.8 A1 Konsideratat në paragrafët 608.5 A1 dhe 608.5 A3 deri në 608.6 A1 janë gjithashtu, të përshtatshme për vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve të përkrahjes, që mund të krijoreshin nga dhënia e këshillimit ligjor për një klient auditimi që është një entitet me interes publik.

B. Te vepruarit si këshilltar i përgjithshëm

Të gjithë klientët e auditimit

- K608.9 Një ortak ose punonjës i firmës ose i firmës së rrjetit nuk do të shërbejë si Këshilltar i Përgjithshëm i një klienti të auditimit.
- 608.9 A1 Pozicioni i Këshilltarit të Përgjithshëm është zakonisht një pozicion i drejtimit të lartë me përgjegjësi të gjerë për çështjet juridike të një shoqërie.

C. Veprimi në rolin e avokatisë

Kërcënimet e mundshme që dalin nga veprimi në rolin e avokatisë përpara një gjykate

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

- K608.10 Një firmë ose një firmë rrjet nuk do të veprojë në një rol mbrojtës (te avokatisë) për një klient të auditimit, që nuk është një entitet me interes publik, në zgjidhjen e një mosmarrëveshje ose padie gjyqësore përpara një gjykate, kur shumat perkatese janë materiale për pasqyrat financiare mbi të cilat firma do të shprehe një opinion
- 608.10 A1 Shembuj të veprimeve që mund të ishin masa mbrojtëse për të trajtuar një kërcënim të vetë-rishikimit ose të përkrahjes, të krijuar kur veprohet në një rol avokatie, për një klient të auditimit që nuk është një entitet me interes publik, përfshijnë:
- Përfshirjen e profesionistëve që nuk janë anëtarë të ekipit të auditimit për të kryer shërbimin.
 - Përfshirjen e një rishikuesi të përshtatshëm i cili nuk ka qenë i përfshirë në dhënien e shërbimit të rishikimit të auditimit ose shërbimin e kryer.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

- K608.11 Një firmë ose një firmë rrjet nuk do të veprojë në një rol të avokatisë, për një klient auditimi që është një entitet me interes publik, në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje ose procesi gjyqësor përpara një gjykate.

NËNSEKSIONI 609 – SHËRBIMET E REKRUTIMIT

Hyrje

609.1 Për zbatimin e kuadrit konceptual, kur jepet një shërbim rekrutimi për një klient të auditimit, përveç kërkesave specifike dhe materialit për zbatim në këtë nën seksion, janë të përshtatshme edhe kërkesat dhe materiali për zbatim në paragrafët 600.1 deri në 600.27.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Përshkrimi i shërbimit

609.2 A1 Shërbimet e rekrutimit mund të përfshijnë aktivitete të tilla si:

- Zhvillimi i një përshkrimi të punës.
- Zhvillimi i një procesi për identifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve të mundshëm.
- Kërkimi ose përzgjedhja e kandidatëve.
- Ekzaminimi i kandidatëve të mundshëm për rolin e caktuar duke:
 - Rishikuar kualifikimet apo kompetencat profesionale të kandidatëve dhe përcaktimi i përshtatshmërisë së tyre për pozicionin.
 - Kryer kontrolle të referencës së kandidatëve të mundshëm.
 - Intervistuar dhe përzgjedhur kandidatët e përshtatshëm dhe këshillimi për kompetencat e kandidatëve.
- Përcaktimi i kushteve të punësimit dhe detajeve të negocimit, siç janë paga, orët e punës dhe shpërblimet e tjera.

Rreziku i marrjes së përgjegjësisë së menaxhimit kur jepet një shërbim i rekrutimit

K609.3 Paragrafi K400.13 përjashton një firmë ose një firmë rrjet nga marrja përsipër e një përgjegjësie të menaxhimit. Kur jep një shërbim rekrutimi për një klient auditimi, firma duhet të sigurohet që:

- (a) Klienti ja ngarkon përgjegjësinë, për të marrë të gjitha vendimet menaxhimit në lidhje me punësimin e kandidatit për pozicionin e punës, një punonjësi kompetent, preferohet brenda ekipit të drejtuesve kryesorë; dhe
- (b) Klienti merr të gjitha vendimet e menaxhimit në lidhje me procesin e punësimit, duke përfshirë:
 - Përcaktimin e përshtatshmërisë së kandidatëve të mundshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve të përshtatshëm për pozicionin.
 - Përcaktimi i kushteve të punësimit dhe detajeve të negocimit, si paga, orët e punës dhe kompensimet e tjera.

Kërcënimet e mundshme që dalin nga dhënia e shërbimeve të rekrutimit

Të gjithë klientët e auditimit

- 609.4 A1 Dhënia e shërbimeve të rekrutimit për një klient të auditimit mund të krijojë një kërcënim të interesit vetjak, familjaritetit ose frikësimit
- 609.4 A2 Zakonisht, dhënia e shërbimeve të mëposhtme nuk krijon një kërcënim për sa kohë individët brenda firmës ose firmës së rrjetit nuk marrin përsipër përgjegjësinë e menaxhimit:
- Rishikimi i kualifikimeve profesionale për një numër kandidatesh dhe këshillimi për përshtatshmërinë e tyre për pozicionin.
 - Intervistimi i kandidatëve dhe këshillimi për kompetencën e kandidatit për pozicionet e kontabilitetit financiar, administrative ose të kontrollit.
- 609.4 A3 Faktorët që janë të përshtatshëm për identifikimin e kërcënimeve të interesit vetjak, familjaritetit ose frikësimit, të cilat krijohen nga dhënia e shërbimeve të rekrutimit për një klient të auditimit dhe, vlerësimi i nivelit të këtyre kërcënimeve, përfshijnë:
- Natyrën e asistencës së kërkuar.
 - Rolin e individit që do të rekrutohet.
 - Çdo konflikt interesi ose marrëdhënie që mund të ekzistojë midis kandidatëve dhe firmës që jep këshillim ose shërbimin.
- 609.4 A4 Një shembull i një veprimi, që mund të ishte një masë mbrojtëse për të trajtuar një kërcënim të tillë të interesit vetjak (egoizmit), familjaritetit ose frikësimit, është përdorimi, për të kryer shërbimin, i profesionistëve që nuk janë anëtarë të ekipit të auditimit.

Shërbime të rekrutimit të ndaluara

- K609.5 Kur jep shërbime rekrutimi për një klient të auditimit, firma ose firma e rrjetit nuk do të veprojë si një negociator në emër të klientit.
- K609.6 Një firmë ose një firmë rrjet nuk do të japë një shërbim të rekrutimit për një klient të auditimit në qofte se shërbimi ka të bëjë me:
- (a) Kërkimin ose përzgjedhjen e kandidatëve;
 - (b) Kryerjen e kontrolleve të referencës së kandidatëve të mundshëm;
 - (c) Rekomandimin e personit që do të emërohet; ose
 - (d) Këshillimin për kushtet e punësimit, shpërblimin ose përfitime të ngjashme të një kandidati të caktuar, në lidhje me pozicionet e mëposhtme:

- (i) Një drejtor ose zyrtar i entitetit; ose
- (ii) Një anëtar i ekipit të drejtuesve kryesorë, në një pozicion që ushtron ndikim të rëndësishëm në përgatitjen e regjistrimeve kontabël ose të pasqyrave financiare të klientit, për të cilat firma do të shprehë një opinion.

NËNSEKSIONI 610 – SHËRBIMET E FINANCAVE TË KORPORATËS

Hyrje

610.1 Për zbatimin e kuadrit konceptual, kur jepet një shërbim financiar i korporatës për një klient auditimi, përveç kërkesave specifike dhe materialit për zbatim në këtë nën seksion, janë të përshtatshme edhe kërkesat dhe materiali për zbatim në paragrafët 600.1 deri 600.27 A1

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Përshkrimi i shërbimit

610.2 A1 Shembuj të shërbimeve të financave të korporatës përfshijnë:

- Ndihmën e një klienti auditimi në zhvillimin e strategjive të korporatës.
- Identifikimin e objektivave të mundshme, që duhet të arrijë klienti i auditimit.
- Këshillimin mbi çmimin e mundshëm të blerjes ose çmimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të një aktivi.
- Ndihmën në transaksionet e financimit.
- Dhënien e këshillave për strukturimin.
- Këshillimin për strukturimin e një transaksioni të financimit të korporatës ose për marrëveshjet financiare.

Kërcënimet e mundshme që burojnë nga dhënia e shërbimeve të financave të korporatës

Të gjithë klientët e auditimit

610.3 A1 Dhënia e shërbimeve të financave të korporatës për një klient të auditimit mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit, kur ekziston rreziku që rezultatet e shërbimeve do të ndikojnë në regjistrimet kontabël ose në pasqyrat financiare, për të cilat firma do të shprehë një opinion. Shërbime të tilla mund të krijojnë gjithashtu një kërcënim të favorizimit.

610.4 A1 Faktorët që janë të përshtatshëm për identifikimin e kërcënimeve të vetë-

rishikimit ose të favorizimit, të krijuara nga dhënia e shërbimeve të financave të korporatës për një klient të auditimit dhe për vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve, përfshijnë:

- Shkallen e subjektivitetit të përdorur në përcaktimin e trajtimit tëduhur për rezultatin ose pasojat e këshillimeve për financat e korporatës në pasqyrat financiare.
- Shkallen në të cilën:
 - Rezultati i këshillimit për financat e korporatës do të ndikojë drejtpërdrejt në shumat e regjistruara në pasqyrat financiare.
 - Rezultati i shërbimit për financat e korporatës mund të ketë një efekt material në pasqyrat financiare.

Kur identifikohet një kërcënim i vetë-rishikimit për një klient të auditimit që është entitet me interes publik, zbatohet paragrafi K610.8.

Shërbimet e financave të korporatës që janë të ndaluara

K610.5 Një firmë ose një firmë rrjet nuk do të japë shërbime të financave të korporatës, të cilat përfshijnë promovimin, tregtimin ose nënshkrimin e aksioneve, borxhit ose instrumenteve të tjera financiare të emetuara nga klienti i auditimit apo këshillimin për investim, si për shembull në aksione, obligacione apo instrumente të tjera financiare.

K610.6 Një firmë ose një firmë rrjet nuk duhet të japë këshilla në lidhje me shërbimet e financave të korporatës për një klient të auditimit kur:

- (a) Efektiviteti i një këshille të tillë varet nga një trajtim kontabël ose paraqitje e veçantë në pasqyrat financiare, për të cilat firma do të shprehë një opinion; dhe
- (b) Ekipi i auditimit ka dyshime për përshtatshmërinë e trajtimit përkatës kontabël ose të paraqitjes sipas kuadrit përkatës të raportimit financiar.

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

610.7 A1 Shembuj të veprimeve që mund të ishin masa mbrojtëse për të adresuar kërcënimet e vetë-rishikimit ose të favorizimit, të krijuara nga dhënia e shërbimeve të financave të korporatës për një klient të auditimit që nuk është një entitet me interes publik, përfshijnë:

- Përdorimi i profesionistëve që nuk janë anëtarë të ekipit të auditimit për të kryer shërbimin, mund të adresonte kërcënimet e vetë-rishikimit ose avokatisë/favorizimit.
- Angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm i cili nuk ka qenë i

përfshirë në dhënien e shërbimit, për të rishikuar punën e auditimit ose shërbimin e kryer, mund të adresonte një kërcënim të vetë-rishikimit.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

Kërcënimet e vetë-rishikimit

K610.8 Një firmë ose një firmë rrjet nuk do të japë shërbime të financave të korporatës për një klient të auditimit që është një entitet me interes publik nëse dhënia e këtyre shërbimeve mund të krijonte një kërcënim të vetë-rishikimit. (Ref: Para. K600.14 dhe K600.16).

Kërcënimet e favorizimit

610.8 A1 Një shembull i një veprimi që mund të kishte qenë një masë mbrojtëse për të trajtuar kërcënimet e favorizimit të krijuara nga dhënia e shërbimeve për financat e korporatës për një klient të auditimit, që është entitet me interes publik, është përfshirja në kryerjen e shërbimit, e profesionistëve, të cilët nuk janë anëtarë të ekipit të auditimit.

SEKSIONI 800

RAPORTET MBI PASQYRAT FINANCIARE PËR QËLLIMETË VEÇANTA QË PËRFSHIJNË NJË KUFIZIM NË PËRDORIM DHE SHPËRNDARJE (ANGAZHIMET E AUDITIMIT DHE TË RISHIKIMIT)

Hyrje

- 800.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120, për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë.
- 800.2 Ky seksion përshkruan disa modifikime të Pjesës 4A të lejuara në disa rrethana, që përfshijnë auditimet e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, ku raporti përfshin një kufizim në përdorim dhe shpërndarje. Në këtë seksion, një angazhim për të lëshuar një raport të kufizuar në përdorim dhe në shpërndarje për rrethanat e përshkruara në paragrafin K800.3, referohet si një “angazhim auditimi i pranueshëm”.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Te përgjithshme

- K800.3 Kur një firmë synon të lëshojë një raport mbi auditimin e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, i cili përfshin një kufizim në përdorim dhe shpërndarje, kërkesat e pavarësisë të përshkruara në Pjesën 4A do të jenë të zbatueshme për modifikimet që lejohen nga ky Seksion, por vetëm nëse:
- (a) Firma komunikon me përdoruesit e synuar, në lidhje me kërkesat e modifikuara për pavarësinë që do të zbatohen për kryerjen e shërbimit; dhe
 - (b) Përdoruesit e synuar të raportit e kuptojnë qëllimin dhe kufizimet e raportit dhe qartësisht bien dakord për zbatimin e modifikimeve.
- 800.3 A1 Përdoruesit e synuar të raportit mund të kishin siguruar një njohje apo kuptim të qëllimit dhe kufizimeve të raportit, nëpërmjet pjesëmarrjes direkte, ose mënyrë indirekte, me anë të një përfaqësuesi të tyre, i cili ka autoritetin për të vepruar në emër të përdoruesve të synuar, në përcaktimin e natyrës dhe të objektit të angazhimit. Në secilin rast kjo pjesëmarrje ndihmon firmën për të komunikuar me përdoruesit e synuar për çështje të pavarësisë, përfshirë rrethanat që janë të përshtatshme për zbatimin e kuadrin konceptual. Kjo i lejon firmës të marrë pëlqimin e përdoruesve të synuar për kërkesat e modifikuara për pavarësinë.

- K800.4 Kur përdoruesit e synuar përbëjnë një klasë të përdoruesve, të cilët nuk janë të identifikueshëm në mënyrë specifike sipas emrit në kohën kur u përcaktuan kushtet e angazhimit, këta përdorues duhet të bëhen më pas me dije nga firma, në lidhje me kërkesat për pavarësinë të pranuar nga përfaqësuesit e tyre.
- 800.4 A1 Për shembull, kur përdoruesit e synuar përbëjnë një klasë të përdoruesve të tillë si huadhënësit në një marrëveshje kredie të sindikuar (kolektive), firma mund të përshkruajë kërkesat e modifikuara për pavarësinë në një letër angazhimi drejtuar përfaqësuesit të huadhënësve. Përfaqësuesi mëtej, mund ta vërë letrën e angazhimit të firmës, në dispozicion të anëtarëve të grupit të përdoruesve, duke përmbyllur kështu kërkesën që firma të vërë në dijeni këta përdorues për kërkesat e modifikuara përpavarësinë, të pranuar nga përfaqësuesi.
- K800.5** Kur firma kryen një angazhim auditimi të pranuar çdo modifikim i Pjesës 4A do të kufizohet tek ato të përshkruara në paragrafët K800.7 deri në K800.14. Firma nuk do t'i zbatojë këto modifikime kur një auditim i pasqyrave financiare kërkohet nga ligji ose rregulli.
- K800.6 Nëse firma lëshon gjithashtu, një raport auditimi që nuk përfshin një kufizim në përdorim dhe në shpërndarje për të njëjtin klient, për këtë angazhim të auditimit firma do të zbatojë Pjesën 4A.

Entitetet me interes publik

- 800.7 Kur firma kryen një angazhim auditimi të pranuar, ajo nuk ka nevojë të zbatojë kërkesat e pavarësisë të përshkruara në Pjesën 4A, të cilat zbatohen vetëm për angazhimet e auditimit për entitetet me interes publik

Entitetet e lidhura

- K800.8 Kur firma kryen një angazhim auditimi të pranuar, referencat për klientin e auditimit nuk përfshijnë entitetet e tij të lidhura. Megjithatë, kur ekipi i auditimit ka dijeni ose ka arsye për të besuar se një marrëdhënie ose rrethanë që përfshin një entitet të lidhur të klientit, ka lidhje me vlerësimin e pavarësisë të firmës, ekipi i auditimit do ta përfshijë këtë entitet të lidhur kur identifikon, vlerëson dhe adreson kërcënimet për pavarësinë.

Rrjetet dhe firmat rrjet

- K800.9 Kur firma kryen një angazhim auditimi të pranueshëm, nuk është e nevojshme të zbatohen kërkesat specifike lidhur me firmat rrjet që jepen në Pjesën 4A. Megjithatë, kur firma ka dijeni ose ka arsye të besojë se

kërcënimet ndaj pavarësisë janë krijuar nga ndonjë interes ose marrëdhënie e një firme rrjet, firma do të vlerësojë dhe adresojë këtë kërcënim.

Interesat financiare, huatë dhe garancitë, marrëdhëniet e afërta të biznesit dhe marrëdhëniet familjare e personale

K800.10 Kur firma kryen një angazhim auditimi të pranueshëm:

- (a) Dispozitat përkatëse të përshkruara në seksionet 510, 511, 520, 521, 522, 524 dhe 525 nevojitet të zbatohen vetëm për anëtarët e grupit të angazhimit, anëtarët e drejtpërdrejtë të familjes së tyre dhe anëtarët e afërt të familjes;
- (b) Firma do të identifikojë, vlerësojë dhe adresojë çdo kërcënim ndaj pavarësisë të krijuar nga interesat dhe marrëdhëniet e përshkruara në seksionet 510, 511, 520, 521, 522, 524 dhe 525, midis klientit të auditimit dhe anëtarëve të mëposhtëm të ekipit të auditimit:
 - (i) Atyre, të cilët japin këshilla në lidhje me çështje teknike ose të veçanta të sektorit të ekonomisë, për transaksionet ose ngjarjet; dhe
 - (ii) Atyre, të cilët bëjnë kontrollin e cilësisë për angazhimin, duke përfshirë ata që kryejnë rishikimin për kontrollin e cilësisë së angazhimit; dhe
- (c) Firma do të vlerësojë dhe adresojë çdo kërcënim, që ekipi i angazhimit ka arsye të besojë se është krijuar nga interesat dhe marrëdhëniet midis klientit të auditimit dhe të tjerëve brenda firmës, të cilët mund të influencojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë rezultatet e angazhimit të auditimit.

800.10 A1 Të tjerët brenda firmës, të cilët mund të ndikojnë drejtpërdrejt rezultatet e angazhimit të auditimit, përfshijnë ata që rekomandojnë shpërblimin ose të cilët bëjnë mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë, menaxhimin apo edhe të tjera mbikëqyrje mbi partnerin e angazhimit të auditimit, në lidhje me kryerjen e angazhimit të auditimit, përfshirë individin në të gjitha nivelet e hierarkisë më të lartë mbi ortakun e angazhimit, me anë të individit, i cili është drejtuesi i lartë i firmës ose ortakut drejtues (Drejtori ekzekutiv ose ekuivalenti i tij).

K800.11 Kur firma kryen një angazhim auditimi të pranueshëm, firma do të vlerësojë dhe adresojë çdo kërcënim, që grupi i angazhimit ka arsye të besojë se është krijuar nga interesat financiare në klientin e auditimit, të mbajtura nga individët, siç përshkruhet në paragrafët K510.4(c) dhe (d), K510.5, K510.7 dhe 510.10 A5 dhe A9.

K800.12 Kur firma kryen një angazhim auditimi të pranueshëm, firma, në zbatimin e dispozitave të përshkruara në paragrafët K510.4(a), K510.6 dhe K510.7

për interesat e firmës, nuk do të mbajë një interes financiar material, të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë në klientin e auditimit.

Punësimi tek një klient i auditimit

K800.13 Kur firma kryen një angazhim auditimi të pranueshem, firma do të vlerësojë dhe adresojë çdo kërcënim të krijuar nga një marrëdhënie punësimi, siç përshkruhet në paragrafët K524.3A1 deri 524.5A3.

Dhënia e shërbimeve të jo sigurisë

K800.14 Nëse firma kryen një angazhim auditimi të pranueshëm dhe jep një shërbim të jo sigurisë për klientin e auditimit, firma do të veprojë në pajtim me seksionet 410 deri në 430 dhe seksionin 600, duke përfshirë nën seksionet e tij, të cilat janë subjekt i trajtimit nga paragrafët K800.7 deri në K800.9

STANDARDET NDERKOMBETARE të PAVARESISE

(PJESET 4A dhe 4 B)

PJESA 4B – PAVAREsia PER ANGAZHIMET E SIGURISE të

NDRYSHME NGA AUDITIMET DHE ANGAZHIMET E RISHIKIMIT

—		
Seksioni 900	Zbatimi i Kuadrit Konceptual për Pavarësinë për Angazhimet e Sigurisë që ndryshojnë nga Auditimet dhe angazhimet e rishikimit	273
Seksioni 905	Honorarët	283
Seksioni 906	Dhuratat dhe Mikpritja	288
Seksioni 907	Paditë Gjyqësore Aktuale ose të Kërcënuara	289
Seksioni 910	Interesat Financiare	290
Seksioni 911	Huatë dhe Garancitë	293
Seksioni 920	Marrëdhëniet e Biznesit	296
Seksioni 921	Marrëdhëniet Familjare dhe Personale	298
Seksioni 922	Shërbimet e Kohëve tësi Fundit me një Klient të Sigurisë	302
Seksioni 923	Shërbimi në rolin e drejtorit apo nëpunësit tek një klient i sigurisë	304
Seksioni 924	Punësimi tek një Klient i Sigurisë	306
Seksioni 940	Lidhja e Gjatë e Personelit me një Klient të Sigurisë	309
Seksioni 950	Kryerja e shërbimeve të jo sigurisë për klientët e sigurisë të ndryshëm nga klientët e angazhimeve të auditimit dhe rishikimit	312
Seksioni 990	Raportet që përfshijnë një kufizim në përdorim dhe shpërndarje (angazhimet e sigurisë të ndryshme nga angazhimet e auditimit dhe rishikimit)	316

PJESA 4B – PAVARËSIA PËR ANGAZHIMET E SIGURISE të NDRYSHME NG ANGAZHIMET E AUDITIMIT DHE TË RISHIKIMIT

SEKSIONI 900

ZBATIMI I KUADRIT KONCEPTUAL PËR PAVARËSINË PËR ANGAZHIMET E SIGURISE të NDRYSHME NGA ANGAZHIMET E AUDITIMIT DHE RISHIKIMIT

Hyrje

Të Përgjithshme

- 900.1 Kjo Pjesë zbatohet për angazhimet e sigurisë të ndryshme nga angazhimet e auditimit dhe rishikimit. Shembuj të këtyre angazhimeve janë:
- Siguria mbi treguesit kryesore të performancës së entitetit
 - Siguria mbi pajtueshmërinë e entitetit me ligjet dhe rregullat
 - Siguria mbi kriteret e performancës, siç është vlera e parasë, e arritur nga një organizëm i sektorit publik.
 - Siguria mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të një entiteti.
 - Siguria mbi pasqyrën që raporton efektin sere të emetimit në atmosferë
 - Një auditim i elementeve, llogarive ose elementeve të veçanta të një pasqyrë financiare
- 900.2 Në këtë Pjesë, termi “profesionist kontabël” i referohet profesionistit kontabël individual në praktikën publike dhe firmave të tyre.
- 900.3 SNMC 1 kërkon që një firmë të hartojë, zbatojë dhe verë në funksionim një sistem të menaxhimit të cilësisë për angazhimet e sigurisë të kryera prej saj. Si pjese e këtij sistemi të menaxhimit të cilësisë, SNMC 1 kërkon që firma të vendosë objektiva për cilësinë, të cilat adresojnë përmbushjen e përgjegjësisë në përputhje me kërkesat etike, përfshirë ato që lidhen me pavarësinë. Sipas SNMC 1, kërkesat përkatëse etike janë ato që lidhen me firmën, personelin e saj dhe, kur është e zbatueshme, me të tjerët që i nënshtrohen kërkesave për pavarësinë, të cilave ju nënshtrohet firma dhe angazhimet e firmës. Përveç kësaj, SNAS-te dhe SNA-te përcaktojnë përgjegjësitë për partnerët e angazhimit dhe ekipet e angazhimit në nivel e angazhimi. Caktimi i përgjegjësisë brenda një firme do të varet nga madhësia, struktura dhe organizimi i saj. Shumë nga dispozitat e Pjesës 4B nuk përshkruajnë përgjegjësi specifike të individëve brenda firmës për veprimet që lidhen me pavarësinë, por i referohen “firmës” për lehtësi

në referim. Një firmë i cakton përgjegjësinë, për pajtueshmërinë me kërkesat e pavarësisë, një individ ose grupi individësh në përputhje me SNMC1. Për më tepër, një profesionist kontabël individual mbetet përgjegjës për pajtueshmërinë me çdo dispozitë që aplikohet për aktivitetet, interesat dhe marrëdhëniet e këtij profesionisti kontabël.

900.4

Pavarësia është e lidhur me parimet e objektivitetit dhe integritetit. Ajo përfshin:

- (a) Pavarësinë në të menduar - Gjendja e të menduarit, e cila lejon shprehjen e një konkluzioni pa u ndikuar nga influencat që komprometojnë gjykimin profesional, me anën e të cilës bëhet mundur që një individ të veprojë me integritet dhe të ushtrojë objektivitetin dhe skepticizmin profesional.
- (b) Pavarësia në dukje - Shmangia e fakteve dhe rrethanave që janë kaq të rëndësishme, sa që një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar do të kishte të ngjarë të arrinte në përfundimin se është kompromentuar integriteti, objektiviteti ose skepticizmi profesional i një firme apo i një anëtarit të grupit të sigurisë.

Në këtë Pjesë, referimi për një individ apo një firmë si “i/e pavarur” nënkupton që individit ose firmës janë në pajtueshmëri me dispozitat e kësaj Pjese.

900.5

Kur kryejnë angazhime të sigurisë, Kodi kërkon që firmat të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore dhe të jenë të pavarura. Kjo Pjesë përcakton kërkesat specifike dhe materialin për zbatim mbi mënyrën e zbatimit të kuadrit konceptual për ruajtjen e pavarësisë kur kryhen angazhime të tilla. Kuadri konceptual që jepet në Seksionin 120 zbatohet për pavarësinë njëjloj siç zbatohet për parimet themelore të përshkruara në Seksionin 110.

900.6

Kjo Pjesë përshkruan:

- (a) Faktet dhe rrethanat, përfshirë aktivitetet, interesat dhe marrëdhëniet profesionale, që krijojnë ose mund të krijojnë kërcënime ndaj pavarësisë.
- (b) Veprimet e mundshme, përfshirë masat mbrojtëse, që mund të jenë të përshtatshme për adresimin e këtyre kërcënimeve; dhe Disa situata, ku kërcënimet nuk mund të eliminohen ose kur nuk ka masa mbrojtëse për reduktimin e kërcënimeve në një nivel të pranueshëm.

Përshkrimi i angazhimeve të sigurisë

900.7 Ne një angazhim të sigurisë firma synon të sigurojë evidencën e nevojshme për të shprehur një konkluzion që ka si qëllim të përmirësojë nivelin e besueshmërisë të përdoruesit të synuar, të cilët janë të ndryshëm nga pala përgjegjëse, rreth informacionit për çështjen në fjalë. SNAS 3000 (i rishikuar) përshkruan elementët dhe objektivat e një angazhimi të sigurisë të kryer sipas këtij standardi dhe Kuadrit i Sigurisë bën një përshkrim të angazhimeve të sigurisë. Një angazhim i sigurisë mund të jetë një angazhim për të provuar ose një angazhim direkt.

900.8 Në këtë Pjesë, termi “angazhim i sigurisë” i i referohet angazhimeve të sigurimit përveç angazhimeve të auditimit dhe angazhimeve të rishikimit.

Raportet që përfshijnë një kufizim në përdorim dhe shpërndarje

900.9 Një raport i sigurisë mund të përfshijë një kufizim të përdorimit dhe shpërndarjes. Nëse është kështu, dhe përmbushën kushtet e përshkruara në seksionin 990, atëherë kërkesat për pavarësi në këtë Pjesë, mund të modifikohen, siç parashikohet në seksionin 990

Angazhimet e auditimit dhe të rishikimit

900.10 Standardet e pavarësisë për angazhimet e auditimit dhe të rishikimit janë përshkruar në pjesën 4A – Pavarësia për angazhimet e auditimit dhe rishikimit. Nëse një firmë kryen, për të njëjtin klient, një angazhim të sigurisë dhe një angazhim të auditimit ose rishikimit, për firmën, një firmë rrjet dhe anëtarët e ekipit të auditimit ose rishikimit do vazhdojnë të zbatohen kërkesat në pjesën 4A

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Te përgjithshme

K900.11 Një firmë që kryen një angazhim të sigurisë do të jetë e pavarur nga klienti i sigurisë.

900.11 A1 Për qëllime të kësaj Pjese, klienti i sigurisë në një angazhim sigurie është pala përgjegjëse dhe gjithashtu, në një angazhim për të provuar, pala që merr përgjegjësinë për informacionin për çështjen në fjalë (ne shqyrtim) (që mund të jetë e njëjtë me palën përgjegjëse).

911.A2 Rolet e palëve të përfshira në një angazhim të sigurisë mund të ndryshojnë dhe të ndikojnë në zbatimin e dispozitave të pavarësisë në këtë Pjesë. Në shumicën e angazhimeve për të vërtetuar (attestation),

pala përgjegjëse dhe pala që merr përgjegjësinë për informacionin e çështjes në fjalë janë të njëjta. Kjo përfshin ato rrethana, kur pala përgjegjëse përfshin një palë tjetër (matësin ose vlerësuesin), për të matur ose vlerësuar çështjen në fjalë kundrejt kritereve ku pala përgjegjëse merr përgjegjësinë për informacionin e çështjes në fjalë, si edhe çështjen në fjalë që shqyrtohet. Megjithatë, pala përgjegjëse ose pala angazhuese mund të caktojë një palë tjetër për të përgatitur informacionin e çështjes në fjalë, me supozimin se kjo pale do të marrë përgjegjësinë për informacionin e çështjes në fjalë. Në këtë rrethanë, pala përgjegjëse dhe pala përgjegjëse për informacionin e çështjes në fjalë janë të dy klientë të sigurisë, për qëllimet e kësaj Pjese.

900.11 A3 Përveç palës përgjegjëse dhe, në një angazhim për të vërtetuar, palës që merr përgjegjësinë për informacionin e çështjes në fjalë, mund të ketë palë të tjera që lidhen me angazhimin. Për shembull, mund të ketë patur një palë të veçantë të angazhuar ose një palë që, është një matës ose vlerësues, përveç palës që merr përgjegjësinë për informacionin e çështjes në fjalë. Në këto kushte, zbatimi i kuadrit konceptual kërkon që profesionisti kontabël të identifikojë dhe vlerësojë kërcënimet ndaj parimeve themelore, të krijuara nga ndonjë interes apo marrëdhënie me këto palë, përfshirë edhe faktin nëse mund të kishte ekzistuar ndonjë konflikt interesi siç përshkruhet në seksionin 310.

K900.12 Një firmë do të zbatojë kuadrin konceptual të përshkruar në seksionin 120, për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar kërcënimet ndaj pavarësisë në lidhje me një angazhim sigurie.

Ndalimi i marrjes së përgjegjësi të menaxhimit (drejtimit)

K900.13 Një firmë nuk do të marrë përsipër një përgjegjësi menaxhimi në lidhje me çështjen në fjalë që shqyrtohet dhe, në një angazhim për të vërtetuar, informacionin për çështjen në fjalë të një angazhimi të dhënies së sigurisë të dhënë nga firma. Nëse firma merr përsipër një përgjegjësi drejtimi, si pjesë e ndonjë shërbimi tjetër, që i jepet klientit të sigurisë, firma do të sigurohet që përgjegjësia nuk lidhet me çështjen në fjalë në shqyrtim dhe, në një angazhim për të vërtetuar, me informacionin për çështjen në fjalë të angazhimit të sigurisë të dhene nga firma.

900.13 A1 Përgjegjësitë e menaxhimit përfshijnë kontrollin, udhëheqjen dhe menaxhimin e një entiteti, përfshirë marrjen e vendimeve në lidhje me blerjen, vendosjen dhe kontrollin e burimeve njerëzore, financiare, teknologjike, fizike dhe jo materiale.

900.13 A2 Kur një firmë merr përsipër një përgjegjësi menaxhimi në lidhje me

çështjen në fjalë në shqyrtim dhe, në një angazhim për të vërtetuar, informacionin mbi çështjen në fjalë, të një angazhimi të sigurisë, krijohen kërcënime të vetë-rishikimit, interesit vetjak dhe familjaritetit. Marrja e një përgjegjësie menaxhimi mund të krijojë një kërcënim të favorizimit për shkak se firma bëhet shumë e lidhur me pikëpamjet dhe interesat e drejtuesve.

900.13 A3 Përcaktimi nëse një aktivitet është një përgjegjësi e menaxhimit varet nga rrethanat dhe kërkon ushtrimin e gjykimit profesional. Shembuj të aktiviteteve që do të konsideroheshin si përgjegjësi e menaxhimit, përfshijnë:

- Përcaktimi i politikave dhe drejtimit strategjik.
- Marrjen në punë ose largimin e punonjësve nga puna.
- Drejtimin dhe marrjen e përgjegjësisë për veprimet e punonjësve në lidhje me punën e tyre për entitetin.
- Autorizimin e transaksioneve.
- Kontrollin ose menaxhimin e llogarive bankare ose investimeve.
- Marrjen e vendimeve se cilat rekomandime të firmës apo të palëve të tjera të treta duhen zbatuar.
- Raportimin tek personat e ngarkuar me qeverisjen në emër të menaxhimit
- Marrja e përgjegjësisë për projektimin, zbatimin, monitorimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm.

900.13 A4 Subjekt i pajtueshmërisë me paragrafit K900.14, dhënia e këshillave dhe rekomandimeve për të ndihmuar menaxhimin e një klienti të sigurisë në shkarkimin e përgjegjësisë të tij nuk është marrje e një përgjegjësie të menaxhimit.

K900.14 Gjatë kryerjes së një aktiviteti profesional për një klient të sigurisë që është i lidhur me çështjen në fjalë që shqyrtohet dhe, në një angazhim për të vërtetuar, me informacionin e çështjes në fjalë të angazhimit të sigurisë, firma do të krijojë bindjen se menaxhimi i klientit bën të gjitha gjykimet dhe merr vendimet e përkatëse, të cilat janë përgjegjësi e duhur e menaxhimit. Kjo përfshin marrjen e sigurisë se menaxhimi i klientit:

- (a) Cakton një individ që zotëron aftësi, njohuri dhe përvojë të përshtatshme, për të qenë përgjegjës në çdo kohë për vendimet e klientit dhe për të mbikëqyrur aktivitetet. Një individ i tillë, preferohet midis drejtuesve të lartë, do duhej të kuptonte:
 - (i) Objektivat, natyrën dhe rezultatet e aktiviteteve;
 - (ii) Përgjegjësitë përkatëse të klientit dhe të firmës.

Megjithatë, individit nuk i kërkohet të zotërojë ekspertizën për të kryer apo ri-kryer veprimtaritë.

- (b) Siguron mbikëqyrjen e veprimtarive dhe vlerëson përshtatshmërinë e rezultateve të veprimtarisë së kryer për qëllimin e klientit; dhe
- (c) Pranon përgjegjësinë për veprimet, nëse ka të tilla, që duhet të ndërmerren në lidhje me rezultatet e aktiviteteve.

Palët përgjegjëse të shumëfishta dhe palët që marrin përgjegjësinë për informacionin e çështjes në fjalë.

900.15 A1 Në disa angazhime të sigurisë, pavarësisht nëse është një angazhim për të vërtetuar apo angazhim i drejtpërdrejtë, mund të ketë disa palë përgjegjëse ose, në një angazhim për të vërtetuar, disa palë që marrin përgjegjësinë për informacionin e çështjes në fjalë. Për të përcaktuar nëse është e nevojshme të zbatohen dispozitat në këtë Pjesë për çdo palë përgjegjëse individuale apo çdo palë individuale që merr përgjegjësinë për informacionin e çështjes në fjalë në këto angazhime, firma mund të marrë parasysh disa çështje. Këto çështje përfshijnë faktin nëse një interes apo marrëdhënie midis firmës, apo një anëtar i ekipit të sigurisë dhe një palë përgjegjëse të veçantë, apo pale që merr përgjegjësinë për informacionin e çështjes në fjalë, do të kishte krijuar një kërcënim për pavarësinë që nuk është krejt i parëndësishëm dhe pa pasoja në kontekstin e informacionit të çështjes në fjalë. Ky përcaktim do të marrë parasysh faktorë të tillë si:

- (a) Materialiteti i çështjes në fjalë që shqyrtohet ose informacionit të çështjes në fjalë, për të cilat pala e veçantë është përgjegjëse në kontekstin e angazhimit të përgjithshëm të sigurisë.
- (b) Shkalla e interesit publik që lidhet me angazhimin e sigurimit.

Nëse firma arrin në përfundimin se kërcënimi i krijuar nga ndonjë interes apo marrëdhënie e tillë me një palë të caktuar do të ishte krejt i parëndësishëm dhe i papërfillshëm, mund të mos ishte e nevojshme që për këtë pale të zbatohen të gjitha dispozitat e këtij seksioni.

Firmat rrjet

K900.16 Kur një firmë e di ose ka arsye të besojë se interesat dhe marrëdhëniet e një firmerrjet krijojnë një kërcënim ndaj pavarësisë së firmës, firma do të vlerësojë dhe adresojë çdo njërin nga këto kërcënime.

900.16 A1 Firmat rrjet trajtohen në paragrafët 400.50 deri të 400.54 A1.

Entitetet e lidhura

K900.17 Kur ekipi i sigurisë është në dijeni apo ka arsye të besojë se një marrëdhënie apo rrethanë që përfshin një entitet të lidhur me klientin e sigurisë, ka të beje me vlerësimin e pavarësisë së firmës nga klienti, ekipi i sigurisë do ta përfshijë këtë entitet të lidhur, kur identifikon, vlerëson dhe adreson kërcënimet ndaj pavarësisë.

[Paragrafët 900.18 deri 900.29, janë lenë bosh qëllimisht]

Periudha gjate të cilës kërkohet pavarësia

K900.30 Pavarësia, sikurse kërkohet nga kjo Pjesë, do të mbahet:

- (a) Gjatë periudhës së angazhimit; dhe
- (b) Gjatë periudhës së mbuluar nga informacioni për çështjen në fjalë.

900.30 A1 Periudha e angazhimit fillon kur ekipi i sigurisë nis të kryejë shërbimet e sigurisë në lidhje me angazhimin përkatës. Periudha e angazhimit përfundon kur lëshohet raporti i sigurisë. Kur angazhimi është i një natyre të përsëritur, ai përfundon në datën më të vonë të njoftuar nga secila palë se marrëdhënia profesionale ka përfunduar apo, të lëshimit të raportit përfundimtar të sigurisë.

K900.31 Kur një entitet bëhet një klient i sigurisë gjatë ose pas periudhës së mbuluar nga informacioni për çështjen në fjalë mbi të cilin firma do të shprehë një konkluzion, firma do të përcaktojë nëse krijohet ndonjë kërcënim për pavarësinë nga:

- (a) Marrëdhëniet financiare ose të biznesit me klientin e sigurisë gjatë ose pas periudhës së mbuluar nga informacioni për çështjen në fjalë, por përpara pranimit të angazhimit të sigurisë; ose
- (b) Shërbimet e mëparshme të dhëna për klientin e sigurisë.

K900.32 Shembuj të veprimeve që mund të kishin qenë masa mbrojtëse për adresimin e këtyre kërcënimeve, janë:

- (a) Përdorimi i profesionistëve, që nuk janë anëtarë të ekipit të sigurisë, për kryerjen e shërbimit.
- (b) Angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për rishikimin e punës së sigurisë dhe jo sigurisë, sipas rastit.

K900.33 Nëse një shërbim i jo-sigurisë që nuk do të ishte lejuar gjatë periudhës së angazhimit nuk ka përfunduar dhe nuk ka mundësi të përfundojë ose

shërbimi të ndërpritet përpara fillimit të shërbimeve profesionale në lidhje me angazhimin e sigurisë, firma do të pranojë angazhimin e sigurisë vetëm nëse:

- (a) Firma bindet që:
 - (i) Shërbimi i jo-sigurisë do të përfundojë brenda një periudhe të shkurtër kohore; ose
 - (ii) Klienti ka marrëveshje për transferimin e shërbimit tek një ofrues tjetër brenda një periudhe të shkurtër kohe;
- (b) Firma zbaton masa mbrojtëse, kur është e nevojshme, gjatë periudhës së shërbimit; dhe
- (c) Firma e diskuton çështjen me palën që angazhon firmën ose personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit të sigurisë.

Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen

900.34 A1 Paragrafët K300.9 deri në 300.9 A2 përshkruajnë kërkesat dhe materialin për zbatim që është i përshtatshëm për komunikimet me një palë që angazhon firmën ose me personat që janë të ngarkuar me qeverisjen e klientit të sigurisë.

900.34 A2 Komunikimi me një palë që angazhon firmën ose me personat që janë të ngarkuar me qeverisjen e klientit të sigurisë, mund të jetë i përshtatshëm kur bëhen gjykime të rëndësishme dhe arrihen përfundime, për të adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë në lidhje me një angazhim të sigurisë, sepse informacioni për çështjen në fjalë të këtij angazhimi është rezultat i një shërbimi të jo-sigurisë të kryer më parë.

[Paragrafët 900.35 deri 900.39, janë lenë bosh qëllimisht]

Dokumentimi i Përgjithshëm mbi Pavarësinë për Angazhimet e Sigurisë të Ndryshme nga Angazhimet e Auditimit dhe Rishikimit.

K900.40 Një firmë do të dokumentojë konkluzionet lidhur me pajtueshmërinë më këtë Pjesë dhe thelbin e ndonjë diskutimi të rëndësishëm në mbështetje të këtyre konkluzioneve. Në veçanti:

- (a) Kur janë zbatuar masa mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi, firma do të dokumentojë natyrën e kërcënimit dhe masat mbrojtëse të vendosura ose të zbatuara; dhe
- (b) Kur një kërcënim kërkon një analizë domethënëse dhe firma arrin në konkluzionin se kërcënim i ka qenë në një nivel të pranueshëm, firma do të dokumentojë natyrën e kërcënimit dhe

arsyetimin e bërë në lidhje me konkluzionin.

900.40 A1 Dokumentimi jep evidencë për gjykimet e bëra nga firma për formimin e konkluzioneve në lidhje pajtueshmërinë me këtë Pjesë. Megjithatë, mungesa e dokumentimit nuk është një tregues i faktit nëse një firmë e ka konsideruar ose jo një çështje të caktuar dhe as nëse firma është e pavarur.

[Paragrafët 900.41 deri 900.49 janë lënë qëllimisht bosh]

Shkelja e një dispozite mbi pavarësinë për angazhimet e sigurisë

Kur një firmë identifikon një shkelje

K900.50 Nëse firma arrin në përfundimin se ka ndodhur një shkelje e kërkesave të kësaj Pjesë, firma do të:

- (a) Ndërpresë, pezullojë ose eliminojë interesin apo marrëdhënien që ka shkaktuar shkeljen;
- (b) Vlerësojë rëndësinë e shkeljes dhe ndikimin që ajo ka në objektivitetin e firmës dhe aftësinë e saj për të lëshuar një raport të sigurisë; dhe.
- (c) Përcaktojë nëse mund të ndërmerren veprime të cilat të adresojnë në mënyrë të kënaqshme pasojat e shkeljes.

Kur bën një përcaktim të tillë, firma do të përdorë gjykimin profesional dhe do të marrë parasysh faktin nëse një palë e tretë e informuar dhe e arsyeshme, do të kishte të ngjarë të arrinte në përfundimin se objektiviteti i firmës do të ishte kompromentuar në një mënyrë të atillë që firma nuk do të mund të lëshonte një raport të sigurisë.

K900.51 Nëse firma përcakton që nuk mund të ndërmerren veprime që adresojnë në mënyrë të kënaqshme pasojat e shkeljes, firma do të informojë, sa më shpejt të jetë e mundur, palët që kanë angazhuar firmën, ose sipas rastit, personat e ngarkuar me qeverisjen. Firma gjithashtu, do të ndërmarrë hapat e nevojshme për të ndërprerë angazhimin e sigurisë në përputhje me kërkesat ligjore apo rregullatore përkatëse të zbatueshme për ndërprerjen e një angazhimi të sigurisë.

K900.52 Nëse firma përcakton se mund të ndërmerren veprime për të adresuar në mënyrë të kënaqshme pasojat e shkeljes, firma do të diskutojë për shkeljen dhe për veprimet që ajo ka ndërmarrë ose propozon të ndërmarrë, me palët që kanë angazhuar firmën, ose sipas rastit, me personat e ngarkuar me qeverisjen. Firma do të diskutojë për shkeljen

dhe për veprimin e propozuar në kohën e duhur, duke mbajtur parasysh rrethanat e angazhimit dhe shkeljen.

K900.53 Në qoftë se pala që ka angazhuar firmën ose personat e ngarkuar me qeverisjen, mendojnë se veprimi i propozuar nga firma në përputhje me paragrafin K900.50(c) nuk trajton në mënyrë të përshtatshme pasojat e shkeljes, firma do të ndërmarrë hapat e nevojshme për të ndërprerë angazhimin e sigurisë në përputhje me kërkesat përkatëse të zbatueshme ligjore apo rregullatore që trajtojnë ndërprerjen e një angazhimi të sigurisë.

Dokumentimi

K900.54 Në pajtim me kërkesat në paragrafët K900.50 deri të K900.53, firma do të dokumentojë:

- (a) Shkeljen;
- (b) Veprimet e ndërmarra;
- (c) Vendimet kryesore të marra; dhe
- (d) Të gjitha çështjet e diskutuara me palën që ka angazhuar firmën ose personat e ngarkuar me qeverisjen.

K900.55 Nëse firma vijon me angazhimin e sigurisë, ajo do të dokumentojë:

- (a) Konkluzionin se, në gjykimin profesional të firmës, nuk është kompromentuar objektiviteti; dhe
- (b) Arsyetimin përse veprimi i ndërmarrë ka adresuar në mënyrë të kënaqshme pasojat e shkeljes, në mënyrë që firma të mund të lëshojë një raport të sigurisë.

SEKSIONI 905

TARIFAT (HONORARET)

Hyrje

- 905.1 Firmat duhet të respektojnë parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të përshkruar në seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 905.2 Tarifatat ose llojet e tjera të shpërblimit mund të krijojnë një kërcënim të interesit vetjak ose frikësimit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin për zbatim që lidhet me zbatimin e kuadrit konceptual për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar kërcënimet ndaj pavarësisë që rrjedhin nga tarifatat e ngarkuara për klientët e shërbimeve të sigurisë.

Kërkesat dhe Materiali për Zbatim

Tarifatat e paguara nga një klient i sigurisë

- 905.3 A1 Kur tarifatat janë negociuar me dhe paguar nga një klient i sigurisë, kjo krijon një kërcënim të interesit vetjak dhe mund të krijojë një kërcënim të frikësimit për pavarësinë.
- 905.3 A2 Zbatimi i kuadrit konceptual kërkon që përpara se një firmë të pranojë një angazhim të sigurisë për një klient të sigurisë, firma të përcaktojë nëse kërcënimet ndaj pavarësisë, të krijuara nga tarifatat e propozuara për klientin janë në një nivel të pranueshëm. Zbatimi i kuadrit konceptual kërkon gjithashtu, që firma të rivlerësojë kërcënimet të tilla, kur faktet dhe rrethanat ndryshojnë gjatë periudhës së angazhimit.
- 905.3 A3 Faktorët që janë të përshtatshëm në vlerësimin e nivelit të kërcënimeve të krijuara kur tarifatat paguhen nga klienti i sigurisë përfshijnë:
- Nivelin e tarifave për angazhimin e sigurisë dhe shkallen në të cilën ato kanë parasysh burimet e kërkuara, duke marrë parasysh prioritetet tregtare dhe të tregut të firmës.
 - Shtrirja e çdo varësie ndërmjet nivelit të tarifës dhe rezultatit të shërbimit.
 - Niveli i tarifës në kuadër të shërbimit që do të jepet nga firma ose një firma e rrjetit.
 - Rëndësia e klientit për firmën ose partnerin.
 - Natyra e klientit.

- Natyra e angazhimit të sigurisë.
- Përfshirja e personave të ngarkuar me qeverisjen në marrëveshjen për rënien dakord me tarifat.
- Nëse niveli i tarifës përcaktohet nga një palë e tretë e pavarur, si p.sh. një organ rregullator.

905.3 A4 Kushtet, politikat dhe procedurat e përshkruara në paragrafë 120.15 A3 (veçanërisht ekzistenca e një sistemi të menaxhimit të cilësisë i projektuar dhe zbatuar nga një firmë në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë të publikuara nga IAASB) mund të ndikojë gjithashtu, në vlerësimin nëse kërcënimet ndaj pavarësisë janë në një nivel të pranueshëm.

905.3 A5 Kërkesat dhe materiali për zbatim që pasojnë, identifikojnë rrethanat që mund të kenë nevojë të vlerësohen më tej kur përcaktohet nëse kërcënimet janë në një nivel të pranueshëm. Për këto rrethana, materiali për zbatim përfshin shembuj të faktorëve shtesë që mund të jenë të rëndësishëm në vlerësimin e kërcënimeve.

Niveli i tarifave për angazhimet e sigurisë

905.4 A1 Përcaktimi i tarifave që duhet t'i ngarkohen një klienti të sigurisë, si për shërbime të sigurisë ashtu edhe për shërbime të tjera, është një vendim biznesi i firmës që merr parasysh faktet dhe rrethanat që lidhen me atë angazhim specifik, përfshirë kërkesat e standardeve teknike dhe profesionale.

905.4 A2 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimeve të interesit vetjak dhe të frikësimit, të krijuara nga niveli i tarifës për një angazhim të sigurisë kur paguhet nga klienti i sigurisë përfshijnë:

- Arsyetimin tregtar të firmës për tarifën e angazhimit për sigurimin.
- Faktin nëse klienti ka ushtruar ose po ushtron presion të panevojshëm për të ulur tarifën për angazhimin e sigurisë.

905.4 A3 Shembuj të veprimeve që mund të kishin qenë masa mbrojtëse për të trajtuar kërcënime të tilla përfshijnë:

- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm i cili nuk merr pjesë në angazhimin e dhënies së sigurisë për të vlerësuar arsyeshmërinë e tarifës së propozuar duke pasur parasysh objektin dhe kompleksitetin e angazhimit.
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk ka marrë pjesë në angazhimin e sigurisë, për rishikimin e punës së kryer.

Honoraret (tarifat) e kushtëzuara

- 905.5 A1** Tarifat e kushtëzuara janë tarifa të llogaritura mbi një bazë të paracaktuar në lidhje me rezultatin e një transaksioni ose rezultatin e shërbimeve të kryera. Një tarifë e kushtëzuar e ngarkuar përmes një ndërmjetësi është një shembull i një tarife të kushtëzuar të tërthortë. Në këtë seksion, një tarifë nuk konsiderohet si e kushtëzuar nëse përcaktohet nga një gjykatë ose një autoritet tjetër publik.
- K905.6** Një firmë nuk do të ngarkojë drejtpërdrejt ose tërthorazi një tarifë të kushtëzuar për një angazhim të dhënies së sigurisë.
- K905.7** Një firmë nuk do të ngarkojë drejtpërdrejt ose tërthorazi një tarifë të kushtëzuar për një shërbim të jo-sigurisë që i jepet një klienti të sigurisë nëse rezultati i shërbimit të jo-sigurisë, dhe për rrjedhojë, shuma e tarifës, është i varur nga një gjykim i ardhshëm ose aktual në lidhje me një çështje që është materiale për informacionin e çështjes në fjalë të angazhimit të sigurisë.
- 905.7 A1** Paragrafët K905.6 dhe K905.7 e përjashtojnë një firmë që të hyjë në marrëveshje me tarifave të kushtëzuara me një klient të sigurisë. Por edhe nëse një marrëveshje me tarifa të kushtëzuara nuk përjashtohet, kur jepet një shërbim i jo-sigurisë për një klient të sigurisë, ai perseri mund të kishte ndikim në nivelin e kërcënimit të interesit vetjak.
- 905.7 A2** Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të një kërcënimitë tillë përfshijnë:
- Intervalin e shumave të mundshme të tarifave.
 - Faktin nëse një autoritet i duhur përcakton rezultatin nga i cili varet tarifa e kushtëzuar.
 - Dhënien e informacioneve për përdoruesit e synuar nërlidhje me punën e kryer nga firma dhe bazën e shpërblimit.
 - Natyrën e shërbimit.
 - Efektin e ngjarjes ose transaksionit në dhënien e informacionit.
- 905.7 A3** Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për të adresuar një kërcënim të tillë të interesit vetjak përfshijnë:
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk ka qenë i përfshirë në kryerjen e shërbimit të jo-sigurisë, për të rishikuar punën përkatëse të sigurisë.
 - Nënshkrimi i një marrëveshjeje paraprake me klientin mbi bazën e shpërblimit

Tarifat gjithsej—Tarifat me vonese në pagese

- 905.8 A1** Niveli i kërcënimit të interesit vetjak mund të ndikohet nëse tarifat e pagueshme nga klienti i sigurisë për angazhimin sigurisë ose shërbime të tjera janë në vonesë gjatë periudhës së angazhimit të sigurisë.
- 905.8 A2** Në përgjithësi, pritët që firma të marrë pagesën e tarifave të tilla para se të lëshohet raporti i sigurisë.
- 905.8 A3** Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë të interesit vetjak përfshijnë:
- Rëndësinë që kanë për firmën tarifat që nuk janë paguar në kohe
 - Kohëzgjatja e vonesës së tarifave të papaguara.
 - Vlerësimi i firmës për aftësinë dhe vullnetin e klientit ose palës tjetër përkatëse për të shlyer tarifën që është në vonesë.
- 905.8 A4** Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për të trajtuar një kërcënim të tillë përfshijnë:
- Shlyerjen e pjesshme e tarifave në vonesë.
 - Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm i cili nuk ka marrë pjesë në angazhimin e sigurisë për të rishikuar punën e kryer.
- K905.9** Kur një pjesë e konsiderueshme e tarifave të paguara nga një klient i shërbimit të sigurisë mbeten të pashlyera për një kohë të gjatë, firma do të përcaktojë:
- (a) Nëse tarifat në pagese të vonuar mund të jenë ekuivalente me një kredi për klientin, rast në të cilin janë të zbatueshme kërkesat dhe materiali për zbatim të përcaktuara në seksionin 911; dhe
 - (b) Nëse është e përshtatshme për firmën, që ajo të rrimërohet ose vazhdojë angazhimin e sigurisë.

Tarifat gjithsej - Varësia nga tarifat

- 905.10 A1** Kur tarifat gjithsej të gjeneruara nga firma prej një klienti të sigurisë, për të cilin firma shpreh një opinion në një angazhim të sigurisë, përfaqësojnë një pjesë të madhe të tarifave gjithsej të asaj firme, varësia dhe shqetësimi për humbjen e mundshme të tarifave nga ai klient ndikojnë në nivelin e kërcënimit të interesit vetjak dhe mund të krijojnë një kërcënim të frikësimit.
- 905.10 A2** Një kërcënim i interesit vetjak dhe i frikësimit krijohet në rrethanat e përshkruara në paragrafin 905.10 A1 edhe nëse klienti i sigurisë nuk është përgjegjës për negocimin ose pagesën e tarifave për angazhimin e

sigurisë.

- 905.10 A3 Në llogaritjen e tarifave gjithsej të firmës, firma mund të përdorë informacionin financiar në dispozicion nga viti i kaluar financiar dhe të vlerësojë shumën e tarifës bazuar në atë informacion nëse kjo është e përshtatshme.
- 905.10 A4 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimeve të tilla të interesit vetjak dhe frikësimit përfshijnë:
- Strukturën operative të firmës.
 - Pritshmëritë e firmës për diversifikim të bazës së klientëve dhe tarifave, në mënyrë që të reduktohet varësia nga klienti i sigurisë.
- 905.10 A5 Shembuj të veprimeve që mund të ishin masa mbrojtëse për të adresuar kërcënime të tilla përfshijnë:
- Reduktimin e shtrirjes së shërbimeve të ndryshme nga angazhimet e sigurisë që i ofrohen klientit.
 - Rritja e bazës së klientëve të firmës për të reduktuar varësinë nga klienti i sigurisë.
- 905.10 A6 Një kërcënim i interesit vetjak ose i frikësimit krijohet kur tarifat e gjeneruara nga një firmë prej një klienti të sigurisë përfaqësojnë një pjesë të madhe të të ardhurave nga klientët e një ortakut (partneri) individual.
- 905.10 A7 Faktorët që janë të rëndësishëm për vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve përfshijnë:
- Rëndësinë cilësore dhe sasiore të klientit të sigurisë për ortakun/partnerin.
 - Shkallen në të cilën shpërblimi i ortakut varet nga tarifat e gjeneruara prej klientit.
- 905.10 A8 Shembuj të veprimeve që mund të ishin masa mbrojtëse për të trajtuar një kërcënim të tillë të interesit vetjak ose të frikësimit përfshijnë:
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk ka qenë anëtar i ekipit të sigurisë, për të rishikuar punën e kryer.
 - Sigurimi që shpërblimi i ortakut/partnerit të mos ndikohet ndjeshëm nga tarifat e gjeneruara nga klienti i sigurisë.
 - Rritja e portofolit të klientëve të partnerit për të reduktuar varësinë nga klienti.

SEKSIONI 906

DHURATAT DHE MIKPRITJA

Hyrje

- 906.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë.
- 906.2 Pranimi i dhuratave apo mikpritjes nga një klient i sigurisë mund të krijojë kërcënime të interesit vetjak, të familjaritetit apo të frikësimit. Ky seksion përshkruan një kërkesë specifike dhe materialin për zbatimin të përshtatshëm për zbatimin e kuadrit konceptual në këto rrethana.

Kërkesa dhe materiali për zbatim

- K906.3** Një firmë apo një anëtar i ekipit të sigurisë nuk do të pranojë dhurata dhe mikpritje nga një klient i sigurisë, përveç nëse vlера është e vogël dhe krejt e parëndësishme.
- 906.3 A1** Kur një firmë apo një anëtar i ekipit të sigurisë jep ose pranon një nxitje për ose nga një klient i sigurisë, aplikohen kërkesat dhe materiali për zbatim i përshkruar në Seksionin 304 dhe papajtueshmëria me këto kërkesa mund të krijojë kërcënime ndaj pavarësisë.
- 906.3 A2** Kërkesat e përshkruara në Seksionin 340 lidhur me dhënien ose pranimin e nxitjeve nuk e lejojnë një firmë apo anëtar të ekipit të sigurisë të pranojë dhurata dhe mikpritje kur qëllimi është influenca e papërshtatshme e sjelljes, edhe nëse vlера është e vogël dhe krejt e parëndësishme.

SEKSIONI 907

PADITË GJYQËSORE AKTUALE OSE TË PARALAJMËRUARA

Hyrje

- 907.1** Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë.
- 907.2** Kur ndodh ose ka të ngjarë të ndodhë një padi gjyqësore me një klient të sigurisë, krijohen kërcënime të interesit vetjak dhe të frikësimit. Ky seksion përcakton materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në rrethana të tilla.

Materiali për zbatim

Të Përgjithshme

- 907.3 A1** Marrëdhënia midis drejtimit të klientit dhe anëtarëve të ekipit të sigurisë duhet të karakterizohet nga një sinjeritet i plotë dhe informimi plotë nëlidhje me të gjitha aspektet e operacioneve të klientit. Paditë gjyqësore aktuale apo të kërcënuara midis klientit të sigurisë dhe firmës apo një anëtari të grupit të sigurisë mund të rezultojnë në pozicione kundërshtuese. Këto pozicione kundërshtuese mund të ndikojnë në vullnetin e drejtimit për të dhënë informacione të plota dhe krijojnë kërcënime të interesit vetjak dhe të frikësimit.
- 907.3 A2** Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve, përfshijnë:
- Materialitetin e padisë gjyqësore.
 - Faktin nëse padia gjyqësore ka të bëjë me një angazhim të mëparshëm të sigurisë.
- 907 A3.3** Nëse padia gjyqësore përfshin një anëtar të ekipit të sigurisë, një shembull i një veprimi që mund të eliminonte kërcënime të tilla të interesit vetjak dhe të frikësimit do të ishte largimi i këtij individi nga grupi i sigurisë.
- 907.3 A4** Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e kërcënimeve të tilla të interesit vetjak dhe të frikësimit është angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për rishikimin e punës së kryer.

SEKSIONI 910

INTERESAT FINANCIARE

Hyrje

- 910.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë.
- 910.2 Mbajtja e një interesi financiar tek një klient i sigurisë mund të krijojë një kërcënim të interesit vetjak. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në rrethana të tilla.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 910.3 A1 Një interes financiar mund të mbahet drejtpërdrejt ose indirekt përmes një ndërmjetësi, siç mund të jetë një mjet investimi i përbashkët, një pasuri e paluajtshme ose një trust. Kur pronari përfitues ka kontroll mbi ndërmjetësin ose aftësi për të influencuar vendimet e tij të investimit, Kodi e përshkruan këtë si një interes financiar të drejtpërdrejtë. Nga ana tjetër, kur pronari përfitues nuk ka kontroll mbi ndërmjetësin ose nuk ka aftësi për të influencuar vendimet e tij të investimit, Kodi e përshkruan këtë si një interes financiar indirekt.
- 910.3 A2 Ky seksion përmban referenca për “materialitetin” e një interesi financiar. Në përcaktimin nëse një interes i tillë është material për një individ, mund të merret në konsideratë pasuria neto e përbashkët e individit dhe anëtarëve të drejtpërdrejtë të familjes.
- 910.3 A3 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimit të interesit vetjak të krijuar nga mbajtja e një interesi financiar tek një klient i sigurisë përfshijnë:
- (a) Rolin e individit që ka interesa financiare.
 - (b) Faktin nëse interesi financiar është i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë.
 - (c) Materialitetin e interesit financiar.

Interesat financiarë të mbajtur nga firma, anëtarët e ekipit të sigurisë dhe

anëtarët e drejtpërdrejtë të familjes

- K910.4 Një interes financiar i drejtpërdrejtë ose një interes financiar material jo i drejtpërdrejtë tek një klient i sigurisë nuk do të mbahet nga:
- (a) Firma; ose
 - (b) Një anëtar i ekipit të sigurisë apo nga ndonjë nga anëtarët e drejtpërdrejtë të familjes të këtij individ.

Interesat financiare në një entitet që kontrollon një klient të sigurisë

- K910.5 Kur një entitet ka një interes kontrollues në një klient të sigurisë dhe klienti është material për entitetin, as firma, as anëtari i ekipit të sigurisë, dhe as ndonjë anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së këtij individ, nuk do të mbajë një interes financiar të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në këtë entitet.

Interesat financiare të mbajtura si një administrator i besuar (trustee)

- K910.6 Paragrafi K910.4 do të zbatohet gjithashtu, për një interes financiar në një klient të sigurisë, të mbajtur në një trust për të cilin firma ose individ vepron si një administrator i besuar, përveç nëse:
- (a) Asnjëri nga sa jepen në vijim nuk është një përfitues i trustit: administratori i besuar, anëtari i ekipit të sigurisë apo ndonjë familjar i drejtpërdrejtë i këtij individ, ose firma;
 - (b) Interesi në klientin e sigurisë, i mbajtur nga trusti, nuk është material për trustin;
 - (c) Trusti nuk është në gjendje të ushtrojë influencë të rëndësishme mbi klientin e sigurisë; dhe
 - (d) Asnjëri nga sa jepen në vijim nuk mund të influencojë në mënyrë të rëndësishme ndonjë vendim investimi që përfshin një interes financiar në klientin e sigurisë: administratori i besuar, anëtari i ekipit të sigurisë apo ndonjë familjar i drejtpërdrejtë i këtij individ, ose firma.

Interesat financiarë të marra në mënyrë të paqëllimshme

- K910.7 Nëse një firmë, një anëtar i ekipit të sigurisë, ose çdo familjar i drejtpërdrejtë i atij individ, merr një interes financiar të drejtpërdrejtë ose një interes financiar material jo të drejtpërdrejtë, tek një klient i sigurisë, për shembull, nëpërmjet një trashëgimie, dhurate apo si rezultat i një shkrirje (bashkimi), apo në rrethana të ngjashme, dhe një interes i tillë nuk lejohet të mbahet sipas këtij seksioni, atëherë:
- (a) Nëse interesi është marrë nga firma, interesi financiar duhet të

zgjidhet menjëherë, ose në rastin e një interesi financiar jo të drejtpërdrejtë, duhet të zgjidhet deri në një shumë të mjaftueshme, të atillë që interesi i mbetur të mos jetë më material; ose

- (b) Nëse interesi është marrë nga një anëtar i grupit të sigurisë, ose një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së atij individi, individi i cili ka marrë interesin financiar duhet që ta zgjidhë atë menjëherë, ose në rastin e një interesi financiar material jo të drejtpërdrejtë duhet ta zgjidhë deri në një shumë të mjaftueshme të atillë që interesi i mbetur të mos jetë më material.

Interesat Financiare – Rrethana të Tjera

Familjarët e Afërt

- 910.8 A1 Një kërcënim i interesit vetjak mund të krijohet kur një anëtar i ekipit të sigurisë është në dijeni se një anëtar i ngushtë i familjes ka një interes financiar të drejtpërdrejtë apo një interes financiar jo të drejtpërdrejtë material tek klienti i sigurisë.
- 910.8 A2 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë përfshijnë:
- Natyrën e marrëdhënies midis anëtarit të ekipit të sigurisë dhe anëtarit të afërt të familjes.
 - Faktin nëse interesi financiar është i drejtpërdrejtë ose jo.
 - Materialitetin e interesit financiar të anëtarit të afërt të familjes.
- 910.8 A3 Shembuj të veprimeve që mund të eliminojnë një kërcënim të tillë të interesit vetjak përfshijnë:
- Zgjidhjen, nga anëtari i afërt i familjes, sa më shpejt të jetë e mundur, e të gjitha interesave financiare ose e një pjese të mjaftueshme të një interesi financiar jo të drejtpërdrejtë, në mënyrë të atillë që interesi i mbetur nuk do të ishte më material.
 - Largimin e individit nga ekipi i sigurisë.
- 910.8 A4 Shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të interesit vetjak është angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për rishikimin e punës së anëtarët të ekipit të sigurisë.

Individë të Tjerë

- 910.8 A5 Kërcënimi i interesit vetjak mund të krijohet nëse një anëtar i ekipit të sigurisë është në dijeni që një interes financiar po mbahet nga klienti i sigurisë nga individë si:

- Ortakët dhe profesionistët e punësuar të firmës, përveç atyre që në mënyrë specifike nuk u lejohet të mbajnë interesa të tillë financiarë sipas paragrafit K910.4, ose anëtarëve të drejtpërdrejtë të familjes së tyre.
- Individët me një marrëdhënie të ngushtë personale me një anëtar të ekipit të sigurisë.

910.8 A6 Shembull i një veprimi që mund të eliminojë një kërcënim të tillë të interesit vetjak është largimi nga ekipi i sigurisë, i anëtarit të grupit që ka marrëdhënien personale.

910.8 A7 Shembuj veprimi që mund të jenë masa mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të interesit vetjak përfshijnë:

- Përfshirjen e anëtarit të ekipit të sigurisë nga çdo vendimmarrje e rëndësishme në lidhje me angazhimin e sigurisë.
- Angazhimin e një profesionisti të përshtatshëm për rishikimin e punës së anëtarit të ekipit të sigurisë.

HUAT DHE GARANCITË

Hyrje

911.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë.

911.2 Një hua ose garanci huaje me një klient të sigurisë mund të krijojë një kërcënim të interesit vetjak. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në rrethana të tilla.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

911.3 A1 Ky seksion përmban referenca për “materialitetin” e një huaje apo garancie. Për të përcaktuar nëse një hua apo garanci është materiale për një individ, do të merret parasysh pasuria neto e përbashkët e individit dhe anëtarëve të drejtpërdrejtë të familjes së individit.

Huat dhe garancitë me një klient të sigurisë

K911.4 Një firmë, një anëtar i ekipit të sigurisë, apo një familjar i drejtpërdrejtë i këtij individ, nuk duhet të kenë hua apo garanci huaje me një klient të

sigurisë, përveç kur huaja ose garancia është jo materiale për të dy palët e mëposhtme:

- (c) Firmën ose individin që merr huan ose garancinë, sipas rastit; dhe
- (d) Klientin.

Huat dhe garancitë me një klient të sigurisë që është një bankë apo institucion i ngjashëm me të

K911.5 Një firmë, një anëtar i ekipit të sigurisë apo një familjar i drejtpërdrejtë i këtij individi, nuk duhet të pranojë një hua apo një garanci huaje nga një klient i sigurisë që është një bankë apo institucion i ngjashëm, përveç nëse huaja ose garancia është bërë sipas procedurave, kushteve dhe termave normale të huadhënies.

911.5 A1 Shembuj të huave përfshijnë huat hipotekore, overdraftet bankare, huat për makina dhe tepricat e kartës së kreditit.

911.5 A2 Edhe nëse firma merr një hua nga një klient i sigurisë që është bankë apo institucion i ngjashëm, sipas procedurave, kushteve dhe termave normale të huadhënies, huaja mund të krijojë një kërcënim të interesit vetjak nëse ajo është materiale për klientin e sigurisë apo për firmën që merr huan.

911.5 A3 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tillë të interesit vetjak, do të ishte rishikimi i punës nga një rishikues i përshtatshëm, që nuk është anëtar i grupit të sigurisë dhe nuk është as përfituesi i huas.

Depozitat ose llogaritë e ndërmjetësimit (brokerimi)

K911.6 Një firmë, një anëtar i ekipit të sigurisë apo një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së këtij individi, nuk do të kenë depozita ose llogari ndërmjetësimi me një klient të sigurisë, i cili është një bankë, ndërmjetësues ose një institucion i ngjashëm, përveç nëse depozita ose llogaria është sipas kushteve tregtare normale.

Huat dhe garancitë me një klient të sigurisë që nuk është bankë apo institucioni ngjashëm me të

K911.7 Një firmë, një anëtar i ekipit të sigurisë apo një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së këtij individi, nuk do të pranojnë hua ose garanci nga një klient i sigurisë që nuk është bankë apo institucion i ngjashëm me të, përveç nëse huaja apo garancia është jo materiale për të dyja palët e mëposhtme:

- (a) Firmën ose individin që merr huan ose garancinë, sipas rastit; dhe
- (b) Klientin.

SEKSIONI 920

MARRËDHËNIET E BIZNESIT

Hyrje

- 920.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë.
- 920.2 Një marrëdhënie e ngushtë biznesi me një klient të sigurisë ose me drejtimin e tij, mund të krijojë një kërcënim të interesit vetjak apo të frikësimit. Ky seksion përshkruan kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në rrethana të tilla.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 920.3 A1 Ky seksion përmban referenca për “materialitetin” e një interesi financiar dhe “rëndësinë” e një marrëdhënieje biznesi. Në përcaktimin nëse një interes financiar i tillë është material për një individ, do të merren parasysh pasuria neto e përbashkët e individit dhe anëtarëve të drejtpërdrejtë të familjes së individit.
- 920.3 A2 Shembuj të marrëdhënieve të ngushta të biznesit nga një marrëdhënie tregtare ose nga interesat financiare të përbashkëta, përfshijnë:
- Ekzistencën e një interesi financiar në një sipërmarrje të përbashkët me klientin ose me një pronar kontrollues, drejtorin, zyrtarin ose individë të tjerë, të cilët kryejnë veprimtari të drejtimit të lartë për atë klient.
 - Marrëveshjet për të kombinuar një apo më shumë shërbime ose produkte të firmës me një ose më shumë shërbime apo produkte të klientit dhe tregtimi i paketës me referim për të dyja palët.
 - Marrëveshjet e shpërndarjes ose të marketingut sipas të cilave firma shpërndan ose tregon produktet ose shërbimet e klientit, ose klienti shpërndan ose tregon produktet ose shërbimet e firmës.

Firma, ekipi i sigurisë ose marrëdhënia e biznesit me familjarin e drejtpërdrejtë

- K920.4** Një firmë ose një anëtar i grupit të sigurisë, nuk duhet të ketë marrëdhënie të ngushta biznesi me një klient të sigurisë ose drejtimin e tij, përveç nëse interesi financiar është jo material dhe marrëdhënia e

biznesit është e parëndësishme për klientin apo drejtimin e tij, si edhe, sipas rastit, për firmën apo anëtarin e grupit të sigurisë.

- 920.4 A1 Një kërcënim i interesit vetjak ose i frikësimit mund të ishte krijuar nëse ekziston një marrëdhënie biznesi e ngushtë midis klientit të sigurisë ose drejtimin të tij me familjarin e drejtpërdrejtë të një anëtari të ekipit të sigurisë.

Blerja e mallrave ose shërbimeve

- 920.5 A1 Blerja e mallrave dhe shërbimeve nga një klient i sigurisë nga një firmë, një anëtar i ekipit të sigurisë, ose një anëtar i drejtpërdrejtë të familjes së atij individi, në përgjithësi nuk krijon një kërcënim për pavarësinë, nëse transaksioni është bërë në rrjedhën normale të biznesit dhe sipas parimit të palëve të lira. Megjithatë, këto transaksione mund të kishin qenë të një natyre apo shkalle të tillë që mund të krijojnë një kërcënim të interesit vetjak.
- 920.5 A2 Shembuj të veprimeve që mund të eliminojnë të tilla kërcëime të interesit vetjak përfshijnë:
- Eliminimin ose reduktimin e madhësisë së transaksionit.
 - Largimin e individit nga ekipi i sigurisë.

SEKSIONI 921

MARRËDHËNIET FAMILJARE DHE PERSONALE

Hyrje

- 921.1** Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë.
- 921.2** Marrëdhëniet familjare ose personale me personelin e klientit mund të krijojnë një kërcënimin të interesit vetjak, të familjaritetit apo të frikësimit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në rrethana të tilla.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 921.3 A1** Një kërcënim i interesit vetjak, familjaritetit apo frikësimit mund të krijohet nga marrëdhëniet familjare ose personale midis një anëtari të ekipit të sigurisë dhe një drejtori ose zyrtari, ose në varësi të rolit të tyre, disa punonjësve të klientit të sigurisë.
- 921.3 A2** Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve, përfshijnë:
- Përgjegjësitë e individit në ekipin e sigurisë.
 - Rolin e familjarit ose individit tjetër brenda klientit dhe afërsinë e marrëdhënies.

Familjari i drejtpërdrejtë i një anëtari të grupit të sigurisë

- 921.4 A1** Një kërcënim i interesit vetjak, familjaritetit apo frikësimit krijohet kurnjë familjar i drejtpërdrejtë i një anëtari të ekipit të sigurisë është një punonjës në një pozicion që ushtron ndikim të rëndësishëm mbi çështjen në fjalë të angazhimit të sigurisë.
- 921.4 A2** Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit kërcënimeve të tilla përfshijnë:
- Pozicionin që mbahet nga familjari i drejtpërdrejtë.
 - Rolin e anëtarit të grupit të sigurisë.
- 921.4 A3** Shembull i një veprimi, që mund të eliminojë kërcënimeve të tilla të

- interesit vetjak, familjaritetit apo frikësimit është largimi i individit nga ekipi isigurisë
- 921.4 A4 Shembull i një veprimi, që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e kërcënimeve të tilla të interesit vetjak, familjaritetit apo frikësimit është strukturimi i përgjegjësive të ekipit të sigurisë në mënyrë që anëtarit i ekipit të sigurisë të mos trajtojnë çështjet që janë brenda përgjegjësisë së familjarit të tij të drejtpërdrejtë.
- K921.5** Një individ nuk do të jetë anëtar i ekipit të sigurisë kur ndonjë prej familjarëve të tij të drejtpërdrejtë:
- (a) Është një drejtor apo zyrtar i klientit të sigurisë;
 - (b) Është një punonjës në një pozicion që ushtron ndikim të rëndësishëm mbi informacionin e çështjes në fjalë të angazhimit të sigurisë; ose
 - (c) Ka qenë në një pozicion të tillë gjatë çdo periudhe të mbuluar nga angazhimi ose informacioni i çështjes në fjalë.

Familjari i afërt i një anëtarit të grupit të sigurisë

- 921.6 A1 Një kërcënim i interesit vetjak, familjaritetit apo frikësimit krijohet kur një familjar i afërt i një anëtarit të ekipit të sigurisë është:
- (a) Një drejtor apo zyrtar i klientit të sigurisë; ose
 - (b) Një punonjës në një pozicion që ushtron ndikim të rëndësishëm mbi çështjen në fjalë në shqyrtim, ose në një angazhim për të vërtetuar, një punonjës në një pozicion që ushtron influence të rëndësishme mbi informacionin e çështjes në fjalë të angazhimit të sigurisë;
- 921.6 A2 Faktorët e përshtatshëm për vlerësimin e nivelit kërcënimeve të tilla përfshijnë:
- Natyrën e marrëdhënies midis anëtarit të grupit të sigurisë me familjarin e afërt.
 - Pozicionin që ka familjari i afërt.
 - Rolin e anëtarit të grupit të sigurisë.
- 921.6 A3 Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë të tilla kërcënimë të interesit vetjak, familjaritetit apo frikësimit është largimi i këtij individit nga ekipi i sigurisë.
- 921.6 A4 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e kërcënimeve të tilla të interesit vetjak, familjaritetit apo frikësimit është strukturimi i përgjegjësive të ekipit të sigurisë, në mënyrë që anëtarit i ekipit të sigurisë të mos trajtojnë çështjet që janë brenda

përgjegjësisë së familjarit të tij të afërt.

Marrëdhënie të tjera të ngushta të një anëtarit të grupit të sigurisë

K921.7 Një anëtar i ekipit të sigurisë duhet të konsultohet, në përputhje me politikat dhe procedurat e firmës, për faktin nëse anëtar i ekipit të sigurisë ka një marrëdhënie të ngushtë me një individ që nuk është familjar i drejtpërdrejtë apo i afërt, por i cili është:

- (a) Një drejtor apo zyrtar i klientit të sigurisë; ose
- (b) Një punonjës në një pozicion që ushtron ndikim të rëndësishëm mbi çështjen në fjalë në shqyrtim, ose në një angazhim për të vërtetuar, një punonjës në një pozicion që ushtron influence të rëndësishme mbi informacionin e çështjes në fjalë të angazhimit të sigurisë;

921.7 A1 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimeve të tilla të interesit vetjak, familjaritetit dhe frikësimit të krijuar nga këto marrëdhënie, përfshijnë:

- Natyrën e marrëdhënies midis individit dhe anëtarit të ekipit të sigurisë.
- Pozicionin që ka individi tek klienti.
- Rolin e anëtarit të ekipit të sigurisë.

921.7 A2 Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë të tilla kërcënime të interesit vetjak, familjaritetit apo frikësimit është largimi i individit nga ekipi i sigurisë.

921.7 A3 Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për adresimin e të tilla kërcënimeve të interesit vetjak, familjaritetit apo frikësimit është strukturimi i përgjegjësisë të ekipit të sigurisë në mënyrë që anëtar i ekipit të sigurisë të mos trajtojë çështjet që janë brenda përgjegjësisë së individit me të cilin anëtar i ekipit të sigurisë ka marrëdhënie të ngushtë.

Marrëdhëniet e partnereve (ortakeve) dhe punonjësve të firmës

921.8 A1 Një kërcënim i interesit vetjak, familjaritetit apo frikësimit mund të krijohet nga një marrëdhënie personale dhe familjare midis:

- (a) Një ortakut ose punonjësit të firmës që nuk është anëtar i ekipit të sigurisë; dhe
- (b) Ndonjërit nga individët e mëposhtëm në klientin e sigurisë
 - (i) Një drejtor ose zyrtar;
 - (ii) Një punonjës në një pozicion që ushtron ndikim të

rëndësishëm mbi çështjen në fjalë në shqyrtim, ose në një angazhim për të vërtetuar, një punonjësi në një pozicion që ushtron influence të rëndësishme mbi informacionin e çështjes në fjalë të angazhimit të sigurisë;

921.8 A2 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit kërcënimeve të tilla përfshijnë:

- Natyrën e marrëdhënies midis ortakut apo punonjësit të firmës me drejtorin, oficerin apo punonjës të klientit.
- Shkallën e ndërveprimit të partnerit apo punonjësit të firmës me ekipin e sigurisë.
- Pozicionin e ortakut dhe punonjësit brenda firmës.
- Rolin e individit brenda klientit.

921.8 A3 Shembuj të veprimeve që mund të ishin masa mbrojtëse për adresimin e të tilla kërcënimeve të interesit vetjak, familjaritetit apo frikësimit përfshijnë:

- Strukturimin e përgjegjësiave të ortakut apo punonjësit për të reduktuar çdo ndikim të mundshëm mbi angazhimin e sigurisë.
- Angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për rishikimin e punës përkatëse të sigurisë.

SEKSIONI 922

SHËRBIMET E KOHËVE TË FUNDIT ME NJË KLIENTTË SIGURISË

Hyrje

- 922.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë.
- 922.2 Nëse një anëtar i ekipit të sigurisë ka shërbyer së fundmi si drejtor, zyrtar, apo punonjës për klientin e sigurisë, mund të krijohet një kërcënim i interesit vetjak, vetë rishikimit ose familjaritetit. Ky seksion përshkruan kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në rrethana të tilla.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Shërbimi gjatë periudhës së mbuluar nga raporti i sigurisë

- K922.3 Një kërcënim i interesit vetjak, vetë rishikimit apo familjaritetit mund të krijohet nëse, gjatë periudhës së mbuluar nga raporti i sigurisë, një anëtar i ekipit të sigurisë:
- (a) Ka shërbyer si drejtor ose zyrtar për klientin e sigurisë; ose
 - (b) Ka qenë një punonjës në një pozicion që ushtron ndikim të rëndësishëm mbi çështjen në fjalë në shqyrtim, ose në një angazhim për të vërtetuar, një punonjës në një pozicion që ushtron influence të rëndësishme mbi informacionin e çështjes në fjalë të angazhimit të sigurisë;

Shërbimi përpara periudhës së mbuluar nga raporti i sigurisë

- 922.4 A1 Një kërcënim i interesit vetjak, vetë rishikimit apo familjaritetit mund të krijohet nëse, përpara periudhës së mbuluar nga raporti i sigurisë, një anëtar i ekipit të sigurisë:
- (c) Ka shërbyer si drejtor ose zyrtar për klientin e sigurisë; ose
 - (d) Ka qenë një punonjës në një pozicion që ushtron ndikim të rëndësishëm mbi çështjen në fjalë në shqyrtim, ose në një angazhim për të vërtetuar, një punonjës në një pozicion që ushtron influence të rëndësishme mbi informacionin e çështjes në fjalë të angazhimit të sigurisë;

Për shembull, një kërcënim do të krijohej, nëse një vendim i marrë ose puna e kryer nga individit në periudhën e mëparshme, ndërkohe që ishte i

punësuar nga klienti, duhej vlerësohej në periudhën aktuale si pjesë e angazhimit aktual të sigurisë

922.4 A2 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimeve të tilla, përfshijnë:

- Pozicionin që individi ka patur tek klienti.
- Kohën që ka kaluar që nga momenti kur individi është larguar nga klienti.
- Rolin e anëtarit në grupin e sigurisë tek klienti

922.4 A3 Një shembull i një veprimi që mund të ishte një masë mbrojtëse për adresimin e të tilla kërcënimeve të interesit vetjak, vetë rishikimit apo familjaritetit, është angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për rishikimin e punës së kryer nga anëtari i ekipit të sigurisë.

SEKSIONI 923

SHËRBIMI SI DREJTOR OSE ZYRTAR TEK NJË KLIENTI SIGURISË

Hyrje

- 923.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë.
- 923.2 Shërbimi si drejtor ose zyrtar tek një klient i sigurisë krijon kërcënime të interesit vetjak dhe të vetë rishikimit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në rrethana të tilla.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Shërbimi si drejtor ose zyrtar

- K923.3** Një ortak ose punonjës i firmës nuk duhet të shërbejë si një drejtor apo zyrtar tek një klient i sigurisë i firmës.

Shërbimi si sekretar i kompanisë

- K923.4** Një ortak ose punonjës i firmës nuk do të shërbejë si Sekretar i Kompanisë për një klient të firmës së sigurisë, përveç nëse:

- (a) Kjo praktikë është e lejuar në mënyrë specifike nga ligjet, rregullat profesionale apo praktika lokale;
- (b) Të gjitha vendimet merren nga drejtimi; dhe
- (c) Detyrat dhe aktivitetet e kryera janë të limituara dhe të një natyre rutinë dhe administrative, të tilla si përgatitja e procesverbaleve dhe mbajtja e deklaratave statutores.

- 923.4 A1 Pozicioni i Sekretarit të Kompanisë ka implikime të ndryshme në juridiksione të ndryshme. Detyrat mund të variojnë nga: detyra administrative (të tilla si menaxhimi i personelit dhe mbajtja e regjistrimeve dhe regjistrave të kompanisë) në detyra po aq të larmishme, siç është siguri se kompania është në pajtueshmëri me rregullat dhe dhënia e këshillave mbi çështje të qeverisjes së korporatës. Në përgjithësi, ky pozicion nënkupton një bashkëpunim të ngushtë me entitetin. Prandaj, krijohet një kërcënim kur një ortak apo punonjës i firmës shërben si Sekretar i Kompanisë për një klient të sigurisë. (Më shumë informacion mbi shërbimet të jo sigurisë për një klient të sigurisë jepet në Seksionin

950, *Kryerja e Shërbimeve Jo Sigurisë për Klientët e Sigurisë*)

SEKSIONI 924

PUNËSIMI TEK NJË KLIENT I SIGURISË

Hyrje

- 924.1** Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë.
- 924.2** Marrëdhëniet e punësimit tek një klient i sigurisë mund të krijojnë një kërcënim të interesit vetjak, të familjaritetit apo të frikësimit. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në rrethana të tilla.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Te përgjithshme

- 924.3 A1** Një kërcënim i familjaritetit ose të frikësimit mund të krijohet nëse ndonjë nga individët e mëposhtëm ka qenë anëtar i grupit të sigurisë ose ortak i firmës:
- Një drejtori ose zyrtari;
 - Një punonjës në një pozicion që ushtron ndikim të rëndësishëm mbi çështjen në fjalë në shqyrtim, ose në një angazhim për të vërtetuar, një punonjësi në një pozicion që ushtron influence të rëndësishme mbi informacionin e çështjes në fjalë të angazhimit të sigurisë.

Kufizimet për ortakët ose anëtarët e mëparshëm të ekipit të sigurisë

- K924.4** Nëse një ortak i mëparshëm i është bashkuar klientit të sigurisë së një firme ose nëse një anëtar i mëparshëm i ekipit të sigurisë i është bashkuar klientit të sigurisë si:
- (a) Një drejtor ose zyrtar; ose
 - (b) Një punonjës në një pozicion që ushtron ndikim të rëndësishëm mbi çështjen në fjalë në shqyrtim, ose në një angazhim për të vërtetuar, një punonjës në një pozicion që ushtron influence të rëndësishme mbi informacionin e çështjes në fjalë të angazhimit të sigurisë, individit nuk do të vazhdoje të marre pjesë në aktivitetet e biznesit apo profesionale të firmës. .

- 924.4 A1** Edhe nëse ndonjëri nga individët e përshkruar në paragrafin K924.4 i është bashkuar klientit të sigurisë në një pozicion të tillë dhe nuk vazhdon

të marrë pjesë në bizneset apo aktivitetet profesionale të firmës, përsëri mund të krijohet një kërcënim i interesit vetjak dhe i frikësimit.

924.4 A2 Një kërcënim i interesit vetjak dhe i frikësimit mund të krijohet gjithashtu, nëse një ish-ortak i firmës i është bashkuar një entiteti në një nga pozicionet e përshkruar në paragrafin 924.3 A1 dhe entiteti më pas bëhet një klient i sigurisë i firmës.

924.4 A3 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të kërcënimeve të tilla, përfshijnë:

- Pozicionin që individit ka tek klienti.
- Çdo përfshirje që individit do të ketë në ekipin e sigurisë.
- Periudhën kohore që ka kaluar që nga momenti i fundit kur individit ishte anëtar i ekipit të sigurisë ose ortak i firmës.
- Pozicionin e mëparshëm të individit brenda ekipit të sigurisë apo firmës. Një shembull është fakti nëse individit ka qenë përgjegjës për mbajtjen e kontakteve të rregullta me drejtuesit e klientit ose personat e ngarkuar me qeverisjen.

924.4A4 Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për adresimin e të tilla kërcënimeve të familjaritetit dhe të frikësimit përfshijnë:

- Bërjen e marrëveshjeve të tilla që individit të mos lejohet të ketë asnjë të drejtë në përfitimet apo pagesat nga firma, përveç nëse këto janë në kuadrin e marrëveshjeve të paracaktuara dhe të fiksuara.
- Bërjen e marrëveshjeve të tilla që çfarëdo shume që firma u detyrohet individëve nuk është materiale për firmën.
- Modifikimin e planit për angazhimin e sigurisë.
- Caktimin, në grupin e sigurisë të individëve, të cilët kanë përvojën të mjaftueshme që ka patur individit që i është bashkuar klientit.
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm për të rishikuar punën e ish-anëtarit të grupit të sigurisë.

Anëtarët e grupit të sigurisë që hyjnë në negociata punësimi me një klient

K924.5 Një firmë duhet të ketë politika dhe procedura që u kërkojnë anëtarëve të ekipit të sigurisë të njoftojnë firmën kur ata futen në negociata punësimi me një klient të sigurisë.

924.5 A1 Një kërcënim i interesit vetjak krijohet kur një anëtar i ekipit të sigurisë merr pjesë në angazhime të sigurisë duke ditur që anëtarit i ekipit të sigurisë mund, ose do t'i bashkohet klientit në të ardhmen.

- 924.5 A2 Një shembull i një veprimi që mund të eliminonte një kërcënim të tille të interesit vetjak është largimi i individit nga angazhimi i sigurisë.
- 924.5 A3 Një shembull i një veprimi që mund të shërbejë si masë mbrojtëse për adresimin e një kërcënimi të tille të interesit vetjak është angazhimi i një rishikuesi të përshtatshëm për rishikimin e çdo gjykimi thelbësor të bërë nga anëtari i ekipit të sigurisë kur ai ishte pjesë e ekipit.

SEKSIONI 940

LIDHJA E GJATË E PERSONELIT ME NJË KLIENTTË SIGURISË

Hyrje

- 940.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë.
- 940.2 Kur një individ është përfshirë në një angazhim të sigurisë të një natyre të përsëritur për një kohe të gjatë, mund të krijohen kërcënime të familjaritetit dhe të interesit vetjak. Ky seksion përcakton kërkesat specifike dhe materialin përkatës për zbatimin e kuadrit konceptual në rrethana të tilla.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- 940.3 A1 Një kërcënim familjariteti mund të krijohet si rezultat i lidhjes së gjatë të një individi me:
- (a) Klientin e sigurisë;
 - (b) Drejtimin e lartë të klientit të sigurisë; ose
 - (c) Çështjen në fjalë që shqyrtohet dhe informacionin e çështjes në fjalë të angazhimit të sigurisë.
- 940.3 A2 Një kërcënim i interesit vetjak mund të krijohet si rezultat i shqetësimit të një individi për humbjen e një klienti të vjetër të sigurisë ose një interesi në mbajtjen e një marrëdhënieje personale të afërt me një anëtar të drejtimit të lartë ose person të ngarkuar me qeverisjen. Një kërcënim i tillë mund të ndikojë gjykimin e individit në mënyrë të papërshtatshme.
- 940.3 A3 Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të një kërcënimi të tillë të familjaritetit dhe interesit vetjak, përfshijnë:
- Natyrën e angazhimit të sigurisë.
 - Sa gjatë ka qëndruar individi si anëtar i ekipit të sigurisë, si drejtues i lartë në ekip dhe natyrën e roleve të kryera, përfshirë faktin nëse kjo marrëdhënie ekzistonte kur individi ishte pjesë e një firme të mëparshme.
 - Shkallën në të cilën puna e individit është drejtuar, rishikuar dhe mbikëqyrur nga një personel më i lartë.

- Shkallën në të cilën individi, për shkak të pozicionit si drejtues i lartë, ka aftësi të ndikojë rezultatin e angazhimit të sigurisë, për shembull, duke marrë vendime të rëndësishme apo duke drejtuar punën e anëtarëve të tjerë të grupit të angazhimit.
- Afërsinë e marrëdhënies personale të individit me klientin e sigurisë ose, nëse është e zbatueshme, me drejtimin e lartë.
- Natyrën, shpeshtësinë dhe shtrirjen e bashkëveprimit midis individit dhe klientit të sigurisë.
- Faktin nëse ka ndryshuar natyra apo kompleksiteti i çështjes në fjalë ose informacionit të çështjes në fjalë.
- Faktin nëse kohët e fundit ka patur ndryshime tek individi apo individët që janë pala përgjegjëse ose, nëse është e zbatueshme, tek drejtimi i lartë.

940.3 A4 Kombinimi i dy ose më shumë faktorëve mund të rrisë ose zvogëlojë nivelin e kërcënimeve. Për shembull, kërcënimet e familjaritetit të krijuara përgjatë kohës nga marrëdhënia gjithnjë e më e afërt midis një anëtari të ekipit të sigurisë dhe një individi tek klienti i sigurisë, i cili është në gjendje të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi çështjen në fjalë në shqyrtim ose, në një angazhim për të vërtetuar, mbi informacionin e çështjes në fjalë, do të reduktoheshin nga largimi i individit që është palë përgjegjëse.

940.3 A5 Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë kërcënimet e familjaritetit dhe të interesit vetjak në lidhje me një angazhim specifik do të ishte rotacioni i individit jashtë ekipit të sigurisë.

940.3 A6 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për adresimin e kërcënimeve të tilla, të familjaritetit dhe interesit vetjak, përfshijnë:

- Ndryshimin e rolit të individit në ekipin e sigurisë ose të natyrës dhe shtrirjes së detyrave që kryen individi.
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm, që nuk ka qenë anëtar i grupit të angazhimit, për rishikimin e punës së individit.
- Kryerjen e rishikimeve të rregullta të pavarura, të brendshme apo të jashtme, të cilësisë së angazhimit.

K940.4 Nëse një firmë përcakton se niveli i kërcënimeve të krijuara mund të adresohet vetëm nëpërmjet rotacionit të individit jashtë ekipit të sigurisë, firma do të përcaktojë një periudhë kohore të përshtatshme gjatë së cilës individi nuk do të:

- (a) Jetë anëtar i ekipit të angazhimit për angazhimin e sigurisë;
- (b) Kryejë kontroll cilësie për angazhimin e sigurisë; ose
- (c) Ushtrijë ndikim direkt mbi rezultatin e angazhimit të sigurisë.

Periodha kohore duhet të jetë e mjaftueshme për të lejuar adresimin e kërcënimeve të familjaritetit dhe të interesit vetjak

SEKSIONI 950

KRYERJA E SHËRBIMEVE TË JO-SIGURISË PËR KLIENTËT E SIGURISË TË NDRYSHËM NGA KLIENTËT E ANGZHIMEVE TË AUDITIMIT DHE RISHIKIMIT

Hyrje

- 950.1 Firmave u kërkohet të respektojnë parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të përcaktuar në seksionin 120 për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 950.2 Në përputhje me aftësitë dhe ekspertizën e tyre, firmat mund të japin një sërë shërbimesh të jo-sigurisë për klientët e tyre të sigurisë. Dhënia e disa shërbimeve të jo-sigurisë për klientët e sigurisë mund të krijojë kërcënimet për pajtueshmërinë me parimet themelore dhe kërcënimet ndaj pavarësisë.
- 950.3 Ky seksion përcakton kërkesat dhe materialin për zbatim që lidhet me zbatimin e kuadrit konceptual për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë kur ofrohen shërbime të jo-sigurisë për klientët e sigurisë.
- 950.4 Praktikrat e reja të biznesit, evolucioni i tregjeve financiare dhe ndryshimet në teknologji janë disa zhvillime që e bëjnë të pamundur hartimin e një liste gjithëpërfshirëse të shërbimeve të jo-sigurisë që firmat mund t'i japin një klienti të sigurisë. Kuadri konceptual dhe dispozitat e përgjithshme në këtë seksion zbatohen kur një firmë i propozon t'i japë një klienti një shërbim të jo-sigurisë për të cilin nuk ka kërkesa specifike dhe material për zbatim.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

Rreziku i marrjes së përgjegjësisë të menaxhimit kur jepet një shërbim i jo-sigurisë

- 950.5 A1** Kur një firmë jep një shërbim të jo-sigurisë për një klient të sigurisë, ekziston rreziku që firma të marrë përsipër përgjegjësi menaxhimi në lidhje me çështjen me çështjen në fjalë në shqyrtim, ose në një angazhim për të vërtetuar, informacionin e çështjes në fjalë të angazhimit të sigurisë, përveç nëse firma është e bindur se janë përmbushur kërkesat në paragrafët K900.13 dhe K900.14.

Pranimi i një angazhimi për të dhënë një shërbim të jo-sigurisë

K950.6 Përpara se një firmë të pranojë një angazhim për të dhënë një shërbim të jo-sigurisë për një klient të sigurisë, firma duhet të zbatojë kuadrin konceptual për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar çdo kërcënim ndaj pavarësisë që mund të krijohet nga dhënia e atij shërbimi.

Identifikimi dhe vlerësimi i kërcënimeve

950.7 A1 Një përshkrim i kategorive të kërcënimeve që mund të krijohen kur një firmë jep një shërbim të jo-sigurisë për një klient të sigurisë është dhënë në paragrafin 120.6 A3.

950.7 A2 Faktorët që janë të përshtatshëm për identifikimin dhe vlerësimin e kërcënimeve të ndryshme, të cilat mund të krijohen nga dhënia e një shërbimi të jo-sigurisë për një klient të sigurisë, përfshijnë:

- Natyrën, qëllimin, përdorimin e synuar dhe qëllimin e shërbimit.
- Mënyra në të cilën do të jepet shërbimi, për shembull anëtarët e personelit që do të përfshihen dhe vendndodhja e tyre.
- Mjedisin ligjor dhe rregullator në të cilin jepet shërbimi.
- Faktin nëse klienti është një entitet me interes publik.
- Nivelin e ekspertizës së drejtuesve dhe punonjësve të klientit në lidhje me llojin e shërbimit të dhënë.
- Nëse rezultati i shërbimit do të ndikojë në çështjen në fjalë në shqyrtime dhe, në një angazhim për të vërtetuar, çështjet e pasqyruara në informacionin për çështjen në fjalë të angazhimit të sigurisë, dhe nëse është kështu:
 - Shkallen në të cilën rezultati i shërbimit do të ketë një efekt material në çështjen në fjalë dhe, në një angazhim për të vërtetuar, në informacionin për çështjen në fjalë të angazhimit të sigurisë.
 - Shkallen në të cilën klienti i sigurisë përcakton çështjet që janë të rëndësishme për gjykimin (Ref: Para. R900.13 deri në R900.14).
- Shkallen e mbështetjes që do të vendoset në rezultatin e shërbimit si pjesë e angazhimit të sigurisë.
- Tarifën që lidhet me dhënien e shërbimit të jo-sigurisë.

Materialiteti në lidhje me informacionin e një klienti të sigurisë

950.8 A1 Materialiteti është një faktor i rëndësishëm për vlerësimin e kërcënimeve të krijuara nga dhënia e një shërbimi të jo-sigurisë për një klient të sigurisë. Koncepti i materialitetit në lidhje me informacionin për çështjen në fjalë të një klienti të sigurisë është trajtuar në Standardin Ndërkombëtar për Angazhimet e Sigurisë (ISAE) 3000 (i rishikuar), Angazhimet e

Sigurisë të Ndryshme nga Auditimet ose Rishikimet e Informacionit Historik Financiar. Përcaktimi i materialitetit përfshin ushtrimin e gjykitimit profesional dhe ndikohet nga faktorë sasiorë dhe cilësorë. Ai ndikohet gjithashtu, nga perceptimet e përdoruesve për nevojat e tyre për informacionet financiare ose informacione të tjera.

Shërbime të shumëfishta të jo-sigurisë të dhëna për të njëjtin klient të sigurisë

950.9 A1 Një firmë mund të japë shërbime të shumëfishta të jo-sigurisë për një klient të sigurisë. Në këto rrethana, efekti i kombinuar i kërcënimeve të krijuara nga dhënia e këtyre shërbimeve është i rëndësishëm për vlerësimin e kërcënimeve nga firma.

Kërcënimet e vetë-rishikimit

950.10 A1 Një kërcënim i vetë-rishikimit mund të krijohet nëse, në një angazhim për të vërtetuar, firma përfshihet në përgatitjen e informacionit për çështjen në fjalë, i cili bëhet më pas informacion për çështjen në fjalë të një angazhimi të sigurisë. Shembuj të shërbimeve të jo-sigurisë që mund të krijojnë kërcënime të tilla të vetë-rishikimit kur jepen shërbimet e lidhura me informacionin e çështjes në fjalë të një angazhimi të sigurisë, përfshijnë:

- (a) Zhvillimin dhe përgatitjen e informacionit parashikues dhe lëshimin me pas të një raporti të sigurisë mbi këtë informacion.
- (b) Kryerja e një vlerësimi që lidhet ose është pjesë e informacionit për çështjen në fjalë të një angazhimi të sigurisë.

Klientët e sigurisë që janë entitete me interes publik

950.11 A1 Pritshmëritë për pavarësinë e një firme rriten kur një firmë ndërmerr një angazhim për sigurinë për një entitet me interes publik dhe rezultatet e këtij angazhimi do të jenë:

- (a) Të disponueshme publikisht, përfshirë për aksionarët dhe palët e tjera të interesuara; ose
- (b) I jepen një entiteti ose organizate të krijuar me ligj ose rregullore për të mbikëqyrur funksionimin e një sektori ose aktiviteti biznesi.

Marrja në konsideratë e këtyre pritshmërive është pjesë e testit palës së tretë të arsyeshme dhe të informuar që zbatohet kur përcaktohet nëse do t'i jepet një shërbim i jo-sigurisë një klienti të sigurisë.

950.11 A2 Nëse ekziston një kërcënim i vetë-rishikimit, në lidhje me një angazhim të ndërmarrë në rrethanat e përshkruara në paragrafin 950.11 A1 (b), firma inkurajohet të deklarojë ekzistencën e këtij kërcënimi të vetë -

rishikimit dhe hapat e ndërmarrë për ta adresuar atë tek pala që angazhon firmën ose personat e ngarkuar me qeverisjen e klient të sigurisë dhe tek entiteti ose organizata e krijuar me ligj ose rregullore për të mbikëqyrur funksionimin e një sektori ose aktiviteti biznesi, për të cilët do të jepen rezultatet e angazhimit.

Adresimi i kërcënimeve

950.12 A1 Paragrafët 120.10 deri 120.10 A2 përfshijnë një kërkesë dhe materialin për zbatim, që janë të përshtatshëm kur trajtohen kërcënimet ndaj pavarësisë, duke përfshirë një përshkrim të masave mbrojtëse.

950.15 A2 Kërcënimet ndaj pavarësisë të krijuara nga dhënia e një shërbimi të jo-sigurisë ose shërbime të shumëfishta për një klient të sigurisëndryshojnë në varësi të fakteve dhe rrethanave të angazhimit të sigurisë dhe natyrës së shërbimit. Kërcënime të tilla mund të adresohen duke zbatuar masa mbrojtëse ose duke rregulluar qëllimin eshërbimit të propozuar.

950.12 A3 Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për të trajtuar këto kërcënime, përfshijnë:

- Përdorimin e profesionistëve, që nuk janë anëtarë të ekipit të sigurisë, për të kryer shërbimin.
- Përfshirjen e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk ishte i përfshirë në dhënien e shërbimit për të rishikuar punën e sigurisë ose shërbimin e kryer.

950.12 A4 Mund të ndodhe që të mos ketë masa mbrojtëse në dispozicion për të reduktuar kërcënimin e krijuar nga dhënia e një shërbimi të jo-sigurisë për një klient të sigurisë në një nivel të pranueshëm. Në një situatë të tillë, zbatimi i kuadrit konceptual kërkon që firma të:

- (a) Të rregullojë objektin e shërbimit të propozuar për të eliminuar rrethanat që krijojnë kërcënimin;
- (b) Të refuzojë ose të përfundojë shërbimin që krijon kërcënimin që nuk mund të eliminohet ose reduktohet në një nivel të pranueshëm; ose
- (c) Të përfundojë angazhimin e dhënies së sigurisë.

SEKSIONI 990

RAPORTET QË PËRFSHIJNË NJË KUFIZIM NË PËRDORIM DHE SHPËRNDARJE (ANGAZHIME E SIGURISË TË NDRYSHME NGA ANGAZHIMETE AUDITIMIT DHE RISHIKIMIT)

Hyrje

- 990.1 Firmave ju kërkohet të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore, të jenë të pavarura dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të dhënë në Seksionin 120 për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë.
- 990.2 Ky seksion përshkruan disa modifikime në Pjesën 4B, të cilat janë të lejuara në disarrethana të caktuara për angazhimet e sigurisë, kur raporti përfshin një kufizim në përdorim dhe shpërndarje. Në këtë seksion, një angazhim për lëshimin e një raporti të sigurisë së kufizuar në përdorim dhe shpërndarje, në rrethanat e përcaktuara në paragrafin K990.3, është referuar edhe si një “angazhim sigurie i pranueshëm”.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Të përgjithshme

- K990.3** Kur një firmë synon të lëshojë një raport mbi një angazhim të sigurisë, i cili përfshin një kufizim në përdorim dhe shpërndarje, kërkesat për pavarësinë të përcaktuara në Pjesën 4B do të jenë të pranueshme për modifikimet që janë të lejuara nga ky seksion, por vetëm nëse:
- (a) Firma komunikon me përdoruesit e synuar të raportit, lidhur me kërkesat e modifikuara për pavarësinë, të cilat do të zbatohen në dhënien e këtij shërbimi; dhe
 - (b) Përdoruesit e synuar të raportit kuptojnë qëllimin, informacionin e çështjes në fjalë dhe kufizimet e raportit dhe në mënyrë të qartë (eksplicite) pranojnë për zbatimin e modifikimeve.
- 990.3 A1 Përdoruesit e synuar të raportit mund të arrijnë një kuptim të qëllimit, informacionit të çështjes në fjalë dhe kufizimeve të raportit, përmes pjesëmarrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë me anë të një përfaqësuesi që ka autoritetin të veprojë për përdoruesit e synuar, në përcaktimin e natyrës dhe objektit të angazhimit. Në secilin rast, pjesëmarrja e ndihmon firmën të komunikojë me përdoruesit e synuar për çështje të pavarësisë, përfshirë rrethanat që janë të përshtatshme për zbatimin e kuadrin konceptual. Gjithashtu, pjesëmarrja i lejon firmëstë marrë miratimin e përdoruesve të synuar për kërkesat e modifikuara për

pavarësinë.

K990.4 Kur përdoruesit e synuar janë një klasë e përdoruesve të pa identifikueshëm në mënyrë specifike me emër në kohën kur përcaktohen termat e angazhimit, firma më pas do t'i njohe këta përdorues për kërkesat e modifikuara për pavarësinë të rëna dakord me përfaqësuesit e tyre.

990.4 A1 Për shembull, kur përdoruesit e synuar janë një klasë përdoruesish të tillë si huadhënësit në një marrëveshje huaje sindikaliste, firma mund të përshkruajë kërkesat e modifikuara për pavarësinë, në një letër angazhimi drejtuar përfaqësuesit të huadhënësve. Më pas përfaqësuesi, letrën e angazhimit e vë në dispozicion anëtarëve të grupit të huadhënësve, kjo në përmbushje të kërkesës për njoftimin nga firma të këtyre përdoruesve mbi kërkesat e modifikuara për pavarësinë të rëna dakord me përfaqësuesin.

K990.5 Kur firma kryen një angazhim për sigurinë që është i pranueshëm, çdo modifikim në Pjesën 4B duhet të kufizohet në përputhje me modifikimet e dhëna në paragrafët K990.7 dhe K990.8.

K990.6 Nëse firma lëshon gjithashtu një raport të sigurisë që nuk përfshin një kufizim në përdorim dhe shpërndarje për të njëjtin klient, për angazhimin e sigurisë firma dotë zbatojë Pjesën 4B.

Interesat financiare, huat dhe garancitë, marrëdhëniet e ngushta të biznesit, familjare dhe personale

K990.7 Kur firma kryen një angazhim të sigurisë që është i punueshëm:

- (a) Dispozitat përkatëse të dhëna në Seksionet 910, 911, 920, 921, 922 dhe 924 nevojitet të zbatohen vetëm për anëtarët e ekipit të angazhimit dhe familjarët e tyre të drejtpërdrejtë dhe të afërt;
- (b) Firma do të identifikojë, vlerësojë dhe adresojë çdo kërcënim ndaj pavarësisë të krijuar nga marrëdhëniet dhe interesat, siç përcaktohet në Seksionet 910, 911, 920, 921, 922 dhe 924, midis klientit të sigurisë dhe anëtarëve të mëposhtëm të grupit të angazhimit;
 - (i) Ata që japin konsulencë lidhur me çështje teknike apo specifike të industrisë, transaksione apo ngjarje; dhe
 - (ii) Ata që kryejnë kontrollin e cilësisë për angazhimin, përfshirë ata që kryejnë rishikimin e kontrollit të cilësisë së angazhimit; dhe
- (c) Firma do të vlerësojë dhe adresojë çdo kërcënim për të cilin ekipi i angazhimit ka arsye të besojë se është krijuar nga interesat dhe

marrëdhëniet midis klientit të sigurisë dhe të tjerëve brenda firmës që mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë rezultatin e angazhimit të sigurisë, siç përshkruhet në seksionet 910, 911, 920, 921, 922 dhe 924.

- 990.7 A1 Persona të tjerë brenda firmës, që mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë rezultatin e angazhimit të sigurisë, përfshijnë ata që rekomandojnë shpërblimin ose që kryejnë mbikëqyrje direkt, drejtim apo lloj tjetër mbikëqyrjeje, për ortakun e angazhimit të sigurisë në lidhje me kryerjen e angazhimit të sigurisë.
- K990.8 Kur firma kryen një angazhim të sigurisë të pranueshëm, firma nuk dotë mbajë një interes financiar material të drejtpërdrejtë ose jo tek klienti i sigurisë.

FJALORI I TERMAVE, PËRFSHIRË LISTËN E SHKURTIMEVE

Në Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë), njëjësi do të interpretohet se e përfshin shumësin si dhe anasjelltas dhe termat e mëposhtëm kanë kuptimet e përcaktuara për to si në vijim.

Në këtë Fjalor, shpjegimet e termave të përkufizuar jepen me shkrim të rregullt; shkrimi i pjerrët përdoret për shpjegimet e termave të përshkruar që kanë një kuptim specifik në pjesë të caktuara të Kodit ose për shpjegime shtesë të termave të përkufizuar. Gjithashtu jepen edhe referenca për termat që përshkruhen në Kod

Acceptable level	Nivel i pranueshëm – Një nivel në të cilin një profesionist kontabël, duke përdorur testin e një pale të tretë të arsyeshme dhe të mirë informuar, ka të ngjarë të arrijë në përfundimin se profesionisti kontabël është në përputhje me parimet themelore
Advertising	Reklamimi - Komunikimi për publikun i informacioneve që lidhen me shërbimet apo aftësitë profesionale që ofrojnë profesionistët kontabël në praktikën publike me qëllim sigurimin e biznesit profesional
Appropriate reviewer	Rishikues i përshtatshëm – Një rishikues i përshtatshëm është një profesionist me njohuritë, aftësitë, eksperiencën dhe autoritetin e nevojshëm për të rishikuar, në mënyrë objektive, punën përkatëse të kryer ose shërbimin e dhënë. Një individ i tillë mund të jetë një profesionist kontabël.
Assurance client	Klient i sigurisë - Pala përgjegjëse që është personi (ose personat), që: (a) Në një angazhim që bazohet në raportimin e drejtpërdrejtë, ka përgjegjësinë për çështjen në fjalë (që shqyrtohet); ose (b) Në një angazhim që bazohet në pohim, ka përgjegjësinë lidhur me informacionet për çështjen në fjalë (që shqyrtohet) dhe mund të jetë përgjegjës edhe për çështjen në fjalë.
Assurance engagement	Angazhim i sigurisë – Një angazhim në të cilin një profesionist kontabël në praktikën publike shpreh një konkluzion që synon tëpërmirësojë nivelin e besimit të përdoruesve të synuar, me përjashtim të palës që është përgjegjëse, për rezultatet e vlerësimit apo të matjes së një çështje në fjalë sipas një kriteri të dhënë. (Për udhëzime mbi angazhimet e dhënies së sigurisë, shiko <i>Kuadrin Ndërkombëtar të Angazhimeve për Dhënien e Sigurisë</i> të publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë. <i>Kuadri Ndërkombëtar i Angazhimeve për Dhënien e Sigurisë</i> përshkruan elementët

dhe objektivat e një angazhimi të sigurisë dhe identifikon angazhimet për të cilat zbatohen *Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)*; *Standardet Ndërkombëtare të Rishikimit të Angazhimeve (SNRA)* dhe *Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Sigurisë (SNAS)*.

- Assurance team Ekipi i sigurisë:
- (a) Të gjithë anëtarët e grupit të angazhimit për angazhimin e sigurisë;
 - (b) Gjithë të tjerët brenda një firme, të cilët mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultatin e angazhimit të sigurisë, ku përfshihen:
 - (i). Personat që rekomandojnë kompensimin ose që japin mbikëqyrje apo drejtim të drejtpërdrejtë, ose çdo monitorim tjetër për një ortak të angazhimit të sigurisë, lidhur me kryerjen e këtij angazhimi të sigurisë.
 - (ii). Personat të cilët japin konsulencë për çështje teknike apo sektorë specifikë të ekonomisë, transaksione apo ngjarje, që kanë të bëjnë me angazhimin e sigurisë; dhe
 - (iii). Personat të cilët kryejnë kontrollin e cilësisë për angazhimet e sigurisë, përfshirë ata të cilët kryejnë angazhimet e rishikimit të kontrollit të cilësisë për angazhimin e sigurisë.

Attestation engagement Angazhim për të vërtetuar. Një angazhim i sigurisë, në të cilin një palë e ndryshme nga profesionisti kontabël në praktikën publike, mat ose vlerëson çështjen në fjalë kundrejt kritereve. Zakonisht, një palë e ndryshme nga profesionisti kontabël, paraqet shpesh informacionin për çështjen në fjalë në një raport ose një pasqyre. Megjithatë, në disa raste, informacioni për çështjen në fjalë mund të paraqitet nga profesionisti kontabël në raportin e sigurisë. Në një angazhim për të vërtetuar, konkluzionet e kontabilistit adresojnë faktin nëse informacioni për çështjen në fjalë ka ose jo anomali materiale.

Konkluzioni i kontabilistit mund të shprehet në termat e:

- (i) Çështjes në fjalë dhe kritereve të zbatueshme;
- (ii) Informacionit për çështjen në fjalë dhe kritereve të zbatueshme; ose
- (iii) Një deklaratë të bere nga një pale e përshtatshme

Audit Auditim – Në Pjesën 4A, termi “auditim” zbatohet njëllëj si termi “rishikim”.

Audit client	Klienti i Auditimit - Një entitet në lidhje me të cilin një firmë kryen një angazhim auditimi. Kur klienti është një entitet i listuar, klienti i auditimit do të përfshijë gjithmonë entitetet e lidhura me të. Kur klienti auditimit nuk është një entitet i listuar, klienti i auditimit përfshin ato entitete të lidhura mbi të cilat klienti ka kontroll të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. <i>(Shiko gjithashtu paragrafin K400.20.)</i> <i>Në Pjesën 4A, termi “klient auditimi” zbatohet njëjloj si “klient rishikimi”</i> <i>Ne rastin e një auditimi të grupit, shiko përkufizimin e klientit të auditimit – grup</i>
Audit engagement	Angazhimi i Auditimit - Një angazhim i dhënies së sigurisë së arsyeshme, në të cilën një profesionist kontabël në praktikën publike shpreh një opinion për faktin nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale (ose japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, ose janë paraqitur në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale), në përputhje me një kuadër të zbatueshëm të raportimit financiar, si për shembull një angazhim i kryer në pajtim me <i>Standardet Ndërkombëtare të Auditimit</i>. Këtu përfshihet një Auditim Ligjor, i cili është një auditim që kërkohet nga legjislacioni ose rregullore të tjera. <i>Në Pjesën 4A, termi “angazhim auditimi” zbatohet njëjloj si “angazhim rishikimi”.</i>
Audit report	<i>në Pjesën 4A, termi “raport auditimi” zbatohet njëjloj si “raport rishikimi”</i>
Audit team	Ekipi i auditimit (a) Të gjithë anëtarët e ekipit të angazhimit për angazhimin e auditimit; (b) Te gjithë të tjerët brenda një firme që mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultatin e angazhimit të auditimit, duke përfshirë: (i) Personat, të cilët rekomandojnë kompensimin ose që japin mbikëqyrje ose drejtim të drejtpërdrejtë, apo bëjnë monitorime të tjera për ortakun e angazhimit në lidhje me kryerjen e angazhimit të auditimit, përfshirë edhe ata individë që ndodhen në të gjitha nivelet hierarkike mbi ortakun e angazhimit deri të individi, i cili është ortaku ose Partneri Drejtues më i lartë (Drejtori Ekzekutiv ose ekuivalenti i tij); (ii) Personat të cilët japin konsulencë në lidhje me çështje teknike ose specifike për sektorin, transaksione ose

ngjarje për angazhimin; dhe

- (iii) Personat të cilët kryejnë kontrollin e cilësisë për angazhimin, përfshirë ata që kryejnë angazhimet e rishikimit të kontrollit të cilësisë për angazhimin; dhe
- (c) Të gjithë ata individë në firmën e rrjetin, të cilët mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultatin e angazhimit të auditimit.

Në Pjesën 4A, termi “ekip auditimi” zbatohet njëjloj si “ekip rishikimi”. në rastin e auditimit të grupit, shiko përkufizimin e ekipit të auditimit të grupit

Close family	Familjar i ngushtë Një prind, fëmijë apo motër/vëlla, që nuk është anëtar i drejtpërdrejtë i familjes.
Component	Komponent (entitet i kontrolluar) Një entitet, njësi biznesi, funksion ose aktivitet biznesi, ose ndonjë kombinim i tyre, i përcaktuar nga audituesi i grupit për qëllime të planifikimit dhe kryerjes së procedurave të auditimit në një auditim të grupit.
Component audit client	Klient auditimi – komponent. Një komponent në lidhje me të cilin një firmë audituese e grupit ose një firmë audituese e komponentit kryen punën e auditimit për qëllime të një auditimi të grupit. Kur një komponent është: (a) Një entitet ligjor, klient i auditimit komponent është entiteti dhe çdo entitet i lidhur mbi të cilin entiteti ka kontroll direkt ose indirekt; (b) Një njësi biznesi, funksion ose aktivitet biznesi (ose ndonjë kombinim i tyre), klienti i auditimit komponent është entiteti ligjor ose entitetet të cilave ju përket njësia e biznesit ose në të cilën kryhet funksioni ose veprimtaria e biznesit.
Component auditor firm	Firma audituese e komponentit - Një firmë që kryen punë auditimi lidhur me një komponent për qëllime të një auditimi të grupit.
Conceptual framework	Kuadër konceptual – Ky term përshkruhet në Seksionin 120.
Contingent fee	Honorar i kushtëzuar (paracaktuar) - Një honorar që llogaritet mbi një bazë të paracaktuar, i cili lidhet me përfundimin apo rezultatin e një transaksioni apo rezultatin e shërbimeve të kryera nga firma. Një honorar që caktohet nga gjykata apo nga një autoritet tjetër publik nuk është një honorar i kushtëzuar.
Cooling-off	Periodha e ndërprerjes – Ky term përshkruhet në paragrafin K540.5

period	<i>për qëllime të paragrafëve K540.11 deri K540.20.</i>
Criteria	Kriter - Në një angazhim sigurie, provat e përdorura për të matur ose vlerësuar çështjen në fjalë që shqyrtohet. "Kriteret e zbatueshme" janë kriteret e përdorura për angazhimin e veçantë.
Direct engagement	Angazhim i drejtpërdrejtë - Një angazhim i sigurisë në të cilin profesionisti kontabël në praktikën publike mat ose vlerëson çështjen në fjalë kundrejt kriterëve të zbatueshme dhe ai paraqet informacionin për çështjen në fjalë që rezulton si pjesë e ose shoqëruese, e raportit të sigurisë. Në një angazhim të drejtpërdrejtë, përfundimi i kontabilistit adreson rezultatin e raportuar të matjes ose vlerësimit të çështjes në fjalë kundrejt kriterëve.
Direct financial interest	Interes financiar i drejtpërdrejtë – Një interes financiar: (a) Që zotërohet drejtpërdrejt nga apo është nën kontrollin e një individi ose të një entiteti (përfshirë ato interesa që menaxhohennë mënyrë diskrete nga të tjerët); ose (b) Që sjell përfitim, i cili zotërohet përmes një mjeti investimi kolektiv, pasurie të patundshme, trusti apo ndërmjetësve të tjerë, mbi të cilët individi apo entiteti ka kontroll ose aftësinë për të influencuar vendimet për investimet.
Eligible audit engagement	<i>Ky term përkthuhet në paragrafin 800.2 për qëllime të Seksionit 800</i>
Eligible assurance engagement	<i>Ky term përkthuhet në paragrafin 990.2 për qëllime të Seksionit 990.</i>
Engagement partner	Ortaku (partneri) i angazhimit – Ortaku apo person tjetër në firmë që është përgjegjës për angazhimin dhe kryerjen e tij, dhe për raportin që lëshohet në emër të firmës, i cili, kur kërkohet një gjë e tillë, ka autoritetin e duhur nga një organizëm profesional, ligjor apo rregullator
Engagement period (Audit and Review)	Periudhë angazhimi (Angazhimi Auditimi dhe Rishikimi) - Periudha e angazhimit fillon kur ekipi i auditimit nis të kryejë auditimin. Periudha e auditimit mbaron me lëshimin e raportit të auditimit. Kur angazhimi është i një natyre të përsëritur, ai mbaron me njoftimin nga cilado palë që marrëdhënia profesionale ka mbaruar ose me lëshimin e raportit përfundimtar të auditimit, cilado qoftë më e vona prej tyre.
Engagement	Periudhë angazhimi (Angazhim i Sigurisë i Ndryshëm nga

period (Assurance Engagements Other than Audit and Review Engagements)	Angazhimet e Auditimit dhe Rishikimit) – Periudha e angazhimit fillon kur grupi i sigurisë nis të kryejë shërbimet e sigurisë në lidhje me angazhimin e veçantë. Periudha e angazhimit përfundon me lëshimin e raportit të sigurisë. Kur angazhimi është i një natyre të përsëritur, ai mbaron me njoftimin nga secila palë që marrëdhënia profesionale ka mbaruar ose me lëshimin e raportit përfundimtar të sigurisë, cilado qofte me e vona prej tyre
--	--

Engagement quality control review	Angazhim për rishikimin e kontrollit të cilësisë – Një proces i projektuar për të dhënë një vlerësim objektiv, përpara ose në datën e lëshimit të raportit, lidhur me gjykimet e rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit dhe me konkluzionet e arritura në formulimin e raportit.
---	--

Engagement quality reviewer	Rishikues i Cilësisë së angazhimit - Një partner, një individ tjetër në firmë, ose një individ i jashtëm, i emëruar nga firma për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit.
--------------------------------	---

Engagement team	Ekipi i angazhimit - Të gjithë ortakët dhe personeli që është ngarkuar për të kryer angazhimin dhe çdo individ i angazhuar nga firma ose nga rrjeti i firmave, që kryejnë procedurat e dhënies së sigurisë për angazhimin, përjashtuar ekspertet e jashtëm dhe audituesit e brendshëm të cilët japin asistencë të drejtpërdrejtë për menaxhimin.
--------------------	--

Në pjesën 4A, termi "ekip angazhimi" i referohet individëve që kryejnë procedurat e auditimit ose rishikimit, respektivisht për angazhimin e auditimit ose të rishikimit. Ky term përshkruhet më tej në paragrafin 400.9.

SNA220 (i rishikuar) jep udhëzime të mëtejshme mbi përkufizimin e ekipit të angazhimit në kuadrin e një auditimi të pasqyrave financiare.

SNA 620 përkufizon ekspertin e një audituesi si një individ ose organizatë që zotëron ekspertizë në një fushë të ndryshme nga kontabiliteti apo auditimi, puna e të cilit në këtë fushë përdoret nga audituesi për të ndihmuar këtë të fundit në sigurimin e evidencës së auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme. SNA 620 trajton përgjegjësitë e audituesit lidhur me punën e këtyre ekspertëve.

SA 610 (i rishikuar në vitin 2013) trajton përgjegjësitë e audituesit, kur ai përdor punën e audituesve të brendshëm, duke përfshirë përdorimin e audituesve të brendshëm për të dhënë ndihmë të drejtpërdrejtë në angazhimin e auditimit.

Në pjesën 4B, termi "ekip angazhimi" i referohet individëve që

kryejnë procedurat e sigurisë në një angazhim të sigurisë.

Existing accountant	Profesionist kontabël ekzistues – Një profesionist kontabël në praktikën publike, që aktualisht ka marrë një emërim auditimi ose po kryen për një klient shërbime kontabël, tatimore, të konsulencës ose shërbime të tjera profesionale të ngjashme.
External expert	Ekspert i jashtëm – Një individ (i cili nuk është një ortak ose anëtar i personelit profesional, përfshirë personelin e përkohshëm të firmës ose një firme rrjet) ose organizatë që zotëron aftësitë, njohuritë dhe përvojën në një fushë të ndryshme nga ajo e kontabilitetit apo auditimit, puna e të cilit në këtë fushë është përdorur për të ndihmuar profesionistin kontabël të sigurojë evidencën e mjaftueshme dhe të përshtatshme.
Financial interest	Interes Financiar - Një pjesëmarrje (interes) në kapital apo në instrumentet e tjera të letrave me vlerë, obligacioneve, huave apo detyrimeve të tjera të një entiteti, përfshirë të drejtat dhe detyrimet për të marrë interesa dhe derivativet e tyre të lidhura drejtpërdrejtë me këtë pjesëmarrje (interes).
Financial statements	Pasqyrat Financiare – Një paraqitje e strukturuar e informacioneve financiare historike, përfshirë shënimet përkatëse, me qëllim për të komunikuar burimet ekonomike ose detyrimet e një entiteti në një moment të kohës ose ndryshimet në to për një periudhë kohe të përcaktuar sipas kuadrit të raportimit financiar. Shënimet përkatëse zakonisht përfshijnë një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese. Termi mund të lidhet me një paketë të plotë të pasqyrave financiare, por mund t'i referohet gjithashtu një pasqyre financiare të vetme, për shembull një bilanc, ose një pasqyrë të të ardhurave e shpenzimeve dhe shënimet përkatëse shpjeguese. <i>Termi nuk i referohet elementeve specifike, llogarive apo zërave të një pasqyre financiare.</i>
Financial statements on which the firm will express an opinion	Pasqyrat financiare mbi të cilat firma shpreh një opinion – Në rastin e një entiteti individual janë pasqyrat financiare të këtij entiteti. Në rastin e pasqyrave financiare të konsoliduara, të referuara gjithashtu si pasqyrat financiare të grupit, janë pasqyrat financiare të konsoliduara.
Firm	Firmë: (a) Një profesionist kontabël praktikues i vetëm, ortakëri ose shoqëri e profesionistëve kontabël; (b) Një entitet që kontrollon këto palë; përmes pronësisë,

- drejtimitose mjeteve të tjera; dhe
- (c) Një entitet i kontrolluar nga këto palë, përmes pronësisë, drejtimit ose mjeteve të tjera.

Paragrafët 400.4 dhe 900.3 shpjegojnë se si fjala “firmë” përdoret për adresimin e përgjegjësisë së profesionistëve kontabël dhe të firmave për pajtueshmërinë respektivisht me Pjesët 4A dhe 4B.

Fundamental principles

Parimet themelore - Ky term përshkruhet në paragrafët 110.1 A1. Secili prej parimeve themelore shpjegohet, me tej, në paragrafët e mëposhtëm:

Integriteti K111.1

Objektiviteti K112.1

Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur K113.1

Konfidencialiteti K114.1

Sjellja profesionale K115.1

Group

Grup - Një entitet raportues për të cilin janë përgatitur deklaratat financiare të grupit.

Group audit

Auditimi i grupit - Auditimi i pasqyrave financiare të grupit

Group audit client

Klienti i auditimit – Grup – Entiteti për të cilin audituesi i grupit për pasqyrat financiare të grupit kryen një angazhim auditimi. Kur entiteti është i listuar në bursë, klienti i auditimit- grup do të përfshijë gjithmonë entitetet e tij të lidhura me të dhe çdo komponent tjetër në të cilin kryhet puna e auditimit. Kur entiteti nuk është i listuar, klienti i auditimit - grup përfshin entitetet e lidhura, mbi të cilat ky entitet ka kontroll direkt ose indirekt dhe çdo komponent tjetër në të cilin kryhet puna e auditimit.

Shih edhe paragrafin K400.20.

Group auditor

Audituesi i grupit – Firma që shpreh një opinion mbi pasqyrat financiare të grupit

Group audit team

Ekipi i auditimit të grupit:

- (a) Të gjithë anëtarët e ekipit të angazhimit për auditimin e grupit, duke përfshirë individët brenda, ose të angazhuar nga firmat e audituesve të komponentëve, të cilët kryejnë procedurat e auditimit lidhur me komponentët për qëllime të auditimit të grupit;
- (b) Të gjithë të tjerët brenda, ose të angazhuar nga firma audituese e grupit, të cilët mund të ndikojnë drejtpërdrejt në

rezultatit e auditimit të grupit, duke përfshirë:

- (i). Ata që rekomandojnë kompensimin e, ose japim mbikëqyrje të drejtpërdrejtë, menaxhim apo mbikëqyrje tjetër të partnerit të angazhimit të grupit në lidhje me performancën e auditimit të grupit, duke përfshirë individët në të gjithë nivelet e larta të njëpasnjëshme mbi partnerin e angazhimit të grupit, nëpërmjet individit, i cili është Senior ose partner menaxhues i firmës Partner (Drejtor Ekzekutiv ose ekuivalent);
- (ii). Ata që japin konsultime lidhur me çështje teknike të veçanta të sektorit të industrisë, transaksionet apo ngjarjet për auditimin e grupit;
- (iii). Ata që kryejnë një rishikim të cilësisë së angazhimit, ose një rishikim në përputhje me objektivin e një rishikimi të cilësisë së angazhimit, për auditimin e grupit;
- (c) Çdo individ tjetër brenda një firme rrjeti të rrjetit të firmës së audituesit të grupit, që mund të ndikojë drejtpërdrejt në rezultatit e auditimit të grupit;
- (d) Çdo individ tjetër brenda një firme të auditimit të komponentit jashtë rrjetit të firmës së audituesit të grupit, i cili mund të ndikojë drejtpërdrejt në rezultatit e auditimit të grupit.

Group financial statements	Pasqyrat financiare të grupit - Pasqyrat financiare që përfshijnë informacionin financiar të më shumë se një entiteti ose njësie biznesi nëpërmjet një procesi konsolidimi.
Historical financial information	Informacioni financiar historik – Informacion i shprehur në terma financiare në lidhje me një entitet të caktuar, që buron kryesisht nga sistemi kontabël i entitetit, për ngjarjet ekonomike të ndodhura në periudhat e kaluara ose rreth kushteve ekonomike apo rrethanave që kanë ekzistuar në momente të caktuara kohore në të kaluarën.
Immediate family	Familjar i drejtpërdrejtë – Një bashkëshort (ose ekuivalenti) apo një person në ngarkim.
Independence	Pavarësia – Pavarësia përfshin: Independence of mind - Pavarësia e të menduarit – gjendje e të menduari që lejon dhënien e një opinionit pa u ndikuar nga influencat që komprometojnë gjykimin profesional, duke e lejuar kështu një individ të veprojë me integritet dhe të ushtrojë objektivitetin dhe skepticizmin profesional. Independence in appearance – Pavarësia në dukje – Mënjanimi i

fakteve dhe rrethanave që janë kaq të rëndësishme sa që një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar, e cila i peshon të gjitha faktet dhe rrethanat specifike, do të arrinte në përfundimin se integriteti, objektiviteti ose skepticizmi profesional i një firme apo të një anëtarë të grupit të angazhimit janë kompromentuar.

Siç përshkruhet në paragrafët 400.5 dhe 900.4, referencat për një individ ose firmë të “pavarur” nënkuptojnë që individit ose firma, sipas rastit, është në pajtueshmëri me Pjesët 4A dhe 4B.

Indirect financial interest Interes financiar i tërthortë – Një interes financiar përfitimet e të cilit zotërohen përmes një mjeti investimi të përbashkët, pasurie të paluajtshme, trust apo ndërmjetës të tjerë, mbi të cilët individit ose entiteti nuk ka asnjë kontroll ose aftësi të influencojë vendimet e investimit.

Inducement Nxitja – Një objekt, situatë ose veprim që përdoret si mënyrë për ndikimin e *sjelljes* së një individit tjetër, por jo domosdoshmërisht me qëllimin e ndikimit të papërshtatshëm të sjelljes së këtij individit. *Nxitjet mund të variojnë nga veprime të vogla mikpritje midis kolegëve të biznesit (për profesionistët kontabël në biznes), ose midis profesionistëve kontabël dhe klientëve ekzistues apo të mundshëm (për profesionistët kontabël në praktikën publike), e deri tek veprimet që rezultojnë në papajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret. Një nxitje mund të marrë formë nga më të ndryshmet, për shembull:*

- *Dhuratat.*
- *Mikpritja.*
- *Argëtimi.*
- *Donacionet politike ose bamirëse.*
- *Thirrjet për miqësi dhe besnikëri.*
- *Punësim apo mundësi të tjera komerciale.*
- *Trajtim preferencial, të drejta apo privilegje.*

Key audit partner Ortaku (partneri) kryesor i auditimit - Ortaku i angazhimit, përgjegjës për rishikimin e kontrollit të cilësisë së angazhimit dhe ortakë të tjerë të auditimit, nëse ka, në grupin e angazhimit, të cilët marrin vendime të rëndësishme apo bëjnë gjykimet mbi çështje të rëndësishme në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, mbi të cilat firma do të shprehë një opinion. Në varësi të rrethanave dhe rolit të individëve në auditim, “ortakët e tjerë të auditimit” mund të përfshijnë, për shembull, ortakët e auditimit përgjegjës për filialet apo ndarjet e rëndësishme.

Listed Entity Entitet i listuar - – Një entitet, aksionet, pjesët e kapitalit apo detyrimet e të cilit janë të kuotuar apo të listuar në një bursë të

njohur ose tregtohen sipas rregullave të një burse të njohur apo një organizmi tjetër ekuivalent.

May Mundet – Ky term përdoret në Kod për të paraqitur lejen për kryerjen e një veprimi të përcaktuar në disa rrethana të caktuara, përfshirë të qenurit përjashtim nga një kërkesë. Nuk përdoret për të treguar mundësinë.

Might Mund – Ky term përdoret në Kod për të paraqitur mundësinë e lindjessë një çështjeje, ndodhjes së një ngjarjeje, ose ndërmarrjes së një rrjedhe veprimi. Termi nuk përshkruan ndonjë nivel të veçantë mundësie ose ndodhjeje kur përdoret bashkë me një kërcënim, duke qenë se vlerësimi i nivelit të një kërcënimi varet nga faktet dhe rrethanat e çdo çështjeje, ngjarjeje apo rrjedhe veprimi të veçantë.

Network Rrjet – Një strukturë e madhe që:
 (a) synon kooperimin; dhe
 (b) në mënyrë të qartë synon fitimin ose ndarjen e kostove, pronësisë, kontrollit apo menaxhimit të përbashkët, strategji biznesi të përbashkët, përdorimin e një emri të përbashkët, ose të një pjesetë rëndësishme të burimeve profesionale.

Network firm Firme rrjet - Një firmë apo entitet që i përket një rrjeti.
Për informacion të mëtejshëm, shiko paragrafët 400.50 A1 deri tek 400.54 A1

Non-compliance with laws and regulations (Professional Accountants in Business) Papajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret (Profesionistët Kontabël në Biznes) – Papajtueshmëria me ligjet dhe rregullat (“papajtueshmëria”) përfshin akte veprimi apo mosveprimi të qëllimshëm apo të paqëllimshëm, që janë në kundërshtim me ligjet ose rregullat ekzistuese, të cilat kryhen nga palët e mëposhtme:
 (a) Organizata punëdhënëse e profesionistit kontabël
 (b) Personat e ngarkuar me qeverisjen e organizatës punëdhënëse;
 (c) Drejtimi i organizatës punëdhënëse; ose
 (d) Individë të tjerë që punojnë për apo nën drejtimin e organizatës punëdhënëse.

Ky term përshkruhet në paragrafin 260.5 A1.

Non-compliance with laws and regulations (Professional) Papajtueshmëria me ligjet dhe rregullat (Profesionistët Kontabël në Praktikën Publike) – Papajtueshmëria me ligjet dhe rregullat (“papajtueshmëria”) përfshin akte veprimi apo mosveprimi të qëllimshëm apo të paqëllimshëm, që janë në kundërshtim me ligjet dhe rregullat ekzistuese, të cilat kryhen nga palët e mëposhtme:

Accountants in Public Practice)	(a) Një klient; (b) Personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit; (c) Drejtimi i klientit; ose (d) Individë të tjerë që punojnë për apo nën drejtimin e klientit.
---------------------------------	---

Ky term përshkruhet në paragrafin 360.5 A1

Office	Zyrë – Një nëngrup i dallueshëm, qoftë ky i organizuar sipas linjës gjeografike ose sipas praktikës së shërbimeve.
Predecessor accountant	Kontabilisti paraardhës – Një profesionist kontabël në praktikën publike që më së fundmi ka mbajtur një emërim si auditues ose ka kryer shërbime kontabël, tatimore, konsulencë apo shërbime të ngjashme për një klient ku nuk ka kontabilist ekzistues.
Professional accountant	Profesionist kontabël - Një individ, i cili është një anëtar i një organizmi anëtar të IFAC-ut. <i>Në Pjesën 1, termi “profesionist kontabël” i referohet profesionistëve kontabël individualë në biznes dhe profesionistëve kontabël në praktikën publike dhe firmave të tyre.</i> <i>Në Pjesën 2, termi “profesionist kontabël” i referohet profesionistëve kontabël në biznes.</i> <i>Në Pjesët 3, 4A dhe 4B, termi “profesionist kontabël” i referohet profesionistëve kontabël në praktikën publike dhe firmave të tyre.</i>
Professional accountant in business	Profesionist kontabël në biznes - Një profesionist kontabël që punon në fusha të tilla si tregtia, industria, shërbimet, sektori publik, arsimi, sektori jofitimprurës, ose në organizmat rregullatore ose profesionale, i cili mund të jetë një i punësuar, i kontraktuar, partner, drejtor (ekzekutiv apo jo ekzekutiv), pronar-menaxher ose vullnetar.
Professional accountant in public practice	Profesionist kontabël në praktikën publike – Një profesionist kontabël, pavarësisht klasifikimit funksional (për shembull, në auditim, shërbime tatimore apo konsulencë) në një firmë që jep shërbime profesionale. <i>Termi “profesionist kontabël në praktikën publike” përdoret gjithashtu për t’iu referuar një firme të profesionistëve kontabël që ushtrojnë profesionin në praktikën publike.</i>
Professional activity	Aktivitet profesional – Një aktivitet që kërkon aftësi në fushën e kontabilitetit dhe fusha të tjera të lidhura, i cili ndërmerret nga një profesionist kontabël, përfshirë kontabilitetin, auditimin, tatim-taksat, konsulencën menaxheriale dhe drejtimin financiar.

Professional judgement	<i>Gjykimi profesional përfshin zbatimin e trajnimeve përkatëse, njohurive profesionale, aftësive, zotësisë dhe eksperiencës në përputhje me faktet dhe rrethanat, duke marrë parasysh natyrën dhe objektin e veprimtarive profesionale të veçanta, dhe interesat dhe marrëdhëniet e përfshira.</i> <i>Ky term përshkruhet në paragrafin 120.5 A4.</i>
Professional services	Shërbimet profesionale - Shërbimet profesionale që kryhen për klientët.
Proposed accountant	Kontabilisti i propozuar – Një profesionist kontabël në praktikën publike që po shqyrton pranimin e një emërimi si auditues apo të një angazhimi për të kryer shërbime kontabiliteti, takse, konsulencë apo shërbime profesionale të ngjashme për një klient të mundshëm (ose nëdisa raste, për një klient ekzistues).
Public interest entity	Entitet me interes publik (a) Një entitet i listuar, ose (b) Një entitet: (i) I përkufizuar nga rregullat ose legjislacioni si entitet me interes publik; ose (ii) Për të cilin kërkohet nga ligji ose rregullat që auditimi të kryhet në pajtim me të njëjtat kërkesa për pavarësinë që zbatohen për auditimin e entiteteve të listuara. Këto rregulla mund të shpallen nga ndonjë rregullator i caktuar, përfshirë një rregullator auditimi. <i>Gjithashtu, sipas paragrafit 400.8, entitete të tjera mund të konsiderohen, si entitete me interes publik,</i>
Reasonable and informed third party - Reasonable and informed third party test	Pala e tretë e arsyeshme dhe e informuar – Testi i palës së tretë të arsyeshme dhe të informuar është një vlerësim nga ana e profesionistit kontabël nëse të njëjtat konkluzione ka të ngjarë të arrihen nga një palë tjetër. Një konsiderim i tillë bëhet nga perspektiva e një pale të tretë të arsyeshme dhe të informuar, që peshon të gjitha faktet dhe rrethanat e rëndësishme për të cilat profesionisti kontabël është në dijeni ose në mënyrë të arsyeshme pritet që të jetë në dijeni, në kohën kur janë arritur konkluzionet. Pala e tretë e arsyeshme dhe informuar nuk ka nevojë të jetë një profesionist kontabël, por duhet të zotërojë njohuritë dhe eksperiencën përkatëse për të kuptuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë e konkluzioneve të profesionistit kontabël në mënyrë të paanshme. <i>Këto terma përshkruhen në paragrafin K120.5 A4.</i>

Related entity	Entitet i Lidhur - Një entitet që ka me klientin njërën nga marrëdhënietë mëposhtme: (a) Një entitet që ka kontroll direkt apo të tërthortë mbi klientin nëse klienti është i rëndësishëm për këtë entitet; (b) Një entitet që ka interes të drejtpërdrejtë financiar tek klienti, kur entiteti ka influencë të konsiderueshme mbi klientin dhe intereset e klientit është material për këtë entitet; (c) Një entitet, tek i cili klienti ka kontroll direkt ose të tërthortë; (d) Një entitet, tek i cili klienti ose një entitet i lidhur me klientin sipas pikës (c) më lart, ka një interes financiar të drejtpërdrejtë, i cili i jep atij influencë të konsiderueshme mbi entitetin dhe interesi është material si për klientin ashtu edhe për entitetin e tij të lidhur në (c); dhe (e) Një entitet i cili është nën një kontroll të përbashkët me klientin (këtu e në vijim një “entitet motër”) po qe se entiteti motër dhe klienti janë që të dy materiale për entitetin që kontrollon si klientin ashtu edhe entitetin e tyre.
Responsible party	Pale përgjegjëse - Në një angazhim të sigurisë, pala përgjegjëse për çështjen në fjalë që i nënshtrohet shqyrtimit.
Review client	Klienti i rishikimit – Një entitet në lidhje me të cilin një firmë kryen një angazhim rishikimi.
Review engagement	Angazhim rishikimi – Një angazhim i sigurisë që kryhet në pajtim me <i>Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Rishikimit</i> ose ekuivalentet e tyre, në të cilin një profesionist kontabël në praktikën publike shpreh një përfundim për faktin nëse bazuar në procedurat të cilat nuk japin të gjithë evidencën që do të kërkohej në një auditim, ka tërhequr vëmendjen e kontabilistit ndonjë gjë që do ta bënte atë të besojë se pasqyrat financiare nuk janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me një kuadër të zbatueshëm të raportimit financiar.
Review team	Ekipi i rishikimit (a) Të gjithë anëtarët e grupit të angazhimit për rishikimin; dhe (b) Të gjithë të tjerët brenda një firme që mund të ndikojnë drejtpërdrejt në rezultatin e angazhimit të rishikimit, duke përfshirë: (i) Ata të cilët rekomandojnë kompensimin ose që japin drejtpërdrejt mbikëqyrje, menaxhim, apo të tjera monitorime të ortakut të angazhimit në lidhje me kryerjen e angazhimit të rishikimit, përfshirë edhe ata

	në të gjitha nivelet hierarkike mbi ortakun e angazhimit deri tek individ, i cili është drejtuesi i lartë ose ortakun menaxhues i firmës (Drejtori Ekzekutiv ose ekuivalenti); (ii) Ata të cilët japin këshillim në lidhje me çështje teknike ose specifike të sektorit, transaksione apo ngjarje përangazhimin, dhe (iii) Ata të cilët kryejnë kontrollin e cilësisë për angazhimin, duke përfshirë edhe ata të cilët kryejnë rishikimin për kontrollin e cilësisë të angazhimit, dhe (c) Të gjithë individët e tjerë brenda rrjetit të firmës të cilët mund të ndikojnë drejtpërdrejtë mbi rezultatin e angazhimit të rishikimit.
Safeguards	Masa mbrojtëse – <i>Masat mbrojtëse janë veprime, individuale ose të kombinuara, që ndërmerren nga profesionisti kontabël për reduktimin efektiv të kërcënimeve, ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore në një nivel të pranueshëm.</i> <i>Ky term përshkruhet në paragrafin 120.10 A2</i>
Senior professional accountant in business	Profesionist kontabël i lartë (senior) në biznes – <i>Profesionistët kontabël senior në biznes janë drejtorë, zyrtarë ose nëpunës të lartë të aftë për të ushtruar ndikim të rëndësishëm mbi dhe për të marrë vendime lidhur me blerjen, shpërndarjen dhe kontrollin e përdorimit të burimeve njerëzore, financiare, teknologjike, fizike dhe jo materiale të organizatës.</i> <i>Ky term përshkruhet në paragrafin 260.11 A1.</i>
Special purpose financial statements	Pasqyra financiare për qëllime të veçanta - Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër të raportimit financiar që synon të përmbushë nevojat për informacion financiar të përdoruesve specifikë.
Subject matter information	Rezultati i matjes ose vlerësimit të çështjes në fjalë që merret në shqyrtim kundrejt kritereve, pra, informacioni që rezulton nga aplikimi i kritereve mbi bazën e çështjes në fjalë
Substantial harm	Dëme thelbësore – <i>Ky term përshkruhet në paragrafin 260.5 A3 dhe 360.5 A3.</i>
Those charged with governance	Personat e ngarkuar me qeverisjen – Personi(at) ose organizata(t) (për shembull, një i besuar i korporatës) me përgjegjësi për mbikëqyrjen e drejtimit strategjik të entitetit dhe të detyrimeve që lidhen me llogaridhënien e entitetit. Këtu përfshihet mbikëqyrja e proceseve të raportimit financiar. Për disa entitete në disa juridiksione, personat e ngarkuar me qeverisjen mund të përfshijnë

personelin drejtues, për shembull anëtarët ekzekutivë të një bordi qeverisës të një entiteti publikose privat, ose një pronar-menaxher.

Threats	<i>Kërcënimet – Ky term përshkruhet në paragrafin 120.6 A3 dhe përfshin kategoritë e mëposhtme:</i> <i>Interesi vet 120.6 A3(a)</i> <i>Vetë – rishikimi 120.6 A3(b)</i> <i>Advokimi/Përkrahja 120.6 A3(c)</i> <i>Familjariteti 120.6 A3(d)</i> <i>Frikësime 120.6 A3(e).</i>
Time on period	<i>Ky term përshkruhet në paragrafin K540.5.</i>
Underlying subject matter	Fenomeni që është matur ose vlerësuar nga zbatimi i kriterëve

LISTA E SHKURTIMEVE DHE STANDARDET E REFERUAR NË KËTË KOD

LISTA E SHKURTIMEVE

Shkurtimi	Shpjegimi
Kuadri i Sigurisë CoCo	Kuadri Ndërkombëtar për Angazhimet e Sigurisë Kriteret e kontrollit të Shoqatës së Profesionistëve kontabël të certifikuar të Kanadasë
COSO	Komiteti i Organizatave Sponsorizuese dhe Komisionit të Tregtisë
IAASB	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë
IESBA	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikes për Profesionistët Kontabël
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IFEA	Federata Ndërkombëtare për Etiken dhe Auditimin
ISAs	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISAEs	Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Sigurisë
ISQMs	Standardet Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë
ISREs	Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Rishikimit

LISTA E STANDARDEVE të REFERUARA në KOD

Standardi	Titulli i plote
SNA 220 (i rishikuar)	Menaxhimi i cilësisë për një auditim të pasqyrave financiare
SNA 320	Materialiteti në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi
SNA 600 (i rishikuar)	Konsiderata të veçanta – Auditimi i pasqyrave financiare të grupit (përfshirë punën e audituesve të komponentëve)
SNA 610 (i rishikuar në vitin 2013)	Përdorimi i punës së audituesve të brendshëm
SNA 620	Përdorimi i punës së një eksperti të audituesit
SNAS 3000 (i rishikuar)	Angazhimet e sigurisë që ndryshojnë nga auditimet ose rishikimet e informacioneve financiare historike
SNMC1	Menaxhimi i cilësisë për firmat që kryejnë auditime ose rishikime të pasqyrave financiare apo angazhime të sigurive të tjera dhe të shërbimeve të lidhura
SNMC2	Rishikimet e cilësisë së angazhimit
SNAR 2400 (i rishikuar)	Angazhimet për të rishikuar pasqyrat financiare historike

DATA E HYRJES NË FUQI

Përveç rishikimeve që kanë të bëjnë me përkufizimin e ekipit të angazhimit dhe auditimet e grupit, për pjesën tjetër Kodi është në fuqi

Rishikimet që kanë të bëjnë me përkufizimin e ekipit të angazhimit dhe të auditimeve të grupit, të publikuara në faqen e internetit të IESBA-s në prill 2023, do të hyjnë në fuqi si më poshtë:

- Ndryshimet në seksionin 400 lidhur me rishikimin e përkufizimit të ekipit të angazhimit dhe dispozitat e reja në seksionin 405 lidhur me auditimet e grupit do të hyjnë në fuqi për auditimet dhe rishikimet e pasqyrave financiare dhe auditimeve të pasqyrave financiare të grupit për periudhat që fillojnë me ose pas datës 15 dhjetor 2023.
- Ndryshimet (amendimet) konformuese të mëposhtme do të hyjnë në fuqi që nga 15 dhjetori 2023:
 - Ndryshimet konformuese në Seksionin 360 për t'u përshtatur me terminologjinë në SNA 600 (i rishikuar).
 - Ndryshimet konformuese për dispozitat e rishikuara të shërbimeve të jo-sigurisë në seksionin 400.
 - Ndryshimet konformuese në përputhje me seksionet 300, 310, 320, 400, 510, 605 dhe 900 që rezultojnë nga rishikimi i bere në termin ekip i angazhimit.
 - Ndryshimet si pasojë e menaxhimit të cilësisë në seksionet 540, 800, 940 dhe 990.
- Ndryshimet në Fjalorin e Termave do të hyjnë në fuqi:
 - Për auditimet dhe rishikimet e pasqyrave financiare dhe auditimet e pasqyrave financiare të grupit për periudhat e pasqyrave financiare, duke filluar nga ose pas datës 15 dhjetor 2023.
 - Për angazhimet e sigurisë, të ndryshme nga angazhimet e auditimit dhe rishikimit në lidhje me çështje në fjalë që mbulojnë periudhat që fillojnë nga ose pas datës 15 dhjetor 2023; ose përndryshe, që nga 15 dhjetori 2023.

Adaptimi me hershëm është i lejuar

DISPOZITA KALIMTARE QË kanë TË BËJË ME DISPOZITAT QË TRAJTOJNË AUDITIMET E GRUPIT

Për angazhimet e shërbimeve të jo-sigurisë, për të cilat një firmë audituese e komponentit, jashtë rrejtës së firmës së audituesve të grupit, ka hyrë në marrëveshje me një klient të auditimit- komponent, përpara datës 15 dhjetor 2023 dhe për të cilën tashmë ka filluar puna, firma e audituesit të komponentit mund të vazhdojë të kryejë këto angazhime, sipas dispozitave ekzistuese të Kodit deri sa angazhimi të përfundojë në përputhje me kushtet fillestare të angazhimit.

**NDRYSHIMET NË KOD ¶ RISHIKIMET E PËRKUFIZIMIMEVE TË
ENTITETIT TË LISTUAR DHE ENTITETI ME INTERES PUBLIK**

PËRMBAJTJET

Seksioni 400

AMENDIME PASUESE DHE KONFORMUESE

Seksioni 300

Seksioni 600

Fjalori i termave, përfshirë listën e shkurtesave

Data e hyrjes në fuqi

**PJESA 4A – PAVARESI PER AUDITIMIN DHE ANGAZHIMRET E
RISHIKIMIT**

SEKSIONI 400

**ZBATIMI I KUADRIT KONCEPTUAL PER PAVARESINE PER AUDIMIN
DHE ANGAZHIMET E RISHIKIMIT**

Hyrje

Te përgjithshme

....

Entitetet me interes publik

Paragrafi ekzistues 400.13 do të zëvendësohet nga paragrafi 400.13 më poshtë]

400.13 Disa nga kërkesat dhe materiali për zbatim të përshkruara në këtë Pjesë janë të zbatueshme vetëm për auditimin e pasqyrave financiare të entiteteve me interes publik, duke reflektuar interes të rëndësishëm publik në kushtet financiare të këtyre entiteteve për shkak të ndikimit potencial të mirëqenies së tyre financiare mbi palët e interesuara.

[Pas paragrafit 400.13 do të shtohen Paragrafët 400.14 dhe 400.15]

400.14 Faktorët që duhet të merren në konsideratë për vlerësimin e shtrirjes së

interesit publik në kushtet financiare të një entiteti përfshijnë:

- Natyrën e biznesit apo veprimtarive, siç është marrja përsipër e detyrimeve financiare ndaj publikut si pjesë e biznesit primar të entitetit
- Faktin nëse entiteti i nënshtrohet mbikëqyrjes rregullatore që synon të japë besim se entiteti do të përmbushë detyrimet e tij financiare.
- Madhësinë e entitetit
- Rëndësinë e entitetit për sektorin në të cilin operon, përfshirë lehtësinë e zëvendësimit në rast të dështimit financiar.
- Numrin dhe natyrën e palëve të interesuara, përfshirë investitorët, klientët, kreditorët dhe punonjësit.

Ndikimin e mundshëm sistemik mbi sektorët e tjerë dhe ekonominë në tërësi në rast të dështimit financiar të entitetit.

400.15 Palët e interesuara kanë rritur pritshmëritë lidhur me pavarësinë e një firme që kryen një angazhim auditimi për një entitet me interes publik për shkak të rëndësisë së interesit publik në kushtet financiare të entitetit. Qëllimi i kërkesave dhe materialit të zbatimit për entitetet me interes publik siç përshkruhet në paragrafin 400.13 është përmbushja e pritshmërisë, duke rritur kështu besimin e palëve të interesuara në pasqyrat financiare të entitetit, të cilat mund të përdoren gjatë vlerësimit të gjendjes financiare të entitetit.

[Paragrafët ekzistues 400.14 deri në R400.19 do të rinumërohen respektivisht në paragrafët 400.16 deri në R400.21.]

Kërkesat dhe materiali për zbatim

[Paragrafët R400.22 deri në R400.26 së bashku me titullin më poshtë do të shtohen pas paragrafit 400.21 A1 (siç është rishikuar nga projekti për Teknologjinë).]

Entitetet me interes publik

K400.22 Për qëllimet e kësaj Pjese, një firmë do ta trajtojë një entitet si një entitet të interesit publik kur ai është brenda njëres prej kategorive të mëposhtme:

- (a) Një entitet i tregtuar publikisht;
- (b) Një entitet, ku një nga funksionet kryesore të të cilit është marrja e depozitave nga publiku;
- (c) Një entitet, ku një nga funksionet kryesore të të cilit është të japë siguri për publikun;
- (d) Një entitet i specifikuar si i tillë me ligj, rregullore ose standarde profesionale për të përmbushur qëllimin e përshkruar në paragrafin 400.15.

400.22 A1 Kur për të përmbushur qëllimin e përshkruar në paragrafin 400.15, për entitetet, përveç termit me interes publik, nga ligji, rregullat apo standardet profesionale, përdoren edhe terma të tjerë, këto terma konsiderohen si terma ekuivalentë. Megjithatë, nëse ligji, rregulli apo standardet profesionale i përcaktojnë entitetet "entitete të interesit publik" për arsye që nuk lidhen me qëllimin e përshkruar në paragrafin 400.15, ky emërtim nuk do të thotë domosdoshmërisht se këto entitete janë entitete me publik për qëllime të Kodit.

K400.23 Në përputhje me kërkesën në paragrafin R400.22, një firmë duhet të marrë parasysh përkufizimet më eksplicite të vendosura me ligj, rregulla ose standarde profesionale për kategoritë e përcaktuara në paragrafin R400.22,(a) deri në (c).

400.23 A1 Kategoritë e përshkruara në paragrafin K400.22(a) deri në (c) janë përkufizuar në mënyrë të përgjithshme dhe asnjë njohje nuk i është dhënë madhësisë apo ndonjë faktori tjetër që mund të jetë i përshtatshëm në një juridiksion të caktuar. Prandaj, Kodi parashikon që organe përgjegjëse për hartimin e standardeve të etikës për profesionistët kontabël t'i përcaktojnë më qartë këto kategori, për shembull:

- Duke iu referuar tregjeve publike specifike për tregtimin e titujve.
- Duke iu referuar ligjit ose rregullores lokale që përcakton bankat ose kompanitë e sigurimeve.
- Duke përfshirë përjashtime për kategori të veçanta entitetesh, siç janë entitet me pronësi të dyfishte.

Duke përcaktuar kritereve të madhësisë për disa lloje entitetesh.

400.23 A2 Paragrafi K400.22(d) parashikon që ato organe që janë përgjegjëse për vendosjen e standardeve të etikës për profesionistët kontabël do të shtojnë kategoritë e entiteteve me interes publik për të përmbushur qëllimin e përshkruar në paragrafin 400.15, duke marrë parasysh faktorë të tillë si ato të përshkruara në paragrafin 400.14. Në varësi të fakteve dhe rrethanave në një juridiksion të caktuar, në këto kategori mund të përfshihen:

- Fondet e pensionit.
- Mjetet e investimeve kolektive.
- Entitetet private me numër të madh të palëve të interesuara (përveç investitorëve).
- Organizatat jofitimprurëse ose entitetet qeveritare.
- Shërbimet publike

400.24 A1 Një firmë inkurajohet të përcaktojë nëse do të trajtojë entitete të tjera si entitete me interes publik për qëllime të kësaj Pjese. Kur bën një përcaktim

të tillë, firma mund të mbaje parasysh faktorët e përshkruar në paragrafin 400.14, si edhe faktorët e mëposhtëm:

- Faktin nëse entiteti ka gjasa që në të ardhmen e afërt të bëhet një entitet me interes publik.
- Faktin nëse në rrethana të ngjashme, një firmë paraardhëse ka aplikuar për entitetin, kërkesat për pavarësinë për entitetet me interes publik
- Faktin nëse në rrethana të ngjashme, firma ka aplikuar për entitetet e tjera, kërkesat për pavarësinë për entitetet me interes publik
- Faktin nëse entiteti ka qenë specifikuar se nuk është një entitet me interes publik sipas ligjit, rregullit apo standardeve profesionale.
- Faktin nëse entiteti apo palët e tjera të interesuara i kishin kërkuar firmës të aplikojë kërkesat për pavarësinë për entitetet me interes publik për entitetin dhe, nëse po, nëse ka ndonjë arsye për të mos përmbushur këtë kërkesë.
- Marrëveshjet e qeverisjes së korporatave të njësisë, për shembull, nëse personat e ngarkuar me qeverisjen janë të dallueshëm nga pronarët apo menaxhimi.

Publikimi i informacioneve - Aplikimi i kërkesave për pavarësi për Entitetet me interes publik

K400.25 Subjekt i zbatimit të paragrafit R400.26, kur një firmë ka zbatuar kërkesat për pavarësinë për entitetet me interes publik, siç përshkruhet në paragrafin 400.13, për kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare të një entiteti, firma do të beje publike informacionin për këtë fakt në një mënyrë që gjykohet e përshtatshme, duke marrë parasysh kohën dhe aksesin e informacionit nga palët e interesuara.

K400.26 Si përjashtim nga paragrafi R400.25, një firmë mund të mos bëjë një paraqitje të tillë të informacionit, nëse kjo do të rezultojë në zbulimin e planeve konfidenciale të ardhshme të entitetit.

[Paragrafi ekzistues K400.20 do të rinumërohet në paragrafin R400.27 dhe do të zëvendësohet nga paragrafi R400.27 më poshtë]

Entitetet e lidhura

K400.27 Siç përkufizohet, një klient i auditimit, që është një entitet i tregtuar publikisht në përputhje me paragrafët K400.22 dhe K400.23 përfshin të gjithë entitetet e tij të lidhura. Për të gjithë entitetet e tjera, referencat për një klient të auditimit në këtë Pjesë, përfshijnë entitete të lidhura mbi të cilat klienti ka kontroll direkt ose indirekt. Kur ekipi i auditimit e di, ose ka arsye të besojë, se një marrëdhënie ose rrethane, që përfshin ndonjë entitet tjetër të lidhur të klientit, është e përshtatshme për vlerësimin e pavarësisë

së firmës nga klienti, ekipi i auditimit do të përfshijë atë entitet të lidhur, kur identifikon, vlerëson dhe adreson kërcënimet për pavarësinë.

[Paragrafët 400.28 deri 400.29 janë lenë qëllimisht bosh]

AMENDIMET PASUESE DHE KONFORMUESE

PJESA 3 – PROFESIONISTET KONTABL në PRAKTIKEN PUBLIKE

SEKSIONI 300

ZBATIMI I KUADRIT KONCEPTUAL PER PROFESIONISTET KONTABEL në PRAKTIKEN PUBLIKE

...

Kërkesa dhe materiali për zbatim

....

Vlerësimi i kërcënimeve

...

Mbajtja parasysh e informacioneve të reja ose ndryshimeve në faktet dhe rrethanat

...

[Paragrafi i rinumëruar 300.7 A8 (i rishikuar nga projekti i Teknologjisë) do të zëvendësohet nga paragrafi 300.7 A8 më poshtë]

3007 A8 Shembuj të informacioneve të reja ose të ndryshimeve në faktet dhe rrethanat që mund të ndikojnë në nivelin e një kërcënimi përfshijnë:

- Kur zgjerohet objekti i një shërbimi profesional
- Kur klienti bëhet një entitet i tregtuar publikisht ose fiton një njësi tjetër biznesi.
- Kur firma bashkohet me një firmë tjetër.
- Kur profesionisti kontabël është i angazhuar nga dy klientë dhe midis dy klientëve lind një mosmarrëveshje.
- Kur ka një ndryshim në marrëdhëniet personale ose të afërta familjare të profesionistit kontabël.

PJESA 4A – PAVARESIA PER AUDITIMET DHE ANGAZHIMET E RISHIKIMIT

...

SEKSIONI 600

DHENIA E SHERBIMEVE të JO SIGURISE PER NJE KLIENT të AIDITIMIT

...

Kërkesa dhe materiali për zbatim

Te përgjithshme

...

[Paragrafi i rinumëruar 600.8 A1 (sipas projektit të Teknologjisë) do të zëvendësohet nga paragrafi 600.8 A1 më poshtë]

Rreziku i marrjes përsipër të përgjegjësi të drejtimit kur jepet një shërbim i jo-sigurisë

600.8 A1 Kur një firmë ose një firmë rrjeti jep një shërbim të jo-sigurisë për një klient auditimi, ekziston rreziku që firma ose firma e rrjetit të marrë një përgjegjësi menaxhimi, përveç nëse firma ose firma e rrjetit është e bindur se janë përmbushur kërkesat në paragrafin K400.21.

Identifikimi dhe vlerësimi i kërcënimeve

Te gjithë klientët e auditimit

...

[Paragrafi i rinumëruar 600.10 A2 (sipas projektit të Teknologjisë) do të zëvendësohet nga paragrafi 600.10 A2 më poshtë]

600.10A2 Faktorët, të cilët janë të përshtatshëm për identifikimin e kërcënimeve të ndryshme, që mund të krijohen nga dhënia e një shërbimi të jo-sigurisë për një klient të auditimit, dhe për vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve, përfshijnë:

- Natyrën, objektin, përdorimin e synuar dhe qëllimin e shërbimit.
- Mënyrën në të cilën do të jepet shërbimi, si për shembull, personeli që do të përfshihet dhe vendndodhja e tyre.
- Mjedisi ligjor dhe rregullator në të cilin jepet shërbimi.

- Faktin nëse klienti është një entitet me interes publik.
- Niveli i ekspertizës së drejtuesve dhe punonjësve të klientit në lidhje me llojin e shërbimit të dhënë.
- Shkallen deri në të cilën klienti vendos për çështje të rëndësishme të gjykimit. (Ref: Para. K400.20 deri K400.21).
- Faktin nëse rezultati i shërbimit do të ndikojë në regjistrimet kontabël apo çështjet e reflektuara në pasqyrat financiare mbi të cilat firma do të shprehë një opinion, dhe, nëse është kështu:
 - Shkalla në të cilën rezultati i shërbimit do të ketë një efekt material në pasqyrat financiare.
 - Shkalla e subjektivitetit në përcaktimin e shumave apo trajtimin e duhur për çështjet e reflektuara në pasqyrat financiare.
- Natyra dhe shtrirja e ndikimit të shërbimit, nëse ka, në sistemet që gjenerojnë informacionin, i cili për përbën një pjesë të konsiderueshme të:
 - Regjistrimeve kontabël ose të pasqyrave financiare mbi të cilat firma do të shprehë një opinion.
 - Kontrolleve të brendshme mbi raportimin financiar.
- Shkallen e mbështetjes që do të vendoset në rezultatin e shërbimit si pjesë e auditimit
- Tarifa në lidhje me dhënien e shërbimit të jo-sigurisë.

...

Dhënia e këshillave dhe rekomandimeve

[Nën paragrafi (a) në paragrafin e rinumëruar 600.18 (sipas projektit të Teknologjisë) do të zëvendësohet me nën paragrafin (a) më poshtë.]

K600.18 Si një përjashtim nga paragrafi R600.17, një firmë ose një firmë rrjeti mund të japë këshilla dhe rekomandime për një klient të auditimit, që është një entitet me interes publik në lidhje me informacionin ose çështjet që dalin gjatë një auditimi, me kusht që firma:

- (a) Nuk merr përsipër një përgjegjësi menaxhimi (Ref: Para. K400.20 dhe K400.21);
- (b) Zbaton kuadrin konceptual për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar kërcënimet ndaj pavarësisë, përveç kërcënimeve të vetë rishikimit, që mund të krijohen nga dhënia e kësaj këshille.

Konsiderata për disa entitete të lidhura

[Paragrafi i rinumëruar 600.27 (sipas projektit të Teknologjisë) do të zëvendësohet nga paragrafi 600.27 më poshtë]

K600.27

Ky seksion përfshin kërkesat që ndalojnë firmat dhe firmat e rrjetit të japin disa shërbime të jo-sigurisë për klientët e auditimit. Si një përjashtim nga këto kërkesa dhe kërkesat në paragrafin K400.20, një firmë ose një firmë rrjeti mund të marrë përgjegjësitë e menaxhimit ose të ofrojë disa shërbime të jo-sigurisë, të cilat përndryshe do t'u ndaloheshin entiteteve të mëposhtme të lidhura me klientin mbi pasqyrat financiare të të cilit firma do të shprehë një opinion:

- (a) Një entitet që ka kontroll direkt ose indirekt mbi klientin;
 - (b) Një entitet me një interes financiar të drejtpërdrejtë tek klienti nëse ky entitet ka ndikim të rëndësishëm mbi klientin dhe interesi për klientin është material për entitetin;
 - (c) Një entitet që është nën kontroll të përbashkët me klientin, me kusht që të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - (i) Firma ose një firmë rrjeti nuk shpreh një opinion mbi pasqyrat financiare të entitetit të lidhur;
 - (ii) Firma ose një firmë rrjeti nuk merr përsipër një përgjegjësi administrimi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për njësinë mbi pasqyrat financiare të së cilës firma do të shprehë një opinion;
 - (iii) Shërbimet nuk krijojnë një kërcënim të vete rishikimit
- Firma adreson kërcënime të tjera të krijuara nga dhënia e shërbimeve të tilla që nuk janë në një nivel të pranueshëm.

NËNSEKSIONI 601 - SHËRBIMET E REGJISTRIMEVE DHE MBAJTJES SE KONTABILITETIT

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

...

Kërcënime të mundshme që lindin nga Dhënia e shërbimeve të regjistrimit dhe mbajtjes se kontabilitetit

...

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

...

[Paragrafi i rinumëruar dhe i rishikuar 601.5 A3 (sipas projektit të Teknologjisë) do të zëvendësohet nga paragrafi 601.5 A3 më poshtë]

601.5 A3 Shembuj të shërbimeve, pavarësisht nëse janë manuale apo të automatizuara, që mund të konsiderohen si shërbime rutinë ose mekanike përfshijnë:

- Përgatitjen e llogaritjeve apo raporteve të pagave bazuar në të dhënat e dërguara nga klienti për aprovim dhe pagesë nga klienti.
- Regjistrimin e transaksioneve që përsëriten, për të cilat shumat përcaktohen lehtë nga dokumentet burimore ose nga të dhënat e origjinës, si një faturë e shërbimeve utilitare ku klienti ka përcaktuar ose miratuar klasifikimin e duhur të llogarisë.
- Llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve afatgjata materiale, kur klienti përcakton politikën kontabël dhe bën vlerësimin me çmuarje të jetës së dobishme dhe të vlerave të mbetura të aktiveve në fund të jetës.
- Postimin e transaksioneve të koduara nga klienti tek Ditari i përgjithshëm.
- Postimin në bilancin verifikues, të regjistrimeve në ditar të miratuara nga klienti,
- Përgatitja e pasqyrave financiare bazuar në informacionin e bilancit verifikues të miratuar nga klienti dhe përgatitja e shënimeve përkatëse shpjeguese, bazuar në regjistrat e miratuar nga klienti.

Firma ose një firmë rrjeti mund të japë shërbime të tilla për klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik, me kusht që firma ose firma e rrjetit, të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit K400.21, për të garantuar që ajo nuk do të marre përsipër një përgjegjësi menaxhimi në lidhje me shërbimin dhe me kërkesën në paragrafin K601.5 (b).

NEN SEKSIONI 605 – SHËRBIMET E AUDITIMIT TË BRENDSHEM

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

...

Rreziku i marrjes përsipër të përgjegjësisë menaxheriale kur jepet një shërbim i auditimit të brendshëm

[Paragrafi ekzistues K605.3 do të zëvendësohet nga paragrafi K605.3 më poshtë]

K605.3 Paragrafi K400.20 e përjashton një firmë ose një firmë rrjeti nga marrja përsipër e një përgjegjësie menaxhimi. Kur jep një shërbim auditimi të brendshëm për një klient të auditimit, firma do të krijojë bindjen që:

- (a) Klienti cakton një burim të përshtatshëm dhe kompetent, i cili raporton tek personat e ngarkuar me qeverisjen për:
 - (i) te qenë përgjegjës në çdo kohë për veprimtaritë e auditimit të brendshëm;
 - (ii) të pranuar përgjegjësinë për hartimin, zbatimin, monitorimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm;
- (b) Klienti rishikon, vlerëson dhe miraton objektin, rrezikun dhe frekuencën e shërbimeve të auditimit të brendshëm;
- (c) Klienti vlerëson përshtatshmërinë e shërbimeve të auditimit të brendshëm dhe të gjetjeve që dalin nga performanca e tyre;
- (d) Klienti vlerëson dhe përcakton se cilat rekomandime që rezultojnë nga shërbimet e auditimit të brendshëm, duhet të zbatohen dhe menaxhon procesin e zbatimit;

Klienti raporton tek personat e ngarkuarve me qeverisjen, gjetjet dhe rekomandimet e rëndësishme që rezultojnë nga shërbimet e auditimit të brendshëm

NENSEKSIONI 606 – SHERBIMET E SISTEMEVE të TEKNOLOGJISË SE INFORMACIONIT

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

...

Rreziku i marrjes përsipër të përgjegjësisë se menaxhimit kur jepet një shërbim i sistemeve të TI-se

[Paragrafi ekzistues K606.3 do të zëvendësohet nga paragrafi K606.3 më poshtë]

K606.3 Paragrafi k400.20 e përjashton një firmë ose një firmë rrjeti nga marrja përsipër e një përgjegjësie menaxhimi. Kur jep shërbime të sistemeve të TI-se për një klient të auditimit, firma ose firma e rrjetit duhet të krijojë bindjen që:

- (a) Klienti pranon përgjegjësinë e tij për venin në funksionim dhe monitorimin e një sistemi të kontrolleve të brendshme;
- (b) Klienti ja ngarkon përgjegjësinë për të marrë të gjitha vendimet e menaxhimit në lidhje me projektimin dhe zbatimin e sistemit hardware ose software, një punonjësi kompetent, preferohet një individ midis drejtuesve të lartë;
- (c) Klienti merr të gjitha vendimet e menaxhimit në lidhje me procesin e projektimit dhe zbatimit;
- (d) Klienti vlerëson përshtatshmërinë dhe rezultatet e projektimit dhe zbatimit të sistemit; dhe
- (e) Klienti është përgjegjës për operimin e sistemit (hardware ose software) dhe për të dhënat që ai përdor ose gjeneron.

NEN SEKSIONI 609 – SHERBIMET E REKRUTIMIT

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

...

Rreziku i marrjes përsipër të përgjegjësisë së menaxhimit kur jepet një shërbim i rekrutimit

[Paragrafi ekzistues K609.3 do të zëvendësohet nga paragrafi K609.3 më poshtë]

K609.3 Paragrafi k400.20 e përjashton një firmë ose një firmë rrjeti nga marrja përsipër e një përgjegjësie menaxhimi. Kur jep një shërbim të rekrutimit për një klient të auditimit, firma do të krijojë bindjen që:

- (a) Klienti ja ngarkon përgjegjësinë për të marrë të gjitha vendimet e menaxhimit në lidhje me marrjen në punë të një kandidati për pozicionin e punës, një punonjësi kompetent, preferohet një individ midis drejtuesve të lartë;
- (b) Klienti merr të gjitha vendimet e menaxhimit në lidhje me procesin e rekrutimit, përfshirë:
 - Përcaktimin e përshtatshmërisë së kandidatëve të mundshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve të përshtatshëm për postin.
 - Përcaktimin e kushteve të punësimit dhe detajet e negociimit, të tilla si paga, orët dhe kompensimet e tjera.

FJALORI I TERMAVE PERFSHIRE LISHTEN E SHKURTESAVE

[Përkufizimet ekzistuese të termave “klient i auditimit” dhe “klient i auditimit – grup” (siç janë rishikuar ose futur nga rishikimet që kanë të bëjnë me përkufizimin e ekipit të angazhimit dhe auditimet e grupit), dhe “entiteti me interes publik” do të zëvendësohen me përkufizimet e përshkruara më poshtë.]

Audit Client Klienti i auditimit - Një entitet, në lidhje me të cilin, një firmë kryen një angazhim të auditimit. Kur klienti është një entitet i tregtuar publikisht, në përputhje me paragrafët K400.22 dhe K400.23, klienti i auditimit do të përfshijë gjithmonë edhe entitetet e tij të lidhura. Kur klienti i auditimit nuk është një entitet i tregtuar publikisht, klienti i auditimit përfshin edhe ato entitete të lidhura mbi të cilat klienti ka kontroll direkt ose indirekt. (Shih edhe paragrafin K400.27.)

Në pjesën 4A, termi “klient i auditimit” zbatohet njëllë me termin “klienti i rishikimit”.

Në rastin e një auditimi të grupit, shih përkufizimin e klientit të auditimit - grup.

Group audit client Klienti i Auditimit – Grup: Entiteti, mbi pasqyrat financiare të grupit të të cilit, firma e audituesit të grupit kryen një angazhim auditimi. Kur entiteti është një entitet i tregtuar publikisht, klienti i auditimit - grup do të përfshijë gjithnjë entitetet e lidhura me të dhe komponentët e tjerë, tek të cilët kryhet puna e auditimit. Kur entiteti nuk është një entitet i tregtuar publikisht, klienti i auditimit - grup përfshin entitetet e lidhura mbi të cilat ky entitet ka kontroll direkt ose indirekt dhe komponentët e tjerë, në të cilat kryhet puna e auditimit.

Shiko edhe paragrafin K400.22.

Public interest entity Entitet me interes publik: Për qëllime të pjesës 4A, një entitet është një entitet me interes publik kur përfshihet brenda njëres prej kategorive të mëposhtme:

- (a) Një entitet i tregtuar publikisht;
- (b) Një entitet, një nga funksionet kryesore të të cilit është marrja e depozitave nga publiku;
- (c) Një entitet, një nga funksionet kryesore të së cilit është të japë siguri për publikun;
- (d) Një entitet i specifikuar si i tillë me ligj, rregullore ose standarde profesionale, për të përmbushur qëllimin e përshkruar në paragrafin 400.15.

Kodi parashikon për kategoritë të jenë përkufizuar në mënyrë me të qarte ose ato shtohen, siç përshkruhet në paragrafët 400.23 A1 dhe 400.23 A2.

[Përkufizimi ekzistues i termit “entitet i listuar” i përshkruar në Fjalorin e termave do të hiqet.]

[Fjalorit të termave do t’i shtohet përkufizimi i termit “entitet i tregtuar publikisht” së bashku me përshkrimin e një entiteti të listuar si një shembull i një entiteti të tregtuar publik siç është përcaktuar më poshtë.]

Publicly traded entity Entitet i tregtuar publikisht: Një entitet që emeton instrumente financiare që janë të transferueshme dhe të tregtuara nëpërmjet një mekanizmi tregu të aksesueshëm publikisht, duke përfshirë edhe nëpërmjet listimit në një bursë.

Një entitet i listuar, siç përcaktohet nga ligji apo rregullorja përkatëse e titujve, është një shembull i një entiteti të tregtuar publikisht.

DATA E HYRJES NË FUQI TË RISHIKIMEVE NË PARAQITJEN E EIP-ve

Rishikimet e përshkruara në prononcimin (shpalljen e EIP-ve) do të hyjnë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë me ose pas datës 15 dhjetor 2024.

Ndryshimet në përkufizimet për klientin e auditimit dhe klientin e auditimit – grup, rrjedhin nga rishikimet e miratuara në përkufizimet për termat “entitet i listuar” dhe “entitet me interes publik”.

Ndryshimet në Fjalorin e termave për përkufizimet e “klientit të auditimit” dhe “klientit të auditimit – grup”, të cilat rrjedhin nga rishikimet e miratuara në lidhje me përkufizimet për “entitetin e listuar” dhe “entitetin me interes publik”, do të hyjnë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare dhe të pasqyrave financiare të grupit, për periudhat që fillojnë me ose pas datës 15 dhjetor 2024.

Do të lejohet miratimi i me hershëm.

**NDRYSHIMET në KOD – RISHIKIMET E KODIT në LIDHJE ME
TEKNOLOGJINE**

PERMBAJTJET

Nën seksioni 113 – Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur

Nën seksioni 114 – Konfidencialiteti

Seksioni 120

Seksioni 200

Seksioni 220

Seksioni 260

Seksioni 300

Seksioni 320

Seksioni 360

Seksioni 400

Seksioni 520

Seksioni 600

Nën seksioni 601 – Shërbimet e regjistrimeve dhe të mbajtjes së kontabilitetit

Shërbimet e sistemeve të teknologjisë së informacionit

Seksioni 900

Seksioni 920

Seksioni 950

Fjalori i termave përfshirë listën e shkurtesave

Data e Hyrjes në fuqi

PJESA 1 – PAJTUESHMERIA ME KODIN, PARIMET THEMELORE DHE KUADRI KONCEPTUAL

...

SEKSIONI 110 – PARIMET THEMELORE

...

NENSEKSIONI 113 – KOMPETENCA PROFESIONALE DHE KUJDESI I DUHUR

[Paragrafi ekzistues K113.1 do të zëvendësohet nga paragrafi R113.1 më poshtë]

K113.1 Një profesionist kontabël do të respektojë parimin e kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur, i cili kërkon që një kontabilist të:

- (a) Të arrijë dhe të mbajë njohuritë dhe aftësitë e zotësitë profesionale në nivelin e kërkuar për të siguruar që një klient ose organizatë punëdhënëse merr shërbim profesional kompetent, bazuar në standardet teknike dhe profesionale aktuale dhe legjislacionin përkatës; dhe
- (b) Veproje me kujdes dhe në përputhje me standardet e zbatueshme teknike dhe profesionale.

[Paragrafi 113.1 A1 do të zëvendësohet nga paragrafi 113.1 A1 më poshtë]

113.1 A1 Shërbimi ndaj klientëve dhe organizatave punëdhënëse me kompetencë profesionale përfshin ushtrimin e gjyqimit të shëndoshë në aplikimin e njohurive dhe aftësive profesionale.

[Paragrafi 113.1 A2 do të shtohet pas paragrafit 113.1 A1]

113.1 A2 Njohuritë dhe aftësitë që janë të nevojshme për një aktivitet profesional ndryshojnë në varësi të natyrës së aktivitetit që ndërmerret. Për shembull, përveç aplikimit të njohurive teknike që lidhen me veprimtarinë profesionale, aftësitë ndër personale, komunikuese dhe zotësitë organizative lehtësojnë ndërveprimin e profesionistit kontabël me entitetin dhe individët me të cilët kontabilisti ndër vepron.

[Paragrafët ekzistues 113.1 A2 deri 113.1 A3 do të rinumërohen dhe do të zëvendësohen me paragrafët 113.1 A3 deri 113.1 A4 më poshtë.]

113.1 A3 Mbajtja e kompetencës profesionale kërkon që një profesionist kontabël ketë një ndërgjegjësim dhe kuptim të vazhdueshëm të zhvillimeve teknike, profesionale, të biznesit dhe të lidhura me teknologjinë që janë të

përshtatshëm për aktivitetet profesionale të kryera nga kontabilisti. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mundëson një kontabilisti të zhvillojë dhe të mbajë aftësitë për të performuar në mënyrë kompetente brenda mjedisit profesional.

- 113.1 A4 Kujdesi përfshin përgjegjësinë për të vepruar në përputhje me kërkesat e një detyre, me kujdes, në mënyrë të plote dhe në kohën e duhur.

[Paragrafi ekzistues R113.3 do të zëvendësohet nga paragrafi R113.3 më poshtë]

- K113.3** Kur është e përshtatshme, një profesionist kontabël duhet t'i bëjë klientët, organizatën punëdhënëse ose përdoruesit të tjerë të veprimtarisë së profesionistit kontabël, të vetëdijshëm për kufizimet që lidhen me veprimtaritë dhe të shpjegojë implikimet e këtyre kufizimeve.

NENSEKSIONI 114 – KONFIDENCIALITETI

[Paragrafi ekzistues R114.1 do të zëvendësohet nga paragrafi R114.1 më poshtë]

- K114.1** Një profesionist kontabël duhet të respektojë parimin e konfidencialitetit, i cili kërkon që një kontabilist të respektojë konfidencialitetin e informacionit të fituar në rrjedhën e marrëdhënieve profesionale dhe të biznesit. Një kontabilist do të:
- (a) jetë vigjilent ndaj mundësisë së zbulimit pa dashje, duke përfshirë zbulimin në një mjedis social, dhe veçanërisht tek një bashkëpunëtor i ngushtë i biznesit ose një anëtar i të afërt i familjes ose një familjar i ngushtë
 - (b) ruajë konfidencialitetin e informacionit brenda firmës ose organizatës punëdhënëse;
 - (c) ruajë konfidencialitetin e informacionit të zbuluar nga një klient i mundshëm (perspektiv) ose një organizatë punëdhënëse;
 - (d) ndërmarre hapa të arsyeshëm për t'u siguruar që personeli nën kontrollin e kontabilistit dhe individët nga të cilët merren këshilla dhe asistence, të respektojnë detyrën e konfidencialitetit të kontabilistit.

[Paragrafët 114.1 A1 deri R114.3 do të shtohen më poshtë paragrafi R114.1]

- 114.1 A1 Ruajtja e konfidencialitetit të informacionit të fituar në rrjedhën e marrëdhënieve profesionale dhe të biznesit përfshin detyrimin që profesionisti kontabël të ndërmarrë veprimet e duhura për të mbrojtur konfidencialitetin e këtyre informacioneve gjatë mbledhjes, përdorimit, transferimit, ruajtjes ose mbajtjes, shpërndarjes dhe shkatërrimit të ligjshëm.

- K114.2 Subjekt i paragrafit K114.3, një profesionist kontabël nuk do të:

- (a) zbulojë informacionin konfidencial të fituar në rrjedhën e marrëdhëniet profesionale dhe të biznesit;
- (b) përdore informacionin konfidencial të fituar në rrjedhën e marrëdhënies profesionale dhe të biznesit në dobi të kontabilistit, firmës, organizatës punëdhënëse ose një pale të tretë;
- (c) përdorë ose të zbulojë çdo informacion konfidencial, të fituar ose të marrë në rrjedhën e një marrëdhënieje profesionale ose biznesi, pasi kjo marrëdhënie të ketë përfunduar;
- (d) përdore ose zbulojë informacione në lidhje me të cilat zbatohet detyrimi i konfidencialitetit, pavarësisht se ky informacion është bërë publik, në mënyrë të përshtatshme apo të papërshtatshme.

K114.3 Si një përjashtim nga paragrafi K114.2, një profesionist kontabël mund të zbulojë ose të përdorë informacione konfidenciale kur:

- (a) Ka një detyrim apo të drejtë ligjore ose profesionale për ta bërë këtë gjë;
- (b) Kjo është e autorizuar nga klienti ose çdo person me autoritet për të lejuar zbulimin ose përdorimin e informacionit konfidencial dhe kjo nuk është e ndaluar me ligj apo rregullore.

[Paragrafi ekzistues 114.1 A1 deri 114.1 A2 do të rinumërohet dhe do të zëvendësohet me paragrafin 114.3 A1 deri 114.3 A2 më poshtë]

114.3 A1 Konfidencialiteti i shërben interesit publik, sepse lehtëson rrjedhjen e lirë të informacionit nga klienti i profesionistit kontabël ose organizata e punëdhënëse tek kontabilisti, nisur nga fakti që informacioni nuk do t'i bëhet i ditur një pale të tretë. Megjithatë, në vijim jepen disa rrethanat kur profesionistët kontabël mund të kërkohet ose të kenë detyrimin ose të drejtën për të zbuluar informacione konfidencial:

- (a) Zbulimi i informacioneve kërkohet nga ligji ose rregulli, për shembull:
 - (i) Prodhi i dokumenteve ose dhënie evidence tjetër në rrjedhën e procedurave ligjore;
 - (ii) Zbulimi pranë autoriteteve publike përkatëse i informacioneve që lidhen me shkelje të ligjit që kanë dale në dritë
- (b) Ekziston një detyrim ose e drejte profesionale për të zbuluar ose përdorur, kur nuk ndalohet nga ligji ose rregulli:
 - (i) Për të qenë në pajtim me rishikimin e cilësisë nga një organizëm profesional
 - (ii) Për t'ju përgjigjur një kërkesë ose një investigimi nga një organ profesional ose rregullator;
 - (iii) Për të mbrojtur interesat profesionale të një profesionisti kontabël në procedurat ligjore; ose
 - (iv) Për të qenë në pajtim me standardet teknike dhe profesionale përfshirë kërkesat etike.

114.3 A2 Faktoret për t'u marrë në konsideratë, gjatë marrjes së vendimit nëse duhet të zbulohen apo të përdoren informacionet konfidenciale, në varësi të rrethanave, përfshijnë:

- Faktin nëse interesat e ndonjë pale, përfshirë palët e treta, interesat e të cilave mund të preken, mund të dëmtohen kur klienti apo organizata punëdhënëse autorizon zbulimin ose përdorimin e informacionit nga profesionisti kontabël
- Faktin nëse të gjitha informacionet përkatëse janë të njohura dhe të vërtetuara, deri në masën që kjo është e mundur. Faktorët që ndikojnë në marrjen e vendimit për të zbuluar ose përdorur, informacionin, përfshijnë:
 - Faktet e pabazuara.
 - Informacionin e paplotë.
 - Përfundime të pabazuara.
- Mjetet e propozuara të komunikimit të informacionit
- Faktin nëse palët të cilave do t'u jepet informacioni apo aksesit, janë marrësit e duhur.
- Çdo ligj apo rregull i zbatueshëm (përfshirë ato që kanë të bëjnë me privatësinë) në një juridiksion, ku mund të bëhet zbulimi dhe, nëse është ndryshe, juridiksioni ku e ka burimin informacioni konfidencial.

[Paragrafi 114.3 A3 do të shtohet pas paragrafit 114.3 A2]

114.3 A3 Rrethanat, në të cilat një firmë ose organizatë punëdhënëse kërkon autorizimin për të përdorur ose për të zbuluar informacione konfidenciale, përfshijnë rastet kur informacioni duhet të përdoret për qëllime trajnimi, në zhvillimin e produkteve apo teknologjisë, në kërkim ose si material burimor për industrinë apo të dhëna apo studime të tjera të të dhënave të bazave krahasuese. Ky autorizim mund të jetë i përgjithshëm në aplikimin e tij (për shembull, në lidhje me përdorimin e informacionit për qëllime të trajnimit të brendshëm ose iniciativa për përmirësimin e cilësisë). Kur merret autorizimi, individit ose entitetit që ka dhënë këto informacione për përdorim në rrethana specifike, duhet të mbaje parasysh çështjet e mëposhtme që duhet të komunikohen (preferohet me shkrim):

- Natyrën e informacionit që duhet përdorur ose zbuluar.
- Qëllimi për të cilin informacioni është për t'u përdorur ose për t'u zbuluar (për shembull, zhvillimi i teknologjisë, kërkimi ose analize krahasuese e të dhënave ose studimeve).
- Individit ose entitetit që do të ndërmarrë veprimtarinë për të cilën informacioni do të përdoret ose do të bëhet i ditur.
- Faktin nëse identiteti i individit apo njësisë që ka dhënë këto informacione apo ndonjë individit apo entitetit me të cilin lidhet ky

informacion, do të jetë i identifikueshëm nga rezultati i veprimtarisë për të cilën informacioni duhet të përdoret ose të zbulohet (behet publik).

[Paragrafi ekzistues K114.2 do të rinumërohet dhe zëvendësohet me paragrafin K114.4]

K114.4 Një profesionist kontabël do të vazhdojë të respektojë parimin e konfidencialitetit edhe pas përfundimit të marrëdhënies ndërmjet tij dhe një klienti ose organizate punëdhënëse. Kur ndryshon punësimin ose fiton një klient të ri, kontabilisti ka të drejtë të përdorë përvojën e mëparshme, por nuk duhet të përdorë ose të zbulojë ndonjë informacion konfidencial të fituar apo të marrë gjatë një marrëdhënieje profesionale apo biznesi.

...

SEKSIONI 120

KUADRI KONCEPTUAL

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

...

Te përgjithshme

[Paragrafi ekzistues K120.5 do të zëvendësohet nga paragrafi K120.5 më poshtë]

K120.5 Kur aplikon kuadrin konceptual, profesionisti kontabël do te:

- (a) Ketë një mendje kërkuese;
- (b) Ushtroje gjykimin profesional;
- (c) Përdorni testin e palës së tretë të arsyeshme dhe të informuar të përshkruar në paragrafin 120.5 A9.

[Pas paragrafit 120.5 A5 do të shtohen Paragrafët 120.5 A6 deri 120.5 A8]

120.5.6 Rrethanat, në të cilat profesionistët kontabël kryejnë veprimtarinë profesionale, dhe faktorët ndikues ndryshojnë shume në gamën dhe kompleksitetin e tyre. Gjykimi profesional i ushtruar nga kontabilistët mund të ketë nevojë të mbaje parasysh kompleksitetin që vjen nga efekti komplementar i ndërveprimit midis, dhe ndryshimeve në, elementet e fakteve dhe rrethanave që janë të pasigurta dhe variabla dhe supozimeve që janë të ndërlidhura ose të ndërvarura.

120.5 A7 Menaxhimi i kompleksitetit përfshin:

- Ndërgjegjësimin e firmës ose të organizatës punëdhënëse dhe, nëse është e përshtatshme, të palëve përkatëse të interesuara në lidhje me pasiguritë ose vështirësitë që lindin nga faktet dhe rrethanat. (Ref: Para. K113.3)
- Vigjilencën ndaj çdo zhvillimi apo ndryshimi të fakteve dhe rrethanave dhe të vlerësimit nëse ato mund të ndikojnë në ndonjë gjykim që bën profesionisti kontabël. (Ref: Para. K120.5 deri 120.5 A3, dhe K120.9 deri 120.9 A2).

120.5 A8 Menaxhimi i kompleksitetit mund të përfshijë gjithashtu:

- Analizimin dhe hetimin si të përshtatshme, të çdo elementi të pasigurt, variabla dhe supozimeve dhe mënyrën se si ato lidhen dhe ndërvaren.
- Përdorimin e teknologjinë për të analizuar të dhënat përkatëse për të informuar gjykimin e kontabilistit profesional.

- Konsultimin me të tjerët, përfshirë ekspertët, për të siguruar sfidën e duhur dhe inputet shtesë si pjese përbërëse e procesit të vlerësimit.

[Paragrafi ekzistues 120.5A6 do të rinumërohet paragrafi 120.5 A9]

...

120.13 A3 Profesionistët kontabël priten të:

- (a) Inkurajojnë dhe promovojnë një kulturë të bazuar në etikë në organizatën e tyre, duke marrë parasysh pozitën dhe vjetërsinë e tyre;
- (b) Shfaqin sjellje etike në marrëdhëniet me individët me të cilët dhe entitetet me të cilat, kontabilistët, firma ose organizata punëdhënëse, ka një marrëdhënie profesionale ose biznesi.

PJESA 2 – PROFESIONISTET KONTABL TË PUNESUAR SEKSIONI 200

ZBATIMI I KUADRIT KONCEPTUAL – PROFESIONISTET KONTABL në BIZNES

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Te përgjithshme

[Paragrafi ekzistues 200.5 A3 do të zëvendësohet nga paragrafi 200.5 A3 më poshtë.]

200.5 A3 Sa më i lartë të jetë pozicioni i një profesionisti kontabël, aq më e madhe do të jetë aftësia dhe mundësia e tij për të patur akses në informacion, dhe për të ndikuar në politikat, vendimet e marra dhe veprimet e ndërmarra nga të tjerët që përfshihen në organizatën punëdhënëse. Deri në shkallen që ata janë në gjendje ta bëjnë këtë gjë, nisur nga pozita dhe vjetërsia (senioriteti) e tyre në organizatë, kontabilistët pritet të inkurajojnë dhe promovojnë në organizatën e tyre, një kulturë të bazuar në etikë dhe të shfaqin sjellje etike në marrëdhëniet me individët dhe entitetet me të cilët, kontabilisti ose organizata që e punëson atë, ka një marrëdhënie profesionale ose biznesi në përputhje me paragrafin 120.13 A3. Shembuj të veprimeve që mund të ndërmerren përfshijnë futjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e:

- Programeve të edukimit dhe trajnimit në çështje të etikës.
- Proceseve të menaxhimit dhe kriterëve vlerësimit të performancës dhe shpërblimit që nxisin një kulturë etike.
- Politikave të etikes dhe të paralajmërimeve të shkeljeve
- Politikave dhe procedurave të hartuara për të parandaluar shkeljet e ligjeve dhe rregullave.

Identifikimi i kërcënimeve

[Pas paragrafit 200.6 A1 së bashku me titullin do të shtohet Paragrafi 200.6 A2]

Identifikimi i kërcënimeve që shoqërojnë përdorimin e teknologjisë

200.6 A2 Më poshtë janë dhënë shembuj të fakteve dhe rrethanave që lidhen me përdorimin e teknologjisë, të cilat mund të krijojnë kërcënime për një profesionist kontabël, kur ai ndërmerr një aktivitet profesional:

- Kërcënimet e interesit vetjak (egoizmit)
 - Të dhënat e disponueshme mund të mos jenë të mjaftueshme për

- përdorimin efektiv të teknologjisë.
- Teknologjia mund të mos jetë e përshtatshme për qëllimin për të cilin duhet përdorur.
- Kontabilisti mund të mos ketë informacionin dhe ekspertizën e mjaftueshme, ose i mungon aksesin tek një ekspert me kuptim të mjaftueshëm, për të përdorur dhe shpjeguar teknologjinë dhe përshtatshmërinë e saj për qëllimin e synuar.

(Ref: Para. 230.2).

- Kërcënimet e vetë rishikimit
 - Teknologjia u projektua ose u zhvillua duke përdorur njohuritë, ekspertizën ose gjykimin e kontabilistit ose organizatës së tij punëdhënëse.

...

Vlerësimi i kërcënimeve

...

[Pas paragrafit 200.7 A3 do të shtohet Paragrafi 200.7 A4]

200.7 A4 Vlerësimi nga profesionistit kontabël i nivelit të një kërcënimi që lidhet me përdorimin e teknologjisë mund të ndikohet edhe nga mjedisi i punës brenda organizatës punëdhënëse dhe mjedisi i saj i operimit. Për shembull:

- Niveli i mbikëqyrjes së korporatës dhe kontrollet e brendshme mbi teknologjinë.
- Vlerësimet e cilësisë dhe funksionalitetit të teknologjisë, që ndërmerren nga një palë e tretë.
- Trajnimi që jepet rregullisht për të gjithë punonjësit përkatës, në mënyrë që ata të arrijnë dhe të mbajnë kompetencën profesionale për të kuptuar, përdorur dhe shpjeguar mjaftueshëm teknologjinë dhe përshtatshmërinë e saj për qëllimin e synuar.

[Paragrafi ekzistues 200.7 A4 do të rinumërohet në paragrafin 200.7 A5]

...

SEKSIONI 220

PERGATITJA DHE PARAQITJA E INFORMACIONIT

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

...

[Paragrafët ekzistues K220.7 deri 220.7 A1 së bashku me titullin do të zëvendësohen nga paragrafët K220.7 deri 220.7 A1 dhe titulli përkatës si më poshtë.]

Përdorimi i punës së tjerëve

K220.7 Një profesionist kontabël që synon të përdorë punën e të tjerëve, qofshin këta të brendshëm apo të jashtëm për organizatën punëdhënëse, ose organizata të tjera, do të ushtrojë gjykim profesional për të përcaktuar hapat e duhur që duhet të ndërmerret, nëse kjo është e nevojshme, me qëllim që të përmbushë përgjegjësitë e përshkruara në paragrafin K220.4.

220.7 A1 Faktorët që duhet të mbahen parasysh kur një profesionist kontabël synon të përdorë punën e të tjerëve përfshijnë:

- Reputacionin dhe ekspertizën e, dhe burimet në dispozicion të individit ose organizatës tjetër.
- Faktin nëse individit tjetër është subjekt i standardeve të zbatueshme profesionale dhe të etikës.

Këto informacione mund të fitohen nga lidhja e mëparshme me ose nga konsultimi me të tjerët, individë të tjerë ose një organizatën tjetër.

[Pas paragrafit 220.7 A1 do të shtohen paragrafët R220.8 deri 220.8 A1 së bashku me titullin]

Përdorimi i rezultatit të teknologjisë

K220.8 Një profesionist kontabël që synon të përdorë rezultatit e teknologjisë, pavarësisht nëse teknologjia është zhvilluar brenda tij apo është dhënë nga palë të treta, do të ushtrojë gjykim profesional për të përcaktuar hapat e duhur që duhet të ndërmerret, nëse kjo është e nevojshme, me qëllim që të përmbushë përgjegjësitë e përshkruara në paragrafin K220.4.

220.8 A1 Faktorët që duhet të merren në konsideratë, kur një profesionist kontabël synon të përdorë rezultatit e teknologjisë përfshijnë:

- Natyrën e aktivitetit që do të kryhet nga teknologjia.
- Përdorimin e pritshëm ose shtrirjen e mbështetjes në rezultatin (outputin) e teknologjisë.
- Faktin nëse kontabilisti ka aftësinë, apo ka akses tek një ekspert me aftësinë për të kuptuar, përdorur dhe shpjeguar teknologjinë dhe përshtatshmërinë e saj për qëllimin e synuar.
- Faktin nëse teknologjia e përdorur është testuar dhe vlerësuar në mënyrë të përshtatshme për qëllimin e synuar.
- Përvojën e mëparshme me teknologjinë dhe nëse përdorimi i saj për qëllimet specifike është përgjithësisht i pranuar.
- Mbikëqyrjen nga organizata punëdhënëse e projektimit, zhvillimit, zbatimit, funksionimit, mirëmbajtjes, monitorimit, azhurnimit ose përditësimit të teknologjisë.
- Kontrollët që kanë të bëjnë me përdorimin e teknologjisë, duke përfshirë procedurat për autorizimin e dhënies së aksesit të përdoruesit për teknologjisë dhe mbikëqyrjen e këtij përdorimi.
- Përshtatshmëria e inputeve për teknologjinë, duke përfshirë të dhënat dhe çdo vendim të lidhur me të, dhe vendimet e marra nga individët gjatë përdorimit të teknologjisë.

[Paragrafi K220.8 deri më 220.11 A3 do të rinumërohet në paragrafët K220.9 deri më 220.12 A3]

...

Konsiderata të tjera

[Pas paragrafit 220.12 A3 do të shtohet paragrafi 220.12 A4]

220.12 A4 Kur një profesionist kontabël mendon të përdorë punën e të tjerëve apo rezultatet e teknologjisë, ai duhet të vlerësojë faktin nëse brenda organizatës punëdhënëse, ndodhet në një pozicion që i jep mundësinë të marre informacione për faktorët e nevojshëm për të përcaktuar nëse një përdorim i tillë është i përshtatshëm.

...

SEKSIONI 260

REAGIMI NDAJ PAPAJTUESHMERISE ME LIGJET DHE RREGULLAT

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

...

Përgjegjësitë e profesionisteve kontabël në biznes në pozicione të larta (Senior)

...

Përcaktimi në se ka nevojë për veprime të mëtejshme

...

Përcaktimi nëse duhet të zbulojë çështjen tek një autoritet i duhur

[Paragrafët ekzistues K260.21 deri K260.22 zëvendësohen me paragrafët K260.21 deri në K260.22, si më poshtë.]

K260.21 Nëse profesionisti kontabël në një pozicion të larte (senior) përcakton se zbulimi i çështjes tek një autoriteti të duhur është një mënyrë e përshtatshme veprimi për rrethanat, një zbulim i tillë i informacioneve është i lejuar sipas paragrafit K114.3 të Kodit. Kur bën një zbulim të tillë, profesionisti do të veprojë me mirëbesim dhe të tregojë kujdes kur bën deklarata dhe pohime.

Shkelje e afërt

K260.22 Në rrethana të përjashtimore, profesionisti kontabël në një pozicion të larte (senior) mund të vihet në dijeni për sjelljen aktuale ose të synuar që ai ka arsye të besojë se do të përbënte një shkelje të afërt të një ligji apo rregulli, e cila do të shkaktoje dëme të mëdha për investitorët, kreditorët, punonjësit apo publikun e gjerë. Pasi me pare ka vlerësuar nëse do të ishte e përshtatshme që çështja të diskutohej me menaxhimin apo me personat e ngarkuar me qeverisjen e organizatës punëdhënëse, kontabilisti do të ushtrojë gjykimin profesional dhe do të përcaktojë nëse do të zbulojë çështjen menjëherë tek një autoritet i duhur, në mënyrë që të parandalojë ose të zvogëlojë pasojat e një shkeljeje të tillë të afërt. Nëse ky zbulim i informacioni ka ndodhur, ky zbulim lejohet në bazë të paragrafit K114.3 të Kodit.

...

Përgjegjësitë e profesionistëve kontabël të ndryshëm nga profesionistët kontabël në pozicion të larte (senior)

[Paragrafi ekzistues R260.26 do të zëvendësohet nga paragrafi R260.26 më poshtë.]

K260.26 Në rrethana përjashtimore, profesionisti kontabël mund të përcaktojë se zbulimi i çështjes ndaj një autoriteti të duhur është një kurs i përshtatshëm veprimi. Nëse kontabilisti e bën këtë në bazë të paragrafëve 260.20 A2 dhe

A3, ky zbulim lejohet sipas paragrafit K114.3 të Kodit. Kur bën një zbulim të tillë, profesionisti kontabël duhet të veprojë me mirëbesim dhe të tregojë kujdes kur bën deklarata dhe pohime.

PJESA 3 – PROFESIONISTET KONTABËL në PRAKTIKEN PUBLIKE

SEKSIONI 300

ZBATIMI I KUADRIT KONCEPTUAL – PROFESIONISTET KONTABEL në PRAKTIKEN PUBLIKE

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Te përgjithshme

[Pas paragrafit 300.5 A1 do të shtohet paragrafi 300.5 A2.]

300.5 A2 Sa më i lartë të jetë pozicioni i një profesionisti kontabël, aq më e madhe do të jetë aftësia dhe mundësia e tij për të patur akses në informacion, dhe për të ndikuar në politikat, vendimet e marra dhe veprimet e ndërmarra nga të tjerët e përfshirë në firmë. Deri në shkallen që ata janë në gjendje ta bëjnë këtë gjë, nisur nga pozita dhe vjetërsia e tyre në firmë, profesionistët kontabël priten të inkurajojnë dhe promovojnë në firmën e tyre, një kulturë të bazuar në etikë dhe të shfaqin sjellje etike në marrëdhëniet me individët dhe entitetet me të cilat, kontabilisti ose firma e tij ka një marrëdhënie profesionale ose biznesi në përputhje me paragrafin 120.13 A3. Shembuj të veprimeve që mund të ndërmerren përfshijnë futjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e:

- Programeve të edukimit dhe trajnimit në çështje të etikës.
- Proceseve të menaxhimit dhe kriterëve të vlerësimit të performancës dhe shpërblimit, të cilat nxisin një kulturë etike.
- Politikave të etikes dhe të paralajmërimeve të shkeljeve
- Politikave dhe procedurave të hartuara për të parandaluar shkeljet e ligjeve dhe rregullave.

Identifikimi i kërcënimeve

[Pas paragrafit 300.6 A1 do të shtohet Paragrafi 300.6 A2 së bashku me titullin si më poshtë.]

Identifikimi i kërcënimeve që shoqërojnë përdorimin e teknologjisë

300.6 A2 Më poshtë janë shembuj të fakteve dhe rrethanave që lidhen me përdorimin e teknologjisë, të cilat për një profesionist kontabël, kur ai ndërmerr një aktivitet profesional, mund të krijojnë kërcënime:

- Kërcënimet e interesit vetjak
 - Të dhënat e disponueshme mund të mos jenë të mjaftueshme për përdorimin efektiv të teknologjisë.
 - Teknologjia mund të mos jetë e përshtatshme për qëllimin për të cilin duhet përdorur.
 - Kontabilisti mund të mos ketë informacionin dhe ekspertizën e mjaftueshme, ose i mungon aksesit tek një ekspert me kuptim të mjaftueshëm, për të përdorur dhe shpjeguar teknologjinë dhe përshtatshmërinë e saj për qëllimin e synuar.

(Ref: Para. 230.2).

- Kërcënimet e vetë rishikimit
 - Teknologjia u projektua ose u zhvillua duke përdorur njohuritë, ekspertizën ose gjykimin e kontabilistit ose organizatës së tij punëdhënëse.

....

Vlerësimi i kërcënimeve

[Pas paragrafit 300.7 A5 do të shtohet paragrafi 300.7 A6.]

300.7 A6 Vlerësimi nga profesionistit kontabël i nivelit të një kërcënimi që lidhet me përdorimin e teknologjisë mund të ndikohet edhe nga mjedisi i punës brenda organizatës punëdhënëse dhe mjedisi i saj i operimit. Për shembull:

- Niveli i mbikëqyrjes së korporatës dhe kontrollet e brendshme mbi teknologjinë.
- Vlerësimet e cilësisë dhe funksionalitetit të teknologjisë, që ndërmerren nga një palë e tretë.
- Trajnimi që jepet rregullisht për të gjithë punonjësit përkatës, në mënyrë që ata të arrijnë dhe të mbajnë kompetencën profesionale për të kuptuar, përdorur dhe shpjeguar mjaftueshëm teknologjinë dhe përshtatshmërinë e saj për qëllimin e synuar.

[Paragrafët ekzistues 300.7 A6 deri 300.7 A7 do të rinumërohen në paragrafët 300.7 A7 deri në 300.7 A8.]

...

SEKSIONI 320

EMËRIMET PROFESIONALE

...

[Paragrafët ekzistues R320.10 deri 320.10 A1 do të zëvendësohen nga paragrafët R320.10 deri 320.10 A1, si më poshtë.]

Përdorimi i punës se një eksperti

K320.10 Kur një profesionist kontabël synon të përdorë punën e një eksperti gjatë kryerjes së një veprimtarie profesionale, ai duhet të vlerësojë nëse përdorimi është i përshtatshëm për qëllimin e synuar.

320.11 A1 Faktorët që duhet të mbahen parasysh, kur një profesionist kontabël synon të përdorë punën e një eksperti, përfshijnë:

- Reputacionin dhe ekspertizën e ekspertit dhe burimet që ka në dispozicion.
- Faktin nëse eksperti i nënshtrohet detyrimit të respektimit të standardeve të zbatueshme profesionale dhe të etikës.

Këto informacione mund të jenë marre nga lidhja e mëparshme e ekspertit ose nga konsultimi i të tjerët.

[Pas paragrafit 320.10 A1. do të shtohet paragrafi R320.11 deri më 320.12 A1]

Përdorimi i rezultatit të teknologjisë Kur një profesionist kontabël gjatë kryerjes se një veprimtarie profesionale synon të përdorë rezultatin (outputin) e teknologjisë, ai duhet të vlerësojë nëse përdorimi është i përshtatshëm për qëllimin e synuar.

320.11 A1 Faktorët që duhet të mbahen parasysh kur një profesionist kontabël synon të përdorë rezultatin e teknologjisë, përfshijnë:

- Natyrën e aktivitetit që do të kryhet me anën e teknologjisë.
- Përdorimin i pritshëm ose shtrirjen e mbështetjes në rezultatin e teknologjisë.
- faktin nëse profesionisti kontabël ka aftësinë, apo aksesin tek një ekspert me aftësinë për të kuptuar, përdorur dhe shpjeguar teknologjinë dhe përshtatshmërinë e saj për qëllimin e synuar.
- Faktin nëse teknologjia e përdorur është testuar dhe vlerësuar në mënyrë të përshtatshme për qëllimin e synuar.
- Përvojën e mëparshme me teknologjinë dhe nëse përdorimi i saj

- për qëllime specifike është përgjithësisht i pranuar.
- Mbikëqyrjen e firmës mbi projektimin, zhvillimin, zbatimin, operimin, mirëmbajtjen, monitorimin, azhurnimin ose përditësimin e teknologjisë.
 - Kontrollat që kanë të bëjnë me përdorimin e teknologjisë, përfshirë procedurat për autorizimin e aksesit të përdoruesit në teknologji dhe mbikëqyrjen e këtij përdorimi
- Përshtatshmëria e inputeve për teknologjinë, përfshirë të dhënat dhe çdo vendim të lidhur me të, dhe vendimet e marra nga individët në rrjedhën e përdorimit të teknologjisë.

Konsiderata të tjera

- 320.12 A1 Kur një profesionist kontabël mendon të përdorë punën e ekspertëve apo rezultatet e teknologjisë, ai duhet të mbaje parasysh edhe faktin nëse ai është në një pozicion brenda firmës, ku mund të marrë informacione në lidhje me faktorët e nevojshëm për të përcaktuar nëse një përdorim i tillë është i përshtatshëm

SEKSIONI 360

REAGIMI NDAJ PAPAJTUESHMERIVE ME LIGJET DHE RREGULLAT

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

...

Auditimet e pasqyrave financiare

...

Përcaktimi nëse ka nevojë për veprime të mëtejshme

...

Përcaktimi nëse duhet t'ia zbulojë çështjen një autoriteti të përshtatshëm

[Paragrafët ekzistues R360.26 deri R360.27 do të zëvendësohen nga paragrafi R360.26 deri në R360.27 më poshtë.]

K360.26 Nëse profesionisti kontabël përcakton se zbulimi apo dhënia e informacionit në lidhje me papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar, tek një autoritet i duhur, është një drejtim veprimi i përshtatshëm për rrethanat, një zbulim i tillë është i lejuar sipas paragrafit K114.3 të Kodit. Kur bën një zbulim të tillë, profesionisti kontabël do të veprojë me mirëbesim dhe të tregojë kujdes kur bën deklarata dhe pohime. Kontabilisti, gjithashtu do të vlerësojë, përpara se të bëjë të ditur çështjen, nëse është e përshtatshme të informojë klientin për qëllimet e tij.

Shkelje e menjëhershme

K360.27 Në rrethana përjashtimor, profesionisti kontabël mund vihet në dijeni të sjelljes faktike ose të synuar, që ai ka arsye të besojë se do të përbënin një shkelje të menjëhershme të një ligji apo rregulli, e cila do të shkaktonte dëme të mëdha ndaj investitorëve, kreditorëve, punonjësve apo publikut të gjerë. Pasi ka shqyrtuar me pare, nëse do të ishte e përshtatshme të diskutohej çështja me menaxhimin apo personat e ngarkuar me qeverisjen e entitetit, kontabilisti do të ushtrojë gjykimin profesional dhe të përcaktojë nëse duhet të zbulojë çështjen menjëherë të një autoriteti i duhur, në mënyrë që të parandalojë apo të zvogëlojë pasojat e një shkeljeje të tillë të menjëhershme. Nëse ky informim është bere, ai është i lejuar në bazë të paragrafit K114.3 të Kodit..

Shërbime profesionale përveç auditimeve të pasqyrave financiare

Vlerësimi nëse nevojiten veprime të mëtejshme

[Paragrafët ekzistues R360.37 deri R360.38 do të zëvendësohen nga paragrafët R360.37 deri në R360.38 më poshtë.]

K360.7 Nëse profesionisti kontabël përcakton se zbulimi apo dhënia e informacionit në lidhje me papajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e dyshuar, tek një autoritet i duhur, është një drejtim veprimi i përshtatshëm për rrethanat, një zbulim i tillë është i lejuar sipas paragrafit K114.3 të Kodit. Kur bën një zbulim të tillë, profesionisti kontabël do të veprojë me mirëbesim dhe të tregojë kujdes kur bën deklarata dhe pohime. Kontabilisti, gjithashtu do të vlerësojë, përpara se të bëjë të ditur çështjen, nëse është e përshtatshme të informojë klientin për qëllimet e tij.

Shkelje e menjëhershme

Në rrethana përjashtimore, profesionisti kontabël mund vihet në dijeni të sjelljes faktike ose të synuar, që ai ka arsye të besojë se do të përbënin një shkelje të menjëhershme të një ligji apo rregulli, e cila do të shkaktonte dëme të mëdha ndaj investitorëve, kreditorëve, punonjësve apo publikut të gjerë. Pasi ka shqyrtuar me pare, nëse do të ishte e përshtatshme të diskutohej çështja me menaxhimin apo personat e ngarkuar me qeverisjen e entitetit, kontabilisti do të ushtrojë gjykimin profesional dhe të përcaktojë nëse duhet të zbulojë çështjen menjëherë të një autoriteti i duhur, në mënyrë që të parandalojë apo të zvogëlojë pasojat e një shkeljeje të tillë të menjëhershme. Nëse ky informim është bere, ai është i lejuar në bazë të paragrafit K114.3 të Kodit.

STANDARDET NDËRKOMBËTARE të PAVARËSISË

(PJESËT 4AA DHE 4B)

Pjesa 4A – pavarësia për Auditimet dhe angazhimet e rishikimit

SEKSIONI 400

ZBATIMI I KUADRIT KONCEPTUAL PRE PAVARËSINË PËR AUDITIMET DHE ANGAZHIMET E RISHIKIMIT

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

...

Ndalimi i marrjes përsipër të përgjegjësive të menaxhimit

[Pas paragrafit R400.21 do të shtohet paragrafi 400.21 A1.]

400.21 A1 Kur, në kryerjen e një aktiviteti profesional për një klient auditimi, përdoret teknologjia, zbatohen kërkesat në paragrafët K400.20 dhe K400.21 pavarësisht nga natyra apo shtrirja e këtij përdorimit të teknologjisë.

SEKSIONI 520

MARRËDHËNIET E BIZNESIT

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

[Paragrafi ekzistues 520.3 A2 do të zëvendësohet nga paragrafi 520.3 A2, më poshtë.]

520.3 A3 Shembuj të një marrëdhënieje të ngushtë biznesi që vjen nga një marrëdhënie tregtare ose interesi financiar të përbashkët përfshijnë:

- Ekzistencën e një interesi financiar në një ndërmarrje të përbashkët me klientin ose me një pronar kontrollues, drejtor, zyrtar ose me një individ tjetër që kryen veprimtari menaxheriale të larta për këtë klient.
- Marrëveshjet për të kombinuar një ose më shumë shërbime ose produkte të firmës ose të një firme rrjeti me një ose më shumë shërbime ose produkte të klientit dhe për të tregtuar paketën duke iu referuar të dyja palëve.
- Marrëveshjet sipas të cilave firma ose një firmë rrjeti shet, rishet, shpërndan ose tregton produktet ose shërbimet e klientit, ose klienti shet, rishet, shpërndan ose tregton produktet ose shërbimet e firmës apo të një firme rrjeti.
- Marrëveshjet sipas të cilave firma ose një firmë rrjeti zhvillohen së bashku me klientin, produktet apo zgjidhjet, të cilat njëra ose të dyja palët i shesin ose i licencojnë pe palë të treta.

[Pas paragrafit 520.3 A2 do të shtohet paragrafi 520.3 A3.]

520.3 A3 Një shembull që mund të krijonte një marrëdhënie të ngushtë biznesi, në varësi të fakteve dhe rrethanave, është një marrëveshje sipas së cilës, firma ose një firmë rrjeti licencon produktet ose zgjidhjet për apo nga një klient.

...

Blerja e mallrave ose shërbimeve

[Paragrafi ekzistues 520.6 A1 do të zëvendësohet nga paragrafi 520.6 A1 më poshtë.]

520.6 A1 Blerja e mallrave dhe shërbimeve, përfshirë licencimin e teknologjisë nga një klient i auditimit prej një firmë, një firmë rrjeti, një anëtar i ekipit të auditimit, apo ndonjë nga familja e afërt të këtij individi, zakonisht nuk krijon një kërcënim për pavarësinë, nëse transaksioni është në rrjedhën normale të biznesit dhe në kushtet e tregut. Megjithatë, këto transaksione mund të jenë të një natyre dhe madhësie të tillë, që ato të krijojnë një kërcënim për interesin vetjak.

[Pas paragrafit 520.6 A2, do të shtohet se bashku me titullin paragrafi 520.7 A1]

Dhënia, shitja, rishitja ose licencimi i teknologjisë

520.7 A1 Kur një firmë ose një firmë rrjeti jep, shet, rishet ose licencon teknologjinë:

- (a) Për një klient të auditimit
- (b) Për një entitet që jep shërbime, duke përdorur një teknologji të tillë, për klientët e auditimit të firmës ose firmës së rrjetit,

në varësi të fakteve dhe rrethanave, zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim në seksionin 600.

...

SEKSIONI 600

DHËNIA E SHËRBIME të JO-SIGURISË PËR NJË KLIENT të AUDITIMIT

Hyrje

[Paragrafi 600.6 që do të shtohet pas paragrafit 600.5.]

600.6 Kërkesat dhe materiali për zbatim në këtë seksion zbatohen kur një firmë ose një firmë rrjeti:

- (a) Përdor teknologjinë për të dhënë një shërbim të jo-sigurisë për një klient të auditimit
- (b) Jep, shet, rishet ose licencon teknologjinë që rezulton në dhënien e një shërbimi të jo-sigurisë nga firma ose një firmë rrjeti:
 - (i) për një klient të auditimit;
 - (ii) për një entiteti që jep shërbime duke përdorur një teknologji të tillë për të audituar klientët e firmës ose firmës së rrjetit.

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Te përgjithshme

Dhënësit e shërbimeve të jo-sigurisë në ligje apo rregulla

[Paragrafi ekzistues 600.6 A1 deri 600.8 do të rinumërohet në paragrafin 600.7 A1 deri në 600.9]

...

Identifikimi dhe vlerësimi i kërcënimeve

Te gjithë klientët e auditimit

[Paragrafi ekzistues 600.9 A1 do të rinumërohet në paragrafin 600.10 A1. Paragrafi ekzistues 600.9 A2 do të zëvendësohet nga paragrafi 600.10 A2 më poshtë.]

600.10 A2 Faktorët që janë të përshtatshëm për identifikimin e kërcënimeve të ndryshme, të cilët mund të krijohen nga dhënia e një shërbimi të jo-sigurisë për një klient të auditimit, dhe për të vlerësuar nivelin e këtyre kërcënimeve përfshijnë:

- Natyrën, objektin, përdorimin e synuar dhe qëllimin e shërbimit.

- Mënyrën e dhënies së shërbimit, si për shembull, personeli që do të përfshihet dhe vendndodhjen e tyre.
- Varësinë e klientit nga shërbimi, përfshirë frekuencën e dhënies së shërbimit.
- Mjedisin ligjor dhe rregullator në të cilin jepet shërbimi.
- Faktin nëse klienti është një entitet me interes publik.
- Nivelin e ekspertizës së drejtuesve dhe punonjësve të klientit në lidhje me llojin e shërbimit të dhënë.
- Shkallen deri në të cilën klienti vendos për çështje të rëndësishme të gjyqimit. (Ref: Para. K400.20 deri K400.21).
- Faktin nëse rezultati i shërbimit do të ndikojë në regjistrimet kontabël apo çështjet e reflektuara në pasqyrat financiare mbi të cilat firma do të shprehë një opinion dhe, nëse është kështu, shkalla:
 - në të cilën rezultati i shërbimit do të ketë një efekt material në pasqyrat financiare.
 - e subjektivitetit në përcaktimin e shumave ose trajtimit të duhur për këto çështje të reflektuara në pasqyrat financiare.
- Natyrën dhe shkallen e ndikimit të shërbimit, nëse ka, në sistemet që gjenerojnë informacionin, i cili formon një pjesë të konsiderueshme të
 - Regjistrimeve kontabël të klientit ose të pasqyrave financiare mbi të cilat firma do të shprehë një opinion.
 - Kontrolleve të brendshme mbi raportimin financiar.
- Shkallen e mbështetjes që do të vendoset në rezultatin e shërbimit si pjesë e auditimit.

Tarifën në lidhje me dhënien e shërbimit të jo-sigurisë.

[Paragrafët ekzistues 600.9 A3 deri 600.27 A1 do të rinumërohen në paragrafin 600.10 A3 deri 600.28 A1]

NËN SEKSIONI 601 – SHËRBIMET E REGJISTRIMIT DHE MBAJTJES SE KONTABILITETIT

Hyrje

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

...

Klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik

[Pas paragrafit 601.5 A1 do të shtohet paragrafi 601.5 A2.]

601.5 A2 Shërbimet e regjistrimit dhe të mbajtjes se kontabilitetit mund të jenë manuale ose të automatizuara. Për të përcaktuar nëse një shërbim i automatizuar është rutinë apo mekanik, duhet të merren në konsideratë faktorë të tilla si aktivitetet e kryera nga teknologjia dhe rezultatet e saj dhe fakti nëse teknologjia jep një shërbim të automatizuar që bazohet ose kërkon ekspertizën apo gjykimin e firmës apo firmës së rrjetit.

[Paragrafi ekzistues 601.5 A2 do të rinumërohet dhe zëvendësohet nga paragrafi 601.5 A3 më poshtë.]

601.5 A3 Shembuj të shërbimeve, qofshin ato manuale apo të automatizuara, që mund të konsiderohen si rutinë ose mekanike, përfshijnë:

- Kryerjen e llogaritjeve të pagave apo raporteve bazuar në të dhënat e origjinuara nga klienti, për t'u miratuar dhe paguar nga klienti.
- Regjistrimin e transaksioneve të përsëritura për të cilat shumat janë lehtësisht të përcaktueshme nga dokumentet baze ose nga të dhënat e origjinës, si një faturë utilitare ku klienti ka përcaktuar ose miratuar klasifikimin e duhur të llogarisë.
- Llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve afatgjata materiale kur klienti përcakton politikën e kontabilitetit dhe bën vlerësimin me çmuarje të jetës së dobishme dhe vlerave të mbetura të aktiveve në fund të jetës së tyre.
- Postimin e transaksioneve të koduara nga klienti në ditarin e madh
- Postimin e hyrjeve të miratuara nga klienti në bilancin vërtetues.
- Përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në informacionin në bilancin vërtetues të miratuar nga klienti dhe përgatitjen e shënimeve shpjeguese bazuar në regjistrat e miratuar nga klienti.

Firma ose një firmë rrjeti mund të japë këto shërbime për klientët e

auditimit që nuk janë entitete me interes publik, me kusht që firma ose firma e rjetit të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit K400.21 për të siguruar se ajo nuk merr një përgjegjësi menaxhimi në lidhje me shërbimin dhe me kërkesën në paragrafin K601.5 (b)

[Paragrafi ekzistues 601.5 A3 do të rinumërohet në 601.5 A4]

...
NËN SEKSIONI 606 – SHËRBIMET E SISTEMEVE të TEKNOLOGJISË SE INFORMACIONIT

Hyrje

....

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Përshkrimi i shërbimit

[Pas paragrafit 606.1 do të shtohet paragrafi 606.2 A1.]

606.2 A2 Shërbimet e sistemeve të TI-se përfshijnë një gamë të gjerë shërbimesh, ku mund të përmenden:

- Projektimi ose zhvillimi i sistemeve të TI-se hardware ose software.
- Zbatimi i sistemeve të TI-se, duke përfshirë instalimin, konfigurimin, ndërveprimin ose personalizimin.
- Operimi, mirëmbajtja, monitorimi, azhurnimi ose përmirësimi i sistemeve të TI- së. •
- Mbledhja ose ruajtja e të dhënave apo menaxhimi (drejtpërdrejt ose tërthorazi) i hostimit të të dhënave.

[Paragrafi ekzistues 606.2 A1 do të rinumërohet dhe zëvendësohet nga paragrafi 606.2 A2 më poshtë.]

606.2 A2 Sistemet e TI-së mund të:

- (a) Agregojë të dhënat baze
- (b) Formojnë pjesë të kontrollit të brendshëm mbi raportimin financiar;
- (c) Gjenerojnë informacione që ndikojnë në regjistrimet kontabël ose në pasqyrat financiare, duke përfshirë informacionet në shënimet shpjeguese

Megjithatë, sistemet e TI-se mund të përfshijnë edhe çështje që nuk kanë lidhje me regjistrimet kontabël të klientit të auditimit ose me kontrollin e brendshëm mbi raportimin financiar apo pasqyrat financiare.

Rreziku i marrjes përsipër të përgjegjësisë së menaxhimit kur jepet një shërbim i sistemeve të TI-së

[Paragrafi ekzistues R606.3 do të zëvendësohet nga paragrafi R606.3 më poshtë.]

K606.3 Paragrafi K400.20 përjashton një firmë ose një firmë rrjeti të marre përsipër një përgjegjësi të menaxhimit. Kur jep shërbime të sistemeve I-se për një klient të auditimit, firma ose firma e rrjetit duhet të krijojë bindjen që:

- (a) Klienti pranon përgjegjësinë e tij për ngritjen dhe monitorimin e një sistemi të kontroleve të brendshme;
- (b) Klienti, nëpërmjet një individi (ose individësh) kompetent, preferohet brenda drejtimit të lartë, merr të gjitha vendimet e menaxhimit që janë përgjegjësi e duhur e menaxhimit në lidhje me projektimin, zhvillimin, zbatimin, funksionimin, mirëmbajtjen, monitorimin, azhurnimin ose përmirësimin e sistemeve të TI-së;
- (c) Klienti vlerëson përshtatshmërinë dhe rezultatet e projektimit, zhvillimit, zbatimit, funksionimit, mirëmbajtjes, monitorimit, azhurnimit ose përmirësimit të sistemit të TI-se;

Klienti është përgjegjës për funksionimin e sistemit të TI-se dhe për të dhënat që ai gjeneron dhe përdor.

[Pas paragrafit R606.3. do të shtohen paragrafët 606.3 A1 deri 606.3 A2]

606.3 A1 Shembuj të shërbimeve të sistemeve të TI-se, të cilat rezultojnë në marrjen përsipër të një përgjegjësie të menaxhimit përfshijnë rastet, kur një firmë ose një firmë rrjeti:

- Ruan të dhënat ose administron (drejtpërdrejt ose tërthorazi) hostimin e të dhënave në emër të klientit të auditimit. Këto shërbime përfshijnë:
 - Veprimin si i vetmi akses në një sistem të informacionit financiar ose jo financiar të klientit të auditimit.
 - Marrjen e kujdestarisë ose ruajtjen e të dhënave ose regjistrave të klientit të auditimit, në mënyrë që të dhënat ose regjistrat e klientit të auditimit, përndryshe, të jenë jo të plota
 - Dhënien e shërbimeve elektronike të sigurisë ose back-up, të tilla si vazhdimësia e biznesit ose një funksion i rimëkëmbjes së dëmtimeve të sistemit, për të dhënat ose regjistrat e klientit të auditimit.

Operimin, mirëmbajtjen ose monitorimin e sistemeve, rrjetin ose faqen e internetit të klientit të auditimit.

606.3 A2 Mbledhja, marrja, transmetimi dhe ruajtja e të dhënave të ofruara nga një klient i auditimit gjatë një auditimi ose për të mundësuar dhënien e një

shërbimi të lejuar për klientin nuk rezulton në një marrje përsipër të përgjegjësisë së menaxhimit.

Kërcënimet e mundshme që vijnë nga dhënia e shërbimeve të sistemeve të TI-se

Te gjithë klientët e auditimit

[Paragrafi ekzistues 606.4 A2 do të hiqet. Paragrafët ekzistues 606.4 A3 do të rinumërohen në paragrafin 606.4 A2.]

[Paragrafi 606.4 A3 do të shtohet pas rinumërimit të paragrafit 606.4 A2.]

606.4 A3 Shembuj të shërbimeve të sistemeve të TI-se që krijojnë një kërcënim të vetë rishikimit kur ato formojnë pjesë ose ndikojnë në regjistrimet kontabël të një klienti të auditimit ose në sistemin e kontrollit të brendshëm mbi raportimin financiar përfshijnë:

- Hartimin, zhvillimin, zbatimin, operimin, mirëmbajtjen, monitorimin, azhurnimin ose përmirësimin e sistemeve të TI- së, përfshirë ato që lidhen me sigurinë kibernetike.
- Mbështetjen e sistemeve të TI-se të një klienti të auditimit, përfshirë aplikacionet e rrjetit dhe softuerit.

Zbatimin e softuerit të kontabilitetit dhe të raportimit të informacionit financiar, pavarësisht nëse është zhvilluar apo jo nga firma apo një firmë rrjeti.

Klientët e auditimit që janë entitete me interes publik

...

[Paragrafi ekzistues 606.6 A1 do të hiqet.]

PJESA 4B – PAVARËSIA PËR ANGAZHIMET E SIGURISË të NDRYSHME NGA AUDITIMI DHE ANGAZHIMET E RISHIKIMIT

SEKSIONI 900

ZBATIMI I KUADRIT KONCEPTUAL PËR PAVARËSINË PËR ANGAZHIMET E SIGURISË të NDRYSHME NGA AUDITIMI DHE ANGAZHIMET E RISHIKIMIT

Hyrje

Te përgjithshme

[Paragrafi ekzistues 900.1 do të zëvendësohet nga paragrafi 900.1 më poshtë.]

900.1 Kjo pjesë zbatohet për angazhimet e sigurisë, përveç angazhimeve të auditimit dhe angazhimeve të rishikimit. Shembuj të angazhimeve të tilla përfshijnë:

- Siguria mbi treguesit kryesorë të performancës së një entiteti.
- Siguria mbi pajtueshmërinë e një entiteti me ligjin dhe rregullin
- Siguria mbi kriteret e performancës, siç është vlera e parasë, e arritur nga një organ i sektorit publik.
- Siguria mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të një entiteti.
- Siguria mbi informacionin jo financiar të një entiteti , për shembull informacionet mbi mjedisin, aspektet sociale dhe të qeverisjes, përfshirë edhe pasqyrën e emetimit të gazrave sere

Një auditim i elementeve, llogarive ose zëra specifike të një pasqyre financiare.

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Ndalimi i marrjes përsipër të përgjegjësi të menaxhimit

[Pas paragrafit 900.13 A3 do të shtohen paragrafët 900.13 A4 deri 900.13 A5.]

900.13 A4 Shembuj të shërbimeve të sistemeve të TI-së që rezultojnë në marrjen përsipër të një përgjegjësie të menaxhimit në lidhje me çështjen në fjalë që shqyrtohet dhe, në një angazhim për të vërtetuar, informacionin e çështjes në fjalë të një angazhimi të sigurisë, përfshijnë rastet kur një firmë:

- Ruan të
- dhënat ose administron (drejtpërdrejt ose tërthorazi) hostimin e të

dhënave që lidhen me çështjen në fjalë ose informacionin për çështjen në fjalë. Shërbime të tilla përfshijnë:

- Ruan të dhënat ose administron (drejtpërdrejt ose tërthorazi) hostimin e të dhënave në emër të klientit të auditimit. Këto shërbime përfshijnë:
 - Veprimin si i vetmi akses në të dhënat ose regjistrimet në lidhje me një çështje në fjalë në shqyrtim dhe informacionin për çështjen në fjalë.
 - Marrjen e kujdestarisë ose ruajtjen e të dhënave ose regjistrave të një çështje në fjalë në shqyrtim dhe informacionin për çështjen në fjalë, në mënyrë që të dhënat ose regjistrat e klientit të sigurisë, përndryshe, të jenë jo të plota
 - Dhënien e shërbimeve elektronike të sigurisë ose back-up, të tilla si vazhdimësia e biznesit ose një funksion i rimëkëmbjes së dëmtimeve të sistemit, për të dhënat ose regjistrat e klientit të sigurisë lidhur me çështje në fjalë ose informacionin për çështjen në fjalë.
 - Operimin, mirëmbajtjen ose monitorimin e sistemeve, rrjetin ose faqen e internetit të klientit të sigurisë në lidhje me çështje në fjalë ose informacionin për çështjen në fjalë.

900.13 A5 Mbledhja, marrja, transmetimi dhe ruajtja e të dhënave të ofruara nga një klient sigurie gjatë një angazhimi të sigurisë ose për të mundësuar dhënien e një shërbimi të lejuar të jo-sigurisë për klientin e sigurisë nuk rezulton në një marrje përsipër të përgjegjësisë së menaxhimit.

[Paragrafi ekzistues 900.13 A4 do të rinumërohet paragrafi 900.13 A6.]

[Pas paragrafit K900.14 do të shtohet paragrafi 900.14 A1.]

900.14 A1 Kur në kryerjen e një aktiviteti profesional për një klient të sigurisë, përdoret teknologjia, zbatohen kërkesat në paragrafët R900.13 dhe R900.14 pavarësisht nga natyra apo shtrirja e përdorimit të teknologjisë.

SEKSIONI 920

MARRËDHËNIET E BIZNESIT

...

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Te përgjithshme

[Paragrafi ekzistues 920.3 A2 do të zëvendësohet nga paragrafi 920.3 A2 më poshtë.]

920.3 A2 Shembuj të një marrëdhënie të ngushtë biznesi që vjen nga një marrëdhënie tregtare ose interesi i përbashkët financiar, përfshijnë:

- Ekzistencën e një interesi financiar në një ndërmarrje të përbashkët me klientin e sigurisë ose me një pronar kontrollues, drejtor ose zyrtar ose me një individ tjetër që kryen veprimtari të larta menaxheriale për këtë klient.
- Marrëveshjet për të kombinuar një ose më shumë shërbime ose produkte të firmës me një ose më shumë shërbime ose produkte të klientit dhe për të tregtuar paketën duke iu referuar të dyja palëve.
- Rregullimet sipas të cilave firma shet, rishet, shpërndan ose tregton produktet apo shërbimet e klientit, ose klienti shet, rishet, shpërndan apo tregton produktet ose shërbimet e firmës.
- Marrëveshjet sipas të cilave një firmë zhvillon së bashku me klientin, produktet ose zgjidhjet të cilat njëra ose të dyja palët i shesin ose i licencojnë për palët e treta.

[Pas paragrafit 920.3 A2 do të shtohet paragrafi 920.3 A3.]

920.3 A3 Një shembull që mund të krijonte një marrëdhënie të ngushtë biznesi, në varësi të fakteve dhe rrethanave, është një marrëveshje sipas së cilës firma licencon produktet ose zgjidhjet për ose nga klienti i sigurisë

Blerja e mallrave dhe shërbimeve

[Paragrafi ekzistues 920.5 A1 do të zëvendësohet nga paragrafi 920.5 A1 më poshtë.]

920.5 A1 Blerja e mallrave dhe shërbimeve, përfshirë licencimin e teknologjisë nga një klient i sigurisë për një firmë, ose një anëtar të ekipit të sigurisë, ose ndonjë nga familjar i afërt i këtij individ, zakonisht nuk krijon një kërcënim për pavarësinë, nëse transaksioni kryhen në rrjedhën normale të biznesit dhe në kushtet e tregut. Megjithatë, këto transaksione, mund të jenë të një natyre dhe madhësie të tillë, që krijojnë një kërcënim të interesin vetjak (egoizmit).

[Pas paragrafit 920.5 A2, do të shtohet paragrafi 920.6 A1 së bashku me titullin.]

Dhënia, shitja, rishitja ose licencimi i teknologjisë

920.6 A1 Kur një firmë jep, shet, rishet ose licencon teknologjinë:

- (a) Për një klient të sigurisë
- (b) Për një entitet që jep shërbime, duke përdorur një teknologji të tillë, për klientët e sigurisë të firmës,

në varësi të fakteve dhe rrethanave, zbatohen kërkesat dhe materiali për zbatim në seksionin 950.

SEKSIONI 950

DHËNIA E SHËRBIMEVE të JO-SIGURISË PËR KLIENTËT E SIGURISË

...

Hyrje

[Pas paragrafit 950.4 do të shtohet paragrafi 950.5.]

- 950.5** Kërkesat dhe materiali për zbatim në këtë seksion zbatohen kur një firmë:
- (a) Përdor teknologjinë për të dhënë një shërbim të jo-sigurisë për një klient të sigurisë
 - (b) Jep, shet, rishet ose licencon teknologjinë që rezulton në dhënien e një shërbimi të jo-sigurisë nga firma:
 - (iii) për një klient të sigurisë;
- për një entiteti që jep shërbime duke përdorur një teknologji të tillë për të klientët e sigurisë të firmës

Kërkesat dhe materiali për zbatim

Te përgjithshme

Rreziku i marrjes përsipër të përgjegjësisë të menaxhimit kur jepet një shërbim i jo-sigurisë

[Paragrafi ekzistues 950.5 A1 në paragrafin R950.6 do të rinumërohet në paragrafin 950.6 A1 deri në R950.7]

...

Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve

[Paragrafi ekzistues 950.7 A1 do të rinumërohet në paragrafin 950.8 A1. Paragrafi ekzistues 950.7 A2 do të rinumërohet dhe zëvendësohet nga paragrafi 950.8 A2 më poshtë.]

- 950.7 A2** Faktorët që janë të përshtatshëm për identifikimin e kërcënimeve të ndryshme, të cilët mund të krijohen nga dhënia e një shërbimi të jo-sigurisë për një klient të sigurisë, përfshijnë:

- Natyrën, objektin, përdorimin e synuar dhe qëllimin e shërbimit.
- Mënyrën e dhënies së shërbimit, si për shembull, personeli që do të përfshihet dhe vendndodhjen e tyre.
- Varësinë e klientit nga shërbimi, përfshirë frekuencën e dhënies së

shërbimit.

- Mjedisin ligjor dhe rregullator në të cilin jepet shërbimi.
- Faktin nëse klienti është një entitet me interes publik.
- Nivelin e ekspertizës së drejtuesve dhe punonjësve të klientit në lidhje me llojin e shërbimit të dhënë.
- Faktin nëse rezultati i shërbimit do të ndikojë në çështjen në fjalë në shqyrtim, dhe në një angazhim për të vërtetuar, çështjet e reflektuar në informacionin për çështjen në fjalë të angazhimit të sigurisë dhe, nëse është kështu, shkalla:
 - në të cilën rezultati i shërbimit do të ketë një efekt material në çështjen në fjalë në shqyrtim, dhe në një angazhim për të vërtetuar, në informacionin për çështjen në fjalë të angazhimit të sigurisë.
 - Në të cilën klienti i sigurisë vendos për çështje të rëndësishme të gjykimit (ref. Para. K900.13 deri K900.14.
- Shkallën e mbështetjes që do të vendoset në rezultatin e shërbimit si pjesë e angazhimit të sigurisë
- Tarifën në lidhje me dhënien e shërbimit të jo-sigurisë.

Materialiteti në lidhje me informacionin e klientit të sigurisë

[Paragrafi ekzistues 950.8 A1 deri 950.9 A1 do të rinumërohet në paragrafin 950.9 A1 deri në 950.10 A1.]

...

Kërcënimet e vetë rishikimit

[Paragrafi ekzistues 950.10 A1 do të zëvendësohet nga paragrafi 950.11 A1 më poshtë.]

950.11 A1 Një kërcënim i vetë rishikimit mund të krijohet nëse, në një angazhim për të vërtetuar, firma është e përfshirë në përgatitjen e informacionit për çështjen në fjalë që më pas bëhet informacioni i çështjes në fjalë të një angazhimi të sigurisë. Shembuj të shërbimeve të jo-sigurisë, të cilat mund të krijojnë kërcënimet të tilla të vetë rishikimit lidhur me informacionin e çështjes në fjalë të një angazhimi të sigurisë, përfshijnë:

- Zhvillimin dhe përgatitjen e informacionit të mundshëm dhe më pas lëshimin e një raporti të sigurisë mbi këtë informacion.
- Kryerjen e një vlerësimi që është i lidhur me ose formon pjesë të informacionit për çështjen në fjalë të një angazhimi të sigurisë.
- Projektimin, zhvillimin, zbatimin, operimin, mirëmbajtjen, monitorimin, azhurnimin ose përditësimin e sistemeve të TI-së ose kontrolleve të TI-se dhe më pas ndërmarrja e një angazhimi të sigurisë mbi një pasqyre apo raport të përgatitur rreth sistemeve të TI-së ose

kontrolleve të TI-së.

- Projektimin, zhvillimin, zbatimin, operimin, mirëmbajtjen, monitorimin, azhurnimin ose përmirësimin e sistemeve të TI-së dhe më pas lëshimin e një raporti të sigurisë mbi informacionin e çështjes në fjalë, siç janë elementet e informacionit jo financiar, që përgatitet nga informacionet e gjeneruara nga sisteme të tilla të TI-se

Klientët e sigurisë që janë entitete me interes publik

[Paragrafi ekzistues 950.11 A1 deri 950.12 A4 do të rinumërohet në paragrafin 950.12 A1 deri më 950.13 A4.]

...

FJALORI I TERMAVE, PËRFSHIRE LISTËN E SHKURTESAVE

[Në Fjalorin e Termave do të shtohet Përkufizimi i termit “informacion konfidencial” siç është përshkrua më poshtë.]

Confidential information Informacion konfidencial. Çdo informacion, të dhëna apo materiale të tjera, në çfarëdo forme apo mediumi (përfshirë të shkruara, elektronike, vizuale ose orale) që nuk është i disponueshëm publikisht

[Përkufizimet ekzistuese të termave “parime themelore”, dhe “Testi i palës së trete të arsyeshme dhe të informuar” do të zëvendësohen me përcaktimet e përcaktuara më poshtë.]

[Përkufizimet ekzistuese të termave “parime themelore”, dhe “testi i palës së trete të informuar dhe të arsyeshme” do të zëvendësohen me përkufizimet që janë dhënë më poshtë.]

Fundamental principles Ky term përshkruhet në paragrafin 110.1 A1. Secili nga parimet themelore është, nga ana e tij, i përshkruar në paragrafët e mëposhtëm:
Integriteti R111.1
Objektiviteti R112.1
Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur R113.1
Konfidencialiteti R114.1 deri në R114.3
Sjellja profesionale R115.1

Reasonable and informed third party test Testi i palës së tretë të arsyeshme dhe të informuar është një vlerësim që behet nga profesionisti kontabël, për faktin nëse të njëjtat përfundime ka të ngjarë të arrihen nga një palë tjetër. Ky vlerësim bëhet nga këndvështrimi i një pale të tretë të arsyeshme dhe të informuar, e cila peshon të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse që kontabilisti i i njeh, ose mund të pritej në mënyrë të arsyeshme të njëjte, në kohën kur janë bërë përfundimet. Pala e tretë e arsyeshme dhe e informuar nuk ka nevojë të jetë kontabilist, por ajo do të duhej zotëronte njohuritë dhe përvojën përkatëse për të kuptuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë e përfundimeve të kontabilistit në mënyrë të paanshme. Këto terma përshkruhen në paragrafin 120.5 A9

DATA E HYRJES NË FUQI TË RISHIKIMEVE të LIDHURA ME TEKNOLOGJINË

- Rishikimet në pjesët 1 deri në 3 do të hyjnë në fuqi që nga 15 dhjetori 2024.
- Rishikimet në pjesën 4A do të hyjnë në fuqi për auditimet dhe rishikimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë me ose pas datës 15 dhjetor 2024.
- Ndryshimet konformuese dhe pasuese të pjesës 4B në lidhje me angazhimet e sigurisë për çështjet në fjalë që mbulojnë periudha kohore do të hyjnë në fuqi për periudhat që fillojnë me ose pas datës 15 dhjetor 2024; përndryshe, këto ndryshime do të hyjnë në fuqi që nga 15 dhjetori 2024.

Adoptimi i mëhershëm është i lejuar